


Inventarizimi kombëtar i strukturave dhe personelit të përkrahjes sociale në bashki pas ndarjes së re Administrativo-Territoriale



Studim i realizuar nga:
Qendra për Çështje të Informimit Publik, INFOÇIP



Rr "Todi Shkurti", P. 4, H. 21 Ap.34, Tiranë ALBANIA

E-mail: gendra@INFOÇIP.org

Web sites: www.inforcip.org

Drejtoi studimin:

Gerti Shella

Përpunimi i të dhënave dhe vizualizimi grafik

Sereta Ylli

Dritjon Selmani

Rezarta Sheshaj

Altin Aliaj

Koordinatorë rajonalë:

F. Lufo

Y. Hoxha

E. Cenolli

U realizua në kuadër të:

"Rapid National Inventory of Human Resources dealing with social protection issues in Local Government level"

Mbeshtetur nga:



*Pohimet dhe rekomandimet në këtë studim janë pikëpamjet e autorëve
dhe jo domosdoshmërisht paqyrojnë politikat apo këndvështrimin e UNICEF.*

Përmbajtja

Hyrje.....

I.	Reforma në Shërbimet e Kujdesit Social.....	5
II.	Reforma Administrativo – Territoriale.....	6
III.	Mbi organizimin e gjetjeve të studimit.....	7

Përmbledhje ekzekutive.....

1.	Pozicionet strukturore të inventarizuara.....	9
2.	Përvoja në punë e personelit.....	10
3.	Marrdhëniet e punës / statusi i punonjësit... ..	10
4.	Arsimimi i stafeve.....	12
5.	Lloji i arsimit universitar.....	13
6.	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve.....	13

Profilet e bashkive dhe inventarizimi i stafeve.....

1.	Bashkia Belsh.....	18
2.	Bashkia Berat.....	21
3.	Bashkia Bulqizë.....	24
4.	Bashkia Cërrik.....	27
5.	Bashkia Delvinë.....	30
6.	Bashkia Devoll.....	32
7.	Bashkia Peshkopi.....	35
8.	Bashkia Divjakë.....	40
9.	Bashkia Dropull.....	43
10.	Bashkia Durrës.....	46
11.	Bashkia Elbasan.....	50
12.	Bashkia Fier.....	54
13.	Bashkia Finiq.....	58
14.	Bashkia Fushë-Arrëz.....	61
15.	Bashkia Gjirokastrë.....	64
16.	Profili bashkisë Gramsh.....	67
17.	Bashkia Has.....	71
18.	Bashkia Himarë.....	74
19.	Bashkia Kamëz.....	77
20.	Bashkia Kavajë.....	80
21.	Bashkia Këlcyrë.....	83
22.	Bashkia Klos.....	86
23.	Bashkia Kolonjë.....	89
24.	Bashkia Konispol.....	92

25.	Bashkia Korçë.....	95
26.	Bashkia Krujë.....	99
27.	Bashkia Kuçovë.....	103
28.	Bashkia Kukës.....	106
29.	Bashkia Kurbin.....	110
30.	Bashkia Lezhë.....	114
31.	Bashkia Libohovë.....	118
32.	Bashkia Librazhd.....	121
33.	Bashkia Lushnjë.....	124
34.	Bashkia Malësi e Madhe.....	128
35.	Bashkia Maliq.....	132
36.	Bashkia Mallakastër.....	135
37.	Bashkia Mat.....	139
38.	Bashkia Memaliaj.....	143
39.	Bashkia Mirditë.....	146
40.	Bashkia Patos.....	150
41.	Bashkia Peqin.....	153
42.	Bashkia Përmet.....	156
43.	Bashkia Pogradec.....	159
44.	Bashkia Poliçan.....	164
45.	Bashkia Prrenjas.....	167
46.	Bashkia Pustec.....	170
47.	Bashkia Pukë.....	172
48.	Bashkia Roskovec.....	175
49.	Bashkia Shkodër.....	178
50.	Bashkia Rrogozhinë.....	182
51.	Bashkia Sarandë.....	185
52.	Bashkia Selenicë.....	187
53.	Bashkia Shijak.....	180
54.	Bashkia Skrapar.....	193
55.	Bashkia Tepelenë.....	196
56.	Bashkia Tiranë.....	199
57.	Bashkia Tropojë.....	207
58.	Bashkia Ura-Vajgurore.....	211
59.	Bashkia Vau i Dejës.....	214
60.	Bashkia Vlorë.....	218
61.	Bashkia Vorë.....	222

Lista e shkurtimeve (sipas rendit alfabetik)

DKS	Drejtoria e Kujdesit Social
DPP	Drejtoria e Politikave të Punësimit
DMSShS	Drejtoria e Menaxhimit të Strehimit dhe Shërbimit Social
DRSHSS	Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social
INFOÇIP	Qendra për Çështje të Informimit Publik
MMSR	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
NJMF	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve
NJA	Njësi Administrative
NJQV	Njësi e Qeverisjes Vendore
RAT	Reforma Administrativo-Territoriale
ShSSh	Shërbimi Social Shtetëror
ShPSH	Shërbimet e përkujdesit shoqëror
SNV	Specialist i nivelit të lartë
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak

HYRJE

I. Reforma në Shërbimet e Kujdesit Social

Që në vitin 2013, Shqipëria nisi përpjekjet për të krijuar një sistem funksional dhe të besueshëm të Shërbimit të Kujdesit Social, i cili duhet të kapërcejë mangësitë e theksuara që janë vënë re në këtë drejtim. Parashikohet që brenda vitit 2016, Shqipëria të ketë “billoqet ndërtuese” të kësaj Reforme shumë të rëndësishme, për të arritur përmes tyre qelimin kryesor: mundësi reale për të ofruar mbrojtje dhe mbështetje sociale për qytetarët në nevojë dhe në risk.

Shërbimet sociale ekzistuese janë të fragmetuara, rudimentare dhe me natyrë *had-hoc*. Krijimi dhe funksioni i tyre ka qenë spontan dhe i pakoordinuar. Nga ana tjetër, nevojat për marrjen e shërbimit të përkrahjes sociale janë në rritje të vazhdueshme. Problem mbetet shtimi i vazhdueshëm i personave që jetojnë në varfëri (shumica në pamundësi për të plosuar edhe nevojat më bazike për ushqim). Hendeku i varfërisë është në rritje, madje edhe brenda vetë shtresave në nevojë. Të gjithë treguesit e tjerë në këtë drejtim kanë pësuar rritje me trend përkeqësues.

Në Shqipëri nuk është matur /indeksuar ende shkalla e varfërisë tek fëmijët, por INSTAT ka raportuar se numri i fëmijëve që jetojnë në varfëri absolute, pra që jetojnë në familje me të ardhura nën 125 USD në muaj, është 17.4% ose e përkthyer në vlerë numerike 147432 fëmijë. Përafërsisht 2% e këtyre fëmijëve jetojnë në familje me “zero” të ardhura.

Familjet shqiptare dhe komunitetet në përgjithësi janë të ekspozuara ndaj riskut që mbartin ndryshimet e forta të strukturës demografike, migrimit të brendshëm dhe atij të jashtëm, modifikimit të rolit tradicional të familjes, papunësia, problemet në familje, etj.

Reformim i Shërbimeve të Kujdesit Social do të thotë një përkthim më i drejtë i nevojave të individëve apo grupeve në vështirësi si dhe përgjigje në kohë ndaj nevojave të tyre komplekse dhe gjithnjë në rritje. Në kuadër të kësaj Reforme synohet zhvillimi i sistemeve të reja financiare, administrative dhe legjislative që do mundësonin një sistem funksional shërbimesh në sferën e e Përkrahjes Sociale. Po ashtu synohet qartësimi i roleve dhe përgjegjësi për autoritet në nivel qëndror dhe vendor në planifikimin, ofrimin dhe mbikqyrjen e shërbimeve të përkrahjes sociale. Reforma synon të promovojë rritjen e rolit të Qeverisjes Vendore në planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve të përkrahjes sociale deri në aktivizimin autonom të mekanizmave në nivel vendor, pikërisht aty ku janë më të prekshme problemet sociale dhe grupet në nevojë.

Reforma që po ndërmerret në fushën e përkrahjes sociale është paraprirë *de-facto* nga Reforma Administrativo-Territoriale (RAT). Ndarja e re u bë efektive me përfundimin e zgjedhjeve vendore të 21 Qershorit 2015. Ndryshimet e thella strukturore që ka pësuar peizazhi institucional ku vepron Pushteti Vendor (ka vetëm 61 bashki të mëdha në vend të 373 NJQV) dhe demografia komplet e përmbysur e bashkive të reja (mbi 50% e popullsisë në juridiksionin e tyre jeton në zona rurale) diktojnë nevojën e një analize të kujdesshme. Vlerësimi sasior dhe cilësor i stafeve në bashki, që lëvrojnë ndihmën ekonomike dhe garantojnë/promovojnë të drejtat sociale për grupet në risk, është një nga komponentët e rëndësishëm të kësaj analize. Ky studim, i realizuar nga Qendra për Çështjet e Informimit Publik, INFOÇIP, me mbështetjen e UNICEF, synon të vendosë disa piketa orientuese në këtë drejtim.

II. Reforma Administrativo - Territoriale

Në Korrik 2014, Kuvendi i Shqipërisë miratoi¹ ndarjen e re administrativo territoriale sipas së cilës 373 NJQV ekzistuese do të ri-grupoheshin në vetëm 61 bashki të mëdha. Ndarja e re u be efektive me përfundimin e zgjedhjeve vendore të 21 Qershorit, 2015. Të gjitha komunat u shkrinë në juridiksionet e zgjeruar të bashkive të mëdha. Me sistemin e ri në fuqi, në vend të tyre krijohen njësi administrative (NJA) që janë pjesë e strukturës së bashkisë së madhe. NJA janë në thelb zgjatime të administratës bashkiake në zonat rurale (dikur nën juridiksion të ish-komunave). Vetë bashkitë e madha janë të vendosura në qendrat kryesore urbane. Reforma e Administrativo-Territoriale ka krijuar *de-facto* bashki policentrike, me shtrirje në qytet dhe në fshat. Ky është padyshim një nga konceptet më reformuese të prezantuara në dekadën e fundit në nivel të qeverisjes vendore.

Zgjerimi i territoreve dhe rritja e numrit të subjekteve nën juridiksionin e bashkive të reja, së bashku me rritjen e cilësisë së stafeve të funksionarëve publikë, janë parashikur të sjellin rritje sasiore dhe cilësore në shërbime. Efikasitetin e ofrimit të tyre pritet gjithashtu të rritet, si rrjedhojë e zmadhimit të bazës së taksueshme dhe rritjes së të ardhurave, shoqëruar kjo nga ulja e kostove të personelit (me rreth 20-30% vende punë më pak). Ky reduktim i pashmangshëm i stafeve në kuadër të RAT, besohet se do të përqëndrojë më mirë cilësinë e burimeve njerëzore dhe rrjedhimisht edhe do të rrisë efektivitetin e bashkive të reja në terma të raportit “të ardhurash-penzime”. Të gjitha sa më sipër janë premisa për adoptimin e një modeli ekonomie shkalë, sidomos në sferën e shërbimeve, për të cilat synohet në çdo rast ulja e kostove për njësi.

¹ Ligji 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”

RAT ka hyrë tashmë në fazën e implementimit të plotë, me proceset amalgamuese që janë duke u implementuar në nivel kombëtar. Konsolidimi financiar dhe administrativ i bashkive të reja ka prodhuar nevojën e rikonceptimit të vetë procesit të Decentralizimit. Një seri ligjesh kuadër janë në proces hartimi dhe dhjetëra të tjera do të rishikohen / amendohen në muajt në vijim.

Secili prej këtyre preceseve mbart një seri sfidash të cilat duhen adresuar me kujdes. Njëra prej tyre është ri-organizimi i strukturave në nivel bashkie edhe rikonfigurimi i stafeve si një përkthim i nevojave të reja që ka diktuar RAT.

Në kuadër të vlerësimeve që janë ndërmarrë gjatë procesit të amalgamimit, janë bërë përpjekje të posaçme për të identifikuar qartë funksionet dhe shërbimet bazë. Ndihma ekonomike në NJQV si dhe personeli i njësive të drejtave të fëmijëve konsiderohen si ndër funksionet sensitive të cilat duhen garantuar dhe promovuar më tej në mjedisin e ri institucional të krijuar.

Në këtë kontekst, Reforma Administrativo Territoriale dhe Shërbimet e Përkujdesit Shoqëror kanë pika takimi të rëndësishme. Ndryshimet e thella strukturore që ka pësuar peizazhi institucional ku vepron Pushteti Vendor kanë një rezonim të fortë në cilësinë dhe mënyrën e lëvimit të përkrahjes social në të gjithë spektrin që ajo mbulon. Edhe peizazhi demografik është tërësish i ndryshuar, po të mbahet parasysh fakti se të paktën gjysma e popullsisë në juridiksionin e bashkive të reja të krijuara jetojnë në zona rurale dhe sub-urbane. Kjo situatë formulon një padyshim një sfidë të re për bashkitë e reja të krijuara por edhe për Reformën që po ndërmerret në fushën e Shërbimit të Përkrahjes Sociale.

Qeveria Shqiptare, në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale e Decentralizimit 2015-2020 ka patur parasysh këto ndryshime cilësore dhe sasiore teksa ka formuluar si një ndër objektivat e saj, garantimin e një roli kryesor të NJQV-ve në zbatimin e programeve të mbrojtjes sociale dhe atyre të përfshirjes sociale. NJQV janë parashikuar qysh në fillim të përfshihen në zbatimin e strategjisë së Mbrojtjes Sociale (2015-2020). Kjo strategji përcakton tre fusha kryesore: 1) programin e ndihmës ekonomike; 2) programin e pagesave dhe shërbimeve për aftësinë e kufizuar; 3) programin e ndërtimit të shërbimeve të kujdesit social. Të treja fushta e ndërhyrjes janë në thelb programe të decentralizuara dhe ofrohen nga Pushteti Vendor me mbështetjen e Pushtetit Qëndror.

Funksioni i ofrimit të shërbimeve sociale vendore do të decentralizohet dhe do të kalojë në kompetencë të bashkive. Në çdo bashki do të krijohen zyrat e shërbimeve sociale të integruara të cilat do të sigurojnë identifikimin, vlerësimin dhe trajtimin e individëve dhe familjeve në nevojë përmes programeve të ndihmës ekonomike dhe të kujdesit social. Do të rishikohet ligji për ndihmën ekonomike dhe shërbimet shoqërore, si dhe do të hartohet një “shportë e shërbimeve bazë sociale” të cilat do të financohen mbi bazën e një mekanizmi të përbashkët financimi.

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR) do të mbështesë me kapacitete dhe mjete NJQV-të për hartimin e Planit Vendor të Shërbimit Social. Bashkitë do të kenë kompetencë të ofrojnë shërbime sociale përmes “shportës të shërbimeve bazë”, të cilat do të sigurojnë mbështetjen për nevojat specifike në bazë të vlerësimit të nevojave. Bashkitë do të mbështeten gjithashtu për përmirësimin e kapaciteteve menaxhuese dhe cilësisë së shërbimeve sociale në lidhje me institucionet residenciale, qendrat ditore, qendrat komunitare,

shtëpitë e të moshuarve etj., të cilat do të jenë pjesë e prioritetëve të qeverisë në sektorin social.

Për të gjitha arsyet e renditura më sipër, burimet njerëzore cilësore janë kusht për performimin e funksioneve ku kanë pike-prerje të dy reformat. Nisur nga kjo premisë, UNICEF mbështeti nevojën për hartëzimin e burimeve njerëzore në sektorët e ndihmës ekonomike, përkrahjes sociale dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve dhe grupeve të tjera në risk në nivel vendor. Inventarizimi i shpejtë i burimeve njerëzore në nivelin e parë të qeverisjes vendore menjëherë pas aktivizimit të RAT synon të përcaktojë terrenin bazë (*baseline*) nga ku më pas, të mund të planifikohet më mirë ristrukturimi, profilizimi i punës për stafin dhe ngritja e kapaciteteve të tyre.

III. Mbi organizimin e gjetjeve të studimit

Inventarizimi i stafeve të ndihmës ekonomike dhe kujdesit social në nivel vendor, realizuar nga INFOÇIP me mbështetjen e UNICEF, është një sipërmarrje e veçantë, si për metodologjinë e përdorur ashtu edhe për kohën brenda të cilës u realizua (rreth 3 muaj). Procesi kishte për synim të realizonte një “fotografi çasti” të situatës së stafeve të targetuara në momentin fillestar të kalimit nga ndarja e vjetër në ndarjen e re administrativo-territoriale. Një objektivi i posaçëm në kuadër të kësaj detyre kanë qenë identifikimi nominal por edhe i pozicioneve në strukturë e NJQV të personelit të njësive të të drejtave të fëmijëve në nivelin e parë të qeverisjes vendore.

Të dhënat e këtij inventarizimi janë organizuar në dy formate: sipas qarkut dhe sipas bashkive në rend alfabetik. Në formatin e parë të dhënat shërbejnë për të krijuar një ide të menjëhershme të shpërndarjes rajonale të personelit të targetuar. Kjo lehtëson kuptimin e të dhënave si dhe mundëson një orientim më të mirë të përdoruesve, sipas nevojave

respektive. Të dhënat e organizuara sipas qarkut u dorëzuan paraprakisht, për përdorim operativ pranë institucioneve që kanë porositur këtë studim (si edhe përfuturit).

Në formatin e dytë, të dhënat organizohen sipas 61 bashkive të reja, të renditura në rend alfabetik. Përmes përdorimit të këtij formati bëhet i mundur edhe hartëzimi i plotë i situatës së stafeve në secilën bashki të re dhe njësi administrative të amalgamuar rreth saj, në kuadër të ndarjes së re administrativo-territoriale. Të dhënat e grumbulluara përfshijnë pozicionet në strukturën organizative të NJQV dhe varësinë administrative, emërtimin në strukturën e miratuar për vitin 2015, arsimimin e stafeve, përvojën e punës (vitet në detyrë), statusin e punonjësit dhe formën e kontraktimit, si dhe, aty ku ka qenë e mundur, indikimin e kategorive të mbrojtura të punonjësve. Një vlerësim i posaçëm është edhe balanca gjinore e stafeve të targetuara nga ky studim për secilën bashki të re të krijuar. Organizimi i të dhënave në këtë mënyrë krijon mundësi reale për të ndërmarrë rivlerësime dhe analiza të mëtejshme të të dhënave, sipas nevojave të aktorëve që do të punojnë mbi të dhënat që përmban ky material.

Është e rëndësishme të shpjegohet qysh në fillim se, në këtë proces janë inventarizuar pozicionet në strukturën e miratuar të bashkive dhe ish-komunave gjatë vitit ushtrimor 2015, e mandej gjatë amalgamimit të këtyre strukturave në një organikë të vetme pas zgjedhjeve të 21 Qershorit 2015. Nga pikpamja metodologjike, kjo qasje është më e mira e mundshme. Përveç “fotografimit” të situatës së stafeve, krijon gjithashtu, për herë të parë, një *baseline* për të vlerësuar ecurinë e mëtejshme të zhvillimit të funksioneve të targetuara dhe harmonizimin më të mirë të tyre, konform kriterëve që do të përcaktohen në muajt në vijim.

Emrat korrespondues për çdo funksion strukturor të inventarizuar nuk janë të publikuar në tabelat e organizuara me

bazë bashkie, për arsye profesionale, etike dhe ligjore. Ndërkohë, me ngjyrë portokollalli janë markuar të gjitha ato kutiza ku, nga inventarizimi rezultojnë të jenë punonjës që kryejnë *njëkohësisht dhe/ose posaçërisht* funksionin e NJMB në bashki. Këto janë të dhëna të rakorduara me Agjensinë Shtetërore të Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijës.

Reforma Administrativo-Territoriale ka krijuar një premisë të rëndësishme për të ri-organizuar më mirë strukturat e ndihmës ekonomike, përkrahjes sociale, garantimit të drejtave të fëmijëve dhe grupeve të tjera në nevojë/risk. Në realitetin e ri të krijuar nga RAT është prodhuar nevoja për të matur dhe vlerësuar zbatimin rigoroz të legjislacionit në fuqi për Mbrojtjen e Femijes, Barazinë Gjinore, Mbrojtjen nga Diskriminimi, Dhuna në Familje, etj.


Meqenëse ky inventarizim punonjësish lidhet ngushtësisht me proceset e amalgamimit të NJQV në kuadër të RAT, stafi i përfshirë e konsideroi të domosdoshme të realizonte edhe hartëzimin e secilës bashki sipas ndarjes së re administrative-territoriale. Studimi ofron të dhëna të gjeografike, demografike, administrative dhe social-ekonomike si për problemet e trashëguara ashtu edhe për sfidat e reja që kanë lindur pas ri-organizimit. Për secilën nga 61 bashkite e reja jepet një paraqitje e plotë e qendrave/njësive administrative, qyteteve dhe fshatrave përbërës. Përveçse një pohim metodologjik, kjo paraqitje në *360 gradë* e situatës në nivel vendor menjëherë pas aktivizimit të RAT, synon të ndihmojë hartuesit e politikave (*për reformimin e shërbimit të ndihmës sociale*) për reflektimin sa më të mirë të kushteve fillestare në vlerësimin e mëtejshëm të cilësisë/nevojave të stafeve. Edhe pse jashtë “*scope*”-it të këtij vlerësimi, ndërtimi i profileve administrative-territoriale të 61 bashkive të reja i jep një vlerë e shtuar hartëzimit të burimeve njerëzore të targetuara nga ky studim.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Pozicionet strukturore të inventarizuara

Gjatë periudhës 10 Korrik–10 Shtator 2015, kohë në të cilën u realizua ky inventarizim (HR Due Diligence), në strukturat e amalgamuara të 61 bashkive (bashki + ish-komuna) rezultuan **655 pozicione (vende pune)** për administratorët e ndihmës ekonomike, përkrahjes sociale, përfshi NJMF. Kjo shifër “përkthen” vetëm ato pozicione pune të cilat janë të reflektuara në VKB-të respektive të strukturës dhe organikës të NJQV-ve në nivelin e parë të qeverisjes vendore (*marzhi i gabimit +/- 10 persona*).

Prej totalit të inventarizuar, 238 pozicione (36%) gjenden në strukturat e bashkive, ndërsa 417 pozicione (64%) janë të shpërndara nëpër njësitë administrative (*ish-komunat*). Epërsia numerike e personelit të NJA ndaj atyre të bashkive (graf. 1) vjen për shkak se numri i këtyre të fundit është mesatarisht 5 herë më i vogël krahasuar me numrin e NJA nën juridiksionin e tyre (ish-komuna deri para 21 Qershorit 2015).



Vlen të theksohet se në shumicën e rasteve, njësitë administrative (*ish-komunat*) kanë të përcaktuar vetëm një (1) pozicion në strukturat organizative për vitin 2015 për kategorinë e punonjësve që targeton studimi. Në shumicën e rasteve ky pozicion në strukturë haset nën emërtimin standart “*specialist/punonjës i ndihmës ekonomike*”.

Bashkitë me më shumë njësi administrative rurale brenda juridiksionin të tyre, sipas ndarjes së re janë Kukësi dhe Peshkopia (14 secila). Bashkia Tiranë, ka nën juridiksionin e saj 24 njësi administrative, por prej tyre 11 janë brenda qytetit dhe vetëm 13 janë në zonën rurale. Këto të fundit janë: *Petrela, Farka, Dajti, Zall-Bastari, Bërzhitë, Krraba, Baldushku, Shëngjergji, Vaqarri, Kashari, Peza, Ndroqi dhe Zall Herri*.

Bashkia e re Tiranë rezulton të ketë në strukturën e saj të amalgamuar numrin më të madh të pozicioneve; vlerësuar rreth 1 muaj pas zgjedhjeve të 21 qershorit 2015, rezultuan 67 pozicione për personelin e ndihmës ekonomike, përkrahjes sociale, NJMF, barazisë gjinore, mos-diskriminimit, etj. Duhet mbajtur parasysh se 11 mini-bashkitë e kryeqytetit, pas zgjedhjeve të 21 Qershorit 2015 referohen si njësi administrative dhe janë përllogaritur si të tilla në kuadër të organizimit të gjetjeve në këtë studim.

Në vend të dytë vjen bashkia e madhe Pogradec me 29 pozicione në strukturën e saj të amalgamuar, e më pas bashkitë Elbasan dhe Kukës me nga 25 pozicione secila. Nga ana tjetër, Bashkia e re Poliçan rezulton të ketë numrin më të vogël të pozicioneve të parashikuar në strukturën e vitit 2015, konkretisht vetëm 3 të tilla.

2. Përvoja në punë e personelit

Në total, personeli i vlerësuar nga kjo HR Due Diligence ka një përvojë punë që lëviz nga disa muaj (periudhë prove) deri tek përvoja më e lartë që shkon në 25 vjet punë (*Njësia Administrative Ishëm, Bashkia Durrës*). Në përgjithësi, rezulton se personeli i ndihmës ekonomike dhe përkrahjes sociale në NJQV ka një përvojë relativisht të gjatë pune.

Për shkak të kohës së paktë në dispozicion të këtij studimi, por mbi të gjitha për shkak të prezumimit të një situatë të paqëndrueshme sa i takon stafeve pas zgjedhjeve të 21 qershorit, grupi i përfshirë në studim nuk u përqëndrua në vlerësime të mëtejshme mbi të dhënat e mbledhura, të tilla si: mesatarja e përgjithshme në vite punë, mesatarja në nivel qarku, rankimi i tyre sipas vjetërsisë në punë, etj. Një funksion i rëndësishëm që mund të analizohet në një kohë të dytë, pasi edhe ndryshimet në nivel të stafeve vendore të jenë stabilizuar, mund të jetë edhe krahasimi midis përvojës në punë dhe nivelit të shkollimit të stafeve në nivelin e parë të qeverisjes vendore.

Është e këshillueshme që, për të nxjerrë rezultate të shpejta mbi cilësinë e stafeve, ato të analizohen në mënyrë të decentralizuar, në kontekstin e secilës bashki. Nuk nuk ka një tipar i cili të përvijohet qartë në një model (*patern*) të qëndrueshme në këtë drejtim. Ajo që mund të thuhet me siguri në këtë nivel analize, është se një pjesë e këtyre stafeve, kanë vjetërsi të madhe punë dhe klasifikohen lehtësisht në kategorinë “*memorje institucionale*”. Në terma të metodologjisë së përdorur në këtë studim, shumica klasifikohen gjithashtu si *asete njerëzore të rëndësishme* për të garantuar vijueshmëri në ofrimin e shërbimeve, tashmë edhe në kontekstin e procesit të amalgamimit midis bashkive të mëdha dhe ish-komunave.

Nga ana tjetër është fakt se një ndër objektivat e RAT ka qenë rritja e eficiencës ekonomike të NJQV përmes reduktimit të stafeve. Ky objektiv specifik është përkthyer edhe në orientimet organizative dhe operacionale që u janë përcjellë përmes AZRAT të zgjedhurve të rinjë bashkiakë, pas zgjedhjeve vendore të 21 Qershorit 2015.

Rekomandim:


- **Për rëndësinë e veçantë që ka personeli i ndihmës ekonomike dhe përkrahjes sociale për komunitetet respektive, memorjen institucionale që mbart në raport me individët në nevojë, rekomandohet që mekanizmat e reduktimit dhe/ose rifreskimit të stafit të veprojnë sa më pak të jetë e mundur mbi këtë kategori punonjësish dhe në çdo rast jo më parë se sa ndaj kategorive të tjera të klasifikuara nga strukturat organizative të vetë NJQV.**

3. Marrdhëniet e punës / statusi i punonjësit

Për personelin që targetoi ky studim, u bë edhe një klasifikim i detajuar për llojin e marrdhënies së punës dhe statusin e punonjësit. Në këtë vlerësim të posaçëm nuk janë të përfshirë punonjësit e bashkisë qendër Tiranë dhe 11 NJA të qytetit (ish mini-bashkitë). Arsyeja e mos-përfshirjes së bashkisë Tiranë (qendër) lidhet me dinamikat e shpejta u aktivizuan menjëherë pas përfundimit të zgjedhjeve të 21 Qershorit 2015, që përfshinë edhe sistemin e stafeve teksa ky inventarizim ishte në proces e sipër.

Nga të dhënat e analizuar rezultoi se në total janë rreth 190 punonjës (*marzhi i gabimit +/-10 persona*) që kanë statusin e nëpunësit civil, pa llogaritur Bashkinë Tiranë (qendër) dhe 11 njësitë administrative të kryeqytetit. Në një vlerësim hipotetik, edhe sikur të gjithë punonjësit e bashkisë së madhe Tiranë (janë inventarizuar 67 pozicione strukturore në total² deri në fund të shtatorit 2015) të kishin statusin e nëpunësit civil, në total, në nivel kombëtar kategoria e punonjësve me këtë status do të përfaqëson 24.3% ose rreth 1/4 e totalit të stafeve që inventarizoi studimi (me të gjelbër në grafikun më poshtë).

Pjesa tjetër, 75.7%, pra $\frac{3}{4}$ (rozë në grafik), nuk kanë status të nëpunësit civil; ata janë në marrdhënie punë me kontratë me afat ose pa afat. Tabelat për secilën bashki ofrojnë të dhëna për raportet mes kontratave me afat dhe atyre pa afat.



GRAF 2: Punonjës me SNC vs. Punonjës pa SNC

² Personel i ndihmës ekonomike në bashki dhe NJA, administratorë sociale dhe punonjësit e tjerë të njësisë së mbrojtjes së fëmijëve, barazisë gjinore, mos-diskriminimit, strehimit social, etj


Rekomandime:

- Në kuadër të ristrukturimeve të mundshme të administratës vendore sipas orientimeve të AZRT, kategoria e punonjësve që gëzon statusin e nëpunësit civil të konsiderohet e fundit për largim eventual nga puna, dhe në çdo rast vetëm bazuar mbi kritere të përcaktuara nga Kodi i Punës dhe Kodi i Procedurave Administrative, për të minimizuar kostot që mund të pasojnë nga atakimi në gjykatë i vendimit administrativ.
- Konform kriterëve ligjorë të përcaktuara dhe në respekt të parimit të qëndrueshmërisë së stafeve, të shtohet “përqëndrimi” i punonjësve që kanë statusin e nëpunësit civil, si një garanci për vijueshmërinë institucionale dhe garantimin e ofrimit të shërbimeve jashtë ndikimit të dinamikave të rotacioneve të pushtetit.
- Pas miratimit të strukturave të reja organizative të bashkive për vitin 2016, të nisë vlerësimi i nevojave për trajnim të stafeve në Shërbimin e Përkrahjes Sociale në bashki, përfshi NJMF.
- Në kuadër edhe të Reformës në Shërbimet e Përkrahjes Sociale, por edhe në kuadër të RAT, rekomandohet që të definohen profilet e punës për të gjithë punonjësit që punojnë në sektorët relevantë.
- Rekomandohet hartimi i metodikës së ofrimit të shërbimeve sociale mbi bazë popullore, duke përditësuar databazën e përfutësve konform ndarjes së re administrativo-territoriale.

4. Arsimimi i stafeve

Niveli i arsimimit të personelit të përkrahjes sociale në bashki është një tjetër e dhënë e mbledhur në kuadër të këtij vlerësimi. Në këtë analizë të posaçme nuk janë të përfshirë vetëm punonjësit e Bashkisë Tiranë (qendër) dhe 11 NJA të kryeqytetit (ish-minibashkitë). Arsyeja e mospërfshirjes, siç u përmend edhe më sipër, lidhet me dinamikën e shpejta që u aktivizuan menjëherë pas përfundimit të zgjedhjeve të 21 Qershorit, 2015, që përfshinë edhe sistemimin e stafeve teksa ky inventarizim ishte në proces.

Në shkallë vendi, pa bashkinë Tiranë dhe 11 NJA të kryeqytetit, rezultuan 372 punonjës me arsim të lartë ose rreth 62% e totalit (me *jeshile në grafik*). Rreth 203 persona ose 34% rezultuan me arsim të mesëm (*portokalli në grafik*); 2 rezultuan me arsim 8-vjeçar (*e kuqe në grafik*). Për 27 punonjës, ose 5% e totalit (*ngjyrë vjollce në grafik*), kjo e dhënë nuk u përcaktua Marzhi i gabimi në këtë përllogaritje është rreth 2%.



GRAF 3, niveli arsimor në stafet e përkrahjes sociale në 61 bashki

Nëse do merrnim të mirëqenë që në Bashkinë e Tiranës, për arsye të njohura, niveli i arsimimit të stafeve s'mund të jetë në asnjë rast më i ulët se mesatarja e bashkive të tjera, atëherë në shkallë vendi do të rezultonte se mbi 62% e personelit të përkrahjes sociale në bashki është me arsim të lartë. Rreth 34% e tyre përllogariten me arsim të mesëm.

Duke patur parasysh mjedisin profesional shpeshherë të nën-paguar të bashkive dhe ish-komunave, shifra prej 34% e personelit me arsim të mesëm nuk është për t'u konsideruar problematike. Megjithatë, në një mjedis institucional më kompetitiv, dhe me juridiksione të zgjeruara, si rezultat i RAT, formimi universitar për të gjitha stafet që punojnë në administratat vendore do të ishte një garanci më shumë për shërbime cilësore ndaj publikut, në rastin konkret ndaj grupeve/individëve në nevojë.

Rekomandime:

- Në kuadër të rekrutimeve të mundshme të stafeve në sektorët e përkrahjes sociale në nivelin e parë të qeverisjes vendore, rekomandohet ngritja e nivelit arsimor të tyre duke synuar 100% të punonjësve me arsim universitar.
- Ato pak stafe me arsim 8-vjeçar që akoma qëndrojnë në sistem duhet të zëvendësohen në rastin më të parë të mundshëm.
- Rekomandohet që, pas miratimit të strukturave të reja organizative të bashkive për vitin 2016, të nisë vlerësimin e nevojave për edukim në vazhdim dhe/ose trajnim të stafeve të angazhuara në Shërbimin e Përkrahjes Sociale në bashki, përfshi NJMF.

5. Lloji i arsimit universitar

Në kuadër të këtij inventarizimi, u pa e arsyeshme të bëhet edhe vlerësim i posaçëm vetëm për stafet me arsim të lartë, duke diferencuar dy kategori:


- 1) “*me formim universitar të përshtatshëm*”
- 2) “*me formim universitar të papërshtatshëm*”.

Kriteri i përzgjedhur për këtë nën-kategorizim është ***lloji i formimit*** universitar dhe jo ***cilësia*** e tij (rezultatet, emri i universiteti, etj). Disiplinat e shkencave sociale, ose më konkretisht dimplomimi në fusha të tilla si *punë sociale*, *psikologji* dhe *sociologji*, për efekte metodologjike të këtij vlerësimi konsiderohen si “*formim universitar i përshtatshëm*”, kurse të gjitha disiplinat e tjera (veterianari, inxhinieri, juridik, financë, etj.), konsiderohen si “*formim universitar i papërshtatshëm*”.

Në kategorinë e parë, “*formim universitar i përshtatshëm*” klasifikohen 70 punonjës, kurse në të dytën, “*formim universitar i jo-përshtatshëm*” rreth 302 punonjës. Edhe në këtë rast, Bashkia e Tiranës (qendër) dhe NJA-të e kryeqytetit nuk janë të përfshira. Nëse lejohet të prezumohet një shifër me gjithë Bashkinë Tiranë të përfshirë, me përafërsi do të rezultonin rreth 100 punonjës me arsim universitar të përshtatshëm brenda stafeve që targetoi ky studim.

Rekomandim:

- Rekomandohet orientimi në përzgjedhje drejt kandidaturave që plotësojnë kriterin e arsimit universitar të përshtatshëm të paktën në nivelin 50% dhe në terma afatgjatë deri në 90%.



GRAF 4: Arsimit i përshtatshëm VS. Arsimit jo-i përshtatshëm

6. Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve

Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve (NJMF) funksionon brenda strukturës administrative të bashkisë (dhe të ish komunave deri para 21 qershorit 2015). Kjo Njësi është kontakti i parë me fëmijën në rrezik dhe ka përgjegjësinë për identifikimin e rastit, menaxhimin dhe ndjekjen e tij derisa fëmija të konsiderohet “jo në rrezik”. NJMF shërben si qendër informacioni ku fëmijët dhe familjet mund të informohen apo të referohen tek shërbime të tjera mbështetëse, sipas nevojave që ata kanë. Ajo mban kontakte të rregullta, bashkëpunon dhe koordinon me OJF dhe ofruesit e shërbimeve për fëmijë brenda territorit të bashkisë dhe raporton periodikisht në ASHMDF, të dhënat statistikore dhe informacion mbi situatën e mbrojtjes së fëmijëve. NJMF bashkëpunon me Njësinë për të Drejtat e Fëmijës në qark (nëse aktorët që operojnë brenda juridiksionit të bashkisë nuk mund të ofrojnë ndihmën e përshtatshme për

fëmijën) dhe aktorë të ndryshëm për përmirësimin e situatës së fëmijës në rrezik.

Inventarizimi i pozicioneve në strukturat e bashkive për personelin që kryen funksione në kuadër të NJMF ishte një prioritet i posaçëm i këtij studimi. Sipas të dhënave zyrtare të disponuara nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, ASHMDF, që nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit Nr.10 347, datë 4.11.2010 **“Per mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”** dhe deri në 30 Korrik 2015 (kohë në të cilën u disponua nga INFOÇIP të dhënat e para zyrtare prej saj), ishte arritur të ngriheshin 202 NJMF në nivelin e parë të qeverisjes vendore. Po sipas këtyre të dhënave, deri në 21 Qershor 2015, këto NJMF ishin prezente në 52 bashki dhe 139 komuna.


Në Korrik 2015 u disponua edhe një listë e personelit të NJMF në nivelin e parë të qeverisjes vendore, për t’a kontrastuar atë me të dhënat e grumbulluara në terren nga INFOÇIP gjatë periudhës Korrik-Shtator 2015. Sipas kësaj liste, shërbimi i NJMF-vë shpërndahej në 231 NJQV, pra në më shumë NJQV se sa referon lista e parë e disponuar nga i njëjti insitucion.

Nga kontrastimi i emrave të personelit ekzistues të bashkive (bashki qendër + NJA) të inventarizuar në terren nga INFOÇIP³, me emrat e disponuar nga ASHMDF u konfirmuan një personel prej 168 administratorësh që vijonin të ishin pjesë e stafeve të bashkive të reja deri në Shtator 2015 (*marzhi i gabimit +/-5 persona*). Për të indikuar qartësisht këtë të dhënë, në tabelat e secilës bashki në kete studim, personeli i NJMF është markuar me ngjyrë portokalli, për të identifikuar vizualisht ata punonjës të referuar nga AMSHDF që janë duke ushtruar funksione ende (edhe) në kuadër të NJMF. Ndërkohë,

³ periudha 15 Korrik- 30 Shtator, 2015

65 emra personeli të referuar nga lista e ASHMDF në fund të Korrikut 2015 nuk figuronin me në totalin e personelit të inventarizuar nga INFOÇIP⁴. Kjo e dhënë sugjeron se, në këto 65 pozicione, personeli mund të jetë ndryshuar, larguar ose rekrutuar nga e para në një periudhë të mëvonshme (nga hartimi i listave prej ASHMDF e deri në momentin e mbylljes së këtij studimi). Nëse do ta prezumonim kështu, në nivelin e parë të qeverisjes vendore në Shqipëri, numri i personelit të NJMF-ve do të arrinte në total 233 persona (*marzhi i gabimit 2%*). Për ta nxjerrë në pah qartësisht këtë të dhënë, në tabelat e inventarit me bazë qarku, personeli i paverifikuar i NJMF-ve është markuar me ngjyrë blu.

Grafiku 4 pasqyron raportin mes stafeve të përkrahjes social-ekonomike në tërësi (*ngjyre bojeqielli*) dhe personelit që kryente funksione (edhe) në kuadër të NJMF në 61 bashkitë e amalgamuara deri ne Shtator 2015 (*ngjyre e kuqe*) .



GRAF 5: funksionë ne tërësi VS. funksione në kuadër të NJMF

⁴ në 655 pozicione /vende pune të inventarizuara në nivel kombëtar sektorin e ndihmës ekonomike dhe përkrahjes sociale në bashki


Termi “NJMF” në shumicën dërrmuese të rasteve nënkupton një person të vetëm. Ky fakt verifikohet njësoj si për bashkitë ashtu edhe për njësitë e sotme administrative (ish-komunat). Ka shumë pak raste kur, në strukturën e NJQV të jenë hasur më shumë se dy persona që kryejnë funksione në kuadër të NJMF (referojuni tabelave për secilën bashki).

Për më tepër, personeli që kryen funksione në kuadër të NJMF figuron në strukturën zyrtare të NJQV-ve me të tjera funksione parësore. Konkretisht, funksioni parësor i personelit të NJMF është më shpesh “*specialist i ndihmës ekonomike*”, kurse funksion që buron nga ligji 10347/2010 nuk pasqyrohet (me përjashtime jashtëzakonisht të rralla) si emërtim zyrtar në strukturën e NJQV-ve që u inventarizuan (viti 2015).

Nga vlerësimet cilësore rezultoi se kjo *anomali* ndodh për shkak të burimeve të kufizuara njerëzore dhe/ose financiare në nivel të NJQV, çka ka diktuar që një punonjës të ngarkohej me kryerjen e dy apo tre funksioneve njëkohësisht.

Rezultoi se, në strukturën e NJQV-ve në të gjithë vendin, për vitin 2015 janë vetëm 36 pozicione të parashikuara ekskluzivisht si emërtim për personelin e NJMF, konform përcaktimeve të ligjit Nr.10 347, datë 4.11.2010 “**Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve**”.

Grafiku përbri ofron një paraqitje vizuale të raportit që ekziston mes pozicioneve të dedikuara për NJMF në organikat e bashkive (me të verdhe në graf.5) dhe emërtesave të tjera të marra të gjitha së bashku, të tilla si: specialist/administrator i ndihmës ekonomike, specialist i barazisë gjinore, anti-diskriminimit etj.



GRAF 6, NJMF si funksion i dedikuar VS. funksione të tjera

Nga vlerësimi rezulton se NJMF janë të pranishme në vetëm 52 nga 61 bashki të reja që janë krijuar nga RAT. Ndërkohë, referohen 139 NJA (ish-komuna) në të cilat ka gjithashtu NJMF. Siç u tha edhe më sipër, shpeshherë personeli i përkrahjes sociale dhe/ose ndihmës ekonomike ushtron funksione edhe në kuadër të NJMF.

Sa i takon 11 NJA të kryeqytetit (ish mini-bashkitë), ato nuk janë të përlogaritura në këtë shifer (139), për shkak të specifikës së tyre urbane. Lidhur me këto 11 NJA vlen të përmendet se të gjitha kanë trashëguar në strukturën (organikën) e tyre pozicione të mirë-përcaktura me emërtimin: “*administrator për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve*”.

Rekomandime:

1. Në strukturat organizative për vitin 2016, bashkitë duhet të përcaktojnë të paktën 61 NJMF brenda organigramës së tyre, me personel i cili të ushtrojë funksione të dedikuara, sipas përshkrimit në dispozitat e ligjit Nr.10 347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”;
2. Rekomandohet hartimi i kriterëve me bazë demografike për të aktivizuar metodikisht shtimin/pakësimin e personelit të NJMF në nivel të NJA;
3. Personeli ekzistues në nivel të bashkive dhe NJA i cili kryen funksione të dyfishta, duhet të trajnohet mbi modelin policentrik të qeverisjes në nivel vendor dhe me linjat vertikale dhe horizontale që duhet të ndjekë në kryerjen e funksioneve specifike që janë të përcaktuara me ligj;
4. Rekomandohet hartimi i *currikulave* profesionale dhe përshkrimit të detyrave dhe përgjegjësi, linjave të raportimit dhe mbikqyerjes administrative për secilin punonjës të NJMF në nivelin e parë të qeverisjes vendore;
5. Rekomandohet vlerësim i plotë i nevojave për trajnim të stafeve të NJMF në nivel të NJA dhe bashkive të cilat kanë mbulim të gjerë territorial të zonave malore;
6. Rekomandohet që të rifreskohet baza e të dhënave për personelin e NJMF në nivelin e parë të qeverisjes vendore pas miratimit të strukturave organizative të 61 bashkive të krijuara (koha e përshtatshme: fillimi i vitit 2016);
7. Rekomandohet të vlerësohet përshtatshmëria dhe kualifikimi arsimor i stafeve të NJMF në nivelin e parë të qeverisjes vendore, konform kërkesave të ligjit Nr.10 347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve” dhe Kodit të Punës, me aktorë ndërveprues MMSR dhe DAP;
8. Rekomandohet përditësimi i ligjit Nr.10 347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve” për të reflektuar ndryshimet strukturore dhe funksionale që dikton Reforma Administrativo-Territoriale (*minimalisht koncepti “komune” duhet abroguar nga trupi i aktit*);
9. Rekomandohet mbledhja dhe analizimi i kujdesshëm i problematikës që përballin NJMF në zonat rurale për ta adresuar atë në kushtet e reja të krijuara brenda strukturës organizative të bashkive të mëdha.
10. Rekomandohet, aty ku është e nevojshme, të nisë reduktimi gradual i personelit me funksione të trifishta në nivel të NJA dhe profilizimi i plotë i tyre në garantimin dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve.

PROFILET E 61 BASHKIVE TE REJA

- të dhënat demografike
- të dhënat social ekonomike
- situata e stafeve të përkrahjes sociale (inventarizimi i plotë)
- të dhëna juridiksionale, administrative, territoriale

Bashkia e re Belsh

Të dhëna demografike, administrative dhe territoriale

Zona Gjeografike: Bashkia e re e Belshit kufizohet në veri me bashkinë Peqin, në lindje me bashkinë Cërrik, në jug me bashkinë Kuçovë dhe në perëndim me bashkinë Lushnje. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Belshit.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, kjo bashki numëron 19.503 banorë dhe densitet prej 99.28 banorë për km², ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil kjo bashki ka një popullsi prej 32.389 vetë dhe densitet prej 168.88 banorë për km². Sipërfaqja e bashkisë së re është 196.44 km².

Bashkia Belsh ka ne perberje edhe 4 njesi të tjera administrative, të cilat janë: Grekan, Kajan, Fierzë dhe Rrasë. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Elbasanit dhe qarkut të Elbasanit. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 34 fshatra (*bashkalidhur me poshte lista e plotë të qyteteve dhe fshatrave të kësaj bashkie*).

Bashkia e re e Belshit shtrihet pothuajse tërësisht në pllajën kodrinore karstike të Dumresë, një zonë kodrash të buta me bazë gëlqerore mbi të cilat është krijuar një panoramë piktoreske me 85 liqene karstike me një sipërfaqe të përgjithshme prej 14.2 km².

Profili social-ekonomik

Një pjesë e banorëve të kësaj zone janë të ardhur nga rrethi i Gramshit në kohën e mbretit Zog, por edhe pas çlirimit të vendit.

Belshi është një bashki me popullsi tërësisht rurale me produkte të diversifikuara nga blegtoaria të zarzavatet dhe bostanoret, por një numër fermerësh janë përqendruar në kultivimin e duhanit, për të cilin janë specializuar. Aktualisht ka një tendencë për braktisje të tokës bujqësore, si rezultat edhe i levizjeve migratore brenda dhe jashtë vendit.



Sfidat pas ndarjes Administrativo-Territoriale

Për shkak se zona është rurale, zhvillimi i infrastruktures nderlidhese eshte nje sfide. Vetë të ardhurat e bashkisë së re pritet të jenë të pamjaftueshme për të zhvilluar shërbimet publike bazë në bashkinë e re Belsh. Hartzimimi i ndihmës ekonomike dhe grupeve në nevojë është i domosdoshëm. Nje sistem i ri ndihmes ekonomike duhet akoma të instalohet dhe të vihet në efience. Prioritarizimi duhet të jetë një politike konstante e admisnitrates së re, për të garantuar qe ndihma shkon tek ata që kanë më nevojë. Rritja e nivelit arsimor të stafeve të ndihmës ekonomike gjithasht është një sfidë.

Ofrimi i shërbimeve të bashkisë në të gjithë popullatën/subjektet e shpërndarë në territorin rural është gjithashtu një sfidë.

Aktivitetet për fëmijë dhe të rinj, promovimi dhe garantimi i të drejtave të tyre janë një sfidë krejt e re për këtë bashki.

Inventarizimi i personelit te Ndhimes Soc-Eko dhe NJMF

Nga vlerësimi i realizuar, rezulton se numri i pozicioneve të amalgamuara në strukturën e bashkisë së re Belsh për personelin e përkrahjes ekonomike dhe sociale është ne total “6”, (Shih Listen e inventarizuar).

Nga të dhenat e mbledhura rezulton se raporti gjinor është 4 me 1 në favor të burrave (mungojnë të dhëna për NJA Grekan).

Sa i takon shkollimit dhe/ose edukimit universitar, rezulton se të paktën 2 nga personeli prej 6 personash (që rezultoi nga HR due Diligence), janë me arsim të mesëm; pjesa tjetër (4) janë me arsim të lartë. Në varësi të politikave që do të ndjekë MMSR, sugjerohet ngritja e nivelit arsimor të stafit të targetuar përmes kualifikimit të posaçëm ose përmes rekrutimit të burimeve

njerëzore me arsimit me të përshtatshëm. Rezulton gjithashtu se 2 nga 6 punonjësit ndihmës ekonomike dhe përkrahjes sociale kanë statusin e nëpunësit civil (bashkia-qendër Belsh), kurse pjesa tjetër janë me “kontratë pune” pa afat.

Sipas të dhënave të ofruara nga ASHMDf, në bashkinë Belsh dhe NJA-të tashmë pjesë e saj (ish komunat), duhet të ishin katër punonjësit që kryejnë *pjesërisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF, sipas *percaktimeve të ligjit Nr.10 347, datë 4.11.2010 “Per mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”*. Vlerësimi i realizuar nga INFOÇIP në periudhën Korrik-Shtator 2015 konkludoi se asnjë nga katër emrat e referuar nga ASHMDf nuk figuronte në marrdhënie pune (*markuar me blu në tabelë*). Rekomandohet përcaktimi eksplicit i të paktën një pozicioni për NJMF në strukturën organizative për vitin 2016.

Bashkia Belsh								
Nr	Emri Mbiemri	Pozicioni i punes	Sektori	Data e fillimit	Lloji i kontrates se punes	Edukimi/ Kualifikimi	Ekperienca e punes ne njesi	Kategori te mbrojtura
Zyra e Ndhimes Ekonomike								
1		Pergj.i Ndhimes Ekonomike	Ndihma ekonomike	01.02.2012	Nepunes civile	Diplome universiteti Punonjes sociale	3.1-vjet	
2		Inspektore Sociale	Ndihma ekonomike	24.02.2014	Nepunes civile	Diplome Universiteti Admini-biznes	1-vit	
Njesia administrative Fierzë								
3		Punonj. Nd.Ekonomike	Nd.Ekonomike	2013	Kontrat me afat	Shkolla e Mesme	2 vjet	
Njesia administrative Rrasë								
4		Punonj. Nd.Ekonomike	Drejtoria e Finances dhe Nd.Ekonomike	2015	Kontrat pa afat	Shkolla e Mesme	3 muaj	
Njesia administrative Kajan								
5		Punonj. Nd.Ekonomike	Nd.Ekonomike	2007	Kontrat me afat	I Larte Mesuesi	8 vjet	
Njesia administrative Grekan								
6		Punonj. Nd.Ekonomike	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	

Bashkia Belsh, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrative Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrit Civil	Sipërfaqja KM ²
Elbasan	Qyteti Belsh	Belsh	Fshatrat; Belsh Qëndër, Çepe, Dushk, Belsh, Stanaj, Shkozë, Qafë Shkallë, Seferan, Trojas, Shkëndi, Gradisht, Marinëz, Shtith	19,503	32,389	196.44
		Grekan	Fshatrat; Grekan, Dëshiran, Guras, Rrenës			
		Kajan	Fshatrat; Kajan, Dragot, Lisaj, Dragot-Dumre, Gjinuk, Gjolen, Turbull, Çestije, Merhoj, Drizaj			
		Fierzë	Fshatrat; Fierzë, Hardhi, Çerragë, Kosovë			
		Rrasë	Fshatrat; Rrasë e Sipërme, Shegas, Guri i Bardhë, Rrasë e Poshtme			

Bashkia e re Berat

Të dhëna demografike, administrative dhe territoriale

Bashkia e re Berat kufizohet në veri me bashkitë Kuçovë dhe Ura Vajgurore, në lindje me bashkinë Gramsh dhe Skrapar, në jug me bashkinë Poliçan, ndërsa në perëndim me bashkinë Mallakastër. Kryeqendra e bashkisë është qyteti i Beratit.

Sipas Censusit të vitit 2011, bashkia e re numëron 60.031 banorë, ndërsa sipas Regjistrit Civil ajo numëron një popullsi prej 98.875 banorë. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 379.98 km².


Bashkia e re Berat ka nën varësi edhe 4 njësi administrative, të cilat janë: Velabisht, Otlak, Sinjë dhe Rroshnik (ish komuna). Të gjitha NJ.A. janë pjesë e qarkut Berat. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 50 fshatra (*me poshtë lista e plotë*).

Zhvillimi social ekonomik

Qyteti i Beratit mbart vlera historike dhe arkitektonike të rëndësishme. Në vitin 2008 ai u përfshi në listën e trashëgimise botërore të UNESCO. Në 2014, qyteti përfitoi nga Fondi Shqiptaro-Amerikan investimin për pedonalen e qytetit, dhe po kështu u restaurua edhe Ura e Goricës (monument kulture).

Qyteti i Beratit, pas mbylljes së fabrikave dhe kombinatit të tekstileve vite më parë, i siguron të ardhurat kryesisht përmes turizmit, biznesit fason, si dhe prodhimit e tregtimit të produkteve të konservuara. Niveli papunësisë mbetet megjithatë i lartë.

Sa i takon NJësive Administrative, Velabishti dhe Otlaku, janë zona kryesisht fushore dhe pjellore, ku të ardhurat kryesore sigurohen nga prodhimi i perimeve ullinjve dhe vreshtarisë. Ndërkohë Rroshniku dhe Sinja, kanë reliev kodrinoro-malor dhe të ardhurat kryesore sigurohen nga pemëtaria dhe blegtoaria.



Sfidat e pas ndarjes Administrativo-Territoriale

Vënia në efikasitet të plotë e infrastruktures rrugore që lidh qendrën me fshtatrat, si dhe e mjeteve të tjera të ndërlidhjes dhe komunikimit përben një parakusht për mirefunksionimin e bashkisë dhe adresimin e problematikës për zgjidhje integrale.

Qyteti është karakterizuar dekadat e fundit nga një depopullim i shpejtë (banorëve kanë levizuar drejt qendrave më të mëdha urbane). Gjatë të njëjtës periudhë ka pasur dhe një lëvizje më të vogël të popullatës nga zonat rurale drejt qytetit të Beratit. Frenimi i largimit të popullatës për shkaqe social ekonomike mbetet një sfidë e cila duhet adresuar përmes politikave të punësimit. Përditësimi i databazës së ndihmës ekonomike është një sfidë në kushtet e reja të krijuara.

Komuniteti rom i këtij qyteti është i integruar, por megjithatë mbeten pjesa më e prekur e popullatës nga problemet social-ekonomike, si papunësia, mungesa e strehimit, etj.

Levrimi i ndihmës ekonomike në fshatra, sikurse dhe krijimi i një baze racionale taksimi mbi aktivitetin e pakët ekonomik përbëjnë gjithashtu një sfidë.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Nga vlerësimi rezulton se numri i pozicioneve të amalgamuara në strukturën e bashkisë së re Berat për personelin e ndihmës ekonomike dhe kujdesit social është “12”. Raporti gjinor është 8 me 7 në favor të grave. Sa i takon shkollimit dhe/ose edukimit, rezulton se i gjithë personeli është me shkollë të lartë (formim universitar). Janë 10 punonjës që gëzojnë statusin e nëpunësit civil; 8 prej tyre punojnë në Bashkinë e Beratit (qendër), një në NJA Otllak dhe një tjetër në NJA Velabisht. Pjesa tjetër (2) kanë kontratë pune “pa afat.

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë së re Berat duhet të jenë 4 punonjës që ushtrojnë *njëkohësisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas percaktimeve të ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP konfirmoi nominalisht vetëm 3 prej tyre (*me ngyre portokalli*). Nuk konfirmohet emri (jo funksioni) i 1 punonjësit të NJMF në NJA Roshnik (me blu). Rekomandohet përcaktimi eksplicit i të paktën një pozicioni për NJMF në strukturën organizative për vitin 2016.

Bashka Berat

Nr	Emri Mbiemri	Pozicioni i punes	Sektori	Data e fillimit	Lloji kontrates i se	Edukimi/ Kualifikimi	Ekperienca e punes ne njesi	Kategori te mbrojtura me ligj
DREJTORIA E SHERBIMEVE SOCIALE DHE E RINISE								
1		Drejtores	Sherb Sociale		Nëpunës Civil	I lartë		
2		Spec. Sherb. Soc. Bar. Gjinore	Sherb Sociale		Nëpunës Civil	I lartë		
3		Specialiste e paafetise	Sherb Sociale		Nëpunës Civil	I lartë		
4		Spec. Invalideve Punes	Sherb Sociale		Nëpunës Civil	I lartë		
5		Spec Ndhm Ekonomike Raj 1	Sherb Sociale		Nëpunës Civil	I lartë		
6		Spec. Ndhm Ekonomike Raj 2	Sherb Sociale		Nëpunës Civil	I lartë		
7		Spec. Ndhm Ekonomike Raj 3	Sherb Sociale		Nëpunës Civil	I lartë		
8		Spec Ndhm Ekonomike Raj 4	Sherb Sociale		Nëpunës Civil	I lartë		
Njesia administrative Roshnik								
9		Insp I nd ekonomike	Nd ekonomike	16.09.1992	Kontrate pa afat	Diplome Universiteti ne Ekonomi	22 vjet	
Njesia administrative Sinje								
10		Specialist Nd ekonomike	Nd ekonomike	2007	Kontrate pa afat	Diplome Universiteti ne Ekonomi	8 vjet	
Njesia administrative Otllak								
11		Admin e larte e nd ek	Nd ekonomike	2012	Nenpunes Civil	Diplome Universiteti ne Ekonomi	3 vjet	
Njesia administrative Velabisht								
12		Pergj I nd ekonomike	Ndhma ekonomike	2013	Nenpunes Civil	Diplome Universiteti Pune Sociale	2 vjet	

Bashkia Berat, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrative Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Berat	Qyteti Berat	Berat	Qyteti Berat	60,031	98,875	379.98
		Velabisht	Fshatrat; Malinat, Bilçë, Drobonik, Bardhaj i Ri, Starovë, Velabisht, Vetterrik, Remanicë, Gjoroven, Palikësht, Veleshnje, Duhanas, Kodras			
		Otlak	Fshatrat; Lapardha 1, Lapardha 2, Qereshnik, Balibardhë, Dyshnik, Moravë, Ullinjas, Vodëz e Sipërme, Orizaj, Otlak			
		Sinjë	Fshatrat; Sinjë, Mbolan, Mbjeshovë, Mbreshtan, Galinë, Sadovicë, Paftal, Kamçisht, Levan, Velçan, Osmënzëzë 1, Osmënzëzë 2, Plashnik i Vogël, Molisht			
		Roshnik	Fshatrat; Bogdan i Poshtëm, Bogdan i Sipërm, Dardhë, Karkanjoz, Kostren i Madh, Kostren i Vogël, Mimias, Perisnak, Qafë Dardhë, Roshnik Qendër, Roshnik i Vogel, Vojnik, Rabjak			

Bashkia e re Bulqizë

Të dhëna demografike, administrative dhe territoriale

Bulqiza kufizohet në veri me Bashkinë e Dibrës, në perëndim me Bashkinë Klos, në jug-perëndim me Bashkinë Tiranë, në jug me Bashkinë Librazhd dhe në lindje me Republikën e Maqedonisë. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Bulqizës.

Sipas Censurit të vitit 2011 ka një popullsi prej 32,210 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki numëron 4,223 banorë. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 678.51 km² me një densitet prej 59.28 banorë/km² sipas Regjistrimit Civil dhe 47.47 banorë/km² sipas Censurit 2011.

Bashkia Bulqizë ka në përbërje 7 Njësi Administrative: Martanesh, Fushë-Bulqizë, Zërëqan, Shupenzë, Gjoricë, Ostren dhe Trebisht. Të gjitha njësitë administrative janë pjesë e qarkut të Dibrës. Bashkia e re ka nën administrimin e saj dy qytete (Bulqiza dhe Krasta) dhe 63 fshatra. *(bashkalidhur lista e plotë).*

Zhvillimi social ekonomik i deritanishëm

Popullsia e Bulqizës është në shumicë dërmuese e besimit mysliman dhe një pakicë fare e vogël i përket besimeve të tjera. Në zonën e Gollobordës ka edhe një pakicë të deklaruar maqedonase, që sipas regjistrimeve të Censurit 2011 arrin në 19 persona. Megjithatë, kjo shifër është e mangët po të kemi parasysh se shumë banorë nuk i janë përgjigjur pyetjes për të deklaruar përkatësi etnike.

Bujqësia dhe blegtoaria, por sidomos industria e nxjerrjes së kromit dhe pasurimit të mineralit të kromit, janë burimet kryesore ekonomike. Ndërkohë, një tjetër burim ekonomik më pak i rëndësishëm konsiderohet edhe turizmi malor si dhe ngritja e grumbullimi i bimëve medicinale, me të cilat zona është mjaft e pasur.



Projekte të mëdha të ndërmarra gjatë viteve të kaluara si asfaltimi i segmentit të rrugës nacionale “Qafa e Buallit- Shupenzë”, si dhe hapjen e tunelit të po kësaj rruge në Qafën e Buallit me gjatësi 460 metër dhe trasenë Qafa e Buallit-Ura e Vashës kanë lehtësuar lëvizjen dhe transportin. Investime të rëndësishme janë edhe sistemim-asfaltimet e rrugëve rurale që lidhin NJA Zërëqan, Fushë-Bulqizë dhe Gjoricë, me rrugën nacionale.

Sfidat

Popullsia në përgjithësi është e varfër. Ka patur me dhjetëra raste të raportimit të punës së fëmijëve në miniera dhe në aktivitetin e grumbullimit të mineralit të kromit, disa prej të cilave kanë qenë fatale. Fenomeni duhet adresuar me urgjencë. Ndër problematikat kryesore të zonës mbetet papunësia, që shkon në rreth 40 për qind të fuqisë së aftë për punë. Nuk ka qendra sociale për të moshuarit dhe invalidët. Sistemi i ndihmes ekonomike tashmë duhet të jetë i rakorduar dhe i aftë të kapërcejë vështirësitë infrastrukturore sidomos gjatë muajve të dimrit. Edhe përkrahja sociale për invalidët e punës ose familjet me një prind për shkak të aksidentëve në miniera duhet sjelle në eficiencë.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Ne total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Bulqizë për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është "10", (Shih Listen).Raporti gjinor është 5 me 5. Sa i takon shkollimit, 5 janë me diplomë universitare kurse 5 janë më shkollë të mesme. Në varësi të politikave që do të ndjekë MMSR, sugjerohet ngritja e nivelit arsimor të stafit të targetuar përmes kualifikimit të posaçëm ose përmes rekrutimit të burimeve njerëzore me arsimin të përshtatshëm. Vetëm 1 punonjes ka statusin e nëpunësit civil (NJA Shupenzë), kurse pjesa tjetër janë me "kontratë pune" pa afat.

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë së re Bulqizë duhet të jenë 4 punonjës që ushtrojnë *njëkohësisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas percaktimeve të ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP konfirmoi nominalisht vetëm 2 prej tyre (*me ngyre portokalli*). Nuk konfirmohet emri (jo funksioni) i 2 punonjësve të NJMF në NJA Ostren dhe Gjoricë (me blu). Rekomandohet përcaktimi eksplicit i të paktën një pozicioni për NJMF në strukturën organizative të bashkisë së re Bulqizë për vitin 2016.

Bashkia Bulqizë								
Nr	Emri Mbiemri	Pozicioni i punes	Sektori	Data e fillimit	Lloji i kontrates se punes	Edukimi/ Kualifikimi	Ekperienca e punes ne njesi	Kategori te mbrojtura
1		Drejtor drejtorie	Sh.Social	2013	Kontrate pa afat	Diplome Universiteti ne Ekonomik	1 vit e 8 muaj	
2		Specialist	Sh.Social	2013	Kontrate pa afat	Diplome Universiteti ne Cikel I Ulet	1 vit e 6 muaj	
3		Specialist	Sh.Social	2014	Kontrate pa afat	Diplome Universiteti ne Inxhinieri Materiale	1 vit e 8 muaj	
Njesia administrative Zerqan								
4		Përgjegjës N.E	Sek. N. Ekonomike	2007	Kontratë me afat	Shkollë e mesme	8 vjet	
Njesia administrative Trebisht								
5		Përgjegjës Ndhma Ekonomike	Sek. N. Ekonomike	3/15/2014	Kontratë me afat	Shkollë e mesme	3 vjet	
Njesia administrative Shupenzë								
6		Përgjegjës N.E	Sek. N. Ekonomike	1/1/2015	Nëpunës Civil	Diploma Universitare Inxhinieri Pyje	2 vjet	
Njesia administrative Ostren								
7		Përgjegjës N.E	Sek. N. Ekonomike	2008	Kontratë me afat	Shkollë e mesme	7 vjet	
Njesia administrative Martanesh								
8		Përgjegjës N.E	Sek. N. Ekonomike	9/19/2001	Kontratë me afat	Shkollë e mesme	13 vjet	
Njesia administrative Gjoricë								
9		Përgjegjës N.E	Sek. N. Ekonomike	11/17/2011	Kontratë me afat	Diploma Universitare Ekonomik	3 vjet	
Njesia administrative Fushë Bulqizë								
10		Inspektor Mbrojtja Sociale Nd. Ekonomike	Sektori Mbrojtja Sociale Ndhma Ekonomike	8/1/2011	Kontratë me afat	Shkollë e mesme	8 vjet	

Bashkia Bulqizë, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrative Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja K
Dibër	Qyteti Bulqizë	Bulqizë	Qyteti Bulqizë, Fshatrat; Vajkal nr1, Vajkal nr 2	31,210	40,223	678.51
		Martanesh	Qyteti Krastë, Fshatrat; Gjon, Lenë, Peshk, Val, Stavec, Mëlçu, Ndërfushas			
		Fushë-Bulqizë	Fshatrat; Fushë - Bulqizë, Dushaj, Dragua, Koçaj			
		Zerqan	Fshatrat; Zerqan, Krajë, Peladhi, Smollik, Sofraçan, Sopot, Strikçan, Tërnovë e Madhe, Tërnovë e Vogël, Valikardhë, Zall-Sopot, Zall-Strikçan, Godvi			
		Shupenzë	Fshatrat; Shupenzë, Vlashaj, Boçevë, Homesh, Okshatinë, Kovashicë, Zogaj, Shtushaj, Topojan, Mazhicë, Gjuras, Bllacë			
		Gjoricë	Fshatrat; Gjoricë e Sipërme, Gjoricë e Poshtme, Çerenec i Sipërm, Çerenec i Poshtëm, Viçisht, Lubalesh			
		Ostren	Fshatrat; Ostren i Madh, Radovesh, Kojavec, Lejçan, Orzhanovë, Okshtun i Madh, Oreshnjë, Okshtun i Vogël, Ostren i Vogël, Tuçep, Lladomericë, Pasinkë, Tërbaç			
		Trebisht	Fshatrat; Klenjë, Gjinovec, Trebisht- Balaj, Trebisht- Çelebi, Trebisht- Mucinë, Vërnice			

Bashkia e re Cërrik

Të dhëna demografike, administrative dhe territoriale

Cërriku kufizohet në veri me bashkitë Elbasan dhe Peqin, në jug-lindje me bashkinë Gramsh, në jug me bashkinë Kuçovë dhe në perëndim me bashkinë Belsh. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Cërrikut.

Sipas Censurit të vitit 2011, kjo bashki numëron 27,445 banorë me densitet prej 144.71 banorë për km², ndërsa që sipas Regjistrimit Civil kjo bashki numëron një popullsi prej 46,652 vetë, me dendësi prej 189.65 banorë për km². Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 189.65 km².

Bashkia Cërrik ka nën varesi 4 njësi administrative: Gostimë, Mollas, Shalës dhe Klos. pjesë të qarkut Elbasan. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 28 fshatra. *(bashkalidhur me poshte lista e plotë).*

Zhvillimi social ekonomik i deritanishem

Bashkia e re e Cërrikut shtrihet në një zonë fushore dhe kodrinore, në mes të lumenjve Shkumbin dhe Devoll. Cërriku u shpall si qytet më 1952 me ndërtimin e Uzinës së Përpunimit të Naftës dhe një termocentrali, të cilat iu shtuan qendrës së shërbimeve për bujqësinë. Në vitet 1990 rafineria e naftës pushoi së ekzistuari duke sjellë largimin e pjesës më të madhe të rinisë nga ky qytet ndërsa pjesa e mbetur e popullsisë ka burime të pakta ekonomike nga pensionet, ndihma ekonomike dhe remitancat. Aktualisht 459 familje trajtohen me ndihmë ekonomike por numri i kërkesave sa vjen e shtohet. Kjo përbën pjesën dërrmuese të familjeve të kësaj qyteze me rreth 7 mijë banorë. Instituti i Duhanit i cili shërbente dikur për kultivimin e kësaj bime është mbyllur prej kohësh ndërsa nga të paktat institucione publike është Radiostacioni funksional



ende por me personel të kufizuar. Zona e Cërrikut mund të përfitojë në terma afatmesëm social ekonomike nga projekti i hidrocentralit të Banjës mbi lumin Devoll, i cili është aktualisht në ndërtim.

Sfidat e pushtetit të ri vendor

Bazuar në shqetësimet e komunitetit, bashkia e re pritët të përballët me sfidën e madhe të papunësisë dhe varfërisë në zonën urbane dhe hartimin e politikave fiskale të cilat do të mund të nxisin hapjen e bizneseve të reja, tërheqjen e ndërmarrjeve fason, por dhe shfrytëzimin e shumë prej ndërtesave të ndërmarrjeve shtetërore të mbyllura tashmë.

Numri i madh i papunësisë dhe i familjeve në nevojë, do kërkojë nga bashkia ngritjen e mekanizmave transparentë të menaxhimit e skemës së ndihmës ekonomike, si dhe mundësinë e ngritjes së banesave sociale dhe shërbimeve sociale në ndihmë të tyre. Mbështetja për ngritjen e shkollave të arsimit profesional në këtë zonë identifikohet nga komuniteti si një tjetër nevojë e cila duhet të adresohet nga bashkia e re krahas ripërtëritjes së aktiviteteve kulturore dhe sportive për fëmijët dhe të rinjtë e zonës. Duke qenë se një pjesë e të ardhurave në këtë bashki sigurohen përmes bujqësisë dhe pemëtarisë, politika konkrete në ndihmë të infrastrukturës bujqësore, si rregullimi i kanaleve kulluese ose sistemeve vaditëse janë sfida për t'u përballur

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Ne total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Cërrik për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është “7” (Shih Listen). Raporti gjinor është 6 me 1 ne favor te grave. Sa i takon shkollimit, kater (4) janë me diplomë universitare kurse 3 janë më shkollë të mesme. Në varësi të politikave që do të ndjekë MMSR, sugjerohet ngritja e nivelit arsimor të stafit të targetuar përmes kualifikimit ose rekrutimit të burimeve njerëzore me arsimin të përshtatshëm. Rezulton se asnje punonjesis e ndihmës ekonomike dhe përkrahjes sociale ne

kete bashki nuk gezon statusin e nëpunësit civil; ata janë te gjithë me kontratë pune “pa afat”.

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë e re Cërrik duhet të jenë 5 punonjës që ushtrojnë *njëkohësisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas percaktimeve te ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP konfirmoi 5 të punonjësit (*me ngyre portokalli*). Rekomandohet përcaktimi eksplicit i të paktën një pozicioni për NJMF në strukturën organizative të bashkisë së re Cërrik për vitin 2016.

Bashkia Cërrik

Nr	Emri Mbiemri	Pozicioni i punes	Sektori	Data fillimit e	Lloji i kontrates se punes	Edukimi/ Kualifikimi	Ekperienc a e punes ne njesi	Kateg ori te mbroj tura
Sektori I Mbrojtjes Sociale								
1		Pergjegjese Sektori I Mbrojtjes Sociale	Mbrojtjes Sociale	2011	Me kontrate	Diplome Universitare Pune Sociale	4 Vjet	
2		Insp.Politikave Sociale	Mbrojtjes Sociale	1995	Me kontrate	Diplome Universiteti ne Ekonomik	13 Vjet	
3		Specialist I Paaftesise & Invaliditeti	Mbrojtjes Sociale	2011	Me kontrate	Diplome Universiteti ne Ekonomik	4 Vjet	
Njesia administrative Gostimë								
4		Inspektore e ndihmes Ekonomike	Ndihmes ekonomike	2000	Kontrate pa afat	Shkolle e mesme	15 vjet	
Njesia administrative Klos								
5		Inspektore e Ndihmes Ekonomike	Ndihma Ekonomike	2004	Kontrate me afat	Shkolle e mesme	11 vjet	
Njesia administrative Shales								
6		Administratore dhe llogaritare + Nd.Ekonomike	Finance	2000	Kontrate me afat	Shkolle mesme ndertim	15 vjet	
Njesia administrative Mollas								
7		Administratore	Perkrahjes Sociale	03.04.2013	Kontrate pa afat	Diplome 'Administrim Publik' ne	2 vjet	

Bashkia Cërrik, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrative Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja K
Elbasan	Qyteti Cërrik	Cërrik	Qyteti Cërrik	27,445	46,652	189.65
		Gostimë	Fshatrat; Gostimë, Gjyral, Shtepanj, Shushicë, Shtermen, Malasej, Çartalloz			
		Mollas	Fshatrat; Mollas, Selitë, Kamuna, Dragot, Topojan, Linas, Dasar			
		Shalës	Fshatrat; Shalës, Liçaj, Kurtalli, Xibrakë, Xherie, Kodras			
		Klos	Fshatrat; Klos, Selvias, Qyrkan, Lumas, Qafë, Floq, Trunç, Banjë			

Bashkia e re Delvinë

Të dhëna demografike, administrative dhe territoriale

Bashkia e re e Delvinës kufizohet në veri me bashkitë Himarë e Gjirokastrë, në jug me bashkitë Sarandë dhe Finiq, në lindje me bashkinë Dropull. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Delvinës.

Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia e re numëron 7,598 banorë, ndërsa sipas Regjistrimit Civil kjo bashki ka një popullsi prej 18,078 personash. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 182.9 km². Densiteti i popullsisë sipas censurit është 45.5 banorë/km² ndërsa sipas regjistrimit civil është 99 banorë/km².

Bashkia ka nën varesinë e evt njësinë administrative Vergo. Bashkia e re është pjesë e rrethit të Delvinës dhe qarkut Vlorë. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 17 fshatra.

Zhvillimi social ekonomik i deritanishëm

Qyteti i Delvinës ka kultivuar një histori të pasur të bashkëjetesës fetare mes myslimanëve, kristianëve (dhe hebrenjve dikur). Bashkia e re ka popullsi të konsiderueshme të minoritetit grek.

Bashkia e Delvinës ka në territorin e saj edhe një vendburim gazi, i cili aktualisht shfrytëzohet nga një kompani koncesionare private. Banorët kanë shqetësime për cilësinë e ujit të pijshëm në qytet. Ndryshe nga qyteti i Delvinës, komuna Vergo është një zonë e gjerë rurale me densitet të ulët të popullsisë.

Bujqësia, blegtoria dhe vreshtaria, krahas institucioneve publike janë burimet kryesore ekonomike të zonës. Ndihma sociale është një mekanizëm që aktivizohet për zbutjen e varfërisë, krahas emigracionit në vendin fqinj, Greqi. Ndërtimi i një ujësjellësi të ri në qytetin e Delvinës dhe ndërtimi i infrastrukturës rrugore për fshatrat e komunës Vergo janë dy sfidat kryesore që bashki të fillojë të jetë funksionale në ofrimin e shërbimeve të saj.



Sfidat e pushtetit vendor pas ndarjes së re

Papunësia është shumë e lartë. Një pjesë e popullsisë punon në Sarandë. Largimi i popullsisë në moshe të reja ka krijuar vështirësi.

Mirëmbajtja e shkollave apo qendrave shëndetësore do të kërkojë që bashkia e re të ketë burimet e nevojshme njerëzore për të aplikuar me sukses në skemën e granteve të qeverisë qendrore për pushtetin vendor.

Skema e ndihmës ekonomike ka nevojë të përshtatet me kushtet e reja territoriale. Databaza duhet përditësuar. Qyteti ka edhe një pjesë të popullsisë që i përket komunitetit rom dhe rrjedhimisht ka nevojë të adresojë problemet e këtij komuniteti dhe të ofrojë mbështetje financiare për të.

Afërsia me Sarandën krijon treg për fermerët e Delvinës (aktiviteti kryesor që gjeneron të ardhura për popullsinë dhe për bashkinë përmes taksave), por mungesa e infrastrukturës rrugore dhe zhvendosja e popullsisë së aftë për punë nga zona rurale krijon vështirësi të shumta në këtë drejtim.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Ne total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Delvinë për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social (femijet, etj) është kater “4”, (Shih Listen).

Raporti gjinor është 3 me 1 ne favor te grave.

Sa i takon shkollimit, që te tre (3) punonjaset e bashkise Delvine (qendrër) janë me diplomë universitare kurse ai i njesise Administrative Vergo rezulton me shkollë të mesme.

Tre (3) nga kater (4) punonjesit e qe targeton vleresimi ne Bashkine e re Delvine ka statusin e nëpunësit civil, (shih tabelen).

Sipas të dhënave të ofruara nga ASHMDF, në bashkinë Delvinë dhe NJA-të tashmë pjesë e saj (ish komunat), duhet të jenë 3 punonjës që kryejnë *pjesërisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF, *sipas percaktimeve te ligjit Nr.10 347, datë 4.11.2010 “Per mbrojtjen e te drejtave te fëmijëve”*. Vlerësimi i realizuar nga INFOÇIP në periudhën Korrik-Shtator 2015 konkludoi se një nga emrat e referuar nga ASHMDF nuk figuronte në marrdhënie pune (*markuar me blu në tabelë*). Rekomandohet përcaktimi eksplcit i të paktën një pozicioni për NJMF në strukturën organizative të bashkisë së re Delvinë për vitin 2016.

Bashkia Delvine								
Nr	Emri Mbiemri	Pozicioni i punes	Sektori	Data fillimit e	Lloji kontrates i punes se	Edukimi/ Kualifikimi	Ekperienca punes ne njesi e	Kategori te mbrojtura
1		Specialiste e larte e ndihmes Ekonomike	Financa	15.11.2007	Nepunes Civil	I larte ,Histori Gjeografi	9 vjet e 2 muaj	
2		Inspektore e Ndhimes Ekonomike	Finance	18.09.2008	Nepunes Civil	Ilarte.Punonjese Sociale	6 vjet e 7 muaj	
3		Spec.Bara.Gjin/Inf/Tur	Personelit	26.12.2014	Nepunes Civil	I larte ,Ekonomi Turizem	4 muaj	
Njesia administrative Vergo								
4		Ad Shoqero	Nd. Ekonom	05.01.2000	Kontrate pa afat	m bujqes	15 vjet	

Bashkia e re Devoll

Të dhëna të përgjithshme

Devollit kufizohet në veri me Bashkinë Pustec, në perëndim me bashkitë Maliq dhe Korçë, në jug me bashkinë Kolonjë, ndërsa në lindje me Greqinë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Bilishtit.

Sipas Censusit të vitit 2011, bashkia e re numëron 26.716 banorë, ndërsa sipas Regjistrit Civil kjo bashki numëron një popullsi prej 42.388 vetësh. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 453.27 km².

Kjo bashki ka nën varesi 4 njësi administrative: Qendër Bilisht, Hoçisht, Progër dhe Miras. Të gjitha njësitë administrative janë pjesë e qarkut të Korçës. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 44 fshatra. (shiko listen e detajuar me poshte).

Zhvillimi social ekonomik i deritanishem

Bashkia e Devollit është një zonë që dominohet nga popullsia fshatare. Sigurimi i të ardhurave mbështeten në dy burime kryesore, bujqësia dhe blegtoria nga njëra anë dhe remitancat nga emigracioni nga ana tjetër.. Zona ka një popullsi të dendur dhe mungesa e vendgrumbullimeve dhe përpunimit të mbetjeve urbane ka sjellë ndotje në nivele të larta, çka ngre domosdoshmërinë që bashkia e re të ngrejë mekanizma për mbledhjen dhe menaxhimin e tyre në të gjithë zonën, me synim edhe gjenerimin e punësimit dhe të ardhurave.

Shumë zona të Devollit kanë pësuar zhvendosje masive të popullsisë ku banorët kanë braktisur totalisht fshatrat e thellë për t'u vendosur në zona më afër qytetit duke u fokusuar tek puna në bujqësi për shkak se toka është produktive. Banorët kanë gjetur zgjidhjet e tyre individuale duke u fokusuar më së shumti tek bujqësia. Furnizimi me ujë të pijshëm, klorifikimi i tij, por edhe rrjetet e kanalizimeve identifikohen si infrastruktura të amortizuara, ku kërkohet ndërhyrje urgjente.



Sfidat e pushteti vendor pas ndarjes së re

Për shkak të pozicionit të saj kufitar me shtetin grek, një numër i konsiderueshëm banorësh kanë emigruar prej vitesh, duke gjeneruar të ardhura jo vetëm për veten e tyre por edhe për familjet e fshatrave. Megjithatë, përgjatë viteve të fundit edhe kjo zonë është prekur nga rënia e ndjeshme e dërgesave valutore si pasojë e krizës greke. Ri-integrimi social ekonomik dhe gjetja e mundësive të reja të punësimit është një sfidë. Problemet e dhunes në familje janë raportuar shpesh 5 vitet e fundit.

Investimet në infrastrukturë kanë qenë të mjaftueshme, por ka mangësi në rrugët dytësore si dhe ndërlidhjen e fshatrave të thellë të njësive administrative Miras.

Nuk vihen re problem serioze të strehimit, për shkak të indit rural të popullatës, organizuar rreth familjes së madhe, që krijon një valvul për reduktimin e presionit social që prodhon mungesa e strehimit.

Për fëmijët dhe të rinjtë nuk ka ambiente dhe kënde sportive ndaj bashkia e re duhet të hartojë politika mbështetëse për ta. Sitet historike dhe arkeologjike të zonës, si Shpella e Trenit mund të promovonin turizmin arkeologjik, por kjo kërkon gjithsesi një qasje të kujdesshme dhe të të koordinuar.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Ne total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Devoll për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është pese “5”, (Shih Listen).

Raporti gjinor rezulton 3 me 2 ne favor te grave.

Sa i takon shkollimit, vetëm 1 është me diplomë universitare kurse 4 te tjeret janë me shkollë të mesme. Në varësi të politikave që do të ndjekë MMSR, sugjerohet ngritja e nivelit arsimor të stafit të targetuar nga ky HR Due Dilegence përmes kualifikimit të posaçëm ose përmes rekrutimit të burimeve njerëzore me arsimin të përshtatshëm.

Asnje nga punonjesit e ndihmës ekonomike dhe përkrahjes sociale nuk gezon statusin e nëpunësit civil; te gjithë figurojne ne marrdhenie pune me bashkine me “kontratë pa afat”.

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë së re Devoll duhet të jenë 3 punonjës që ushtrojnë *njëkohësisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas percaktimeve te ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP konfirmoi nominalisht të tre (emrat dhe pozicionet) (*me ngyre portokalli*). Rekomandohet përcaktimi eksplicit i të paktën një pozicioni për NJMF në strukturën organizative të bashkisë së re Devoll për vitin 2016.

Bashkia Devoll

Nr	Emri Mbiemri	Pozicioni i punes	Sektori	Data e fillimit	Lloji i kontrates se punes	Edukimi/ Kualifikimi	Ekperienca e punes ne njesi	Kategori te mbrojtura
1		Spec I niv te Larte	Nd.Ekonomike	2011	Kontrate pa afat	Diplome Universiteti ne Agronomi	4 Vjet	
Njesia administrative Qender Bilisht								
2		PERGJEGJESE E ZYRES SE NDIHMES EKONOMIKE	Nd.Ekonomike	3/12/2007	ME KONTRATE	I MESEM PERGJITHSHEM	8 VJET	S'ka
Njesia administrative Proger								
3		ADMINISTRATOR I NDIHMES EKONOMIKE DHE MAGAZINIER	FINANCE	16.05.2006	PA AFAT	ARSIM I MESEM	9	
Njesia administrative Miras								
4		Specialist I ndihmes ekonomike	Komuna Miras	20.06.2006	Me kontrate	Arsim I mesem	9 vjet	
Njesia administrative Hoçisht								
5		ADMINISTRATORE E NDIHMES EKONOMIKE	FINANCES	02. 08. 2004	Me kontrate	ARSIMI I MESEM I PERGJITHESHEM	11 VJET	

Bashkia Devoll, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrative Territorial

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Korçë	Qyteti Bilisht	Bilisht	Qyteti Bilisht	26,716	42,388	453.27
		Qendër Bilisht	Fshatrat; Bitinckë, Tren, Buzliqen, Vërnik, Vishocicë, Kuç, Poloskë, Kapshticë, Trestenik, Kurilë			
		Hoçisht	Fshatrat; Hoçisht, Grace, Baban, Stropan, Eçmenik, Përparimaj, Grapsh, Çipan, Borsh, Bradvicë			
		Progër	Fshatrat; Progër, Mançurisht, Cangonj, Pilur, Vranisht, Bickë, Rakickë, Shyec			
		Miras	Fshatrat; Miras, Vidohovë, Arrëz, Çetë, Qytezë, Sinicë, Nikolicë, Menkulas, Ponçarë, Braçanj, Koshnicë, Dobranj, Fitore, Ziçisht, Gjyres, Sul			

Bashkia e re Peshkopi

Të dhëna demografike, administrative dhe territoriale

Kufizohet në veri me Bashkinë e Kukësit, në veri-perëndim me bashkinë Mirditë, në perëndim me bashkinë Mat, në jug-perëndim me bashkinë Klos, në jug me bashkinë Bulqizë dhe në lindje me FYROM. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Peshkopisë. Bashkia e Dibrës është një nga bashkitë me territorin më të madh në rang vendi si dhe me një numër të konsiderueshëm fshatrash të shtrira në një zonë të thellë.

Sipas Censusit të vitit 2011, bashkia e re ka një popullsi prej 61,619 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrit Civil, kjo bashki numëron 78,940 banorë. Me një sipërfaqe prej 937.88 km², bashkia e re ka densitet popullsie prej 84.16 banorësh/km² sipas Regjistrit Civil dhe 65.70 banorë/km² sipas Censusit 2011.

Bashkia Peshkopi, ke nën varesi 14 njësi administrative: Tomin, Melan, Kastriot, Lurë, Maqellarë, Muhurr, Luzni, Selishtë, Sllovë, Kala e Dodës, Zall-Dardhë, Zall-Reç, Fushë Çidhën dhe Arras (pjesë e qarkut të Dibrës). Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 141 fshatra. (shih me poshte listën e plote)

Zhvillimi social ekonomik i deritanishem

Përgjatë 25 viteve të fundit Dibra ka pasur një migrim të brendshëm drejt Tiranës dhe Durrësit si dhe emigrim të konsiderueshëm jashtë vendit. Zona e Dibrës vijon të përdorë në shkallë të gjerë infrastrukturën rrugore të trashëguar nga koha e komunizmit, pa shumë përmirësime. Projekti i Rrugës së Arbërit mund të çlirojë nga izolimi bashkinë e re. Ndërtimi së fundmi i rrugës Peshkopi- Kukës ka nxjerrë disi nga izolimi pjesën veriore të krahinës. Bashkia e Dibrës është aktualisht një nga zonat më të varfëra të Shqipërisë, ku për një pjesë të madhe të popullsisë ndihma ekonomike e shpërndarë nga qeveria është burimi i vetëm i të ardhurave.



Projektet e mëdha, në këtë bashki lidhen me rehabilitimin e ujësjellësit të qytetit (Kala e Dodës-Peshkopi), sistemim-asfaltimin e segmentit të rrugës nacionale Peshkopi-Kukës, Peshkopi-Kastriot, Maqellarë-Herebel etj. Po kështu një investim i rëndësishëm ka nisur aktualisht edhe për rikonstruksionin e rrjetit të ujësjellësit të qytetit të Peshkopisë, me vlerë 4.2 milionë euro.

Sfidat e pushteti vendor pas ndarjes së re

Lidhja me infrastrukturë rrugore si dhe mirëmbajtja e saj pritet të jetë sfida më e madhe për shkak të numrit shumë të lartë të fshatrave(141). Taksimi i popullsisë rurale për të siguruar të ardhura është gjithashtu një sfidë. Ndër problematikat e kësaj zone mbetet ajo e papunësisë që shkon në rreth 45 për qind të fuqisë punëtore të aftë për punë, po të kemi parasysh edhe trendin në rritje të emigrantëve të kthyer në Dibrë.

Bujqësia si e vetmja mundësi punësimi që gjeneron të ardhura është lënë totalisht në harresë, fshatra të shumta me toka mjaft prodhuese dhe me sipërfaqe të mëdha u mungojnë kanalet vaditëse. Aplikimi i një sistemi efikas të ndihmës sociale është nga qendra në periferi është një sfidë. Ofrimi i shërbimeve sociale të kualifikuar për zonat e thella mbetet gjithashtu një sfidë.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Ne total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Pershkopi për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është “21”, (Shih Listen). Raporti gjinor është 6 me 15 ne favor te burrave. Vihet se se kjo dominace ruhet kryesisht ne zonat rurale, pra ne ish-komuna qe sot jane kthyer ne njesi administrative. Sa i takon shkollimit, 7 janë me diplomë universitare kurse pjesa tjeter me shkollë të mesme. Shtate (7) nga punonjesit e ndihmës ekonomike dhe përkrahjes sociale kane statusin e nëpunësit civil; te tjeret janë me kontratë pune “pa

afat”. Përvoja ne detyre e tyre eshte e konsiderueshme.

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë e re Peshkopi duhet të jenë 9 punonjës që ushtrojnë funksione në kuadër të NJMF. Vlerësimi i INFOÇIP konfirmoi nominalisht vetëm 5 prej tyre (*me ngyre portokalli*). Nuk konfirmohet emri (jo funksioni) i 4 punonjësve të NJMF në NJA Fishe, Çidhën, Melan, Muhurr dhe Tomin (me blu). Në strukturën ekzistuese rezulton një pozicion parashikuar posaçërisht për NJMF. Rekomandohet shtimi i një pozicioni më shumë në një nga NJA per vitin 2016.

BASHKIA PESHKOPI

Nr	Emri Mbiemri	Pozicioni i punes	Spektori	Data fillimit e	Lloji i kontrates se punes	Edukimi/ Kualifikimi	Ekperienca e punes ne njesi	Kategori te mbrojtura me ligj
1		Pergj Seksioni Nd Ekon	Ndihma Ekonomike		Nenpunes Civil	Jurist	5 vjet	
2		Specialist Administrator	Ndihma Ekonomike		Nenpunes Civil	Shkollë mesme e		
3		Specialist Administrator	Ndihma Ekonomike		Nenpunes Civil	Psikologji	2 vjet	
4		Administrator Nd Sociale	Ndihma Ekonomike		Kontratë me afat			
5		Insp e femijeve dhe grave	Ndihma Ekonomike		Nenpunes Civil	Sociologji	5 vjet	
6		Administratore per paaftesisne	Ndihma Ekonomike		Nenpunes Civil	mesem	7 vjet	
7		Spec Barazise Gjinore	Ndihma Ekonomike		Nenpunes Civil	Sociologji	4 vjet	
Njesia administrative Arras								
8		Përgjegjës Shërbimi Social Ndihma Ekonomike	Spektori Shërbime Sociale Ndihma Ekonomike	11/1/2000	Kontratë me afat	Diploma Universitare	15 vjet	
Njesia administrative Fushë Çidhën								
9		Përgjegjës Ndihma Ekonomike	Spektori i Ndhmës Ekonomike	2003	Kontratë pa afat	Shkollë mesme e	12 vjet	
Njesia administrative Kalaja e Dodës								
10		Përgjegjës Ndihma Ekonomike	Spektori Ndihma Ekonomike	12/1/2010	Kontratë me afat	Shkollë e mesme	7 vjet	

Njesia administrative Kastriot								
11		Përgjegjës Ndhma Ekonomike	Sektori Ndhma Ekonomike	5/1/1993	Kontratë pa afat	Diploma Universitare Ekonomik	22 vjet	
Njesia administrative Lurë								
12		Përgjegjës Ndhma Ekonomike	Sektori Ndhma Ekonomike	5/6/2007	Kontratë me afat	Shkollë e mesme	8 vjet	
Njesia administrative Luzni								
13		Përgjegjës Ndhma Ekonomike	Sektori Ndhma Ekonomike	3/1/2013	Kontratë pa afat	Shkollë e mesme	2 vjet	
Njesia administrative Maqellarë								
14		Përgjegjës Ndhma Ekonomike	Sektori Ndhma Ekonomike	2/4/1993	Nëpunës Civil	Diploma Universitare Ekonomik	22 vjet	
Njesia administrative Melan								
15		Përgjegjës Ndhma Ekonomike	Sektori Ndhma Ekonomike	2/16/2014	Kontratë me afat	Shkollë e mesme	12 vjet	
Njesia administrative Muhurr								
16		Përgjegjës Ndhma Ekonomike	Sektori Ndhma Ekonomike	11/15/2000	Kontratë me afat	Shkollë e mesme	15 vjet	
Njesia administrative Selishtë								
17		Përgjegjës Ndhma Ekonomike	Sektori Ndhma Ekonomike	3/1/2011	Kontratë pa afat	Shkollë e mesme	15 vjet	
Njesia administrative Sllovë								
18		Përgjegjës Ndhma Ekonomike	Sektori Ndhma Ekonomike	9/1/2011	Kontratë pa afat	Shkollë e mesme	4 vjet	
Njesia administrative Tomin								
19		Përgjegjës Ndhma Ekonomike	Sektori Ndhma Ekonomike	5/1/2007	Kontratë me afat	Shkollë e mesme	8 vjet	
Njesia administrative Zall Dardhe								
20		Përgjegjës Ndhma Ekonomike	Sektori Ndhma Ekonomike	11/15/2000	Kontratë me afat	Shkollë e mesme	15 vjet	
Njesia Administrative Zall Reç								
21		Përgjegjës Ndhma Ekonomike	Sektori Ndhma Ekonomike	8/10/2011	Kontratë me afat	Shkollë e mesme	4 vjet	

Bashkia Peshkopi, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrative Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësiti administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Dibër	Qyteti Peshkopi	Peshkopi	Qyteti Peshkopi	61,619	78,940	937.88
		Tomin	Fshatrat; Tomin, Brezhdan, Cetush, Dohoshisht, Pilafe, Pollozhan, Rrashnapojë, Selane, Ushtelenxë, Bahute, Staravec, Shimçan, Zimur, Zdojan			
		Melan	Fshatrat; Melan, Cerjan, Rabdisht, Zagrad, Begjunec, Trepçë, Grevë, Illicë, Bellovë, Pejke, Pjeçë, Trenë			
		Kastriot	Fshatrat; Kastriot, Brest i Sipërm, Brest i Poshtëm, Kishavec, Kandër, Kukaj, Vakuf, Fushë-Kastriot, Borovjan, Deshat, Limjan, Sohodoll, Sohodoll i Vogël, Vrenjt, Përgjegje			
		Lurë	Fshatrat; Fushë-Lurë, Borie-Lurë, Arth, Gurë-Lurë, Lurë e Vjetër, Arrëmolle, Krej-Lurë, Pregj-Lure, Sumej, Vlashej			
		Maqellarë	Fshatrat; Maqellarë, Bllatë e Poshtme, Bllatë e Sipërme, Burim, Çernen, Fushë e Vogël, Katund i Vogël, Kërçisht i Sipërm, Kërçisht i Poshtëm, Kllobçisht, Kovashicë, Majtarë, Pocest, Pesjak, Podgorc, Vojnik, Dovoln, Erebarë, Grezhdan, Herbel, Popinar, Gradec			
		Muhurr	Fshatrat; Muhurr, Bulaç, Fushë-Muhurr, Hurdhë-Muhurr, Rreth-Kale, Shqath, Vajmëdhej			

		Luzni	Fshatrat; Katund i Ri, Hotesht, Lishan i Poshtëm, Lishan i Sipërm, Arap i Sipërm, Arap i Poshtëm			
		Selishtë	Fshatrat; Selishtë, Kacni, Lukan, Murrë, Qafë-Murrë, Selishtë e Sipërme			
		Sillovë	Fshatrat; Sillovë, Kallë, Vleshë, Zall-Kalis, Dypjakë, Palaman, Sllatinë, Shumbat, Venisht, Trojak			
		Kala e Dodës	Fshatrat; Ceren, Kullas, Ploshtan, Radomirë, Shullan, Tejzë, Ujëmirë, Vasie			
		Zall-Dardhë	Fshatrat; Zall-Dardhë, Lashkizë, Lugjej, Menesh, Nezhaj, Qa, Soricë, Shënlleshën, Tartaj			
		Zall-Reç	Fshatrat; Zall-Reç, Bardhaj-Reç, Draj-Reç, Gur-Reç, Hurdhë-Reç, Kraj-Reç, Ndërshenë, Qafdraj, Tharkë			
		Fushë Çidhën	Fshatrat; Fushë Çidhën, Blliçe, Laçe, Rrenz			
		Arras	Fshatrat; Arras, Gur i Zi, Lazrej, Kodër Leshaj, Mustafe, Sinë e Sipërme, Sinë e Poshtme, Çidhën, Grykë Nokë			

Bashkia e re Divjakë

Të dhëna demografike, administrative dhe territoriale

Bashkia e re Divjakë kufizohet në veri me bashkinë Rrogozhinë, në lindje me bashkinë Lushnjë, në jug me bashkinë Fier dhe në perëndim me Detin Adriatik. Kryeqendra e bashkisë së re do të jetë qyteti i Divjakës, i shpallur qytet në vitin 1996.

Sipas Censusit të vitit 2011, bashkia e Divjakës numëron një popullsi prej 34.254 banorësh ndërkohë që në regjistrin civil rezulton një popullsi 53.372 vetë. Territori i bashkisë së re është 309.58 kilometra katrore. Në bazë të censusit, densiteti i popullsisë është 110 banorë për kilometër katror ndërsa në bazë të regjistrin civil densiteti është 172.40 banorë/km².

Bashkia e re Divjake ka edhe 4 njësi administrative: Tërbuf, Grabjan, Gradisht dhe Remas. Bashkia Divjake është pjesë e qarkut Fier. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 36 fshatra. (shiko listën e plotë me poshte).


Zhvillimi social ekonomik i deritanishem

Bashkia e re ka aktivitet kryesor ekonomik bujqësinë dhe në një masë më të vogël peshkimin në lagunën e Karavastasë. Prodhimi kryesor bujqësor janë bostanoret, të cilat shiten në tregun e brendshëm si dhe eksportohen në shumë vende të Europës qendrore dhe lindore.

Divjaka ka perspektivë të mirë për zhvillimin e turizmit detar si dhe ekoturizmit. Gjatë viteve të fundit këtu është shfaqur turizmi i vrojtimit të zogjve për shkak të pranisë së një kolonie të vogël pelikanësh në zhdukje në lagunën e Karavastasë.

Turizmi është zhvilluar për turistët ditorë dhe kulinaria është e përqendruar te prodhimet e peshkut, për të cilat zona është e famshme në të gjithë vendin.

Divjaka ka një jetë artistike dhe kulturore relativisht të pasur. Funksionon akoma një grup artistik me djem e vajza valltarë, të cilët përfaqësojnë Divjakën në aktivitete të ndryshme kulturore. Po ashtu edhe sporti është në nivele të mira (ekipi i volejbollit për femra përfaqësohet në aktivitete brenda dhe jashtë vendit).



Sfidat

Bashkia e Divjakës është nga të paktat bashki të krijuara nga reforma administrative dhe territoriale e cila përbëhet pothuajse tërësisht nga zona rurale. Bashkia e re ka një shtrirje veri-jug ndërkohë që rrugët janë më së shumti në drejtimin lindje-perëndim dhe lidhja rrugore mes qytetit të Divjakës dhe komunave Gradishtë e Remas është e dobët.

Ofrimi i shërbimeve komunale në të gjithë territorin e bashkisë së re pritet të jetë sfida kryesore të bashkisë së re, Divjakës, veçanërisht për shkak të mungesës së lidhjeve të forta infrastrukturore mes qytetit dhe komunave jugore.

Databaza e ndihmës ekonomike dhe përkrahjes sociale duhet integruar dhe përditësuar. Gjenerimi i të ardhurave nga taksimi i prodhimit bujqësor në fshat për suportimin e skemës është gjithashtu një sfidë.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Ne total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Divjake për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është pese “5” (Shih Listen me poshte).

Raporti gjinor është 1 me 4 ne favor te burrave. Keta jane praktikisht te shperndare nëpër njësitet administrative.

Sa i takon shkollimit, 2 janë me diplomë universitare kurse 3 te tjere janë më shkollë të mesme. Në varësi të politikave që do të ndjekë MMSR, sugjerohet ngritja e nivelit arsimor të stafit të targetuar përmes kualifikimit të posaçëm ose përmes rekrutimit të burimeve njerëzore me arsimin të përshtatshëm.

Asnje nga administartoret e ndihmës ekonomike dhe përkrahjes sociale nuk ka statusin e nëpunësit civil; te gjithë figurojne me “kontratë pune” pa afat.

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë së re Divjakë asnjë nga punonjësit nuk ushtron *njëkohësisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas percaktimeve te ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP konfirmoi gjithashtu se asnjë prej tyre nuk e kryen njëkohësisht dhe/ose pjesërisht këtë funksion. Rekomandohet përcaktimi eksplcit i të paktën një pozicioni për NJMF në strukturën organizative të bashkisë së re Divjakë për vitin 2016.

Bashkia Divjakë

Nr	Emri Mbiemri	Pozicioni i punes	Spektori	Data e fillimit	Lloji i kontrates se punes	Edukimi/ Kualifikimi	Ekperienca e punes ne njesi	Kategori te mbrojtura
1		Punonjese ndimes ekonomike	Ndihma Ekonomike	2014	Kontrate me afat	Shkolla e mesme	8 muaj	
Njesia administrative Gradishtë								
2		Arketar/Adm. Nd. Ekonomik	Spektori I Finances	2007	Kontrate me afat	Shkolle e Mesme	8 vjet	
Njesia administrative Remas								
3		Administrator	Ndihmat Ekonomike	2012	Kontrate pa afat	Shkolle e mesme	3 vjet	
Njesia administrative Tërbuf								
4		Administrator Shoqeror	Ndihmes Ekonomike	2014	Kontrate pa afat	Diplome Universitare ne Ekonomi	1 vit	
Njesia administrative Grabian								
5		Insp/Nd Ekonomik	Nd/Ekonomik	2014	Kontrate pa afat	Diplome UBT	4 vjet	

Bashkia Divjake, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrative Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrativ e përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Fier	Qyteti Divjakë	Divjakë	Qyteti Divjakë Fshatrat; Mizë, Xengë, Germenj i Madh, Germenj i Vogël, Hallvaxhias, Bregas, Dushk Cam, Zharrec, Bishtçukas	34,254	53,372	309.58
		Tërbuf	Fshatrat; Çermë Shkumbin, Çermë Proshkë, Sulzotaj, Çermë e Sipërme, Tërbuf, Shënepremte, Çermë Pasha			
		Grabjan	Fshatrat; Grabjan, Stravec, Ferras			
		Gradishtë	Fshatrat; Këmishtaj, Mertish, Gorica, Sopës, Fier Seman, Gradishtë, Gungas, Spolet, Babunjë			
		Remas	Fshatrat; Remas, Muçias, Karavasta Fshat, Gure, Kryekuq, Kamenicë, Karavasta e re, Adriatik			

Bashkia e re Dropull

Zona Gjeografike: Dropulli kufizohet në veri me bashkinë Libohovë. Kryeqendra e Bashkisë është Jorgucati.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011 ka një popullsi prej 3.503 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki numëron 23.131 banorë. Bashkia Dropull shtrihet në një sipërfaqe prej 466.67 km² me një densitet prej 49.56 banorë/km².

Kjo bashki përbëhet nga 3 njësi administrative, të cilat janë: Dropull i Poshtëm, Dropull i Sipërm dhe Pogoni. Bashkia është pjesë e qarkut Gjirokastrë. Bashkia e re ka nën administrimin e saj 41 fshatra. (shiko listen e detajuar me poshte).

Bashkia e Dropullit përbëhet nga pjesëtarë të pakicës etnike greke në Shqipëri. Dervicani njihen nga vendasit si kryeqendra e zonës, pasi në të zhvillohen pothuajse të gjitha aktivitetet e rëndësishme politike, kulturore dhe fetare të minoritetit. Megjithatë, qendra e komunës do të jetë në Jorgucati, një pikë e ndërmjetme mes dy komunave që ishin më parë.

Profili i bashkisë së re

Falë granteve qeveritare, por edhe ndihmave financiare nga Greqia, shumë fshatra kanë zgjidhur edhe problemet e ujit të pijshëm. Por në këto 25 vite të tranzicionit, zonës së Dropullit vuan prej emigracion të lartë, vala e parë e së cilës nisi në vitet '20-'30. Në fshatrat e Dropullit mungojnë moshat e reja, shumë shtëpi janë mbyllur me vite dhe shumë toka kanë mbetur djerrë.

Riintegrimi i emigrantëve që kthehen nga Greqia e prekur prej krizës ekonomike dhe financiare është një nga sfidat e bashkisë së re. Bashkia e re duhet të investojë në përmirësimin e sektorit arsimor dhe sidomos qendrave shëndetësore, duke qenë se zonat banohen nga moshat të thyera që kanë nevojë për asistencë mjekësore.



Sfidat e pushteti vendor pas ndarjes së re

Riintegrimi i emigrantëve që kthehen nga Greqia e prekur prej krizës ekonomike dhe financiare është një nga sfidat e bashkisë së re. Bashkia e Dropullit duhet të llojë për financime të reja për ndërtimin e ujësjellësve dhe rikonstrukcionin e rrugëve si dhe për mbështetjen e shtresave në nevojë në disa fshatra.

Një sfidë tjetër konsiderohet integrimi dhe përditësimi i databasës së ndihmës ekonomike, duke aplikuar kriteret e ndershme vlerësimi, nisur edhe nga rrethana e përhapur e fenomenit të pensioneve që jepen/ofrohen nga shteti grek për minoritarët. Bashkia duhet të ketë një plan të detajuar rezervë në rast të përkeqësimit të mëtejshëm të situatës së borxhit në shtetin fqinjë, Greqi.

Bashkia e re duhet të marrë përgjegjësi në përmirësimin e sektorit arsimor dhe sidomos qendrave shëndetësore, duke qenë se zonat banohen nga moshat të thyera që kanë nevojë për asistencë mjekësore.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Ne total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Dropull për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është kater “4”, (Shih Listen).

Raporti gjinor është 3 me 1 ne favor te burrave.

Sa i takon shkollimit, vetem 1 rezulton me shkollin te larte (universitar) kurse 3 te tjeret janë me shkollë të mesme. Në varësi të politikave që do të ndjekë MMSR, sugjerohet ngritja e nivelit arsimor të stafit përmes kualifikimit të posaçëm ose përmes rekrutimit të burimeve njerëzore me arsimin të përshtatshëm.

Te gjithë punonjesit e ndihmës ekonomike dhe përkrahjes sociale janë me “kontratë pune” pa afat. NUK ka punonjes qe te kete marre akoma statusin e nepunesit civil.

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë e re Dropull nuk ka asnjë punonjës që ushtron *njëkohësisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas percaktimeve te ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP konfirmoi gjithashtu se nuk ka asnjë punonjës që të kryejë *njëkohësisht* dhe/ose *posaçërisht këto funksione*. Rekomandohet përcaktimi eksplisit i të paktën një pozicioni për NJMF në strukturën organizative të bashkisë së re Dropull për vitin 2016.

Bashkia Dropull

Nr	Emri Mbiemri	Pozicioni i punes	Sektori	Data fillimit	Lloji i kontrates se punes	Edukimi/ Kualifikimi	Ekperienca e punes ne njesi	Kategori te mbrojtura
1		Magaziniere, Inspektore e ndihmes		2006		Shkolle mesme	9	
Njesia administrative Dropulli I Poshtem								
2		adm I ndih. Ek arketar	Ndihma ekonomke	2011	dipl. Univ mesuesi	Universitare	4 vjet	
Njesia administrative Pogon								
3		administrator I ndihmes ekoomike	ndihma ekonomike	2014	kontrat me afat	I mesem	6 muaj	
4		administrator I ndihmes ekoomike	ndihma ekonomike	2014	kontrat pa afat	I mesem	6 vjet	Leje lindje

Bashkia Dropull, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrative Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Gjirokastrë	Fshati Sofratikë	Dropull i Poshtëm	Fshatrat; Dervican, Goranxi, Vanistër, Haskovë, Dhuvjan, Sofratikë, Terihat, Goricë, Frashtan, Lugar, Grapsh, Peshkëpi e Sipërme, Peshkëpi e Poshtme, Glinë, Vrahogoranxi, Radat	3,503	23,131	466.67
		Dropull i Sipërm	Fshatrat; Jorgucat, Zervat, Bularat, Bodrishtë, Kërrë, Vodhinë, Pepel, Klishar, Selo, Likomil, Llovinë, Krioner, Sotirë, Llongo, Koshovicë, Dritë, Kakavie, Vrisera			
		Pogon	Fshatrat; Poliçan, Skore, Sopik, Çatistër, Mavrojer, Hllomo, Selckë			

Bashkia e re Durrës

Të dhëna të përgjithshme

Bashkia Durrës kufizohet në perëndim me Detin Adriatik, në veri me bashkinë Kurbin, në lindje me bashkitë Krujë, Vorë e Shijak dhe në jug me bashkinë Kavajë. Bashkia e Durrësit shtrihet përgjatë bregut të detit, nga grykëderdhja e lumit Ishëm në veri deri në kufi me Kavajën në jug. Vija e gjatë bregdetare që i shtohet qytetit të Durrësit. Përveç plazhit të Durrësit asaj i shtohet i gjithë gjiri i Lalëzit si dhe Kepi i Rodonit, të cilat deri tani kanë qenë pjesë e komunave Ishëm, Sukth, Katund i Ri dhe Rrashbull.

Sipas censusit të vitit 2011, në territorin e bashkisë së re Durrës banojnë 175,110 vetë ndërsa sipas regjistrit civil popullsia rezidente është 299,989 vetë. Me një sipërfaqe prej 338.30 kilometrash katrorë, densiteti i popullsisë sipas të dhënave të Censusit 2011 është 517 banorë km² ndërsa sipas Regjistrit Civil është 680 banorë km².

Bashkia e re Durrës ka gjithashtu 5 njësi administrative: Sukthi, Ishmi, Katundi i Ri, Rrashbulli dhe Manëz. Bashkia është pjesë e Qarkut Durrës. Në territorin e bashkisë së re gjenden tre qytete, Durrës, Sukth dhe Manëz si dhe 39 fshatra. (Shiko Listen).

Profili i Bashkisë

Durrësi ka portin më të madh në Shqipëri, ku përpunohet mbi 90 për qind e të gjithë volumit të ngarkim-shkarkimit portual, gjë që e bën atë njën më të rëndësishme tregtare në vend.

Për shkak të lehtësisë që krijon porti, Durrësi është zhvilluar edhe si një qytet i rëndësishëm për manifakturën, ndërsa joshja nga turizmi shkaktoi gjatë dy dekadave të fundit një bum në sektorin e ndërtimit.



Me mbi 5600 aktivitetet ekonomike të tij dhe 15% të investimeve të huaja, Durrësi është renditur në vendin e dytë si ekonomia më e fortë e vendit, pas Tiranës. Durrësi është një nga zonat më problematike sa i përket furnizimit me ujë, për shkak se burimet ujore aktuale janë të kufizuara dhe gjenden në distancë të largët.

Sfidat e pushteti vendor pas ndarjes së re

Durrësi është një zonë me shkallë të lartë të migrimit të brendshëm, gjë që ka sjellë zgjerimin e shpejtë dhe informal të qytetit në zonën e ish-Kënetës si dhe përgjatë vijës bregdetare në jug të qytetit. Sipas Zyrës Rajonale të Punës të Durrësit, forcat aktive për të punuar llogariten rreth 54,000 njerëz. Niveli i të papunëve për rrethin e Durrësit shkon në rreth 10,38%, ku papunësia është më e përhapur te femrat. Sektori privat ka punësuar rreth 31,3%, i ndjekur nga sektori bujqësor privat me 36,7%, dhe sektori shtetëror me 21.3%.

Infrastruktura rrugore e bashkisë së re është relativisht e mirë. Urbanizimi i shpejtë ka krijuar mbingarkesë të shërbimeve publike dhe vështirësi në optimizimin e infrastrukturës për lëvrimin e këtyre shërbimeve. Popullsia është mjaft e polarizuar në terma të të ardhurave dhe mundësive ekonomike. Përditësimi i datëbazës së përfutësve të ndihmës ekonomike duhet të jetë i shpeshtë dhe të përfshijë problematikën e popullsisë rurale që i shtohet tashmë qytetit.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Ne total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Durrës për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është "23", (Shih Listen e detajuar me poshte).

Raporti gjinor rezulton 22 me 1 ne favor te grave. Sa i takon shkollimit, 22 nga personeli i inventarizuar jane me diplomë universitare dhe vetem 1 me shkollë të mesme. Nga ky personel, 18 kane statusin e nëpunësit civil, 4 jane me "kontratë pune" pa afat; 1 është me kontrate pune me afat.

Sipas të dhënave të ofruara nga ASHMDF, në bashkinë Durrës

dhe NJA-të tashmë pjesë e saj (ish komunitat), duhet të jenë 8 punonjës që kryejnë *pjesërisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF, sipas *percaktimeve te ligjit Nr.10 347, datë 4.11.2010 "Per mbrojtjen e te drejtave te fëmijëve"*. Vlerësimi i realizuar nga INFOÇIP në periudhën Korrik-Shtator 2015 konfirmoi nominalisht vetëm 5 prej tyre (*me ngyre portokalli*). Nuk konfirmohet emri (jo funksioni) i 3 punonjësi të NJMF në NJA Katundi i ri dhe Rrashbull (me blu). Rekomandohet përcaktimi eksplicit i të paktën një pozicioni për NJMF në strukturën organizative të bashkisë së re Durrës për vitin 2016.

Bashkia Durrës

Nr	Emri Mbiemri	Pozicioni i punes	Spektori	Data e fillimit	Lloji i kontrates se punes	Niv.Arsimor	Eksp. e punes ne njesi.	Kategori mbrojtura te ligj
1		Drejtor	DREJTORIA E SHERBIMIT SOCIAL	20.10.2005	Statusi i N.C	Jurist	10.7 vite	
2		Shef Spektori	Spektori i Ndhmes Ekonomike dhe Invaliditetit	12.03.2009	Statusi i N.C	Agronomi	7 vite	
3		Ins.finance dhe statistike	Spektori i Ndhmes Ekonomike dhe Invaliditetit	19.07.2002	Statusi i N.C	Ekonomist	22 vite	
4		Insp.nd.ekon., pa aftesise	Spektori i Ndhmes Ekonomike dhe Invaliditetit	25.04.2001	Statusi i N.C	Zooteknike	14 vite	
5		Ins.prane Lagjes nr.1	Spektori i Ndhmes Ekonomike dhe Invaliditetit	01.02.2011	Statusi i N.C	Pune Sociale	4 vite	
6		Ins.prane Lagjes nr.2	Spektori i Ndhmes Ekonomike dhe Invaliditetit	19.07.2002	Statusi i N.C	Agronomi	18.9 vite	
7		Ins.prane Q.A.nr.5	Spektori i Ndhmes Ekonomike dhe Invaliditetit	14.01.2014	Statusi i N.C	Drejttesi	1.2 vite	
8		Ins.prane Q.A.nr.4	Spektori i Ndhmes Ekonomike dhe Invaliditetit	07.07.2008	Statusi i N.C	Ekonomist	11 vite	

9		Ins.prane Q.A.nr.3	Sektori i Ndhmes Ekonomike dhe Invaliditetit	03.11.2008	Statusi i N.C	Pune Sociale	6.4 vite	
10		Shef Sektori	Sektori Sherbimeve Sociale	16.06.2004	Statusi i N.C	Psikologji	11 vite	
11		Specialiste	Sektori Sherbimeve Sociale	17.03.2009	Kontr. Pa afat	Mesme	6 vite	
12		Specialiste	Sektori Sherbimeve Sociale	01.11.2006	Statusi i N.C	Frengjisht	8 vite	
13		Specialiste	Sektori Sherbimeve Sociale	01.06.2011	Statusi i N.C	Drejttesi	4 vite	
14		Specialiste	Sektori Sherbimeve Sociale	14.10.2009	Statusi i N.C	Pune Sociale	5.5 vite	
Njesia administrative Sukth								
15		Përgjegjëse	S.ND.EK.SH.SOC.	16.02.2007	Nëpunës Civil	U.Bujqësor i TR,Fakulteti Ekonomik	8 vjet	
16		Insp.Mbr.Dr.Fëmij.	S.ND.EK.SH.SOC.	11.03.2013	Nëpunës Civil	U.A.Xhuvani,Fak .Shkencave të Edukimit DND	2 vjet	
17		Insp.Barazisë Gjinore	S.ND.EK.SH.SOC.	03.01.2014	Nëpunës Civil	U."Aleksandër Moisiu",Fak.Edu kimit.DND	2 vjet	
Njesia administrative Manëz								
18		Administratore	Zyra Nd ek e PAK	1993	Nenpunes Civil	Diplome Univ Ekonomik	22 vjet	
Njesia administrative Ishëm								
19		Admin.Shoqerore	Admin.Shoqerore	Korrik 2011	Nenpunes Civil	I LARTE	25 vjet	
Njesia administrative Katund i Ri								
20		ADMINISTRATOR	ND.EKONOMIKE	01.08.2011	KONTR.ME AFAT	DIPLOM EK.FINANCE	12	
Njesai administrative Rashbull								
21		Pergj. Sektori		2003/	Kontrate pa afat	Agronomo pergjth. E larte	13	
22		Sp. Ndhmes Ekn		2001/	Kontrate pa afat	E mesme ekonomik	14	
23		Sp. Per.Mbrojt. Femij		2011/	Kontrate pa afat	e mesme	4	

Bashkia Durrës, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrative Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrativ e përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Durrës	Qyteti Durrës	Durrës	Qyteti Durrës	175,110	299,989	338.3
		Sukth	Qyteti Sukth, Fshatrat; Hamallaj, Kullë, Perlat, Vadardhë, Rushkull, Hidrovori			
		Ishëm	Fshatrat; Likmetaj, Kërtushaj, Kapidanaj, Gjuricaj, Lalëz, Kuraten, Bizë, Draç, Shetaj,			
		Katundi i ri	Fshatrat; Katundi i ri, Jubë, Qerret, Fllakë, Bisht-Kamëz, Rinia, Erzen, Sukth, Adriatik			
		Rrashbull	Fshatrat; Rrashbull, Arapaj, Shënavlash, Shkallnur, Manskuri, Romanat, Bozanhije, Xhafzotaj,			
		Manëz	Qyteti Manëz, Fshatrat; Armath, Borç, Hamallaj, Kameronas, Radë, Shkallë, Fshat Manëz			

Bashkia e re Elbasan

Të dhëna të përgjithshme

Bashkia e re e Elbasanit kufizohet në veri me bashkinë Tiranë, në lindje me bashkinë Librazhd, në jug-lindje me bashkinë Prrenjas, në jug-perëndim me bashkinë Gramsh dhe në perëndim me bashkitë Cërrik dhe Peqin.

Sipas Censurit të vitit 2011, kjo bashki numëron 141,714 banorë me densitet prej 162.51 banorë për km², ndërsa sipas Regjistrat Civil ajo numëron një popullsi prej 205,892 vetësh dhe densitet prej 236.11 banorë për km². Bashkia e Elbasanit ka një sipërfaqe prej 872,03 km².

Bashkia e re Elbasan ka edhe 12 njësi administrative: Labinot-Fushë, Labinot-Mal, Gjinar, Shushicë, Gjergjan, Funar, Shirqjan, Tregan, Gracen, Bradashesh, Zavalinë dhe Papër. Bashkia është pjesë e qarkut të Elbasanit. Ajo ka nën administrimin e saj një qytet dhe 116 fshatra. (shiko Listen)

Profili i bashkisë

Bashkia e re e Elbasanit do të jetë një nga më të mëdhatë në Shqipëri. Qyteti i Elbasanit, me rreth 80 mijë banorë, ka aktualisht rreth 60 për qind të popullsisë së bashkisë ndërsa pjesa tjetër është e ndarë nëpër njësi administrative, disa prej të cilave gjenden në terrene të thyera malore, me infrastruktura rrugore shumë të amortizuara.

Elbasani merr 6 orë ujë në ditë dhe synimi i përhershëm ka qenë shtimi i furnizimit me ujë deri në 24 orë.

Bashkia e re ka në territorin e saj një pjesë të madhe të industrisë së rëndë të Shqipërisë, përfshirë fabrikën e çelikut, atë të çimentos, ferrokromit, etj, gjë që i ka dhënë kësaj zone edhe një nga nivelet më të larta të ndotjes së ajrit në vend. Zona industriale shtrihet mbi një sipërfaqe të madhe ku veprojnë me dhjetëra biznese ndër të cilat edhe kompani të mëdha që

eksportojnë hekur e krom. Ndaj duhet një plan që jo vetëm të mbrojë qytetarët nga ndotja por edhe që bashkia të përfitojë ekonomikisht nga këto ndërmarrje private. Ka aktualisht dy çerdhe dhe 8 kopshte të pavarura nga institucionet shkollore.



Sfidat e pushtetit vendor pas ndarjes së re

Elbasani është një nga zonat më të varfra në Shqipëri; qyteti u zgjerua gjatë kohës së komunizmit për të përqendruar disa dhjetëra-mijëra punëtorë përreth zonës industriale të Kombinatit Metalurgjik (rreth 12 mijë punëtorë menjëherë). Ndërkohë, industria e mbijetuar/rindertuar këto vite punëson vetëm pak mijëra banorë duke lënë pjesën tjetër të popullsisë të papunë. Fshtrat janë në shumicën e rasteve në zona të thella me pak tokë bujqësore në dispozicion.

Komuniteti rom dhe egjiptian përbën rreth 10 për qind të popullsisë së qytetit të Elbasanit. Ai jeton aktualisht në kushte shumë të këqija, pavarësisht programeve të kosiderueshme të implementuar për ri-integrimin e tyre social-ekonomik. Njëra nga lagjet e banuara nga romët nuk është pajisur ende me infrastrukturë bazë dhe është vazhdimisht e rrezikuar nga përmbytjet.

Numri shumë i lartë i fshatrave e ben levrimin e ndihmës ekonomike në fshat një çështje që meriton vëmendje të posacme.

Inventarizimi i personelit të Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Ne total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Elbasan për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është “25”, (Shih Listen e detajuar me poshte).

Raporti gjinor është 17 me 8 ne favor te grave. Nga personeli i inventarizuar, vetëm 4 rezultojnë me arsim të mesëm, kurse pjesa tjetër janë me arsim të lartë. Jane 12 punonjës që kanë statusin e nëpunësit civil; pjesa tjetër janë me “kontratë pune” pa afat ose “ne prove”.

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë së re Elbasan duhet të jenë 13 punonjës që ushtrojnë *njëkohësisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas percaktimeve të ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP konfirmoi nominalisht vetëm 11 prej tyre (*me ngyre portokalli*). Nuk konfirmohet emri (jo funksioni) i 2 punonjësve të NJMF në NJA Gjinor dhe Zavalinë (me blu). Konstatohet se në strukturën aktuale ka pozicione eksplicite për NJMF (ngjyrosur me ngjyrë jeshile) si ne administratën e bashkisë (qendër) ashtu edhe në një NJA Shushicë.

Bashkia Elbasan

Nr	Emri Mbiemri	Pozicioni i punes	Sektori	Data fillimit e	Lloji i kontrates se punes	Edukimi/ Kualifikimi	Ekperienca e punes ne njesi	Kategori te mbrojtura
1		Drejtor	Drejtoria e Kujdesit Social	26.09.2011	Nepunes Civil	I Larte/Gjuhe Frenge	4 Vjet	
2		Pergj.	Sektori I Programeve Sociale dhe njesia per mbrojtjen e femijeve	01.10.2006	Nepunes Civil	I Larte/Pune Sociale	9 Vjet	
3		Specialiste	Sektori I Programeve Sociale dhe njesia per mbrojtjen e femijeve	03.12.1993	Nepunes Civil	I Larte/Ekonomi Plani	22 Vjet	
4		Specialiste	Sektori I Programeve Sociale dhe njesia per mbrojtjen e femijeve	07.07.2014	Periudhe Prove	I Larte/Pune Sociale	1 Vit	
5		Koordinatorë lokale kunder dhunes ne familje	Sektori I Programeve Sociale dhe njesia per mbrojtjen e femijeve	22.02.2013	Nepunes Civil	I Larte/Pune Sociale	2 Vjet	
6			Sektori I Ndhmes Ekon.					
7		Pergj.	Sektori I Ndhmes Ekon.	12.07.2007	Nepunes Civil	I Larte/Ekonomik	8 Vjet	
8		Specialiste	Sektori I Ndhmes Ekon.	10.12.1998	Nepunes Civil	I Larte/Ing. Mekanike, Matemati	17 Vjet	
9		Specialiste	Sektori I Ndhmes Ekon.	01.02.1997	Kontrate Pune	I Mesem	18 Vjet	
10		Specialiste	Sektori I Ndhmes Ekon.	16.06.2011	Nepunes Civil	I Larte/Ekonomik	4 Vjet	
Njesia administrative Gjinor								
11		Punonj. Nd.Ekonomike	Nd.Ekonomike	2011	Kontrate me afat	I larte Ekonomik	4 vjet	
Njesia administrative Zavalin								
12		Punonjse Nd.Ekonomike	Ndihma Ekonomike	3. 2001	Nenpunes Civil	Diplome Universiteti ne Ekonomik	14 vjet	
Njesia administrative Shushicë								

13		Punonjes I Ndhmes Ekonomike	Nd. Ekonomike	3. 2009	Nenpunes Civil	Diplome Universiteti ne Ekonomik	6 vjet	
14		Punonjese Sociale	Kujdesi Social per Femijet	3. 2012	Nenpunes Civil	Shkolla e Mesme	3 vjet	
Njesia administrative Shirgjan								
15		Inspektor e ndihmes ekonomike	Sektori indihmes ekonomike	16.05.2001	Kontrate me afat	Arsim Mesem Ekonomik	14 vjet	
Njesia administrative Gjergjan								
16		Insp. E Nd. Ekonomike	Nd. Ekonomike	2013	Kontrate me afat	Diplome ne Bio-Kimi	2 Vjet	
Njesia administrative Labinot Mal								
17		Punonj. Nd.Ekonomike	Nd.Ekonomike	1992	Kontrat me afat	Diplome Universiteti ne Finance	23 vjet	
18		Punonj. Nd.Ekonomike	Nd.Ekonomike	2013	Kontrate me afat	Diplome Universite Gjermanisht -	4 vjet	
Njesia administrative Labinot Fushë								
19		Punonjese Nd. Ekonomike	Nd.Ekonomike		Nenpunes Civil	Diplome Universiteti ne Ekonomik		
Njesia administrative Funar								
20		Punonj. Nd.Ekonomike	Nd.Ekonomike	2009	Kontrat me afat	Edukate Qytetare	6 muaj	
Njesia administrative Gracen								
21		Punonj. Nd.Ekonomike	Nd.Ekonomike	2011	Kontrat me afat	Shkolla e Mesme	4 vjet	
Njesia administrative Paper								
22		Inspekt soc shtet	Sherb social	2011	pa afat	I larte Marketing	4 vjet	
Njesia administrative Bradashesh								
23		Insp Nd Ekonomike	Nd. Ekonomike	2004	Nenpunes Civil	I larte mesuesi	12 vjet	
24		Insp Nd Ekonomike	Nd. Ekonomike	1993	Kontrat pa afat	I Mesem	22 vjet	
Njesia administartive Tregan								
25		Pun. e Nd.Ekonomike	Nd. Ekonomike	2011	Kontrate me afat	I larte mesuesi	4 vjet	

Bashkia Elbasan, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrative Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Elbasan	Qyteti Elbasan	Elbasan	Qyteti Elbasan	141,714	205,892	872.03
		Labinot-Fushë	Fshatrat; Labinot-Fushë, Godolesh, Griqan i Sipërm, Griqan i Poshtem, Xibrakë, Mengel			
		Labinot-Mal	Fshatrat; Labinot-Mal, Guri Zi, Sericë, Lamollë, Benë, Lugaxhi, Qafë, Qerret, Shmil, Dritas			
		Gjinar	Fshatrat; Gjinar, Lleshan, Valesh, Pashtresh, Derstilë, Lukan, Sterstan, Xibresh, Maskarth, Kaferr, Pobrat			
		Shushicë	Fshatrat; Shushicë, Shelcan, Mlizë, Hajdaran, Fush-Bull, Vasjan, Polis i Vogël, Polis Vale, Vreshtaj			
		Gjergjan	Fshatrat; Gjergjan, Bujaras, Gjonmë, Kështjellë, Kodër Bujaras, Muriqan, Thanë			
		Funar	Fshatrat; Branesh, Bixëlle, Prec e Sipërme, Cerujë, Korrë, Mollagjesh, Krrabë e Vogël, Prec e Poshtme, Stafaj			
		Shirgjan	Fshatrat; Shirgjan, Bathes, Bujqës, Jagodinë, Kuqan, Kryezjarr, Mjekës			
		Tregan	Fshatrat; Tregan, Blerimas, Bizhdan, Cikallesh, Gurisht, Kacivel, Kyçyk, Muçan, Shinavlash, Shilbater, Trepsenisht, Tudan			
		Gracen	Fshatrat; Gracen, Plangaricë, Tërbaç, Bodin, Shingjin, Gjorm, Pajengë, Mamel, Dopaj			

Bashkia e re Fier

Bashkia e re Fier kufizohet në veri me bashkinë Divjakë, në lindje me bashkitë Patos dhe Roskovec, ndërsa në jug me bashkinë Vlorë. Ajo shtrihet në Ultësirën Perëndimore, mes lumenjve Seman dhe Vlorë. Cakrani dhe Frakulli kanë territor kodrinor. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Fierit.

Sipas Censurit të vitit 2011 në territorin e bashkisë së re banojnë 120.655 njerëz ndërsa në regjistrin civil rezultojnë banorë 196.324 njerëz. Sipërfaqja e bashkisë së re është 619.9 km². Në bazë të censurit, densiteti i popullsisë është 194.6 banorë për kilometër katror ndërsa në bazë të regjistrin civil, densiteti është 316.70 banorë/km².

Bashkia e Fierit ka në përbërje edhe 9 njësi administrative: Cakran, Mbrostar Ura, Libofshë, Qendër, Dërmenas, Topojë, Levan, Frakull dhe Portëz. Ato janë pjesë e qarkut Fier. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 85 fshatra. (shih listen e plotë me poshtë)

Profili i bashkisë

Më shumë se 55% e popullsisë së bashkisë së re jetojnë në zonat rurale, gjë që tregon rëndësinë e sektorit të bujqësisë në jetën ekonomike të bashkisë së re.

Bashkia e re do të ketë një vijë bregdetare të konsiderueshme, nga grykëderdhja e lumit Vjosë deri në grykëderdhjen e lumit Seman në kufijtë e parkut kombëtar Divjakë-Karavasta.

Bujqësia dhe blegtoaria janë aktiviteti kryesor ekonomik. Në territorin e bashkisë së re gjenden toka shumë pjellore, të cilat di kur kanë qenë kënetat dhe që sot janë të rrezikuara vazhdimisht nga përmbytjet. Ndotja mjedisore e lënë pas është problem. Edhe sot industria e mbetur e naftës dhe rafineritë e vajit ushqimor, të cilat ndosin ajrin sidomos gjatë periudhës së natës.



Sfidat e pushtetit vendor pas ndarjes së re

Si një zonë industriale e rëndësishme e kohës së komunizmit Fieri vuan në veçanti nga papunësia e lartë e shkaktuar nga mbyllja e fabrikave. Skema e përkrahjes ekonomike për familjet pa të ardhura është nën presion konstant. Gjetja e burimeve ekonomike të reja për ta mbështetur këtë skemë është një sfidë për bashkinë e re në kushtet ku ajo është zgjeruar në zona akoma dhe më të varfra se sa vetë qyteti.

Përbërja demografike, sidomos në qytet është e larmishme. Ka një komunitet cam shumë të integruar ndërkohë që në Fier ka edhe një komunitet të vogël rom i cili përballlet me vështirësi sociale ekonomike, ku papunësia dhe varfëria janë probleme konstante.

Zgjerimi i funksioneve të bashkisë ekzistuese të qytetit të Fierit në një territor të gjerë pritet të përbëjë një tjetër sfidë, veçanërisht për shkak të nevojave shumë të ndryshme nga qyteti që kanë të 85 fshatrat që përfshihen në bashkinë e re. Në zonat rurale, mirëmbajtja e infrastrukturës së vaditjes dhe kullimit të cilat janë përgjegjësi e pushtetit vendor identifikohen nga komuniteti si shqetësimet kryesore. Amortizimi i kësaj infrastrukture shkakton përmbytje në vjeshtë-dimër nga Vjosa e se fundmi Gjanica. Rikuperimi i dëmeve të përmbytjeve herën e fundit vuri në vështirësi seriozë skemat e mbështetjes sociale dhe sistemin e reagimit ndaj emergjencave të bashkisë dhe të ish-komunave.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Ne total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Fier për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është “15”, (Sipas listes me poshtë). Raporti gjinor është 8 me 7 ne favor te grave. Te dhenat per shkollimin e stafit eksistues jane jo konkluzive, megjithate, per nje pjese te tyre ato jane te indikuara ne tabelen me poshte. Tete (8) nga stafi i inventarizuar gezojne statusin e nepunesit civil, kurse pjesa tjetër janë me “kontratë pune” pa afat ose me afat (rreth 4 te tilla deri ne fund te gushtit 2015). Sa i takon pozicioneve ne strukture per NJMF, te dhenat jane gjithashtu jo-konkuziv, sidomos referuar njesive administrative.

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë së re Fier duhet të jenë 4 punonjës që ushtrojnë *njëkohësisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas percaktimeve te ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP konfirmoi nominalisht vetëm 1 prej tyre (*me ngyre portokalli*). Nuk konfirmohet emri (jo funksioni) i 3 punonjësve të NJMF në NJA Dërmenas, Qender dhe Levan (me blu). Rekomandohet përcaktimi eksplicit i të paktën një pozicioni për NJA në strukturën organizative të bashkisë së re Fier për vitin 2016.

Bashkia Fier

Nr.	Emer Mbiemer	Pozicioni i punes	Arsimi/ titulli i diplomes	Perfshire ne Strukture	Statusi i nepunesit (N/Civil) (jo)	Ekaperienca ne pune ne institucion	Arsimimi ne vazhdim	Kategori
								Mbrojtue Me ligj
	Drejtoria e sherbimeve Sociale							
1		Drejtor Drejtorie	UE, Gjuhe letersi	17 Maj 1999	Nepunes civil	16		
2		S. N. L Per Sherb S. M. e Trete	Pune Sociale	05 shkurt 2014	Nepunes civil	1		
3		S. N. L Per Sherb S. dhe financat	UT, Ekonomik	03 Maj 2002	Nepunes civil	13		
4		S. N. L Per Sherb S. per Invalidet	Ugj, Histori Gjeografi	29 Mars 2004	Nepunes civil	11		
5		S. N. L Per Sherb. Sociale dhe Barazin Gjinore	UT, Pune sociale	07 Nentor 2012	Nepunes civil	3		
6		S. N. L Per Sh. Sociale per femijet Jetim, te dhunuar	UV, Pedagogji e specializuar	06 dhjetor 2006	Nepunes civil	9		

Njesia administrative Libofshe								
7		Inspektore Ndhimes Ekonomike	Nd Ekonomike	2014	Kontrate pa afat	I Larte Turizem	6 muaj	
Njesia administrative Dërmenas								
8		Pergjegjese e nd.ekonomike	Nd Ekonomike	2 0 0 7	Kontrate pa afat	Shkolle e mesme	8 vjete	
Njesia administrative Frakull								
9		Inspektor i Mbrojtjes Shoqerore dhe Ndhimes Ekonomike	Nd Ekonomike	2007	Kontrate pa Afat	Shkolle e Mesme Ekonomike	8 vjet	Invalid Pune
Njesia administrative Qender								
10		Punonjese e Ndhimes Ekonomike	Nd Ekonomike	16.01.2006	Nenpunes Civil	I Larte Ekonomik	9 vjet	
Njesia administrative Topojë								
11		Pergjegjes Finance dhe Nd Ekon	Finance dhe Nd ekon	1995/2012	Nepunes Civil	I Larte Ekonomik	11 vjet	
Njesia administrative Cakran								
12		Admin Ndhima Ekon.P.Sociale	Nd Ekonomike	2007	Kontrate me afat	Shkolle e mesme ekonomike	8 VJET	
Njesia administrative Levan								
13		Jurist dhe Ad/NE	Nd Ekonomike	01.08.2011	Kontrate afat	Jurist	4 vjet	
Njesia administrative Mbrostar								
14		Pergjegejs	Zyra e Ceshtjeve Sociale dhe Ekonomike	2011	Kontrate me afat	Ekonomi Agrare	4	
Njesia administrative Portez								
15		Administror Shoqeror	Z. Ndhimave Ekonomike	01.08.2008	Kontrate me afat	Shkolle e Mesme	7	

Bashkia Fier, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrative Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Fier	Qyteti Fier	Fier	Qyteti Fier	120,655	196,324	619.9
		Cakran	Fshatrat; Cakran, Cakran i Ri, Floq, Buz Madh, Hambar, Varibop, Vjosë, Kreshpan, Gjorgos, Vreshtas, Gorishovë, Gjonç			
		Mbrostar Ura	Fshatrat; Mbrostar, Verri, Vajkan, Petov, Kallmi i Madh, Kallmi i Vogël			
		Libofshë	Fshatrat; Libofshë, Rreth Libofshë, Vanaj, Daullas, Agimi, Metaj, Gozhdaras, Havaleas, Ndërnënas, Hasturkas, Adriatik			
		Qendër	Fshatrat; Çlirim, Mujalli, Grecalli, Daullas, Afrim i Ri, Vadhizë, Zhupan, Drizë, Drizë Myrteza, Romët			
		Dërmenas	Fshatrat; Dërmenas, Pojan, Kryegjatë, Havaleas, Hoxharë, Radostinë, Sulaj, Hamil, Muçaj, Baltëz, Povelçë, Darëzezë e Re			
		Topojë	Fshatrat; Topojë, Seman, Gjokalli, Sheq Marinas, Sheq, Fushë, Grykë, Seman i Ri, Kavaklli			
		Levan	Fshatrat; Levan, Ferras, Peshtan i Madh, Peshtan i Vogël, Shtyllas, Bishan, Bashkim, Boçovë, Martinë, Pishë Poro, Qarr			
		Frakull	Fshatrat; Frakull e Madhe, Frakull e Vogël, Adë, Peshtan Bregas, Kafaraj, Kashishtë, Sheq Musalala, Çerven			
		Portëz	Fshatrat; Portëz, Mbyet, Plyk, Kraps, Lalar, Patos Fshat			

Bashkia e re Finiq

Të dhëna të përgjithshme

Zona Gjeografike: Bashkia e re e Finiqi kufizohet në veri me bashkinë Delvinë, në jug me bashkinë Konispol, në lindje me bashkinë Dropull dhe në perëndim me bashkinë Sarandë. Kryeqendra e Bashkisë është Finiqi.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011 numëron një popullsi prej 11,862 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil kjo bashki numëron 39,055 banorë në një sipërfaqe prej 441.20 km². Në bazë të të dhënave të censurit, densiteti i popullsisë është 26.7 banorë për km² ndërsa në bazë të regjistrimit civil densiteti është 88.51 banorë/km².

Njësitë administrative që i lidhen bashkisë Finiq janë: Aliko, Mesopotam, Dhiver dhe Livadhja. Bashkia është pjesë e Qarkut Vlorë. (shikomi me poshte listën e plotë të qyteteve dhe fshatrave të kësaj bashkie)

Profili i bashkisë

Finqiq është një bashki që shtrihet në zonën bujqësore të fushës së Vurgut dhe në zonën malore të rrëzomës së Vurgut.

Zona bujqësore është pjellore dhe aktiviteti bujqësor është rigjallëruar vitet e fundit. Infrastruktura është përmirësuar gjatë dy dekadave të fundit falë investimeve ndërkufitare. Pas rikonstruksionit nga fondi grek i kanalit Thoma-Filipeu, ai tashmë është drejt përfundimit dhe mbulon gjithë sipërfaqen e punueshme. Bashkia e re pret hartimin e një plan zhvillimi më të detajuar ku do të mbizotërojnë veprat që përfshijnë një sipërfaqe

më të madhe territori, si p.sh. furnizimi me ujë të pijshëm i të gjitha fshatrave. Janë burimet e kristalta të Leshnicës, syri i kaltër prej të cilave pritet të bëhet furnizimi me ujë të pijshëm i zonës.



Sfidat e pushtetit vendor pas ndarjes së re

Banorët e zonës i përkasin minoritetit grek dhe kjo zonë ka përjetuar hemorragji demografike si pasojë e largimit të popullsisë drejt kërkimit të një jete më të mirë në Greqi.

Emigrimi ka larguar nga zona pjesën më të madhe të popullsisë, veçanërisht të rinjtë, duke lënë pas njerëz të moshuar. Rindertimi i kohezionit social, mbështetja për të moshuarit, aplikimi i standarteve në ofrimin e shërbimeve mbeten sfidat kryesore.

Skema e Ndhmës Soc-Eko nuk është nën presion edhe për shkak të përfundimit të banorëve nga sekmat e shtetit fqinjë, Greqisë (pensione, etj). Megjithatë, sfida e organizimit të një administrate eficiente jo vetëm të sektorit të ndihmës ekonomik, por në përgjithësi të bashkisë së re Finiq, mbetet një prioritet.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Ne total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Finiq për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është kater “4”, (Shih Listen). Raporti gjinor është 2 me 2. Sa i takon shkollimit, 3 prej tyre janë me diplomë universitare kurse 1 është me shkollë të mesme. Ky eshte nje tregues pozitiv krahasuar edhe me bashki te tjera, madje edhe ato të medha. Asnjë nga punonjesit e ndihmës ekonomike dhe përkrahjes sociale ne bashkine e re Finiq nuk gezon statusin e nepunesit civil. Sugjerohet qe ky tregues të permiresohet cilësisht.

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë së re Finiq duhet të jenë 4 punonjës që ushtrojnë *njëkohësisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas percaktimeve te ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP konfirmoi nominalisht se të 4 punonjësit vazhdojnë të kryejnë këtë funksion (*me ngyre portokalli*). Rekomandohet përcaktimi eksplicit i të paktën një pozicioni për NJMF në strukturën organizative të bashkisë së re Finiq për vitin 2016.

Bashkia Finiq								
Nr	Emri Mbiemri	Pozicioni i punes	Sektori	Data e fillimit	Lloji i kontrates se punes	Edukimi/ Kualifikimi	Ekperienca e punes ne njesi	Kategori te mbrojtura
1		Inspektor - nd. Ekonom.	Nd. Ekonom	1/3/2014	Kod. Pune	Universitet ne B.E.	1 vite (2014-2015)	
Njesia administrative Aliko								
2		Administrator i Nd.Ekonomike	Financa	01.06.2006	Kod. Pune	Shkollë larte ekonimike	7 vjet (2006-2012)	
Njesia administrative Livadhja								
3		P/Zyres sherbimit social		01,04,1992	kod pune	Universitet ekonomike	1994-2015	
Njesia administrative Mesopotam								
4		Sp. Nd. Ekonomike	Nd. Ekonom	16.04.2004	kod pune	I mesem	11 vjet	

Bashkia Finiq, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrative Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative e përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Vlorë	Fshati Dermish	Livadhja	Fshatrat; Livadhja, Kulluricë, Llazat, Kalcat, Kodër, Lefter Talo, Gravë, Qesarat, Komat, Karroq, Grazhdan, Zminec.	11,862	39055	441.2
		Dhivër	Fshatrat; Dhivër, Rumanxë, Memoraq, Navaricë, Dermish, Leshnicë e Sipërme, Leshnicë e Poshtme, Janicat, Llupsat, Cerkovicë, Shëndre, Malcan			
		Aliko	Fshatrat; Aliko, Çausht, Neohor, Tremul, Rahullë, Pllakë, Jermë, Vurgu i Ri, Halo, Dritas			
		Finiq	Fshatrat; Finiq, Buronjë, Çlirim, Vrion, Karahaxhë, Bregas			
		Mesopotam	Fshatrat; Mesopotam, Dhrovjan, Krongj, Bistricë, Velahovë, Livinë, Brajlat, Sirakat, Kostar, Fitore, Krane, Ardhasovë			

Bashkia Fushë-Arrëz

Të dhëna të përgjithshme

Zona Gjeografike: Fushë-Arrëzi kufizohet në veri me Bashkinë Tropojë, në perëndim me bashkitë Vau i Dejës dhe jug-perëndim me bashkitë Pukë dhe Mirditë. Në lindje kufizohet me bashkinë Kukës. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Fushë-Arrësit.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia ka një popullsi prej 7.405 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrat Civil, kjo bashki numëron 11.651 banorë. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 540.42 km² me një densitet prej 21.55 banorë/km² sipas Regjistrat Civil dhe 13.70 banorë/km² sipas Censurit 2011.

Bashkia e re ka edhe 4 Njësi Administrative: Fierzë, Blerim, Qafë-Mali dhe Iballë. Bashkia e është pjese e qarkut Shkoder. Bashkia e re ka nën administrim një qytet dhe 35 fshatra. (shih tabelen)

Profili i Bashkisë

Bashkia Fushë-Arrëz shtrihet në një zonë malore, me një sipërfaqe të konsiderueshme pyjore, e cila prej vitesh është dëmtuar nga njerëzit kryesisht për tregti.

Rishikimi i koncesioneve të minierave dhe përdorimi eficient i rentës minerare është një tjetër pritshmëri e banorëve për bashkinë e re. Promovimi dhe zhvillimi i industrisë së përpunimit të drurit, duke marrë për bazë pasuritë natyrore pyjore të Fushë-Arrëzit si dhe traditat e zonës mund të nxiste një sërë biznesesh të reja në bashki. Trajtimi më vëmendje i koncesioneve të HEC-eve që po ndërtohen në Fushë Arrëz dhe zbatimi detyrimeve të përcaktuara në kontratë, shihet si një mundësi e mirë për të balancuar të ardhurat e pakëta. Grumbullimi i bimëve mjekësore dhe prodhimeve të dyta pyjore, janë dy sektorë potencialë të cilët mund të gjenerojnë të ardhura për banorët e zonës.



Sfidat e pushtetit vendor pas ndarjes së re

Bashkia e Fushë Arrëzit është një nga bashkitë më të varfëra në Shqipëri, Mungesës së punësimit është problem madhor. Ndiurma ekonomike për banorët është shpesh i vetmi burim mbijetese. Përveç emigrimit drejt vendeve të BE, shumë banorë nga zonat malore të Fushë Arrëzit kanë lëvizur kryesisht drejt kryeqytetit. Infrastruktura rrugore është e amortizuar jo vetëm në akset rurale, por edhe në ato nacionale.

Specifike për këtë zonë është fakti se gjatë muajve të dimrit pjesa më e madhe komunave izolohehen nga dëborat. Kjo e kthen në një sfidë të vërtetë ofrimin e shërbimit të ndihmës ekonomike dhe ëprkrahjes sociale për familjet në nevojë me burimet e vetë bashkisë.

Pasuritë natyrore të Fushë-Arrëzit, kryesisht ato nëntokësore të shprehura në rezervat e mëdha minerale janë të shumta, ndërsa minierat janë dhënë me koncesion tek firma të ndryshme turke por shfrytëzimi i mineraleve nuk i ka sjellë zhvillim të kësaj zone.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Ne total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Fushe-Arrez për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është gjashtë “6”, (Sipas listes se detajuar e poshte). Raporti gjinor është 1 me 5 ne favor te burrave. Sa i takon shkollimit, vetem 1 eshte me diplomë universitare kurse 5 janë me shkollë të mesme. Në varësi të politikave që do të ndjekë MMSR, sugjerohet ngritja e nivelit arsimor të stafit të targetuar përmes kualifikimit të posaçëm ose përmes rekrutimit të burimeve njerëzore me arsimin të përshtatshëm. Vetëm 1 ndër 6 punonjesit e ndihmës ekonomike dhe përkrahjes sociale eshte aplikues per

statusin e nëpunësit civil (NJA Qafe Mali), 1 është me kontratë pune “pa afat” kurse tre te tjere kanë kontratë punë “me afat”.

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë së re Fushë-Arrëz duhet të jetë vetëm 1 punonjës që ushtron *njëkohësisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas percaktimeve te ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP konfirmon funksionin por jo emrin e punonjësi të NJMF në NJA Qafë Mali (me blu). Rekomandohet përcaktimi eksplisit i të paktën një pozicioni për NJMF në strukturën organizative të bashkisë së re Fushë-Arrëz për vitin 2016.

Bashkia Fushe Arrez

Nr	Emri Mbiemri	Pozicioni i punes	Sektori	Data fillimit e	Lloji i kontrates se punes	Edukimi/ Kualifikimi	Ekperienca e punes ne njesi	Kategori te mbrojtura me ligj
1		Inspek.Z.N.Ekonomike	Ndihma ekonomike	2012	Nepunes civil	I larte,Gjuhe Letersi	3	
Njesia administrative Blerim								
2		Administrator i ndihmes ekonomike	Zyra e Ndhme Ekonomike	2001	Kontrate me afat	I mesem i pergjithshem	14	
Njesia administrative Fierze								
3		Administrator i Ndhmes Ekonomike	Ndihma ekonomike	2011	Kontrate pa afat	I Larte,Drejtesi	4	
4		Pergjegjes Ndhmes ekonomike	Ndihma ekonomike	2011	Kontrate pa afat	I mesem	4	
Njesia administrative Iballe								
5		Adminis ndihme ekon	Ndihma ekonomike	1.01.2012	“	Mesem	2	-
Njesia administrative Qafe Mali								
6		Insp.Nd/Ekonomike	Ndihma ekonomike	2011	Aplikues per Nenpunes Civil	I Mesme , Pergjithsh	4	

Bashkia Fushe-Arrëz, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrative Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Shkodër	Qyteti Fushë-Arrëz	Fushë-Arrëz	Qyteti Fushë-Arrës, Fshatrat; Fushë-Arrës, Miçaj, Lumëardhe	7,405	11,651	540.42
		Fierzë	Fshatrat; Fierzë, Porav, Bugjon, Kokdodë, Arst, Miliska, Mëzi, Arip-Guri			
		Blerim	Fshatrat; Flet, Xeth, Kulumri, Trun, Blerim, Dardhë, Qebik			
		Qafë-Mali	Fshatrat; Qafë-Mali, Armiraj, Srriqe, Mollkuqe, Lajthizë, Lumbardhë, Tuç, Kryezi, Orosh			
		Iballë	Fshatrat; Iballë, Sapaç, Levosh, Berishë e Vogël, Berishë Vendi, Berishë e Sipërme, Shopel, Mërtur			

Bashkia e re Gjirokastrër

Të dhëna të përgjithshme

Zona Gjeografike: Bashkia e Gjirokastrës kufizohet në veri me bashkinë Tepelenë, në lindje me Bashkinë Libohovë, në jug me bashkinë Dropull dhe në perëndim me bashkitë Himarë dhe Delvinë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Gjirokastrës.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia ka një popullsi prej 25.301 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil ajo numëron 52.054 banorë. Bashkia shtrihet në një sipërfaqe prej 469.25 km² me një densitet prej 53.91 banorë/km² sipas Censurit 2011 dhe 110.93 banorë sipas Regjistrimit Civil.

Kjo bashki ka edhe 6 njësi administrative: Cepo, Lazarat, Picar, Lunxhëri, Odrie dhe Antigone. Bashkia është pjesë e qarkut Gjirokastrë. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 38 fshatra. (shiko tabelën e plotë me poshtë)

Profili i bashkisë

Bashkia e re e Gjirokastrës do të përbëhet nga qyteti i Gjirokastrës, i cili prej vitit 2005 ndodhet në listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s si dhe zonat rurale kodrinore përreth, të përqendruara më së shumti te prodhimet blegtorale.

Qyteti ka mbi 800 ndërtesa historike, shumë prej të cilave rrezikohen nga degradimi. Polifonia e zones, pjesë e Iso-polifonisë shqiptare, është njohur më 2005 nga UNESCO si *“trashëgimi kulturore e njerëzimit”*.

Turizmi në qytetin e Gjirokastrës ka shënuar një hov cilësor gjatë viteve të fundit. Megjithatë, përballë bashkisë së re shtrohet nevoja e përmirësimit të kapaciteteve për promovimin dhe administrimin e turizmit si dhe për zgjatjen e sezonit turistik përtej muajve të pranverës dhe vjeshtës.

Qyteti numëron rreth 50-60 mijë vizitorë të huaj në vit si dhe zotëron një rrjet hotelesh që e përballojnë këtë fluks. Bashkia ka një zyrë informimi turistik, por pak produkte promocionale.

Burimet kryesore të ekonomisë urbane në Gjirokastrë janë turizmi dhe fasoni, përgjithësisht për tregun grek dhe që gjatë viteve të fundit është goditur rëndë për shkak të krizës në Greqi. Gjirokastra është qytet me aktivitete të konsiderueshëm tregtar, veçanërisht me Greqinë, kryesisht importe.

Zona rurale e saj është e njohur për blegtorinë e imtë dhe për produktet blegtorale cilësore.



Sfidat e pushtetit vendor pas ndarjes së re

Gjirokastra është zona më e prekur në Shqipëri nga emigrimi masiv i popullsisë përgjatë dy dekadave të fundit, gjë që ka sjellë edhe plakjen e shpejtë të popullsisë. Sipas regjistrimit të popullsisë 2011, qarku i Gjirokastrës ka moshën mesatare më të lartë në Shqipëri me gati 40 vjeç. Ky fakt e ekspozon ndaj presioneve skemën e përkrahjes sociale, sin e qyte ashtu ehe ne fshtra. Edhe pse një pjesë e këtij presioni përballet nga skema e pensioneve, që menaxhohet në nivel qendror

Infrastruktura rurale është e rindertuar, por ofrimi i shërbimeve sociale edhe në zonat rurale me të njëjtin standart sikurse dhe në qytet përben një sfidë për bashkinë e re.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Ne total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Gjirokaster për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është “10”, (Shih Listen).Raporti gjinor është 5 me 5. Sa i takon shkollimit, te gjithë janë me arsim te larte (shumica universitar). Te dy keta tregues e pozicionojne mjaft mire personelin bashkise se re Gjirokaster.Jane vetem 4 nga 10 punonjes ne kete sektor qe gezojne statusin e nepunesit civil; pjesa tjetër janë me “kontratë pune” me afat dhe/ose pa afat.

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë së re Gjirokastër duhet të jetë 1 punonjës ushtron *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas percaktimeve te ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP e konformon punonjës in edhe nominalisht (*me ngyre portokalli*). Ky është ndër të paktat raste të hasura kur përcaktimet ligjore reflektohen rigorozisht në strukturën e një bashkie.

Bashkia Gjirokaster								
Nr	Emri Mbiemri	Pozicioni i punes	Sektori	Data e fillimit	Lloji i kontrates se punes	Edukimi/ Kualifikimi	Ekperienca e punes ne njesi	Kategori te mbrojtura
1		Pergj Sek Mbrojtjes Shoqerore	Sek Mbroj Shoq	01.02.1994	Sherbim civil	Fakulteti Ekonomise Mercologji	21 vjet+3 muaj	
2		Inspek per Familjet pa te Ardhura	Sek Mbroj Shoq	16.03.2002	Sherbim civil	Fakulteti Ekonomise Mercologji	13 vjet	
3		Inspek per Komunitetet BGj Diskrim e Dhunen ne Familje	Sek Mbroj Shoq	25.03.2014	Sherbim civil	Kontabilitet-Finance	1 vit	
4		Inspe Mbrojtjen e Femijve	Sek Mbroj Shoq	25.03.2014	Sherbim civil	Histori-Gjeografi	1 muaj	
Njesia administrative Antigone								
5		insp.sherb.social	sherbimi social	2013	kontrat pa afat	diplom kontabilitat - finanac	2 vjet	
Njesia administrative Cepo								
6		Nd ekonomike	Nd Ekonomike	2012	me kontrat	arsimi I lart	3 vjet	
Njesia administrative Lazarat								
7		Arkiv Protokoll Ndhime sociale	Nd Ekonomike	2008	kontrate pa afat	MCS Kontabilitet Financ + letersi	8 vjet e 3 muaj	
Njesia administrative Lunxheri								
8		Shef I ndihmes ekonomike	Nd Ekonomike	2013	Kontrate pa afat	Diplome Universiteti ne Ekonomik	2 vjet	
Njesia administrative Odrje								
9		Perkrahje sociale	Nd Ekonomike	01.03.2007	Kont pa afat	Ekonomi Plani	8 vjet	
Njesia administrative Picar								
10		Perkrahje sociale	Nd Ekonomike	01.03.2007	Kont pa afat	Ekonomi Plani	8 vjet	

Bashkia Gjirokastrer, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrative Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqj KM ²
Gjirokastrë	Qyteti Gjirokastrë	Gjirokastrë	Qyteti Gjirokastrë	25,301	52,054	469.25
		Cepo	Fshatrat; Fushëbardhë, Zhulat, Taroninë, Mashkullorë, Palokastrë, Çepun, Kodër, Plesat, Kardhiq, Prongji, Humelicë			
		Lazarat	Fshatrat; Lazarat, Kordhoce			
		Picar	Fshatrat; Picar, Shtëpëz, Kolonjë, Golem, Kaparjel			
		Lunxhëri	Fshatrat; Qesorat, Dhoksat, Këllëz, Mingul, Nokovë, Erind, Gjat, Kkoz, Karjan, Valare			
		Odrie	Fshatrat; Andon Poçi, Hundëkuq, Tërbuq, Labovë e Madhe, Labovë e Vogël			
		Antigonë	Fshatrat; Asim Zeneli, Arshi Lengo, Krinë, Tranoshisht, Saraqinisht			

Bashkia e re Gramsh

Të dhëna të përgjithshme

Bashkia e re Gramsh kufizohet në veri me bashkinë Elbasan, në lindje me bashkinë Pogradec, në jug-lindje me bashkinë Maliq, në jug me bashkinë Skrapar dhe në perëndim bashkitë Berat, Kuçovë dhe Cërrik. Kryeqendra është qyteti i Gramshit.

Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia e re numëron 24,231 banorë me densitet 32.78 banorë për km², ndërsa sipas Regjistrit Civil ajo numëron një popullsi prej 36.305 banorësh dhe densitet 49.11 banorë për km². Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 739.22 km².

Bashkia Gramsh ka edhe 9 njësi administrative të tjera: Pishaj, Kodovjat, Kukur, Kushovë, Lenie, Poroçan, Skënderbegas, Sult dhe Tunjë. Bashkia është pjesë e qarkut të Elbasanit. Ajo do admistroje një qytet dhe 94 fshatra (shih tabelen e detajuar)

Profil i bashkisë

Bashkia e Gramshit shtrihet në një territor shumë malor në Shqipërinë qendrore, ku toka bujqësore është e paktë (rreth 14 për qind e sipërfaqes) ndërsa pjesa tjetër e territorit është zonë pyjore ose kullotë. Qendra e bashkisë së re, Gramshi, u shpall qytet në vitin 1960 si një qendër e agroindustrisë dhe e industrisë ushtarake, e cila ka lënë një trashëgimi ndotjeje dhe papunësie.

Në vitin 1991 ka pasur një popullsi prej 55 mijë banorësh ku vetëm 8,600 jetonin në qytet dhe pjesa tjetër në fshat. Në vitin 2015 Gramshi ka rreth 24 mijë banorë nga të cilët 8,400 jetojnë në qytet.

Ndërsa burimet ekonomike janë të pakta, bukurite natyrore janë të shumta, si Ujëvara e Sotirës, Uji i Ftohtë më malin e Lenies, liqeni i Dushkut, Pishat e Grabovës, liqenet në malin e Rovjes, etj. Infrastruktura rrugore është shumë e dobët. Ndërtimi i hidrocentraleve mbi kaskadën e Devollit si dhe infrastruktura shoqëruese e këtyre hidrocentraleve pritet të zgjidhë pjesërisht

problemin e rrugëve të këqija në territorin e bashkisë së re, si dhe të krijojë një mundësi punësimi.



Sfidat e pushtetit vendor pas ndarjes së re

Papunësia është problemi më i madh social për Bashkinë e re. Gramshi dikur gjeneronte punësim përmes dy ndërmarrjeve të mëdha ushtarake. Uzina e prodhimit të armatimeve, ku dikur punonin 1100 punëtorë u mbyll në vitin 2006. Ndërkohë uzina e prodhimit të baterive ka pasur të punësuar 440 punëtorë. Kjo e fundit u privatizua në vitin 2003, por me reduktim të punojësve. Në Gramsh ka pasur edhe një ndërmarrje të grumbullim-përpunimit me 880 punëtorë, edhe kjo e mbyllur.

Më shumë se gjysma e popullsisë është larguar nga kjo zonë në drejtim të qyteteve të mëdha apo në emigrim jashtë shtetit. Ndiham ekonomike është mundësia e vetme për shumë familje që kanë mbetur. Qyteti i Gramshit ka rreth 300 biznese të regjistruara, shumica prej të cilave biznese të vogla tregtie apo shërbimesh. Baza e taksueshme është e vogël për të mbështetur nevojat në rritje, përfshi lëvrimin e ndihmën ekonomike. Krijimi i kushteve më të mira të jetesës dhe të punësimit është sfida kryesore e bashkisë së re dhe mënyra e vetme për ndalimin e depopullimit. Qyteti i Gramshit ka edhe një problem edhe me përhapjen e konsumit të drogës mes të rinjve të qytetit, gjë që kërkon angazhim të madh të institucioneve publike për rehabilitimin e përdoruesve të saj.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Ne total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Gramsh për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është “13”, (Shih Listën më poshtë). Raporti gjinor është respektuar; 6 punonjëse në këtë bashki janë femra dhe 7 punonjës janë meshkuj, Sa i takon shkollimit, 8 punonjës kanë arsimin e lartë ku vetëm një me social, 5 punonjësit e tjerë janë me arsim të mesëm. Sugjerohet ngritja e nivelit arsimor të stafit të targetuar përmes kualifikimit të posaçëm ose përmes rekrutimit të burimeve njerëzore me arsimin të përshtatshëm. Vetëm 6 nga 13 punonjës në këtë sektor rezultojnë te kene statusin e nëpunësit civil. Vetëm një prej tyre është punësuar me kohë të pjesshme; 7 punonjësit e tjerë janë punësuar me “kontratë pune” me afat.

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë së re Gramsh duhet të jenë 9 punonjës që ushtrojnë *njëkohësisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas percaktimeve të ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP konfirmoi nominalisht se 5 punonjës në detyrë i ushtrojnë këto funksione. Ky vlerësim konfirmon funksionin por jo emrin e 4 punonjësve të NJMF në NJA Gramsh, Tunjë, Kukur dhe Kushoë (me blu). Rekomandohet përcaktimi eksplicit i të paktën një pozicioni për NJMF në strukturën organizative të bashkisë së re Gramsh për vitin 2016.

Bashkia Gramsh								
Nr	Emri Mbiemri	Pozicioni i punes	Sektori	Data e fillimit	Lloji i kontrates se punes	Edukimi/ Kualifikimi	Ekperienca e punes ne njesi	Kategori te mbrojtura
1		Pergj.Sek.Mb.Sociale	Mbrojt.Sociale (NE)	19.09.2011	Kohe te pjeseshme NC(neni 65/c)	Diplome (DND) Ekonomik	3 vjet 7muaj	
2		Spec.Mb.Sociale	Mbrojt.Sociale (NE)	01.05.2014	Kohe te Plote-NCPP	Master Profesional Ekonomik	1 vit	
Njesia administrative Pishaj								
3		Adm nd ekonomike	Nd Ekonomike	09.01.2012	Kontate me afat	Asistenet ligjore	2 muaj	
Njesia administrative Kodovjat								
4		Specialit i NE	Nd Ekonomike	10.01.2014(?)	Nepunes civil????	UE- Ekomiks(DIND)	1vit2 muaj	
5		Punonjese NE(Paaftesia)	Nd Ekonomike	2011	Kontrate me afat	Shkolle e mesme	4 vjet	
Njesia administrative Poroçan								
6		Punonjes i zyres NE	Nd Ekonomike	01.08.2007	Kontrate me afat	Shkolle e mesme	8 vjet t	
Njesia administrative Sult								
7		Administrator NE	Nd. Ekonomike	2004	Kontrate me afat	Mesem Pergjithshem	11 vjet	

Njesia administrative Skenderbegas								
8		Sherb Sociale	Nd Ekonomike	2007	Nepunes civil	Diplome (DND) Inxhinieri Pyjesh	7vjet	
Njesia administarive Lenie								
9		Administrator NE	Nd Ekonomike	01.08.2005	Kontrate me afat	Shkolle e mesme	10 vjet	
Njesai administrative Tunjë								
10		Pergjegjes i Zyres Nd.Ekonomike	Finance	01.04.2014	Kontrate me afat	Shkolle e mesme	20 vjet	
Njesai administrative Kukur								
11		Specialiste NE	Nd Ekonomike	01.07.2012	Nepunes civil	Larte/Ekonomik	4 vjet	
12		Punonjese NE	Nd Ekonomike	02.02.2013	Kontrate me afat	Larte	2 vjet	
Njesia administarive Kushovë								
13		Specialiste e Zyres NE	Nd Ekonomike	20.11.2012	Nepunes civil	Pune sociale	02 vjet 04 muaj	

Bashkia Gramsh, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrative Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Elbasan	Qyteti Gramsh	Gramsh	Qyteti Gramsh	24,231	36,305	739.22
		Pishaj	Fshatrat; Pishaj, Trashovicë, Shëmrizë, Ostenth, Gurrëz, Cerunjë, Çekin, Qerret, Koçaj, Vinë, Fshat-Gramsh, Drizë, Cingar i Sipërm, Cingar i Poshtëm, Galigat, Kotorr, Gjergjovinë, Storrë, Liras, Tervol			
		Kodovjat	Fshatrat; Kodovjat, Bratilë, Bulçar, Kishtë, Kokel, Posnovisht, Shelcan, Bersnik i Poshtëm, Bërsnik Sipërm, Mashan, Broshtan, Zamshe			
		Kukur	Fshatrat; Kukur, Grazhdan, Gribë, Kalaj, Mukaj, Rashtan, Rmath, Snosëm, Sojnik			
		Kushovë	Fshatrat; Kushovë, Bregas, Gjeraqinë, Dumberas, Bërsnik, Ulovë, Sotirë, Kerpice			
		Lenie	Fshatrat; Lenie, Bicaj, Grabovë e Poshtme, Grabovë e Sipërme, Kurate, Valth			
		Poroçan	Fshatrat; Poroçan, Lleshan, Gjerë, Kabash, Holtas			
		Skënderbegas	Fshatrat; Skënderbegas, Bletëz, Ermenj, Fushëz, Harunas, Kotkë, Kullollas, Lemnushë, Nartë, Siman, Sëmbërdhenj, Vidhan, Zenelas			
		Sult	Fshatrat; Sult, Mazrek, Dushk, Kukuçovë, Kutërqar, Kodër Zgjupe, Zgjup Fushë, Dufshan, Grekan			
		Tunjë	Fshatrat; Tunjë, Duzh, Irmanj, Jançe Qëndër, Jançe Mal, Katërlis, Lubinjë, Oban, Prrenjas, Plepas, Saraselë, Tunjë e Re			

Bashkisa e re Has

Të dhëna të përgjithshme

Hasi kufizohet në veri dhe perëndim me Bashkinë Tropojë, në jug me Bashkinë Kukës dhe në lindje me Republikën e Kosovës. Qendra e bashkisë është qyteti i Krumë (u shpall qytet në 1994).


Sipas Censusit të vitit 2011, Hasi ka një popullsi prej 16,790 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrat Civil, ka 21,247 banorë. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 399.62 km² me një densitet prej 53.16 banorë/km² sipas të dhënave të Regjistrat Civil dhe 42.01 banorë/km² sipas Censusit 2011.

Kjo bashki përbëhet nga 4 njësi administrative, të cilat janë: Kruma, Fajza, Gjinaj dhe Golaj. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Hasit dhe të qarkut Kukës. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 29 fshatra (shihni listën e plotë të qyteteve dhe fshatrave me poshte)

Profili i bashkisë

Relievi i zonës shtrihet nga rreth 300 metra mbi nivelin e detit deri në malet e larta të Gajrepit. Toka bujqësore e disponueshme për banorët e zonës u reduktua ndjeshëm pas ndërtimit të hidrocentralit të Fierzës, i cili përmblyti disa lugina dhe fshatra. Deri në mesin e viteve '90 ka funksionuar miniera dhe fabrika e pasurimit të bakrit në Golaj, 6 kilometra larg qytetit të Krumës si dhe disa miniera më të vogla, me mbi 3000 punëtorë.

Hasi është një zonë kufitare, ku një pjesë e banorëve kalojnë kufirin rregullisht për punësim apo për arsimim në zonën e Gjakovës në Kosovë, ku gjenden edhe lidhjet historike kulturore dhe ekonomike të krahinës. Nisur nga fakti se ekonomia në rrethin e Hasit varet kryesisht nga burimet nëntokësore të kromit, sfida kryesore mbetet koordinimi dhe bashkëpunimi mes institucioneve të Bashkisë dhe kompanive që punojnë në këtë sektor.



Kuadri ligjor ekzistues e lejon transferimin e një pjese të taksave të industrisë minerare të njësitë e pushtetit vendor dhe burimet minerare aktualisht në shfrytëzim ose që mund të shfrytëzohen në të ardhmen mund të furnizojnë një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave. Bashkia e re ka tashmë nën juridiksionin e saj edhe fshatrat e tre ish-komunave. Për shkak të fragmentarizimit të lartë dhe mungesës së organizimit, tokat e ndara me ligjin 7501 lihen aktualisht në një masë të madhe të papunuara.

Sfidat e pushtetit vendor pas ndarjes së re

Hasi është një zonë e varfër ekonomisht. Popullata mbijeton falë të ardhurave që vijnë nga emigrimi, bujqësia dhe ndihma ekonomike. Rigjallërimi i shfrytëzimit të minierave do të sillte rritjen e punësimit, zbutjen e varfërisë së theksuar dhe mirëmenaxhimit të të ardhurave që merren nga kjo industri mund të nxiste pozitivisht mbështetjen social ekonomike në nivel vendor. Për ta nxitur prodhimin bujqësor, Bashkia duhet që të gjejë mënyrën dhe donatorët që të bëjë të mundur subvencione për bujqesinë. Kjo gjithashtu do të lehtësonte në masë të konsiderueshme skemën e ndihmës ekonomike si dhe do të rriste bazën e taksueshme në territorin rural.

Bashkia e re e Hasit do të përballet dhe me një sërë nevojash për ndërhyrje në infrastrukturë, e cila raportohet si shumë e dëmtuar ose e munguar, sidomos rrugët rurale.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Në total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Has për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është “6”, (Shih Listën më poshtë). Raporti gjinor është 2 me 4 në favor të meshkujve. Sa i takon shkollimit, vetëm 2 punonjës janë me arsim të lartë (me profilin sociologji) ndërsa 4 të tjerët kanë arsim të mesëm. Në varësi të politikave që do të ndjekë MMSR, sugjerohet ngritja e nivelit arsimor të stafit të targetuar përmes kualifikimit të posaçëm ose përmes rekrutimit të burimeve njerëzore me arsimin të përshtatshëm. Të dy punonjësit me arsim të lartë gëzojnë statusin e nëpunësit civil ndërsa 4 punonjësit me arsim të mesëm janë me kontratë, respektivisht 2 kanë “kontratë pune” me afat, 1 ka “kontratë pune” pa afat dhe një me “kontratë vjetore”.

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë së re Has duhet të jenë 4 punonjës që ushtrojnë *njëkohësisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas percaktimeve të ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP konfirmoi nominalisht vetëm 3 prej tyre (*me ngyre portokalli*). Nuk konfirmohet emri (jo funksioni) i 1 punonjësi të NJMF në NJA Golaj (me blu). Rekomandohet përcaktimi eksplicit i të paktën një pozicioni për NJMF në strukturën organizative të bashkisë së re Has për vitin 2016.

Bashkia Has								
Nr	Emri Mbiemri	Pozicioni i punes	Sektori	Data e fillimit	Lloji i kontrates se punes	Edukimi/ Kualifikimi	Ekperienc a e punes ne njesi	Kategori te mbrojtura
1		P.Sek.Nd Ekon	Sek.Nd.Ekon.dhe Përk.Shoqërore	22.07.2011	SHC	larte, Sociologji	3 vite 9 muja	
2		Inspektore Nd Ekone	Sek.Nd.Ekon.dhe Përk.Shoqërore	05.01.2015	SHC	larte, Sociologji	0 vite 4 muaj	
Njesia administrative Golaj								
3		P/Nd/Ekonomike	Nd. Ekonomike	2011	Kontrate me afat	Shkolle e mesme	4 vjet	
4		Ins/Nd/Ekonomike	Nd. Ekonomike	2014	Kontrate me afat	Shkolle e mesme	1 vit	
Njesia administrative Gjinaj								
5		Adm/Nd/Eko	Nd. Ekonomike	1993	Kontrat pa afat	Shkolle e mesme	22 vjet	
Njesia administrative Fajzaj								
6		Pergj zyre nd. ekono.	Nd. Ekonomike	05.07.2011	me kontrate vjetore	I mesem	10 vjet	

Bashkia Has, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrative Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Kukës	Qyteti Krumë	Krumë	Qyteti Krumë, Fshatrat; Krumë, Gajrep, Cahan, Mujaj-Dajç, Zahrisht,	16,790	21,247	399.62
		Fajza	Fshatrat; Fajza, Vranisht, Tregtan, Likeni i Kuq, Metaliaj, Brenogë			
		Gjinaj	Fshatrat; Gjinaj, Pusi i Thatë, Myç-Has, Domaj, Pogaj, Kishaj			
		Golaj	Fshatrat; Golaj, Nikoliq, Bardhaj, Perollaj, Vlahen, Letaj, Peraj, Dobrunë, Zgjeç, Qarr, Helshan, Kosturr			

Bashkia e re Himarë

Të dhëna të përgjithshme

Zona Gjeografike: Bashkia e re e Himarë kufizohet në veri me bashkitë Vlorë dhe Selenicë, në lindje me bashkitë Tepelenë, Gjirokastër dhe Delvinë, në jug me bashkinë Sarandë dhe në lindje me detin Jon. Kryeqendra e Bashkisë është Himara.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011 Himara ka 7,818 banorë, ndërsa sipas Regjistrat Civil kjo bashki numëron 27,049 banorë. Me sipërfaqe prej 571.94 km², densiteti i popullsisë në bazë të censurit rezulton vetëm 13.7 banorë/ km² ndërsa sipas regjistrat civil, densiteti është 47 banorë/ km².

Njësitë administrative përbërëse janë: Himarë, Lukovë dhe Horë-Vranisht. Himara dhe Horë-Vranishti i përkasin rrethit Vlorë ndërsa Lukova i përket rrethit Sarandë. Të trija njësitë janë pjesë e Qarkut Sarandë. Bashkia e re do të ketë nën administrim një qytet dhe 24 fshatra. (shih tabelen me poshte)

Profili i bashkisë

Himara është një bashki që shtrihet përgjatë të gjithë bregut të Jonit si dhe në malet e Labërisë në pjesën e ish-komunës Horë-Vranisht. Ajo është e pasur me burime ekonomike me përqendrim të turizmit, peshkimit, blegtorisë e ullishtet, të gjitha produkte dhe shërbime me vlerë të lartë të shtuar.

Bashkia e re ndahet në dy territore shumë të ndryshme: zona bregdetare si dhe zona e ish-komunës Horë-Vranisht, një zonë e thyer malore e cila aktualisht nuk lidhet me qendrën e bashkisë me rrugë moderne të drejtpërdrejtë, por vetëm me një rrugë historike mushkash e cila aktualisht nuk është e përdorshme. Peshkimi është një aktivitet ekonomik që siguron të ardhura por shumica e këtij aktivitet kryehet me metoda të paligjshme.



Ndërkohë, resurset bujqësore dhe blegtorale të zonës janë shumë pak të shfrytëzuara për shkak të largimit masiv të popullsisë apo tërheqjes së popullsisë së mbetur në aktivitete me më shumë të ardhura si turizmi.

Sfidat

Himara do të jetë bashkia e dytë me densitetin më të ulët të popullsisë në Shqipëri pas Dropullit si pasojë e largimit të pjesës dërrmuese të banorëve për në Greqi ose në qendrat e mëdha urbane në vend.

Për shkak të dy zonave me tipologji të ndryshme (Himra bregdetare dhe Horë Vranisht zonë malore e thyer) ndërtimi i kohezioni social-ekonomik është një "inxhinieri" shumë sfiduese. Ndërtimi i rrugës lidhëse me ish-komunën Horë-Vranisht është në këtë kontekst një domosdoshmëri e cila varet jo vetëm nga bashkia por edhe nga qeveria qendrore. Pa këtë infrastrukturë, banorët e Horë-Vranishtit mund ta gjejnë veten pa akses në shërbimet e ofruara nga Bashkia dhe të mënjanuar nga pjesëmarrja në nivel të qeverisjes vendore.

Integrimi i një numri banorësh të rinj, të cilët kanë zbritur nga zonat më të varfra të vendit për t'u punësuar në ndërtim apo turizëm është një sfidë tjetër.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Ne total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Himarë për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është “3”, (Shih Listën më poshtë).Raporti gjinor është 2 me 1 në favor të femrave.Sa i takon shkollimit, një punonjës ka arsimin e lartë, ndërsa 2 të tjerët kanë arsim të mesëm .Rekomandohet përmirësimi i këtij treguesi në të ardhmen. Në varësi të politikave që do të ndjekë MMSR, sugjerohet ngritja e nivelit arsimor të stafit të targetuar përmes kualifikimit të posaçëm ose përmes rekrutimit të burimeve njerëzore me arsimin të përshtatshëm. Vetëm 1 nga 3 punonjësit në këtë sektor gëzon statusin e nëpunësit civil;

2 të tjerët janë me kontratë sipas Kodit të Punës.

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë së re Himarë duhet të jenë 3 punonjës që ushtrojnë *njëkohësisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas përcaktimeve të ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP konfirmoi nominalisht vetëm 2 prej tyre (*me ngjyre portokalli*). Nuk konfirmohet emri (jo funksioni) i 1 punonjësi të NJMF në NJA Hor-Vranisht (me blu). Rekomandohet përcaktimi eksplicit i të paktën një pozicioni për NJMF në strukturën organizative të bashkisë së re Himarë për vitin 2016.

Bashkia Himare								
Nr	Emri Mbiemri	Pozicioni i punes	Sektori	Data e fillimit	Lloji i kontrates se punes	Edukimi/ Kualifikimi	Ekperienca e punes ne njesi	Kategori te mbrojtura
1		INS.NDIHMA SOCIALE	FINANCE	3/3/2009	NEPUNES CIVIL	ARSIM I LARTE FINANCE	6 VJET	
Njesia administrative Lukove								
2		Ins finance dhe Nd. Ekonomike	Finance	2008	Kod. Pune	Arsimi Mesem	7 vjet	
Njesia administrative Hor-Vranisht								
3		Pergj. Z.Ndihmës Ekonomike	Financa	14.06.2007	Kod. Pune	Shkollë e mesme Bujqësore	8 vjet (2007-2015)	

Bashkia Himarë, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrative Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative e përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsi a sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Vlorë	Qyteti Himarë	Himarë	Qyteti Himarë, Fshatrat; Pilur, Kudhës, Qeparo fshat, Qeparo, Fushë, Vuno, Iliaz, Dhërmi, Gjilekë, Palasë	5,738	27049	571.94
		Lukovë	Fshatrat; Lukovë, Borsh, Fterrë, Çorraj, Piqeras, Sasaj, Qazim, Pali, Shënvasil, Nivicë			
		Horë - Vranisht	Fshatrat; Vranisht, Kuç, Kuç Buronjë, Bolenë, Kallarat, Tërbaç			

Bashkia e re Kamëz

Të dhëna të përgjithshme

Zona Gjeografike: Bashkia Kamëz kufizohet në veri, lindje dhe jug me bashkinë Tiranë, në veri-perëndim me bashkinë Krujë dhe në perëndim me bashkinë Vorë. Kamza përbëhet nga dy njësi administrative, Kamza dhe Paskuqani.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011 Bashkia Kamëz ka një popullsi prej 104,190 banorësh, ndërsa sipas regjistrit civil numëron 125,632 banorë. Ajo ka një sipërfaqe prej 37.18 km². Në bazë të censurit, densiteti i popullsisë është 2802 banorë /km² ndërsa sipas regjistrit civil, densiteti është 3379.02 banorë/km².

Kryeqendra e bashkisë së re është Kamza ndërsa ajo ka edhe 14 fshatra. Të dyja njësitë administrative janë pjesë e rrethit Tiranë, qarkut Tiranë. (shihni tabelen me poshte)

Profili i Bashkisë

Bashkia e re Kamëz është bashkia me sipërfaqen më të vogël dhe me densitetin më të lartë në Shqipëri, duke e bërë atë praktikisht bashkinë më urbane të Shqipërisë pavarësisht se përfshin edhe 14 vendbanime që zyrtarisht janë fshatra.

Bashkia e re është ndërtuar gjatë 20 viteve të fundit ku rritja e popullsisë ka qenë në përmasa të jashtëzakonshme. Kamza si qendër e banuar numëronte më pak se 5 mijë banorë të përqendruar rreth ndërmarrjes bujqësore “Ylli i Kuq”, instituteve të teknologjisë bujqësore si dhe rreth minierës së qymyrit të Valiasit ndërsa popullsia u shtua me shpejtësi nga migrimi i brendshëm i popullsisë përgjatë 25 viteve të fundit. Kamza mori titullin e qytetit në vitin 1996. Kamza ka një sipërfaqe të punueshme prej 2,364 hektarë, shifër kjo e papërfillshme në krahasim me popullsinë, ndërkohë që pjesa më e madhe e tokës bujqësore është zënë nga banesat.



Popullsia e zbritur më së shumti nga zonat veriore dhe verilindore e vendit dhe ndërtimi i banesave të nevojshme për të strehuar këtë popullsi solli zhvillimin e industrisë së ndërtimit ndërsa një numër fabrikash të manufakturës u hapën në zonë për të përdorur krahun e lirë të punës, sidomos të grave dhe vajzave.

Sfidat e pushteti vendor pas ndarjes së re

Kamza është një zonë e re urbane dhe me densitet të lartë të popullsisë. Infrastruktura rrugore është zhvilluar viett e fundit, por nevojitet ndërtimi i shkollave, kopshteve, çerdheve e qendrave shëndetësore. Këto janë sfidat kryesore të bashkisë së re. Bashkia e re numëron rreth 1200 biznese Kriza ekonomike e viteve të fundit, dobësimi i mundësisë për të emigruar në Greqi si dhe rënia e madhe e punësimit në sektorin e ndërtimit ka rritur varfërinë në këtë zonë duke e kthyer Kamzën në një xhep varfërie. Ka patur të dhëna për abuzime me skema e ndihmës ekonomike. Përditësimi i saj dhe vlerësimi objektiv i nevojave përbëjnë një sfidë. Një problem tjetër i rëndësishëm është fakti që një pjesë e banorëve nuk janë të regjistruar në gjendjen civile dhe rrjedhimisht kanë vështirësi në përfitimin e shërbimeve kryesore publike si arsim dhe shëndetësi. Mungesa e regjistrimit të një pjese të popullsisë si dhe në shumë raste, distanca e konsiderueshme nga shtëpitë të shkollat e pakta të zonës kanë sjellë braktisje të shkollave nga një pjesë e fëmijëve.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Ne total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Kamëz për personelin e përkrahjes sociale është “ 9 ”, (Shih Listen). Raporti gjinor është 4 me 5 ne favor të burrave. Sa i takon shkollimit, tetë (8) jane me arsim te larte universitar kurse një (1) është me arsim të mesëm. Të paktën 5 punonjes ne kete sektor gezojne statusin e nepunesit civil (kjo e dhënë mund të ketë ndryshuar gjithsesi pas 31 Gushtit 2015).

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë së re Kamëz duhet të jenë 2 punonjës që ushtrojnë *njëkohësisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas percaktimeve te ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP konfirmoi nominalisht 2 prej tyre (*me ngyre portokalli*). Rekomandohet përcaktimi eksplicit i të paktën një pozicioni për NJMF në strukturën organizative të bashkisë së re Kamëz për vitin 2016.

Bashkia Kamez								
1		Përgjegjës I sektorit të ndihmës ekonomike				I Lartë/Ekonomik/Juridik		
2		Specialiste ndihmës ekonomike dhe paaftësie				I Lartë/Ekonomik/Juridik		
3		Specialiste, ndihmë ekonomike+punonjës social+mbrojtja e fëmijëve				I Lartë/Ekonomik/Juridik		
4		Specialist ndihme ekonomike+për barazinë gjinore				I Lartë/Ekonomik/Juridik		
5		Specialist I ndihmës ekonomike Bathore +shërbime				I Lartë/Ekonomik/Juridik		
6		Specialist I ndihmës ekonomike Bathore				I Lartë/Ekonomik/Juridik		
Njesia administrative Paskuqan								
7		Shef I Sektorit te Ndhmes Ekonomike	Sektori I Ndhmes Ekonomike	2004	Nenpunes Civil	Diplome Universiteti ne Ekonomik	11 vjet	
8		Administrator I Nd. Ek.	Sektori I Ndhmes Ekonomike	2008	Kontrate Pa Afat	Arsimi I Mesem	7 vjet	
9		Administrator I Nd. Ek.& Ceshtjeve Sociale	Sektori I Ndhmes Ekonomike	2012	Nenpunes Civil	Diplome Universiteti ne Pune Sociale	3 vjet	

Bashkia Kamëz, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrative Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative e përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Tiranë	Qyteti Kamëz	Kamëz	Qyteti Kamëz, Fshatrat; Bathore, Laknas, Valias, Frutikulturë, Bulçesh, Zall-Mner	104,190	125,632	37.18
		Paskuqan	Fshatrat; Paskuqan, Babrru Qëndër, Kodër e Kuqe, Shpat, Fushë e Kërçikëve, Kodër Babrru, Paskuqan Fushë, Paskuqan Kodër			

Bashkia e re Kavajë

Të dhëna të përgjithshme

Zona Gjeografike: Kavaja kufizohet në veri nga bashkia Durrës, në lindje nga bashkia Tiranë, në jug nga bashkia Rrogozhinë dhe në perëndim nga deti Adriatik. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Kavajës.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011 Kavaja numëron një popullsi prej 40,094 banorësh, ndërkohë që sipas Regjistrat Civil kjo bashki numëron 79,445 banorë. Me sipërfaqe prej 198.81 km², ajo ka densitet prej 201 banorë/km² sipas censurit dhe 400 banorë/km² sipas regjistrat civil.

Bashkia e re Kavajë ka edhe 4 njësi administrative të cilat janë: Synej, Luz i Vogël, Golem dhe Helmas. Të gjitha janë pjesë e Rrethit Kavajë të Qarkut Tiranë. Bashkia e re ka një qytet dhe 32 fshatra. (shih listën e plotë të qyteteve dhe fshatrave)

Profili Bashkisë

Bashkia e Kavajës shtrihet në një zonë kodrash të buta dhe fushash pjellore deri në detin Adriatik, ku gjenden plazhe pjesërisht ranore dhe pjesërisht shkëmbore. Golemi, është ndërtuar gjatë viteve të fundit për shërbime turistike duke u larguar nga bujqësia. Komuna Synej e ka bregun e detit në përgjithësi ende pa ndërtime.

Qyteti i Kavajës është një qendër historike zejtare i cili e mori statutin e Kasabasë (ekuivalentin e titullit qytet) në vitin 1867). Popullsia e tij u shtua gjatë kohës së komunizmit në përgjithësi e përqendruar rreth traditës zejtare të qytetit, përfshirë prodhimin e enëve të baltës, prodhimin të qilimave si dhe industrive të reja si fabrika e qelqit apo Uzina e Gozhdeve dhe Bullonave.. Furnizimi me ujë dhe kanalizimet janë të ndërtuara në qytetin e Kavajës por një problem i vazhdueshëm dhe me pasoja të rënda negative për njësinë administrative të Golemit, ku uji i pijshëm është shumë i paktë dhe ujërat e zeza derdhen në det.



Sfidat e pushtetit vendor pas ndarjes së re

Aktiviteti industrial i qytetit është reduktuar ndjeshëm pas rënies së komunizmit duke sjellë edhe emigrim të konsiderueshëm dhe papunësi. Ndiham ekonomike në bashki është burim mbijetese për një nuër të konsiderueshëm familjesh. Nuk ka një përkufizim të saktë mbi nevojat për përkrahje sociale në fshat. Baza e taksueshme është ende e paperaktuar dhe po ashtu niveli e mbledhjes së të ardhurave.

Për zonën kodrinore të Helmësit, e cila ka edhe numrin më të vogël të popullsisë nga njësitë administrative përbërëse të Kavajës ka vështirësi me mirëmbajtjen e rrugëve. Rentabiliteti ekonomik i investimeve në infrastrukture për këto zone është shumë i ulët dhe përben një dilemë zhvillimore.

Marrëdhëniet mes qytetit të Kavajës dhe njësive administrative përbërëse mund të jenë problematike për shkak se shumica e votave në bashkinë e re janë përqendruar në qytetin e Kavajës gjë që redukton ndjeshëm peshën e votave të zonave rurale.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Në total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Kavajë për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është “ ”, (Shih Listen). Raporti gjinor është ... me Sa i takon shkollimit, të gjithë janë me arsim të lartë (shumica universitar). Te dy këta tregues e pozicionojmë mjaft mirë personelin bashkise se re Janë veem 4 nga 10 punonjes ne kete sektor qe gezojne statusin e nepunesit civil; pjesa tjetër janë me “kontratë pune” me afat dhe/ose pa afat.

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë së re Kavajë duhet të jenë 3 punonjës që ushtrojnë *njëkohësisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas përcaktimeve të ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP konfirmoi nominalisht 3 punonjës që kryejnë këtë funksion (*me ngyre portokalli*). Rekomandohet përcaktimi eksplicit i të paktën një pozicioni për NJMF në strukturën organizative të bashkisë së re Kavajë për vitin 2016.

Bashkia Kavaje

Marjusa CARA

Njesia administrative Synej

2		Administratore e ndihm,es ekonomike	Ndihma ekonomike	01.11.2003	Nepunes Civil	Diplome Universiteti Ekonomik	11	
---	--	-------------------------------------	------------------	------------	---------------	-------------------------------	----	--

Njesia administrative Luz iVogel

3		Inspekt perkr.soc	Finance	16/11/2010	1 vjeçare	Larter (Pune Sociale)	5 vjet	ska
---	--	-------------------	---------	------------	-----------	-----------------------	--------	-----

Njesia administrative Helmas

4	Megli Kazazi	Jurist					5	
---	--------------	--------	--	--	--	--	---	--

Njesia administrative Golem

5		Përgjegjëse Zyre	Zyra e Mbrojtjes Shoqësore	01.06.1993	Kontratë pa afat	Diplomë Universitare Ekonomik	22 vjet	
---	--	------------------	----------------------------	------------	------------------	-------------------------------	---------	--

Bashkia Kavajë, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrative Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Tiranë	Qyteti Kavajë	Kavajë	Qyteti Kavajë	40,094	79,556	198.81
		Synej	Fshatrat; Synej, Butaq, Rrikaj, Hajdaraj, Peqinaj, Rrakull, Bago			
		Luz i Vogël	Fshatrat; Luz i Vogël, Vorrozen, Beden, Blerimaj			
		Golem	Fshatrat; Golem, Kryemëdhej, Tilaj, Seferaj, Golemas, Qeret, Karpen, Zik-Xhafaj, Kanaparaj, Agonas, Karpen i ri			
		Helmas	Fshatrat; Helmas, Zikular, Lis-Patros, Shtodhër, Çetë, Momël, Habilaj, Çollakaj, Kryezi, Cikallesh			

Bashkia e re Këlcyrë

Të dhëna të përgjithshme

Zona Gjeografike: Këlcyra kufizohet në veri me bashkinë Poliçan, në lindje me Bashkinë Skrapar, në jug me bashkinë Përmet dhe Libohovë dhe në perëndim me Bashkinë Tepelenë dhe Memaliaj. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Këlcyrës.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia ka një popullsi prej 6.113 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki numëron 12.468 banorë. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 304.65 km² me një densitet prej 40.92 banorë/km².

Bashkia e Kercyre merr nën varesi edhe 3 njësi administrative, të cilat janë: Ballaban, Sukë dhe Dishnicë. Bashkia dhe NJA të saj janë aktualisht pjesë e rrethit Përmet dhe e qarkut Gjirokastrë. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 48 fshatra. (shih listën e plotë të qyteteve dhe fshatrave).

Profili i bashkisë

Këlcyra është një qytezë mes maleve [Trebeshinë](#) dhe [Nemerckë](#), e cila përshkohet nga ujërat e kthjellëta të Vjosës. Zona me peizazhe mahnitëse dhe vende historike ofron pak sa i përket strukturës arkitekturore. Zhvillimet urbane pa kriter, mos-kombinimi i ndërtimeve para viteve '90 me ato të tranzicionit dhe mungesa e një plani urban për zgjerimin kanë sjellë pasoja për qytezën e Këlcyrës.

Të ardhurat ekonomike të banorëve janë të ulëta. Ato vijnë nga aktivitete të vogla tregtare dhe shërbimi, por edhe nga bujqësia dhe blegtoria e pakët. Këlcyra është dalluar gjithmonë për cilësinë e lartë të frutave dhe rrushit dhe është njohur si qendër për kultivimin e rakisë dhe verës. Por kaosi në tregun shqiptar të pijeve dhe spekulimet kanë bërë që Merloti i famshëm i Këlcyrës pothuajse të humbasë në tregun shqiptar të verës.



Sfidat e pushtetit vendor pas ndarjes së re

Popullsia e Këlcyrës është e përbërë kryesisht nga vendas dhe të ardhur nga fshatrat përreth. Shumë banorë kanë migruar drejt Tiranës, ndërsa një pjesë e madhe e popullsisë kanë emigruar kryesisht drejt Greqisë fqinje. Të ardhurat nga emigracioni kanë mbështetur mjaft familje të zonës, por rënia e tyre për shkak të krizës ka rënduar situatën ekonomike të banorëve.

Sfida kryesore e bashkisë së re të Këlcyrës është integrimi i politikave të zhvillimit mes zonave të reja dhe Bashkisë aktuale, Rikonstruksioni i rrugëve, ndërtimi i urave dhe ujësjellësve, përballimi i përmytjeve që mund të vijnë nga Vjosa apo dëmeve që shkaktohen nga erozioni konsiderohen çështje që kërkojnë ndërhyrje emergjente për rivitalizimin e bashkisë.

Bashkia e re duhet të rrisë nivelin e të ardhurave duke menaxhuar më mirë fondet pyjore dhe asetet e saj, ndërsa duhet t'u ofrojë më shumë mbështetje shtresave në nevojë.

Bashkia do duhet të përballojë nevojat e sektorit arsimor, sidomos për përmirësimin e mjediseve të shkollave, rikonstruksionin e godinave dhe ngrohjen e tyre gjatë dimrit.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Në total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Këlcyrë për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është “4”, (Shih Listën më poshtë).Raporti gjinor është 1 me 3, ne favor te meshkujve.

Sa i takon shkollimit, 3 punonjës kanë mbaruar studimet e larta dhe vetëm 1 ka arsim të mesëm.

Asnjë nga të katërt punonjësit nuk gëzon statusin e nëpunësit civil. Të 4 punonjësit janë punësuar me “kontratë pune”. 3 prej tyre kanë kontratë pune pa afat dhe vetëm një ka kontratë pune me afat.

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë së re Këlcyrë nuk ka punonjës që ushtron *njëkohësisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas percaktimeve të ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP konfirmoi nominalisht se asnjë prej tyre nuk e ushtron këtë funksion *njëkohësisht* dhe/ose *posaçërisht*. Rekomandohet përcaktimi eksplicit i të paktën një pozicioni për NJMF në strukturën organizative të bashkisë së re Këlcyrë për vitin 2016.

Bashkia Këlcyrë

Nr	Emri Mbiemri	Pozicioni i punes	Sektori	Data e fillimit	Lloji i kontrates se punes	Edukimi/ Kualifikimi	Ekperienca e punes ne njesi	Kategori te mbrojtura
1		admin .n.e.pun arshive etj .	Nd Ekonomike	2012	pa afat	master profesional matematik informatik	3 vjet	
Njesia administrative Ballaban								
2		punonjes I ndihmes ekonomike	Nd Ekonomike	2010	me afat	shkoll e mesme	5 vjet	
Njesia administrative Sukë								
3		Administrator Z.Ndihmes Shoqerore	Sektori i Ndhmes Ekonomike	2012	Kontrate pa afat	Histori-Gjeografi	3 vjet	
Njesia administrative Dishnicë								
4		Shef I sektorit te finances	Sektori I Finances	1997	Kontrate pa afat	Universiteti I Tiranes		

Bashkia Kërcyrë, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrative Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Gjirokastrë	Qyteti Këlcyrë	Këlcyrë	Qyteti Këlcyrë, Fshatrat; Fshat Këlcyrë, Mbrezhdan, Maleshovë, Limar, Leskaj	6,113	12,468	304.65
		Ballaban	Fshatrat; Ballaban, Vinokash, Vinokash Fushë, Komarak, Mazhar, Kondas, Psar, Ball, Kajcë, Pavar, Toshkëz, Bubës 1, Bubës 2, Beqaraj			
		Sukë	Fshatrat; Sukë, Goricë, Fshat i Ri, Rodenjë, Podgoran, Podgoran Fushë, Ujmirë, Zhepovë, Shelq, Topojan, Luar, Delilaj, Çorogunj, Taroninë			
		Dishnicë	Fshatrat; Beduqas, Tolar, Panarit, Riban, Varibop, Kuqar, Mërtinjë, Xhanaj, Bënjë, Fratar, Senican, Katundishtë, Leskovec, Gërdas, Kodrishtë			

Bashkia e re Klos

Të dhëna të përgjithshme

Zona Gjeografike: Klosi kufizohet në veri me bashkinë e Matit, në perëndim me bashkinë e Krujës, në jug-perëndim me bashkinë Tiranë, në jug-lindje me bashkinë Bulqizë. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Klosit.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011 numëron një popullsi prej 16,618 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil kjo bashki numëron 20,281 banorë. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 357.48 km² me një densitet prej 58.24 banorë/km² sipas regjistrimit civil dhe 46 banorë/km² sipas Censurit.

Bashkia Klos ka nën varesi edhe 3 njësi administrative: Xibër, Suç, Gurrë. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Mat dhe qarkut të Dibrës. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 30 fshatra (shih listën e plotë).

Profili i bashkisë

Një pjesë e mirë e sipërfaqes së kësaj bashkie është zonë fushore që përbëhet nga lugina e Matit me kullota që variojnë nga 240 metra në 600 metra mbi nivelin e detit. Klosi është dhe mbetet një nyje që lidh Dibrën me Tiranën.

Degët kryesore të ekonomisë janë pemtaria, blegtoaria dhe shërbimet. Klosi është i pasur me burime të shumta natyrore, tokësore dhe nëntokësore. Pyjet dhe kullotat komunale zënë një sipërfaqe të konsiderueshme, ku përveç lëndës drusore, ka edhe mjaft bimë mjekësore. Një tjetër burim kryesor të ardhurash për banorët e këtij rajoni përbën edhe turizmi malor. Ndër investimet e dhëna në realizimin e projekte të mëdha në këtë zonë përmendim: Sistemim-asfaltim i bulevardit të qytetit, rrugës rurale që lidh fshatin Fullqet me qendrën e bashkisë, si dhe sistemim-asfaltimi i rrugëve që lidhin fshatrat Fullqet, Cërujë, Benjë, Lis, Gurrë dhe Kurdari me rrugën nacionale. Investime të mëdha konsiderohen për ndërtimet e ujësjellësve në Bershi dhe Cërujë.



Ndër problematikat kryesore renditen: menaxhimi i pasurive minerare, menaxhimi i tokës bujqësore, ndërhyrjet në infrastrukturën rrugore që lidhin qendrat turistike të zonës, hartimi i planit strategjik urbanistik, sistemim-asfaltim i rrugëve që lidhin komunat me qendrën e bashkisë, krijimi i hartës turistike të zonës, -ndërtimi i ujësjellësve duke filluar nga fshatrat me popullsi më të madhe, ndërtimi i kanaleve vaditëse për secilin fshat duke u mbështetur në anën financiare që do të ketë bashkia, zhvillimi i bujqësisë dhe blegtorisë sipas kushteve klimatike për zhvillimin e një kulture bujqësore apo blegtorale. ndërtimi i një pallati kulture në qytet, ndërtimi i unazës së qytetit dhe shndërrimi i bulevardit në pedonale, ndërtimi i dy urave mbi lumin Mat dhe kalimi i qytetit në pjesën jug-perëndimore të tij.

Sfidat e pushtetit vendor pas ndarjes së re

Lëvizjet demografike të popullsisë drejt zonave urbane, karakteristike për rajonin e Dibrës, vihen re dhe në Klos. Kryesisht lëvizja ka pasur tendencën drejt qendrës urbane të Burrelit dhe asaj metropolitane në Tiranë e Durrës. Emigrimi është i dukshëm sidomos tek të rinjtë dhe burrat dhe remitancat janë baza kryesore e të ardhurave që vijnë për familjet. Greqia, Italia dhe Anglia janë vendet ku është përqendruar ky emigrim, ku statusi i tyre është si i gjithë emigrantëve të tjerë shqiptarë me dokumenta dhe pa dokumenta.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Në total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Klos për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është “5”, (Shih Listën më poshtë). Raporti gjinor është 5 me 0 në favor të meshkujve. Rekomandohet që Bashkia Klos në politikat e rekrutimit ti kushtojë një vemendje më të madhe cështjeve gjinore. Sa i takon shkollimit, vetëm një punonjës ka arsimin e lartë , 4 të tjerët kanë arsim të mesëm . Në varësi të politikave që do të ndjekë MMSR, sugjerohet ngritja e nivelit arsimor të stafit të targetuar përmes kualifikimit të posaçëm ose përmes rekrutimit të burimeve njerëzore me arsimin të përshtatshëm Vetëm 1 punonjës në këtë sektor gëzon statusin e nëpunësit civil; 4 punonjësit e tjerë janë me “kontratë pune”, konkretisht 2 punonjës

me kontratë pune me afat dhe dy punonjës me kontratë pune pa afat

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë së re Klos duhet të jenë 2 punonjës që ushtrojnë *njëkohësisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas percaktimeve të ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP konfirmoi nominalisht vetëm 1 prej tyre (*me ngyre portokalli*). Nuk konfirmohet emri (jo funksioni) i 1 punonjësi të NJMF në NJA Suc (*me blu*). Rekomandohet përcaktimi eksplicit i të paktën një pozicioni për NJMF në strukturën organizative të bashkisë së re Klos për vitin 2016.

Bashkia Klos								
Nr	Emri Mbiemri	Pozicioni i punes	Sektori	Data e fillimit	Lloji i kontrates se punes	Edukimi/ Kualifikimi	Ekperienc a e punes ne njesi	Kategori te mbrojtur a
	Sektori I Çeshtjeve Sociale							
1		P/Sek.Çeshtjeve Sociale	Sek.Çeshtjeve Sociale	30.09.2010	Nenpunes Civil	Diplome Universiteti ne Drejtim Biznesi	9 vjet	
2		Ins.Çeshtjeve Sociale	Sek.Çeshtjeve Sociale	11.03.2013	Kontrate me afat	Mesem pergjithshem	9 vjet	
Njesia administartive Gurrë								
3		Përgjegjës Ndhma Ekonomike	Sektori Ndhma Ekonomike	6/4/2012	Kontratë pa afat	Shkollë e mesme	16 vjet	
Njesia administartive Suç								
4		Përgjegjës Ndhma Ekonomike	Sektori Ndhma Ekonomike	2/1/2004	Kontratë pa afat	Shkollë e mesme	11 vjet	
Njesia administartive Xibër								
5		Përgjegjës Ndhma Ekonomike	Sektori Ndhma Ekonomike	10/1/2010	Kontratë me afat	Shkollë e mesme	14 vjet	

Bashkia Klos, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrative Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrativ e përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Dibër	Qyteti Klos	Klos	Qyteti Klos, Fshatrat; Bejnë, Klos Katund, Shëngjun, Plani i Bardhë, Fullqet, Dars, Fshat, Bel, Unjate, Pleshë, Cerrujë, Patin, Bërshi	16,618	20,821	357.48
		Xibër	Fshatrat; Xibër Murriz, Petralbë, Shkallë, Xibër Hane, Gur i Bardhë, Ketë			
		Suç	Fshatrat; Kurdari, Kurqelaj, Skënderaj, Suç, Kujtim,			
		Gurrë	Fshatrat; Rripë, Gurrë e Vogël, Mishtë, Shulbatër, Dom, Gurrë e Madhe			

Bashkia e re Kolonjë

Të dhëna të përgjithshme

Zona Gjeografike: Bashkia Kolonjë kufizohet në veri me bashkitë Devoll dhe Korçë, në perëndim dhe jug me bashkinë Përmet, ndërsa në lindje me Greqinë. Kryeqendra: qyteti i Ersekës.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia e re numëron 11.070 banorë, ndërsa sipas Regjistrat Civil kjo bashki numëron një popullsi prej 19.919 vetësh në një sipërfaqe prej 864.06 km².

Kjo bashki ka edhe 7 njësi administrative të tjera, të cilat janë: Qendër Ersekë, Leksovik, Qendër Leksovik, Novoselë, Barmash, Mollas dhe Çlirim. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e qarkut të Korçës. Bashkia e re ka nën administrimin e saj dy qytete (Ersekë dhe Leksovik) dhe 76 fshatra. (shiko listën e plotë me poshte).

Profili i bashkisë

Bashkisë së Ersekës, pas ndarjes së re administrative, nga njëra anë i bashkohen edhe disa prej malësive përreth saj, ndërsa nga ana tjetër, me shkrirjen në një me të bashkisë së Leksovikut përveç zgjerimit të kufirit administrativ-territorial, zgjerohet edhe diapazoni i veprimtarisë dhe mënyrës së jetesës së banorëve. Zona kryesisht malore ka një varfëri të theksuar ndërsa të ardhurat kryesore kanë qenë të mbështetura tek emigracioni, megjithatë, si pasojë e krizës greke janë reduktuar ndjeshëm dhe të ardhurat e banorëve nga remitancat.

Përveç emigracionit, zona ka pasur edhe largim masiv të banorëve drejt qendrave urbane duke sjellë braktisje të fshatrave ose popullim të pakët të tyre dhe duke e bërë zonën me densitet më të ulët të popullatës banuese në vend. Për shkak të pozicionit, zona e thellë nuk arrin të tërheqë investitorët dhe frenon hapjen e bizneseve, duke krijuar mundësi të pakta punësimi të cilat do të mund të kapërceheshin nëpërmjet ngritjes së ndërmarrjeve fasone, fabrikave të përpunimit të qumështit, etj.



Përgjatë viteve të fundit hov ka marrë kultivimi i bimëve medicinale por edhe grumbullimi i tyre në malin e Gramozit, Në zonën e Leksovikut potencialet turistike janë të shumta por distanca nga zonat e rëndësishme urbane të vendit, si dhe mungesa infrastrukturore i ka lënë të pashfrytëzuara Traditat kulturore dhe folklorike janë ruajtur mjaft mirë nga banorët.

Sfidat e pushtetit vendor pas ndarjes së re

Bashkia e Ersekës fillimisht do të duhet të përballë me vështirësitë e menaxhimit të një hapësire të madhe, ku do të përfshihet edhe zona e Leksovikut dhe harmonizimi i bashkëjetesës dhe ndërveprimit mes banorëve në zonat rurale dhe ato urbane. Kanalizimi i problematikës së shpërndarjes së investimeve mes zonave të cilat prioritet kanë bujqësinë, blegtorinë dhe vreshtarinë dhe qytetit që ka papunësi të theksuar identifikohet si një nga sfidat kryesore. Përcaktimi i kapaciteteve ekonomike dhe i burimit të ardhurave të njësisë së re vendore nga njëra anë dhe rikthimi i banorëve drejt kultivimit të tokave të lëna djerrë për shkak të mungesës së infrastrukturës në vaditje dhe kullim nga ana tjetër kërkon një strategji të mirëpërcaktuar. Në fushën e arsimit, godinat e shkollave, përveçse janë në kushte tepër të këqija infrastrukturore, në periudhën e dimrit thuajse nuk frekuentohen nga nxënësit për shkak të mungesës së ngrohjes dhe bllokimit të rrugëve nga dëbora. Kjo sjell për pasojë braktisjen e shkolles nga nxënësit.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Në total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Kolonjë për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është “8”, (Shih Listën më poshtë).Raporti gjinor është 2 me 6, ne favor te meshkujve. Sa i takon shkollimit, 5 punonjës janë me arsim të lartë (shumica universitar), të gjithë me profil ekonomik. Vetëm 3 punonjës kanë arsim të mesëm. Asnjë punonjës me profil social. Jane vetem 2 nga 8 punonjës në këtë sektor që gëzojnë statusin e nëpunësit civil; 6 punonjësit e tjerë janë punësuar me kontratë pune konkretisht me “kontratë pune” me afat (1 punonjës), me kontratë pune pa afat pa afat (3

punonjës), me kontratë pune (1 punonjës). Mungojnë të dhëna për një punonjës.

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë së re Kolonjë vetëm 1 punonjës ushtron *njëkohësisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas percaktimeve të ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP konfirmoi nominalisht 1 punonjës (*me ngyre portokalli*). Rekomandohet përcaktimi eksplicit i të paktën një pozicioni për NJMF në strukturën organizative të bashkisë së re Kolonjë për vitin 2016.

Bashkia Kolonje

Nr	Emri Mbiemri	Pozicioni i punes	Sektori	Data e fillimit	Lloji i kontrates se punes	Edukimi/ Kualifikimi	Ekperienca e punes ne njesi	Kategori te mbrojtura
1		Administrator i zyles ekonomike	Zyra e ndihmes Ekonomike	1997	Nenpunes Civil	Diplome Universiteti ne Ekomomis,Plan	18vjet	
Njesia administrative Leskovik								
2		Administrator		2014	pa afat	Diplo.unv ekonomike	6 muaj	
Njesia administrative Qender Leskovik								
3		Administratore e ndihmes ,mbledhese taksash	Sektori i finances	20.02.1998	Nenpunes civil	Diplome e universitetit Ekon kontabel	17 vjet	
Njesia administrative Mollas								
4		Inspektor I N. E	Sektori I N.Ekonomike	05.09.2011	kontrate me afat	I mesem	3 vite e 7 muaj	
Njesia administrative Qender Erseke								
5		Sherbimi Social		10.01.2012		Diplome shkolla e mesme Ekonomike	3 vjet e 3 muaj	
Njesia administrative Barmash								
6		Administratore shoq	Sektori i finances	14.09.2007	kontrate pune	Arsim I mesem	7 vjet	
Njesia administrative Çlirim								
7		Inspektor N. Ekon	Zyra Nihmes.Ek	1997	Kontrate pa afat	Diplome Universiteti ne Ekonomik	18 vjet	
Njesia administrative Novosele								
8		Inspektor Nd Ekonomike	Zyra Ekonomik	1996	Kontrate pa afat	Ekonomik Mesem	19 Vjet	

Bashkia Kolonjë, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrative Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrativ e përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Korçë	Qyteti Erseke	Ersekë	Qyteti Ersekë	11,070	19,919	864.06
		Qendër Ersekë	Fshatrat; Starie, Bejkovë, Psar, Selenicë, Kreshovë, Gostivisht, Lëngës, Kodras, Kabash, Borovë, Taç Qëndër, Taç Poshtë, Taç Lartë, Rehovë, Gjonç, Prodan			
		Leskovik	Qyteti Leskovik			
		Qëndër Leskovik	Fshatrat; Pobickë, Cerckë, Radat, Radovë, Postenan, Lashovë, Peshtan, Podë, Kovaçisht, Vrepckë, Gërmenj, Radanj, Glinë, Gjirakar			
		Novoselë	Fshatrat; Novoselë, Mesiçkë, Kagjinas, Zharkan, Piskal, Vitisht, Shijan, Kaduq, Ndërmarr, Mbreshtan			
		Barmash	Fshatrat; Barmash, Leshnjë, Shalës, Gozhdorazhd, Sanjollas, Kamnik, Bënjëz, Radimisht, Arrëz, Rajan			
		Mollas	Fshatrat; Mollas, Skorovot, Qinam, Vodicë, Qafzez, Helmës, Shtikë, Pepellash, Butkë, Kozel, Milec, Bezhan, Boshani, Blush			
		Çlirim	Fshatrat; Çlirim, Qesarak, Kaltanj, Qytezë, Selenicë e Pishës, Luaras, Lënckë, Kurtez, Orgockë, Qinam-Radovickë, Radovickë, Psar i Zi			

Bashkia e re Konispol

Të dhëna të përgjithshme

Zona Gjeografike: Bashkia e re e Konispoli kufizohet në veri me bashkinë Finiq, në perëndim me Sarandën dhe në jug me Greqinë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Konispolit. Bashkia e re përbëhet nga 3 Njësi Administrative.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011 bashkia e re Konispol ka një popullsi prej 8,245 banorësh ndërsa sipas regjistrimit civil ka 13,737 banorë. Sipërfaqja e bashkisë së re është 221.88 km². Sipas të dhënave të censurit, densiteti i popullsisë është 37.1 banorë për kilometër katror ndërsa sipas regjistrimit civil densiteti është 61.91 banorë/km².

Njësitë administrative në varesinë e bashkisë Konispol janë Xarrë dhe Markat. (shih me poshte edhe listën e fshtrave)

Profili i bashkisë

Bashkia e re e Konispolit ka si aktivitet kryesor ekonomik bujqësinë dhe blegtorinë si dhe tregtinë ndërkufitare me Greqinë. Një pjesë e popullsisë shërben në sektorin e transportit për qëllime turistike në Sarandë ose për transportin ndërkufitar, ndërsa një pjesë e popullsisë kalon kufirin rregullisht për të punuar përkohësisht në zonat pranë kufirit në Greqi.

Bujqësia është e përqendruar te argumet, ullinjë dhe vreshtat ndërsa zona është e famshme edhe për kullota dimërore.

Infrastruktura e zonës është sistemuar me ndërtimin e rrugëve lidhëse me Sarandën dhe me Finiqin si dhe me rrugën drejt pikës kufitare të Qafë-Botit. Bashkia e re do të ketë në territorin e saj edhe një vijë bregdetare prej rreth 10 kilometra të gjatë e cila aktualisht është e pazhvilluar përreth Kepit të Stillos me bukuri të rrallë. Në këtë pjesë të bregdetit gjenden mes të tjerash Ishulli i Tongos, një shkëmb me sipërfaqe prej rreth 5 mijë metrash katrorë pranë gjirit të Fteliat, në kufi me Greqinë, si dhe ishulli i Stilit.



Sfidat e pushtetit vendor pas ndarjes së re

Në pjesën veriore të bashkisë së re është krijuar një fshat i ri me banorë të ardhur nga Mirdita, popullsi që është përqendruar te artizanati në funksion të turistëve që vizitojnë Butrintin.

Në fshatin Xarë një përpjekje e përbashkët e komunitetit ka krijuar një kooperativë shumë të suksesshme të përqendruar te prodhimi i agrumeve. Por pavarësisht suksesit të bujqësisë në Xarë, popullsia e të gjithë zonës ka qenë në rënie të shpejtë gjatë dekadës së fundit.

Zhvillimi i bujqësisë dhe blegtorisë duke u bazuar te praktikat e suksesshme të kooperativës së Xarës është një sfidë që duhet të marrë parasysh nevojën për të krijuar kushte të mira jetese për popullsinë duke shmangur në këtë mënyrë emigrimin e mëtejshëm. Kujdesi për me te moshuarit është gjithashtu një nevojë.

Personeli i ndihmes ekonomike dhe/ose shërbimeve sociale duhet shtuar. Forcimi i kohezionit social gjithashtu është një parakusht për zhvillim e potencialit ekonomik të kësaj bashkie.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Në total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Konispol për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është "3", (Shih Listën më poshtë). Raporti gjinor është 2 me 1 në favor të femrave.

Sa i takon shkollimit, 1 punonjës është me arsim të lartë (universitar) dhe dy të tjerët kanë arsim të mesëm (profili ekonomik). Asnjë punonjës në këtë sektor nuk gëzon statusin e nëpunësit civil; dy punonjës janë të punësuar me Kod Pune, për punonjësin e mbetur mungon kjo e dhënë. Në varësi të politikave që do të ndjekë MMSR, sugjerohet që bashkia Konispol të punojë më shumë për ngritjen e nivelit arsimor të stafit të

targetuar përmes kualifikimit të posaçëm ose përmes rekrutimit të burimeve njerëzore me arsimin të përshtatshëm.

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë së re Konispol duhet të jenë 3 punonjës që ushtrojnë *njëkohësisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas percaktimeve të ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP konfirmoi nominalisht vetëm 1 prej tyre (*me ngyre portokalli*). Nuk konfirmohet emri (jo funksioni) i 2 punonjësve në NJA Konispol dhe Markat (me blu). Rekomandohet përcaktimi eksplicit i të paktën një pozicioni për NJMF në strukturën organizative 2016.

Bashkia Konispol								
Nr	Emri Mbiemri	Pozicioni i punes	Sektori	Data e fillimit	Lloji i kontrates se punes	Edukimi/ Kualifikimi	Ekperienca e punes ne njesi	Kategori te mbrojtura
1		Sp. Nd. Ekonomike	Nd. Ekonom	27.09.2011	Kod Pune	Shkolla e mesme Ekonomike	1993-2015	
Njesia administrative Xare								
2		ADMINISTRATORE ND.EKON.	ND.EKONOM.	15.04.1998	"	SHKOLLE E MESME EKONOMIKE	17 Vjet	
Njesia administrative Markat								
3		Administratore Ndhmës Soc-Eko	Financa	01,04,2007	Kodi I Punes	Diplome Universitare Niveli I Pare ne Pedagogji	8 vjete (2007-2015)	

Bashkia Konispol, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrative Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Vlorë	Qyteti Konispol	Konispol	Qyteti Konispol, Fshati; Çiflik,	8,245	13737	221.88
		Xarrë	Fshatrat; Xarrë, Mursi, Shkallë, Vrinë, Shëndëlli, Sopik, Pandalejmon, Vagalat.			
		Markat	Fshatrat; Dishat, Vërvë, Shalës, Markat, Ninat, Janjar			

Bashkia e re Korçë

Të dhëna të përgjithshme

Zona Gjeografike: Korça kufizohet në veri me bashkinë Maliq, në lindje me bashkinë Devoll, në perëndim me bashkinë Skrapar, ndërsa në jug me bashkinë Kolonjë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Korçës.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, kjo bashki numëron prej 75.994 banorësh, ndërsa sipas Regjistrat Civil ajo numëron një popullsi prej 129.065 vetë. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 805.99 km².

Kjo bashki ka në përbërje edhe 7 njësi administrative, të cilat janë: Qendër Bulgarec, Voskop, Voskopojë, Lekas, Vithkuq, Mollaj dhe Drenovë. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Korçës dhe qarkut Korçë. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 62 fshatra.

Profili i bashkisë

Bashkisë së Korçës iu bashkëngjiten disa zona rurale të cilat merren me bujqësi dhe blegtori, por edhe disa prej fshatrave turistike më të spikatur. Qyteti ka një ekonomi të konsoliduar dhe biznese të shumta, por rritja e numrit të popullsisë si pasojë e zhvendosjes së banorëve nga zonat rurale ka sjellë edhe rritje të numrit të personave të papunë duke ngritur domosdoshmërinë e gjetjes së zgjidhjeve për punësim dhe kualifikimin e këtyre.

Në zonat rurale janë zhvilluar nga njëra anë bujqësia dhe pemëtaria, dhe nga ana tjetër turizmi malor ku banorët kanë vetë-siguruar mënyrën e organizimit të ambienteve dhe kuzhinës por edhe aktiviteteve dimërore si një atraksion për turistët. Zonat më të thella si Lekasi dhe Vithkuqi për shkak të klimës së ashpër dhe izolimit të përvitshëm në dimër kanë pësuar zhvendosje masive të popullsisë çka ka minimizuar edhe shërbimet për pjesën e mbetur të banorëve duke nisur nga arsimi, mjekësia, infrastruktura, transporti, etj.



Përgjatë viteve të fundit Korça ka synuar dhe ka arritur të shumëfishojë shifrat e turistëve përmes një kalendari të mbushur me festa përgjatë verës.

Sfidat e pushtetit vendor pas ndarjes re

Një nga sfidat me të cilat do të përballlet bashkia e re në sajë të reformës është sigurimi i përfaqësimit të drejtë në këshillat bashkiakë të komuniteteve nga zona urbane dhe nga zonat rurale, si dhe hartimi i strategjive që do orientohen në mënyrë të drejtë nga nevoja për investime në të dy këto zona.

Një tjetër problematikë e identifikuar nga komuniteti i kësaj bashkie të re e cila duhet të adresohet është dhe përmirësimi i infrastrukturës arsimore në disa zona, sigurimi i ngrohjes në ambientet shkollorë, si dhe mundësimi i transportit për nxënës të zonave të thella drejt shkollave më të mëdha.

Një ndër aspektet e rëndësishme të cilat bashkia e re duhet të adresojë është dhe përmirësimi i infrastrukturës në zonat e banuara kryesisht nga komuniteti rom i kësaj bashkie, si dhe nxitja e gjithëpërfshirjes së këtij komuniteti në jetën social-ekonomike të bashkisë, me fokus të veçantë në zgjidhjen e problemeve të arsimit dhe strehimit të këtyre familjeve.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Në total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Korçë për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është “19”, (Shih Listën më poshtë).

Raporti gjinor është 13 me 6 ne favor të femrave.

Sa i takon shkollimit, 16 punonjës kanë arsim të lartë (5 prej në profiling filozofi psikologji). 3 punonjës të tjerë kanë arsimin e mesëm. 11 punonjës në këtë sektor gëzojnë statusin e nëpunësit civil; 6 punonjës janë me “kontratë pune” me afat dhe 1 punonjës me kontratë pune pa afat.

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë së re Korçë duhet të jenë 5 punonjës që ushtrojnë *njëkohësisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas përcaktimeve të ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP konfirmoi nominalisht vetëm 4 prej tyre (*me ngyre portokalli*). Nuk konfirmohet emri (jo funksioni) i 1 punonjësi të NJMF në NJA Mollaj (me blu). Rekomandohet përcaktimi eksplicit i të paktën një pozicioni për NJMF në strukturën organizative të bashkisë së re Korçë për vitin 2016.

Bashkia Korçe

Nr	Emri Mbiemri	Pozicioni i punes	Sektori	Data e fillimit	Lloji i kontrates se punes	Edukimi/ Kualifikimi	Ekperienca e punes ne njesi	Kategori te mbrojtura me ligj
Drejtorja e Kujdesit Social								
1		Drejtor		19.04.2012	Nepunes civil	Univ ne mesuesi	3 vjet	
2		Specialiste	Sektori I pagesave ne kesh	14.01.2013	Kontrate pa afat	Shkolla e mesme teknike	2.5 vjet	
3		Specialiste	Sektori I pagesave ne kesh	31.05.2010	Kontrate pa afat	Univ. ne ekonomik	5 vjet	
4		Specialist	Sektori I pagesave ne kesh	05.03.2014	Kontrate pa afat	Univ.Filozofi Sociologji	2.2 vjet	
5		Specialist	Sektori I pagesave ne kesh	18.04.2008	Kontrate pa afat	Univ.ne ekonomik	5 vjet	
6		Specialist	Sektori I pagesave ne kesh	05.04.2013	Kontrate pa afat	Univ . Ne ekonomik	2 vjet	
7		Specialist per invalidalid	Sektori I pagesave ne kesh	20.05.2013	Nepunes civil	Univ. Ing Agronomike	2 vjet	
8		Spec per PAK, verberi	Sektori I pagesave ne kesh	18.04.2008	Nepunes civil	Univ ne ekonomik	7 vjet	
9		Spec per pagesa invalid	Sektori I pagesave ne kesh	13.11.2006	Nepunes civil	Univ Filozofi Sociologji	7.6 vjet	

10		Spec per mbrojtjeve	Sektori I shërbimeve Sociale	13.01.2014	Nepunes civil	Univ. ne Psikologji	1,5 vjet	
11		specialiste	Sek. Shërbimeve sociale	21.01.2013	Nepunes civil	Univ.sociologji-filozofi	2,5 vjet	
12		specialiste	Sek.Shërbimeve sociale	14.08.2012	Nepunes civil	Univ.sociologji-filozofi	3-vjet	
Njesia administrative Bulgarec								
13		Specialist	Sektori ndihmes ekon.	2006		Diplome Shkolla e Mesme	12 vjet	
Njesia administrative Drenove								
14		Sekretar keshilli dhe Administrator Shoqëror	Sek Ndhimes Ekonom	12/6/2006	Nenpunes Civil	Agronom I larte	9 Vjet	
Njesia administrative Mollaj								
15		N/Kryetare+Pergj AMT	Sek Ndhimes Ekonom	2007	Nenpunes Civil	Universiteti buqësor dega agronomi e Pergj.	18 vjet	
Njesia administrative Voskop								
16		Inspektore	Finance /ndihmes ekonomike	1997	Nenpunes civil	Diplome Universiteti ne Ekonomik	19 vjet	
Njesia administrative Voskopoje								
17		Insp.finance ndihmes ekonomike	finances	1/7/2004	Kontrate pa afat	Shkolla e mesme profesionale ekonomike	10vjet	
Njesia administrative Vithkuq								
18		Zyra e Mbrojtjes se tokes dhe shërbime sociale		10.02.1994	Kontrate me afat	Diplome Universiteti ne Agronomi	21 vjet	
Njesia administrtaive Lekas								
19		P/SHERBIMI+ Nd Eko	Shërbimi social	1993	Nenpunes Civil	Diplome Universiteti ne Ekonomik	22	

Bashkia Korçë, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrative Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrativ e përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Korçë	Qyteti Korçë	Korçë	Qyteti Korçë	75,994	129,065	805.99
		Qëndër Bulgarec	Fshatrat; Bulgarec, Lumalas, Biranj, Melcan, Porodinë, Dishnicë, Shamoll, Belorta, Kuç i Zi, Barç, Çiflig, Malavec, Neviçisht			
		Voskop	Fshatrat; Voskop, Dërsnik, Polen, Vinçan, Goskovë lart, Goskovë poshtë, Damjanec			
		Voskopojë	Fshatrat; Voskopojë, Shipskë, Krushovë, Gjonomadhi, Lavdar			
		Lekas	Fshatrat; Lekas, Marjan, Gjonbabas, Gurmuja, Shkozan, Xerje, Tudas, Gjergjevicë, Lavdar Brozdovec, Mazrek, Poponivë			
		Vithkuq	Fshatrat; Vithkuq, Leshnje, Gjanc, Lubonjë, Rehovë, Roshanj, Trebickë, Grabockë, Treskë, Stratobërdh, Panarit, Shtyllë, Cemicë			
		Mollaj	Fshatrat; Mollaj, Floq, Pulahë, Ujë Bardhë, Kamenicë			
		Drenovë	Fshatrat; Drenovë, Mborje, Boboshticë, Moravë, Qatrom, Ravonik, Turan, Dardhë			

Bashkia e re Krujë

Të dhëna të përgjithshme

Zona Gjeografike: Bashkia Krujë kufizohet në veri me Bashkinë e Kurbinit, në perëndim me Bashkinë Durrës, në jug me bashkitë Kamëz dhe Tiranë dhe në lindje me bashkitë Mat dhe Klos. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Krujës.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011 Kruja ka 59.814 banorë. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil kjo bashki numëron një popullsi prej 79.608 vetësh. Kruja ka një sipërfaqe prej 339.02 km². Sipas Censurit, densiteti i popullsisë është 176.43 banorë/km² ndërsa sipas Regjistrimit Civil dendësia është 234.81 banorë/km².

Kjo bashki ka edhe 5 njësi administrative, të cilat janë: Fushë-Krujë, Bubq, Nikël, Thumanë dhe Cudhi. Në bashkinë e re gjenden dy qytete dhe 50 fshatra. Të gjitha njësitë janë pjesë e Qarkut Durrës.

Profili i Bashkisë

Bashkia Krujë shtrihet në një terren të përzierë fushor dhe malor. Ajo përshkohet në pjesën fushore nga korridori rrugor dhe hekurudhor veri–jug. Në zonën fushore disponon rezerva të konsiderueshme të gurit gëlqeror, gjë që ka sjellë ndërtimin e disa fabrikave të çimentos si dhe shumë punishteve të prodhimit të gëlqeres, industri të cilat kanë ndikim të madh negativ në mjedis duke qenë industritë më ndotëse në vend.

Ndryshe nga zona fushore, qyteti i Krujës, Mali i Krujës dhe Parku Kombëtar i Qafë Shtamës ofrojnë resurse të konsiderueshme të turizmit kulturor, malor, fetar dhe shëndetësor, (Ilixhat në fshatin Bilaj). Lumi Ishëm që kalon përmes bashkisë së re është një ndotës i vazhdueshëm, problem që duhet të zgjidhet në bashkëpunim me të gjitha bashkitë e këtij baseni ujëmbledhës, përfshirë Tiranën dhe bashkinë Kamëz.

Qyteti i Krujës me kështjellën mesjetare, tregun e stilit osman, muzeun etnografik dhe muzeun kombëtar “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” është ndoshta vendi më i vizituar turistik në Shqipëri ndërsa turizmi ka sjellë edhe ruajtjen e traditës së artizanatit në disa zeje të kufizuara në Pazarin e Krujës.



Sfidat e pushtetit vendor pas ndarjes së re

Të dyja qytetet, Kruja dhe Fushë-Kruja, kanë si burime kryesore punësimi industrinë e veshjeve dhe këpucëve ndërsa qyteti i Fushë-Krujës siguron një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave edhe nga fabrika e çimentos. Furnizimi me ujë është me orar të reduktuar.

Menaxhimi i një bashkie me zona me tipare shumë të ndryshme dhe me nevoja të ndryshme pritet të përbëjë sfidën kryesore për bashkinë e re. Qyteti i Krujës dhe Malësia kanë nevojë për nxitjen e turizmit dhe të artizanatit, ndërkohë që bashkia e re duhet të ndalojë shfrytëzimin pa kriter të resurseve të gëlqeres, të cilat kanë shkatërruar tashmë pyjet dhe kanë krijuar një nivel shumë të lartë ndotjeje.

Ndërtimi i rrugëve lidhëse me fshatrat e thellë malorë është një sfidë tjetër për të bërë një lëvrime efikas të ndihmës ekonomike si dhe të shërbimeve të tjera sociale. Përditësimi i databazës së grupeve sociale më në nevojë është një domosdoshmëri.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Ne total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Krujë për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është “17”, (Shih Listën më poshtë).

Raporti gjinor është 11 me 6 në favor të femrave.

Sa i takon shkollimit, 2 punonjës janë me arsim tetë-vjecar, 6 punonjës janë me arsim të mesëm dhe 9 me arsim të lartë. Në varësi të politikave që do të ndjekë MMSR, sugjerohet ngritja e nivelit arsimor të stafit të targetuar përmes kualifikimit të posaçëm ose përmes rekrutimit të burimeve njerëzore me arsimin të përshtatshëm. Jane vetem 5 nga 17 punonjës në këtë sektor që gëzojnë statusin e nëpunësit civil; pjesa tjetër janë me “kontratë

pune” konkretisht , me kontratë punë me afat (8 punonjës) dhe 4 punonjës janë me kontratë.

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë së re Krujë duhet të jenë 6 punonjës që ushtrojnë *njëkohësisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas percaktimeve të ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP konfirmoi nominalisht vetëm 5 prej tyre (*me ngyre portokalli*). Nuk konfirmohet emri (jo funksioni) i 1 punonjësi të NJMF në NJA Nikël (me ngjyrë blu). Rekomandohet përcaktimi eksplicit i të paktën një pozicioni për NJMF në strukturën organizative të bashkisë së re Krujë për vitin 2016.

Bashkia Kruje

Nr	Emri Mbiemri	Pozicioni i punes	Sektori	Data e fillimit	Lloji i kontrates se punes	Edukimi/ Kualifikimi	Ekperienca e punes ne njesi	Kategori te mbrojtura
1		Përgjegjës Sherb Social	Sektori Sherbimit Social	2011	Kontrate pa afat	juridik	4	
2		Inspektore	Sektori Sherbimit Social	2000	Kontrate pa afat	I Mesem	15	
3		Inspektore	Sektori Sherbimit Social	1996	Kontrate pa afat	I Mesem	19	
4		Inspektore	Sektori Sherbimit Social	2009	Kontrate pa afat	Finance	6	

Njesia administrative Fushe Kruje

5		Dr.Sherb.Social	Sh.Social	01.09.1997	NP. Civil	I larte, Ekonomik	17 vjet	
6		Insp.Nd.Eko	Sh.Social	16.1.2003	NP. Civil	I larte, pun sociale	12 vjet	
7		Insp.Nd.Eko	Sh.Social	26.9.2011	NP. Civil	I larte, Psikologji	3 vjet	
8		Infermjere	Sh.Social	1.4.2008	kontrate pa afat	I larte, Infermjeri	7 vjet	
9		RojeQ.Soc	Sh.Social	1.1.2007	Kontrate pa afat	I mesem	8 vjet	

Njesia administrative Nikël

10		P.Nd.Ekonomike	Nd.Ekonomike	01.03.2007	Nenpunes Civil	Diplome ne Drejtesi	8 vjet	
Njesia administrative Thuman								
11		Pergj Zyre	Ndihma Ekonomike	15.05.1993	Me kontrate	Universiteti Bujqesor Agronomi	22 vite	
12		Insp Nd.Ekonomike	Ndihma Ekonomike	01.03.2014	Me kontrate	Fakul. Ekonomik Agro-Biznes	1 vit	
13		Punonjes SH Social	Ndihma Ekonomike	2012	Me kontrate	Arsimi 8-vjecar	3 vite	
14		Punonjes Q Sociale	Ndihma Ekonomike	2008	Me kontrate	Arsimi 8-vjecar	7 vite	
Njesia administrative Cudhi								
15		Zyra e ndihmes ekonomike	Administrator	1995	Kontrate pa afat	Agronomi e mesme	19 vjet	
16		Zyra e ndihmes ekonomike	Administrator	2011	Kontrate pa afat	Mesme e pergjithshme	4 vjet	
Njesia administraive Bubq								
17		Administrator Shoqeror	Komuna Bubq	1994	Nenepunes Civil	Zooteknik I larte	21vjet	-

Bashkia Krujë, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrative Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Durrës	Qyteti Krujë	Krujë	Qyteti Krujë, Fshatrat; Barkanesh, Picërragë, Brret	59,814	79,608	339.02
		Fushë - Krujë	Qyteti Fushë Krujë, Fshatrat; Fushë Krujë, Arrameras 1, Luz 1, Hasan, Larushk 1, Halil, Zgërdhesh, Zallë, Luze 2, Larushke 2, Arrameras 2			
		Bubq	Fshatrat; Bubq, Bilaj, Budull, Mazhë – Madhe, Mazhë – Vogël, Mallkuç, Murqinë			
		Nikël	Fshatrat; Nikël, Tapizë, Qerekë, Rinas, Virjon, Buran, Mukaj, Kurcaj, Zezë			
		Thumanë	Fshatrat; Kodër-Thumanë, Borizanë, Derven, Gramëz, Thumanë, Bushnesh, Dukagjin i Ri, Sukth-Vendas, Miliska, Derven Kodër,			
		Cudhi	Fshatrat; Cudhi-Zall, Nojë, Mafsheq, Shqezë, Shkretë, Cudhi – Kant, Kroi Madh, Bruz-Zall, Bruz-Mal, Rranxë			

Bashkia e re Kuçovë

Të dhëna të përgjithshme

Zona Gjeografike: Kuçova kufizohet në veri dhe perëndim me bashkinë Belsh, në lindje me bashkinë Gramsh, në jug me bashkinë Berat dhe në perëndim me bashkinë Ura Vajgurore. Kryeqendra e bashkisë është qyteti i Kuçovës.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, kjo bashki numëron 31.262 banorë, ndërsa sipas Regjistrat Civil ajo numëron një popullsi prej 55.293 banorë. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 160.23 km².

Kjo bashki ak edhe 3 njësi administrative, të cilat janë: Kozar, Perondi dhe Lumas. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit Kuçovë, përveç komunës Lumas e cila është pjesë e rrethit Berat. Të gjitha njësitë administrative janë pjesë e po këtij qarku. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 31 fshatra.

Profili i bashkisë

Qyteti i Kuçovës bashkohet me tre komuna, duke kombinuar resurset e tij deri me tash të bazuara kryesisht tek nafta, me sektorin bujqësor të këtyre zonave rurale. Burimi kryesor i Kuçovës vazhdon të mbetet nafta dhe gazi, zbuluar hershëm në mënyrë primitive në këtë zonë, që në kohën e mbretërisë së Mbretit Zog. Pasuria natyrore e naftës dhe gazit në këtë zonë, vazhdon të konsiderohet ende e lartë, por jo e shfrytëzuar sa duhet si pasojë e mungesës së investimeve në këtë fushë.

Aktualisht zona naftë-nxjerrëse është nën administrimin e ALBETROL. Ndërmarrja e nxjerrjes së naftës vazhdon punën, ndërsa ajo e përpunimit të naftës jo, pasi nafta bruto përcillet drejt Patosit për t'u përpunuar. Ndërkohë, që resurse të saj janë qindra puse naftë në të gjithë territorin kryesisht në fshatrat Gegë, Havalehas, Frashër, por dhe në qytetin e Kuçovës. Megjithatë,

numri i lartë i puseve të naftës, aktive apo të braktisura, ka lënë pas probleme të rënda lidhur me ndotjen mjedisore.



Sfidat e pushtetit vendor pas ndarjes së re

Gjatë dekadave të fundit, qyteti ka pësuar rënie të ndjeshme popullore, në sajë të largimit të popullsisë për shkak të mundësive të pakta për punësim që ofron zona, duke sjellë për pasojë moshimin e ndjeshëm të popullsisë.

Ndër problematikat shqetësuese është përmirësimi i infrastrukturës rrugore në të gjithë territorin e bashkisë dhe sidomos me vëmendje të veçantë në të fshatrave të ish-komunës Lumas me qendrën e re administrative, mes të cilave deri më tani kanë munguar lidhjet organike. Perlllogaritja e sakte dhe levrimi në kohe i ndihmes ekonomike në fshatrat është një sfidë për bashkinë e re. Edhe përmirësimi i infrastrukturës shkollore dhe shëndetësore në zonat rurale është një problem që duhet adresuar.

Nga ana tjetër, për shkak të resurseve alternative të munguara dhe niveleve të papunësisë, bashkia e re kërkohet të hartojë strategji të qarta mbi shfrytëzimin e puseve ekzistuese, si dhe nxitjen e ngritjes së uzinave të përpunimit të naftës, çka do të sillte mundësi të reja punësimi për banorët.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Ne total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Kuçovë për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është “8”, (Shih Listën më poshtë). Raporti gjinor është 8 me 0 në favor të femrave. Sygjerohet përmirësimi i këtij raport në politikat e rekrutimit duke i kushtuar një vëmendje më të madhe çështjeve gjinorea i takon shkollimit, të gjithë janë me arsim të lartë (50% e të cilëve me profil social). 6 nga 8 punonjës në këtë sektor gëzojnë statusin e nëpunësit civil; pjesa tjetër (2) janë me “kontratë pune” me afat.

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë së re Kuçovë duhet të jenë 3 punonjës që ushtrojnë *njëkohësisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas percaktimeve të ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP konfirmoi nominalisht 3 prej tyre (*me ngjyre portokalli*). Në strukturën e bashkisë Kuçovë (qendër) për vitin 2015 ka një pozicion të parashikuar në mënyrë eksplicite me emërtimin “Specialist i Mbrojtjes së fëmijëve dhe Grave” Rekomandohet që personeli dhe struktura për NJMF të qëndrojnë kështu edhe për vitin 2016.

Bashkia Kuçove

Nr	Emri Mbiemri	Pozicioni i punes	Sektori	Data e fillimit	Lloji i kontrates se punes	Edukimi/ Kualifikimi	Ekperienca e punes ne njesi	Kategori te mbrojtura
DREJTORIA E NDIHMES EKONOMIKE								
1		Drejtores	Nd. Ekonomike	21.06.2005	Nëpunës Civil	Punë Sociale	09 vjet	
2		Administratore	Nd. Ekonomike	01.02.2003	Nëpunës Civil	Mësuesi	12 vjet	
3		Spec. Mbrojtjes femijeve Grave	Nd. Ekonomike	01.04.2005	Nëpunës Civil	Punë Sociale	10 vjet	
4		Administratore	Nd. Ekonomike	04.02.2014	Nëpunës Civil	Shkenca Administrative	01 vit	
5		Administratore	Nd. Ekonomike	16.08.2011	Nëpunës Civil	Mësuesi	03 vjet	
Njesia administrative Perondi								
6		Pergj sekt nd ekonomike	Nd ekonomike	2011	Kontrate me afat	Diplome Universiteti Punonjes social	4 vjet	
Njesia administrative Kozare								
7		Insp nd ekonomike	Nd ekonomike	2011	Nenpunes civil	Diplome Universiteti ne Mesuesi	4 vjet	
Njesia administrative Lumas								
8		Specialist nd ekonomike	Nd ekonomike	2013	Kontrate me afat	Diplome Universiteti Shkenca Sociale	2 vjet	

Bashkia Kuçovë, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrative Territorial

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrativ e përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Berat	Qyteti Kuçovë	Kuçovë	Qyteti Kuçovë	31,262	55,293	160.23
		Kozare	Fshatrat; Havalehas, Kozare, Feras Kozare, Salcë Kozare, Vlashuk, Demollarë, Fier Mimar, Zdravë, Gegë, Drizë, Frashër			
		Perondi	Fshatrat; Perondi, Magjatë, Tapi, Goraj, Velagosht, Rreth Tapi, Polovinë			
		Lumas	Fshatrat; Lumas, Luzaj, Pëllumbas, Katundas, Zelevizhdë, Belesovë, Mëndrak, Sheqës, Bardhaj, Pashtraj, Vodëz, Krekëz, Koritëz			

Bashkia e re Kukës

Të dhëna të përgjithshme

Zona Gjeografike: Kukësi kufizohet në veri me Bashkinë Krumë, në perëndim me bashkitë Mirditë dhe Fushë-Arrëz, në jug me Bashkinë Dibër dhe në lindje me Republikën e Kosovës dhe me atë të Maqedonisë. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Kukësit.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, popullsia është 47,985 banorë. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki ka 59,393 banorë. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 933.86 km² me një densitet prej 63.59 banorë/km² sipas Regjistrimit Civil dhe 51.38 banorë/km² sipas Censurit 2011.

Kjo bashki ka edhe 14 njësi administrative: Malzi, Bicaj, Ujmisht, Tërthore, Shtiqën, Zapod, Shishtavec, Topojan, Bushtricë, Grykë-Çajë, Kalis, Surroj, Arrën dhe Kolsh. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e Qarkut Kukës. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 87 fshatra.

Profili i bashkisë

Kukësi ishte një qendër industriale gjatë regjimit komunist në Shqipëri. Deri në vitet '90, Kukësi kishte industri të nxjerrjes dhe shkrirjes së bakrit (teknologji sovjetike e viteve '60), nxjerrjes dhe koncentrimit të mineralit të kromit, nxjerrjes së mineralit të kuarcit, prodhimit të materialeve të ndërtimit (materiale inerte, parafabrikate etj).

Ai njihet si një vend me traditë në rritjen dhe mbarështimin e bagetive. Kukësi ishte gjithashtu një qendër e njohur e transportit. Krahas llojeve të tjera të transportit, aty ishte i zhvilluar dhe transporti ujqor përmes liqenit artificial të Fierzës, i cili bënte të mundur lëvizjen e mallrave dhe të udhëtarëve si dhe zhvillimin e turizmit. Që prej vitit 2000, transporti përmes Liqenit të Fierzës ka pushuar së ekzistuari.

Menaxhimi i mbetjeve dhe pastrimi pritet të jetë sfidë kryesore. Zhvillimi i liqenit të Kukësit si resurs turistik apo për peshkim

kërkon gjithashtu krijimin e një sistemi të peshkëzimit vjetor. Po kaq problem janë edhe ujërat e zeza të qytetit të Kukësit, të cilat aktualisht derdhen drejtpërdrejt në liqenin e Fierzës.

Gjatë viteve të fundit janë shpenzuar rreth 3 milionë euro për ujësjellëse, por sërish qyteti vuan për ujë, pavarësisht se është i rrethuar nga burime të bollshme hidrike.



Sfidat e pushtetit vendor pas ndarjes së re

Pjesa më e madhe e 87 fshatrave të bashkisë së re nuk janë ende të lidhura me rrugë të asfaltuar, ndërsa rrugët e paasfaltuara janë të degraduara, duke krijuar distancë të konsiderueshme mes qytetit të Kukësit dhe fshatrave.

Një pjesë e konsiderueshme e banorëve të qytetit dhe të fshatrave punonin në zonën nxjerrëse dhe përpunuese të kromit në Kalimash si dhe në minierën e nxjerrjes së bakrit në Gjegjan. Transformimet ekonomike pas viteve '90 bënë që pjesa më e madhe e industrisë së lartpërmendur të falimentojë. Kjo krijoi një numër të madh të papunësh, konflikte pronesi dhe prapambetje. Menaxhimi i burimeve minerare të zonës në shërbim të komunitetit është një sfidë tjetër, pasi sistemi aktual i fragmentarizuar i lejeve të shfrytëzimit të burimeve natyrore ka sjellë dëme mjedisore, përveç keqpërdorimit të këtyre burimeve

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Në total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Kukës për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është “25”, (Shih Listën më poshtë).

Raporti gjinor është 6 me 19. në favor të meshkujve . Sugjerohet që në politikat e rekrutimit t'i kushtohet një vëmendje më të madhe çështjeve gjinore.

Sa i takon shkollimit, 14 punonjës janë me arsim të mesëm që përbëjnë 56% e punonjësve në këtë sektor, ndërsa 11 punonjës janë me arsim të lartë, ose 44 % të punonjësve.

Sugjerohet ngritja e nivelit arsimor të stafit të targetuar përmes kualifikimit të posaçëm ose përmes rekrutimit të burimeve njerëzore me arsimin të përshtatshëm.

Asnjë punonjës në këtë sektor nuk gëzojnë statusin e nëpunësit civil; Punonjësit janë me “kontratë pune” nga të cilët me afat (4 punonjës), pa afat (4 punonjës), vetëm me kontratë (15 punonjës) për 2 punonjës nuk ka të dhëna.

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë së re Kukës duhet të jenë 8 punonjës që ushtrojnë *njëkohësisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas përcaktimeve të ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP konfirmoi nominalisht të 8 punonjësit (*me ngyre portokalli*). Rekomandohet përcaktimi eksplicit i të paktën një pozicioni për NJMF në strukturën organizative të **bashkisë së re Kukës** për vitin 2016.

Bashkia Kukës

Nr	Emri Mbiemri	Pozicioni i punes	Sektori	Data e fillimit	Lloji i kontrates se punes	Niv.Arsimor	Eksp. e punes ne njesi.	Kategori te mbrojtura me ligj
1		Drejtor Nd Ek dhe SH. Soc	Nd. Ek dhe Sh. Soc	30.01.2015	Kontrate	Jurist	6 muaj	
2		Punonjese Sociale	Nd. Ek dhe Sh. Soc	29.01.2015	Kontrate	Shkenca sociale	6 muaj	
3		Punonjese Sociale	Nd. Ek dhe Sh. Soc	17.10.2011	Kontrate	Mesuesi	4 vjet	
4		Punonjes Social	Nd. Ek dhe Sh. Soc	01.08.2011	Kontrate	Mesem	4 vjet	
5		Punonjese Sociale	Nd. Ek dhe Sh. Soc	03.05.2010	Kontrate	Mesuesi	5 vjet	
6		Pergj. Nd. Ekon	Nd. Ek dhe Sh. Soc	22.01.2009	Kontrate	Mesem	6.5 vjet	
7		Adm. Nd Ekon	Nd. Ek dhe Sh. Soc	16.5.2007	Kontrate	Mesem	8 vjet	
8		Adm. Nd Ekon	Nd. Ek dhe Sh. Soc	01.06.2012	Kontrate	Shkenca sociale	3 vjet	
Njesia administrative Bicaj								
9		Admin/ndihmes ekonomike	Sherbim Social	12.03.2013	Me afat	Ekonomiste	2 vjet	
10		Admin/ndihmes ekonomike	Sherbim Social	11.09.2013	Me afat	Pune Sociale	2 vjet	
Njesia administrative Shtiqen								

11		P.Zyres Nd. Ekon	Nd.Ekonomike	Shkurt 2011	Kontrate me afat	I larte Juridik	4-vjet	
12		Adm Nd. Ekon	Nd.Ekonomike	Mars 2007	Kontrate	I MESEM	8-Vjet	
Njesia administrative Terthore								
13		Admi. Nd. Ekon.	Nd ekonomike	01.07.2011	Pa afat	I Mesem	4 vjet	-
Njesia Administrative Shishtavec								
14		ndihme ekonomike	Nd ekonomike	1994	kontrate pune	I larte	21	
Njesia administrative Zapod								
15		Adm. nd ekon dhe ceshtjeve sociale	Nd.ekonomike	1996	Kontrat me afat	Zooveteriner	19	
Njesia administrative Malzi								
16		Administrator Nd/Ek	Nd ekonomike	01.09.2012	Kontrat	I Mesem	4 vjet	
Njesia administrative Bushtrice								
17		Pergj. Nd. Ekon	Nd ekonomike	1994	1994	I Mesem	21 vjet	
Njesia administrative Ujmisht								
18		Ndihme ekonomike	Ndih.Ekonomike	2007	Kontrate	I Mesem	8 vjet	
Njesia administrative Grykecaje								
19		ndihme ekonomike	Ndih.Ekonomike	2007	Kontrate	I Mesem	8 vjet	
Njesia administrative Kolsh								
20		ndihme ekonomike	Ndih.Ekonomike	2014	Kontrate	I Mesem	1 vit	
Njesia administrative Surroj								
21		Shef I Zyres	Ndih.Ekonomike	16.01.2001	Pa afat	Larte	15 vite	
22		Administratot	Ndih.Ekonomike	01.02.1997	Pa afat	Mesem	19 vite	
Njesia administrative Topojan								
23		Administratot		01.02.1997	Pa afat	Mesem	19 vite	
Njesia administrative Arrën								
24		Adm.ndihme.ek	Ndihme.ekonomike	1.02.2004	Kontrate	mesem	11 vjet	
Njesia administrative Kalis								
25		Pergj.Ndihmes Ekonomike	Ndih.Ekonomike	02.11.2000		mesme ped.	15 vjet	

Bashkia Kukës, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrative Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative e përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrit Civil	Sipërfaqja KM ²
Kukës	Qyteti Kukës	Kukës	Qyteti Kukës; Fshatrat; Gostil, Drinas	47,985	59,393	933.86
		Malzi	Fshatrat; Shëmri, Shtanë, Petkaj, Mguille, Çam, Gdheshte, Pistë, Spas, Shikaj, Dukagjin, Kalimash,			
		Bicaj	Fshatrat; Bushat, Bicaj, Osmane, Mholaj, Mustafaj, Nangë, Kolesjan, Domaj, Gabricë, Tërshenë			
		Ujmisht	Fshatrat; Lusën, Zallë, Malqene, Resk, Ujmisht, Skavicë, Tejdrine			
		Tërthore	Fshatrat; Morinë, Bardhoc 1, Bardhoc 2, Breg-Lumë, Pobreg, Gjegjan			
		Shtiqën	Fshatrat; Shtiqën, Koder Lume, Krenze, Gjallicë			
		Zapod	Fshatrat; Orgjost, Kosharisht, Pakisht, Zapod, Orçikël, Bele, Lojmë			
		Shishtavec	Fshatrat; Shishtavec, Novosej, Kollovoz, Shtrezë, Borje, Oreshkë, Cërnalevë			
		Topojan	Fshatrat; Topojan, Xhaferaj, Turaj, Brekiye, Nimçë			
		Bushtricë	Fshatrat; Bushtricë, Gjegje, Matranxh, Palush, Vilë, Barruç, Shpat			
		Gryk-Çajë	Fshatrat; Fshat, Çajë, Buzëmadhe, Shkinak			
		Kalis	Fshatrat; Gështejë, Kodër-Gështejë, Kalis, Gurrë, Pralisht			
		Surroj	Fshatrat; Çinamak, Fusharë, Surroj, Aliaj			
		Arrën	Fshatrat; Arrën, Arrëz, Barrë, Vërrij, Tejmollë			
		Kolsh	Fshatrat; Kolsh, Mamëz, Myç-Mamëz			

Bashkia e re Kurbin

Të dhëna të përgjithshme

Zona Gjeografike: Bashkia e re e Kurbin shtrihet në Shqipërinë qendrore dhe kufizohet në veri me bashkitë Lezhë dhe Mirditë, në lindje me bashkinë Mat, në jug me bashkitë Krujë dhe Durrës dhe në perëndim me Detin Adriatik.

Popullsia: Sipas censurit të vitit 2011, në territorin e bashkisë së re Kurbin ka 46,291 banorë, ndërsa sipas regjistrimit civil ka 72,987 banorë. Me një sipërfaqe prej 269.03 kilometrash katrorë, densiteti i popullsisë sipas të dhënave të Censurit 2011 është 172 banorë km² ndërsa sipas Regjistrimit Civil, densiteti është 271 banorë km².

Bashkia e re është evendosur në Laç. Ajo ka edhe tre njësi administrative nën juridiksion, të cilat janë: Mamurrasi, Miloti dhe Fushë-Kuqja. Në këtë bashki ka tre qytete, Laçi, Miloti dhe Mamurrasi dhe 27 fshatra. Të gjitha janë njësi përbërëse e Qarkut Lezhë (listën e plotë me poshte).

Profili i Bashkisë

Bashkia e re Kurbin shtrihet në një zonë bujqësore dhe pjesërisht malore në Shqipërinë qendrore dhe ka një vijë bregdetare, që shtrihet në rezervatin natyror Patok-Fushë Kuqe.

Me rëndësi konsiderohet Laguna e Patokut, e cila është zhvilluar si zonë peshkimi dhe qendër e turizmit ditor. Pastrimi i zonës dhe zhvillimi i infrastrukturës në parkun e Lagunës së Patokut mund të shërbejë për zhvillimin e mëtejshëm të turizmit.

Mbrojtja e mjedisit konsiderohet një tjetër sfidë e rëndësishme për Bashkinë e re. Zhvillimi i turizmit në kushtet e mungesës së infrastrukturës, përfshirë kanalizimet e ujërave të zeza rrezikon të dëmtojë natyrën dhe të shkatërrojë bregdetin si resurs turistik.



ekonomike dhe sociale për zonën, e cila sot ka një shkallë të theksuar të kriminalitetit. Aktorët e shoqërisë civile në qytet kanë shqetësim të veçantë mungesën e vendeve të punës dhe praninë e lartë të lokaleve të bixhozit apo basteve sportive.

Sfidat e pushtetit vendor pas ndarjes së re

Qyteti i Laçit, i cili ka një të tretën e popullsisë së bashkisë së re, është një zonë ish-industriale dhe është krijuar si qytet përreth fabrikave të Superfosfatit dhe të pasurimit të bakrit, që të dyja të mbyllura shumë kohë më parë. Fasoni ka zëvendësuar këto fabrika si burimi kryesor i punësimit në qytet. Megjithatë, sot funksionon vetëm një fabrikë të prodhimit të këpucëve, ku janë të punësuar 100 gra. Papunësia është tepër e lartë. Popullsia është e përzjerë me prurje nga shumë anë të vendit gjatë kohës së komunizmit. Mbyllja e industrisë solli probleme të rënda sociale.

Një pjesë e familjeve rrojnë me ndihmë ekonomike. Skema e perftuesve megjithatë nuk është e perditesuar. Kriminaliteti juvencil është një problem dhe kërkon vëmendje të posaçme. Barazia gjinore mbetet ende një sfidë sa i takon implementimit të standarteve dhe monitorimit nga ana e strukturave vendore.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Në total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Kurbin për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është “13”, (Shih Listën më poshtë). Raporti gjinor është 13 me 0, në favor të femrave. Sa i takon shkollimit, vetëm 3 punonjës kanë arsim të mesëm, 10 punonjës të tjerë janë me arsim të lartë (4 nga të cilët me profil social). Janë vetëm 3 punonjës në këtë sektor që gëzojnë statusin e nëpunësit civil; pjesa tjetër janë me “kontratë pune”, nga të cilët 7 punonjës me “kontratë pa afat”, 1 punonjës me kontratë pune dhe 1 punonjës me kontratë pune tre mujore.

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë së re Kurbin duhet të jenë janë 2 punonjës që ushtrojnë *njëkohësisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas percaktimeve të ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP I konfirmoi gjithashtu nominalisht të dy punonjës të (me *ngyre portokalli*). Po ashtu, në strukturën e bashkisë Kurbin (qendër) për vitin 2015 ka dy pozicion të parashikuar në mënyrë eksplicite me emërtimin “Specialist i Mbrojtjes së Fëmijëve”.

Bashkia Kurbin

Nr	Emri Mbiemri	Pozicioni i punes	Spektori	Data e fillimit	Lloji i kontrates se punes	Edukimi/ Kualifikimi	Ekperienca e punes ne njesi	Kategori te mbrojtura
1		Pergjegjese e Zyres se SMSH	Nd. Ekon	07.09.2011	KP	I larte, Pune sociale	4 vjet	
2		Administrator	Nd. Ekon	01.04.2015	KP, Kontrate 3 mujore	I larte, Agrobiznes	6 muaj	
3		Administrator	Nd. Ekon	18.03.2002	SNC	I larte, Kimi	13 vjet	
4		Administrator	Nd. Ekon	28.02.2014	KP, Kontrate pa afat	I larte, Pune sociale	1.5 vjet	
5		Administrator	Nd. Ekon	07.04.2014	KP, Kontrate pa afat	I mesem	1 vit	
6		Specialiste BGj & MF	Nd. Ekon	21.04.2014	KP, Kontrate pa afat	I larte, Pune sociale	1 vit	
Njesia administrative Mamurras								
7		Pergj. Sekt.	Spektori i Mbrojtjes Shogerore	1993	Nenpunes Civil	I Larte Agronomi	21 vjet	
8		Administratore	Spektori i Mbrojtjes Shogerore	2006	Nenpunes Civil	I Larte Veterinari	9 vjet	
9		Administratore	Spektori i Mbrojtjes Shogerore	2014	Kontrate pa afat	Larte Agronomi	8 muaj	

10		Specialiste e barazise gjinore	Sektori i Mbrojtjes Shoqerore	2011	Kontrate pa afat	Mesem	4 vjet	
11		Specialiste per mbrojtjen e te drejtave te femijeve	Sektori i Mbrojtjes Shoqerore	2006	Kontrate pa afat	Mesem	9 vjet	
Njesia administrative Milot								
12		Pergj. Nd. Ekonomike	Nd. Ekonomike	2010	Kontrat pa afat	Shkenca Sociale	5 vjet	
Njesia administrative Fushe Kuqe								
13		Administratore	Nd. Ekonomike	2003	kontrate me afat	Mesuesi	12 vjet	

Bashkia Kurbin, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrative Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Lezhë	Qyteti Laç	Laç	Qyteti Laç, Fshatrat; Laç (Sanxhak)	46,291	72,987	269
		Mamurras	Qyteti Mamurras, Fshatrat; Fushë-Mamurras, Shpërthet, Shëmri, Zhejë, Katund i Ri, Gjorm, Drojë			
		Milot	Qyteti Milot, Fshatrat; Skuraj, Mal Milot, Fush Milot, Mal Bardhë, Mal Bardhe I siperm, Gallatë, Selitë, Gernac, Vinjoll, Shullaz, Prozhmë, Delbnisht, Ferr-Shkopet, Shkopet			
		Fushë-Kuqe	Fshatrat; Fushë - Kuqe, Adriatik, Patok, Gorre, Gurëz			

Bashkia e re Lezhë

Të dhëna të përgjithshme

Zona Gjeografike: Lezha kufizohet në veri me Bashkitë e Vaut të Dejës dhe Pukës, në perëndim me Detin Adriatik, në lindje me Bashkinë e Mirditës dhe në jug me Bashkinë Kurbin. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Lezhës.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, Lezha ka 65,633 banorë. Ndërkohë që sipas Regjistrat Civil, kjo bashki numëron 106,245 banorë. Me një sipërfaqe prej 509.1 km² bashkia e re e Lezhës ka një densitet prej 208.69 banorë/km² sipas të dhënave të Regjistrat Civil dhe 128.91 banorë/km² sipas Censurit 2011.

Kjo bashki ka në përbërje edhe 9 njësi administrative të tjera: Shëngjini, Zejmeni, Shënkoll, Balldreni, Kallmeti, Blinishti, Dajçi, Ungreji dhe Kolshi. Të gjitha këto njësi janë pjesë e qarkut Lezhë. Bashkia e re ka nën administrimin e saj dy qytete (Lezhë dhe Shëngjin) dhe 65 fshatra. (siko listen e plote me poshte)

Profili i Bashkisë

Bashkia e Lezhës shtrihet në pjesën dërrmuese të vet në një zonë të ulët dhe bregdetare, me lartësi 5 metra mbi nivelin e detit. E shtrirë në të dy anët e lumit Drin, e rrethuar nga lagunat Kunë e Vain si dhe nga plazhi i bukur i Shëngjinit, Lezha ofron bukuri natyrore të larmishme dhe mundësi të shumta për zhvillimin e turizmit.

Aktualisht, ekonomia në qytet është e diversifikuar, por mbështetet në tregti dhe shërbime, sektorë që punësojnë numrin më të madh të banorëve të Lezhës. Ndërtimi i Parkut të Biznesit në pjesën veriore të qytetit pritet të nxisë përqendrimin e bizneseve vendore dhe rajonale në këtë qytet.

Vitet e fundit, industria e përpunimit të peshkut në rajonin e Lezhës ka njohur investimet më të mëdha në rang vendi, sa i përket ngritjes së stabilimenteve të peshkut.



Një pjesë e territorit të Lezhës vazhdon të kërcënohet nga përmytjet, të cilat shkaktojnë herë pas here dëme të konsiderueshme.

Sfidat e pushtetit vendor pas ndarjes së re

Sida kryesore e Bashkisë së Lezhës është zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit i cili është një nga burimet kryesore të të ardhurave për banorët. Një pjesë e konsiderueshme familjesh marrin ndihmë ekonomike. Rakordimi i të dhënave dhe përfaqësimi me të mirë në kushtet e reja të krijuara nga amalgamimi i ish-komunave në një bashki të vetme të madhe është një sfidë.

Personeli i kualifikuar nuk mungon në strukturat e nejsive administrative si dhe në bashkinë e madhe, megjithatë, ndryshimet politike që pasuan në zgjedhjet e 21 qershorit i bëjnë ata të vulnerabël ndaj ndryshimit të stafëve (pas dy mandatesh të ish-kryetarit Viktor Tusha).

Zonat në lumin Drin shpesh herë vuajnë problemin e përmytjeve në stinën e ftohtë. Kjo shton problematiken sociale ekonomike për zonat e prekura dhe nën trynisi skemat e mbështetjes sociale. Qeveria qendrore shpesh herë ka marrë përsiper barrën financiare të demshperblimeve, por me kalimin e emergjencave civile në varesi të bashkisë, në kuadër të decentralizimit të funksioneve, kjo mund të kthehet në një barrë të madhe për bashkinë e re Lezhë.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Në total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Lezhë për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është “18”, (Shih Listën më poshtë).

Raporti gjinor është 10 femra dhe 8 meshkuj.

Sa i takon shkollimit, 15 punonjës janë me arsim të lartë (shumica universitar) dhe 3 punonjës janë me arsim të mesëm.

Janë vetëm 5 nga 15 punonjës në këtë sektor që gëzojnë statusin e nëpunësit civil; punonjët e tjerë janë me “kontratë pune” nga të cilë me afat (1 punonjës), me “kontratë pune” pa afat (8 punonjës), vetëm me kontratë 1 punonjës, 1 punonjës me kontratë 6 mujore, 1 punonjës i komanduar dhe 1 i emëruar.

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë së re Lezhë duhet të jenë 5 punonjës që ushtrojnë *njëkohësisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas percaktimeve të ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP konfirmoi nominalisht vetëm 4 prej tyre (*me ngyre portokalli*). Nuk konfirmohet emri (jo funksioni) i 1 punonjësi të NJMF në NJA Shëngjin (me blu). Në strukturën e bashkisë Lezhë (qendër) për vitin 2015 ka një pozicion të parashikuar në mënyrë eksplicite me emërtimin “Zyra e Mbrojtjes së fëmijëve ” (*markuar me jeshile*). Rekomandohet shtimi/parashikimi i një strukture të ngjashme edhe në ndonjë nga NJA.

Bashkia Lezhe

Nr	Emri Mbiemri	Pozicioni i punes	Sektori	Data e fillimit	Lloji i kontrates se punes	Edukimi/ Kualifikimi	Ekperienca e punes ne njesi	Kategori te mbrojtura
1		Drejtor	Per. Sociale	21.01.2014.	N. Civil	Larte	1 vit	
2		Pergjegjes	Per. Sociale	21.9.2007	N. Civil	larte	8 vjet	Leje lindje
3		Specialiste.	Per. Sociale	29.1.2001	N. Civil	larte	14 vjet	
4		Specialist	Per. Sociale	31.03. 2015	Komandim	Larte	-	
5		Specialist	Per. Sociale	01.04.2010	N. Civil	larte	5 vjet	Leje lindje
6		Specialist	Per. Sociale	08.10.2013.	N. Civil	Larte	2 vjet	
Njesia administrative Balldre								
7		Zyra Mbrojt Fëmijëve	Nd. Ekonomike	2011	Afat I pacaktuar	Shkenca Sociale	4 vjet	
8		Adm/Mbrojt Sociale	Nd. Ekonomike	2012	Afat I pacaktuar	Shkolla e Mesme	3 vjet	
Njesia administrative Blinisht								
9		ADMIN.ND.EKONOMIKE	Nd.	2010	KONTRATE PA AFAT	Agronom	5 VJET	

			Ekonomike					
Njesia administrative Dajç								
10		ADMIN.ND.EKONOMIKE	Nd. Ekonomike	2013	KONTRATE 6-MUJORE ME RINOVIM	FINANCIERE	2 VJET	
Njesia administrative Dajç								
11		Sp. sherbimeve Sociale	Nd. Ekonomike	11/1/2011	Kontrate	Jurist	4 vite	
Njesia administrative Kolsh								
12		Ad/ndihm	Sek/Ndih ekono	2013	Me afat	Shkolle e mesme	2 vjet	
Njesia administrative Shenkoll								
13		P.Z.Perkrah.sociale	P.Sociale	1.04.2012	Kontrate pa afat	Diplome Juridik	3 vite	
Njesia administrative Ungrej								
14		Admin/ social + fin	Sherb/ social	16.01.2001	I emruar	I larte mesues	15 vjet	
15		Admin/ social Nd/ ek	Sherb/ social	01.05.2009	Kont/ pa afat	I mesem bujq	6 vjet	
Njesia administrative Zejmen								
16		P.Z.Nd.Ekon.	Nd. Ekon	01.02.2009	pa afat	DNP P.Soc	6 vjet	
Njesia administrative Shengjin								
17		Pergj. Nd Ekonomike	Nd. Ekon	21.06.2011	Pa afat	Larte	8	
18		Sp/Ndihma Ekonomike	Nd. Ekon		Pa afat	Larte	2	

Bashkia Lezhë, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrative Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrativ e përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Lezhë	Qyteti Lezhë	Lezhë	Qyteti Lezhë	65,633	106,245	509
		Shëngjin	Qyteti Shëngjin, Fshatrat; Ishull-Shëngjin, Ishull- Lezhe, Mali- Shëngjin, Mali- Rencit, Kodër Mulliri			
		Zejmen	Fshatrat; Zejmen, Tresh, Pruell, Berzane, Pllanë, Markatomaj, Spiten			
		Shënkoll	Fshatrat; Shënkoll, Rilë, Tale 1, Tale 2, Barbullojë, Grykë-Lumi, Gajush, Alk			
		Balldren	Fshatrat; Balldren, Mali-Kakariq, Qëndër-Kakariq, Gocaj, Balldrën i Ri, Torovicë, Malecaj, Koljakaj			
		Kallmet	Fshatrat; Kallmet i Madh, Kallmet i Vogel, Rraboshtë, Mërq			
		Blinisht	Fshatrat; Blinisht, Troshan, Fishtë, Krajnë, Piraj, Baqel, Kodhel			
		Dajç	Fshatrat; Dajç, Gjadër, Gramsh, Mabë, Dragush, Kotërr, Zojs			
		Ungrej	Fshatrat; Ungrej, Kashnjet, Gjobardhaj, Kalivaç, Ras-Butë, Zinaj, Fregen, Kaluer, Sukaxhi			
		Kolsh	Fshatrat; Kolsh, Gjash, Kacinar, Patalej, Lalm, Lalm Lukaj, Velë, Manati, Grykë, Barbullojë e Re			

Bashkia e re Libohovë

Të dhëna të përgjithshme

Zona Gjeografike: Libohova kufizohet në veri me bashkinë Këlcyrë, në lindje me Bashkinë Përmet, në jug me bashkinë Dropull dhe në perëndim me bashkinë Gjirokastrë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Libohovës.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011 ka një popullsi prej 3.667 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki ka 7.158 banorë. Libohova shtrihet në një sipërfaqe prej 248.24 km² me një densitet prej 28.83 banorë/km².

Kjo bashki ka ne përbërje edhe 2 njësi të tjera administrative: Qendër Libohovë dhe Zagorie. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e qarkut Gjirokastrë. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 17 fshatra.

Profili i bashkisë

Bashkia Libohovë ka qenë që prej vitit 1914 nënprefekturë. Zona që përfshihet në bashkinë e re është e pasur me monumente arkeologjike, historike, monumente kulti dhe natyrore, me vlera unike në llojin e vet, dhe të njohura ndërkombëtarisht.

Të ardhurat nga bujqësia, nga blegtoaria, janë burim kryesor ekonomik për shumë abnorë të bashkisë së re.

Trashëgimia e pasur historike dhe kulturore krijon premisat e zhvillimit të agroturizmit në këtë zonë, por cilësia e keqe e rrugëve lidhëse duhet adresuar me projekte konkrete. Shumë objekte të trashëgimisë kulturore mbeten të paarrishme për turistët pasi nuk ka rrugë.

Restaurimi i Kalasë së Libohovës dhe disa monumenteve historike mbetet një tjetër sfidë për bashkinë e re, që së bashku me sarajet e bejlerëve të Libohovës mund të kthehen në atraksione turistike të periudhës osmane.

Bashkia e re e Libohovës ka nevojë për investime në infrastrukturë, ekonomi, turizëm, bujqësi e blegtori, pasi është një nga zonat më të rëndësishme për numrin e bagëtive të imta dhe sipërfaqes bujqësore. Libohova mban rekord në Shqipëri për shumëllojshmërinë e bimëve medicinale. Pozicioni gjeografik e bën Libohovën një qendër potenciale, duke u bashkuar me zonat e tjera përreth si komunën Qendër- Libohovë apo komunën Zagorie.



Sfidat e pushtetit vendor pas ndarjes së re

Gjatë 20 viteve të fundit, popullsia e Libohovës ka njohur nivel të ulët të rritjes demografike, edhe pse emigrimi apo migrimi ka shënuar ulje të ndjeshme.

Admisnitrata vendore është e paket në numer. Infrastruktura rrugore është shumë e keqe. Rikuperimi i saj duhet adresuar me projekte konkrete, të cilat do të mund të lehtësojnë sadopak edhe papunesinë e madhe në zonë dhe do të lehtësojnë pagesat e ndihmes ekonomike. Administrimi më i mirë i të ardhurave nga bujqësia, nga blegtoaria, fuqizimi dhe nxitja e bizneseve dhe promovimi i produkteve të zonës mbeten sfida për t'u përballuar nga bashkia e re e Libohovës.

Zhvillimi i arsimit mbetet një sfidë sidomos në zonat ku ka pak nxënës dhe kryhet mësim i kombinuar.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Në total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Libohovë për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është “4”, (Shih Listën më poshtë).

Raporti gjinor është 3 me 1 në favor të femrave. Sa i takon shkollimit, të gjithë janë me arsim të lartë (shumica universitar).

Vetëm 1 nga 4 punonjës në këtë sektor gëzon statusin e nëpunësit civil; 3 punonjësit e tjerë janë me kontratë pune “me pa afat”.

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë së re Libohovë asnjë punonjës nuk ushtron *njëkohësisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas percaktimeve të ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP konfirmoi të njëjtën situatë. Rekomandohet përcaktimi eksplicit i të paktën një pozicioni për NJMF në strukturën organizative të bashkisë së re Libohovë për vitin 2016 dhe rekrutimi i stafit me arsimin përkatës për ushtrimin e këtij funksioni në bashkinë e re Libohovë.

Bashkia Libohove

Nr	Emri Mbiemri	Pozicioni i punes	Sektori	Data e fillimit	Lloji i kontrates se punes	Edukimi/ Kualifikimi	Ekperienca e punes ne njesi	Nr
1		Ins ndihmes ekonomike	Zyra e ndihmes ekonomike	1996	Kontrate pa afat	Diplomuar per Zooteknik	19-vjet	
2		Specialiste e ndihmes ekonomike	Zyra e sherbimit social	2015	Kontrate me afat	Diplomuar per Kontabilitet Finance	3-muaj	
Njesia administrative Qender Libohove								
3		pergjegjese e z. finac dhe nd ekon	Finance dhe nd ekon	2011	nepunes civil	fakulteti ekonomik	4 vjet	
Njesia administrative Zagori								
4		zyra e ndihmes ekonomike	inspektor I ndihmes ekonomike	2014	kontrat pa afat	Ek Financ	1.5 vjet	

Bashkia Libohovë, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrative Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrativ e përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrit Civil	Sipërfaqja KM ²
Gjirokastrë	Qyteti Libohovë	Libohovë	Qyteti Libohovë	3,667	7,158	248.24
		Qëndër Libohovë	Fshatrat; Labovë e Sipërme, Labovë e Poshtme, Suhë, Stegopull, Bullo, Drino, Nepravishtë			
		Zagorie	Fshatrat; Sheper, Nivan, Konckë, Vithuq, Hoshtevë, Doshnicë, Zhej, Lliar, Topovë, Nderan			

Bashkia e re Librazhd

Të dhëna të përgjithshme

Zona Gjeografike: Librazhdi kufizohet në veri me bashkinë Bulqizë, në lindje me Republikën e Maqedonisë, në jug me bashkinë Përrenjas dhe në perëndim me bashkitë Elbasan dhe Tiranë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Librazhdit.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, Librazhdi ka një popullsi prej 31,892 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki numëron 44,181 banorë. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 793.36 km². Sipas regjistrimit civil, densiteti i popullsisë është 55.68 banorë/km² sipas ndërsa sipas censurit, densiteti është 40 banorë/km².

Bashkia Librazhd ka edhe 6 njësi administrative nën varesi: Qendër Librazhd, Hotolisht, Lunik, Stëblevë, Polis dhe Orenjë. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e qarkut të Elbasanit. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 52 fshatra (shih me poshte listen e plote)

Profili i bashkisë

Parku kombëtar Shebenik- Jabllanicë përbën një ndër pasuritë e rralla natyrore dhe me biodiversitet të larmishëm të bashkisë së Librazhdit. Përveç këtij parku, treva numëron edhe 26 monumente të tjera natyrore, të listuara si të kategorisë së parë.

Megjithëse ligjërisht janë të mbrojtura, pasuritë natyrore të Librazhdit kërcënohen vazhdimisht nga abuzimi dhe keqshfrytëzimi. Vetëm në parkun kombëtar Shebenik-Jabllanicë janë dhënë 45 licenca hidrocentralesh të vegjël, qëpërbëjnë një kërcënim për biodiversitetin e parkut.

Ekonomia e bashkisë së Librazhdit është e ndarë mes shërbimeve në qytet dhe bujqësisë e blegtorisë në zonat rurale. Shfrytëzimi i pyjeve ka qenë gjithashtu një aktivitet tradicional dhe



fitimprurës për disa biznese të zonës. Megjithatë, infrastruktura e dobët dhe mungesa e investimeve përgjatë dy dekadave të fundit i ka mbajtur zonat rurale brenda rrethit vicioz të varfërisë.

Sfidat e pushtetit vendor pas ndarjes së re

Bashkia e re Librazhd do të duhet të adresojë probleme të shumta që lidhen me infrastrukturën rrugore dhe gjendjen e amortizuar të shkollave në zonat rurale. Ai do të duhet gjithashtu të hartojë politikat e duhura për mbrojtjen e pasurive natyrore të zonës së Librazhdit, të cilat kërcënohen nga dhënia pa kriter e licencave për ndërtimin e hidrocentraleve të vegjël.

Përmirësimi i infrastrukturës rrugore do të ndihmonte banorët e zonave të thella malore të tregtonin produktet e tyre dhe të fuqizonin ekonominë familjare. Nga ana tjetër, shumë fshatra do të shpëtonin nga izolimi gjatë muajve të dimrit.

Gjetja e mundësive për strehim për familjet e varfra është një tjetër çështje që konsiderohet e rëndësishme për t'u zgjidhur. Një numër i madh familjesh rome jetojnë në baraka buzë lumit Shkumbin, ndaj sistemimi i tyre është një tjetër sfidë.

Rrjeti i amortizuar i shkollave dhe çerdheve kërkon ndërhyrje emergjente nga pushteti lokal, ndërkohë që në vëmendjen e drejtuesve të rinj duhet të jetë edhe zgjidhja përfundimtare e depozitimit të plehrave të qytetit të Librazhdit.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Në total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Librazhd për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është “12”. Raporti gjinor është 5 ferma dhe 7 meshkuj. Dhjete (10) punonjës janë me arsim të lartë (shumica universitar); 2 punonjës janë me arsim të mesëm Asnjë punonjës nuk ka statusin e nëpunësit civil; Të gjithë punonjësit janë me “kontratë

pune” nga të cilë 8 me kontratë pune pa afat dhe 2 me kontratë pune me afat. Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë së re Librazhd duhet të jenë 6 punonjës që ushtrojnë *njëkohësisht dhe/ose posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF. INFOÇIP konfirmoi vetëm 4 prej tyre (*me portokalli*). Nuk konfirmohet emri (jo funksioni) i 2 punonjësve në NJA Qendër dhe Polis (me blu). Në NJA Lunik ka një pozicion me emërtimin “Administratore në çështjet sociale dhe Mbrojtjes së Fëmijëve”.

Bashkia Librazhd

Nr	Emri Mbiemri	Pozicioni i punes	Sektori	Data e fillimit	Lloji i kontrates se punes	Edukimi/ Kualifikimi	Ekperienca e punes ne njesi
SEKTORI I NDIHMES EKONOMIKE SHERBIMEVE SOCIALE							
1		Pergjegjes I Sektorit te N. Ekonomike	Nd.Ekonomike	2014	Kontrate pa afat	Sociologji	1 vit
2		Administratore e Sektorit N.Ekonomike	Nd.Ekonomike	2014	Kontrate pa afat	Punonjese Sociale	7 muaj
Njesia administrative Qendër							
3		Administrator zyres nd.ekonomike	Sektori i nd.ekon	15.03.2012	Kontrate pa afat	Universiteti,mesuesi	3
4		Administrator zyres nd.ekonomike	Sektori i nd.ekon	16.09.2014	Kontrate pa afat	Universitet Ad-Biznes	1
Njesia administrative Stebleve							
5		Administrator I Ndhmes Ekonomike	Zyra e ndihmes ekonomike	2013	Kontrate me afat	Shkolle e mesme	2 vjet
Njesia administrtative Polis							
6		pergjegjes sherbimit social	Sektori i Nd. Ekonomike	03.01.2013	Kontrate pa afat	Diplome Master pune Sociale	2 vjet e 4 muaj
7		inspektore Nd. Ekonomike	Sektori i Nd. Ekonomike	01.03.2014	Kontrate pa afat	Diplome bachelor ekonomi	1 vit
Njesia administrative Lunik							
8		Administratore I Ndhmes ne ceshtjet sociale dhe Mbrojtjes se Femijeve	Ceshtjet Sociale	2011	Kontrate me afat	Arsimi I Mesem	4 vjet
Njesia administrative Orenjë							
9		Punojes i Nd. Ekonomike	Nd. Ekonomike	2001	Kontrate pa afat	Diplome universitet ne ekonomi	14 vjet
10		Punojes i Ndhmës Soc-Eko	Nd. Ekonomike	2012	Kontrate pa afat	Diplome universite per inxhinjeri	3 vjet
Njesia administrative Hotolisht							
11		P/ Z. Ndhmes Ekonomike	Nd. Ekonomike	2006	Kontrate me afat	instituti larte bujqesor Kamez	9 vite
12		Administratore Ndhmes Ekonomike	Nd. Ekonomike	01.03.2011	Kontrate me afat	Diplome Universiteti Ekonomik Elbasan	4 vite

Bashkia Librazh, qytetet dhe fshatrat sipas RAT

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Elbasan	Qyteti Librazhd	Librazhd	Qyteti Librazhd	31,892	44,181	793.36
		Qendër Librazhd	Fshatrat; Librazhd Qëndër, Arrëz, Babje, Dorëz, Dragostunjë, Kuturman, Gizavesh, Librazhd Katund, Marinaj, Qarrishtë, Spathar, Togëz, Merqizë, Semes			
		Hotolisht	Fshatrat; Hotolisht, Dardhë, Vulçan, Buzgarë, Kokrevë, Vehçan, Xhyrë, Çerçan			
		Lunik	Fshatrat; Lunik, Prevall, Dranovicë, Kostenjë, Letëm, Zgosht, Koshorisht			
		Stëblevë	Fshatrat; Stëblevë, Zabzun, Borovë, Llangë, Sebisht, Moglicë, Prodan			
		Polis	Fshatrat; Polis, Mirakë, Gostimë, Sheh, Gurëshpatë, Vilan			
		Orenjë	Fshatrat; Orenjë, Floq, Gurakuq, Ballgjin, Rinas, Zdrajsh Verri, Zdrajsh, Neshtë, Mëxixë, Funarës			

Bashkia e re Lushnjë

Të dhëna të përgjithshme:

Zona Gjeografike: Bashkia e re Lushnjë kufizohet në veri me bashkitë Rrogozhinë dhe Peqin, në lindje me bashkinë Divjakë, në jug me bashkitë Fier dhe Roskovec, ndërsa në perëndim me bashkinë Belsh. Kryeqendra e bashkisë së re është qyteti i Lushnjes.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011 bashkia e re Lushnjë numëron një popullsi banuese prej 83.659 vetë, ndërsa në Regjistrin Civil rezulton një popullsi prej 127.438 vetë. Sipërfaqja e bashkisë së re është 372.72 km². Në bazë të censurit, densiteti i popullsisë është 244.7 banorë për km² ndërsa në bazë të regjistrit civil densiteti është 341.91 banorë për km².

Kjo bashki ka edhe 10 njësi administrative të tjera, të cilat janë: Allkaj, Bubullimë, Hysgjokaj, Golem, Dushk, Karbunarë, Ballagat, Fier Shegan, Kolonjë dhe Krutje. Të gjitha njësitë administrative janë pjesë e qarkut Fier. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 85 fshatra.

Profili i bashkisë

Bashkia e re ka nën administrimin e saj një zonë përgjithësisht rurale, ku 63 për qind e popullsisë jeton në 85 fshatra që janë pjesë e saj. Lushnja është edhe zona bujqësore më e rëndësishme e Shqipërisë me prodhime të bimëve të arave, zarzavateve, bostanoreve dhe prodhimeve blegtorale në zonat e ulëta, si dhe me ullinj e vreshta në zonat kodrinore.

Toka e Lushnjës mbillen zakonisht dy herë në vit dhe në raste të veçanta edhe tre herë në vit. Tipar tjetër është afërsia e kësaj zone bujqësore me tregjet kryesore konsumatore të vendit si Tirana, Durrësi dhe Vlora. Gjatë dekadave të fundit, fermerët e zonës janë përqendruar në përdorimin e teknikave që realizojnë prodhim të hershëm të fushës, si dhe në prodhimin e zarzavateve në sera për të realizuar furnizimin e tregut në periudhat e dimrit.



Gjithashtu, mbjellja e drithërave është një tjetër burim ekonomik i të ardhurave të banorëve.

Tregtimi i prodhimeve bujqësore kryhet përgjithësisht në tregun pranë qytetit të Lushnjës nga ku nisen edhe një pjesë e madhe e eksporteve bujqësore të Shqipërisë për tregjet në brendësi të Ballkanit apo në Europën qendrore e lindore. Gjithashtu në zonat rurale ka banorë të cilët e ushtrojnë aktivitetin e tyre në mbareshtimi i bagëtive të imta si lopët dhe delet, si dhe në prodhimin e nënprodukteve të qumështit. Në këto zona operojnë disa kompani të përpunimit të qumështit, të cilat kanë krijuar një rrjet të grumbullimit të qumështit shtëpi më shtëpi duke krijuar kushtet për profilizimin e një pjese të fermerëve drejt mbarështimit të lopëve.

Sfidat

Sa i takon zonës urbane, njësitë e shërbimit, tregtimit dhe subjektet e ndryshme private janë të vetmet burime të ardhurash për banorët e kësaj zone, të ardhura këto që duket se nuk mjaftojnë për të mbajtur një qytet që në censusin e vitit 2011 numëronte 31 mijë banorë. Infrastruktura ndërlidhëse me fshatrat kryesore të zonës është përmirësuar ndjeshëm gjatë viteve të fundit, por mirëmbajtja e investimeve të kryera është një problem i vazhdueshëm.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Në total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Lushnje për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është “14”, (Shih Listën më poshtë). Raporti gjinor është 6 femra me 8 meshkuj, një raport mirë me një tendencë të lehtë në favor të meshkujve. Sa i takon shkollimit, 11 janë me arsim të lartë (shumica universitar), 3 punonjës janë me arsim të mesëm.

Janë vetëm 2 punonjës në këtë sektor që gëzojnë statusin e nëpunësit civil; pjesa tjetër janë me “kontratë pune” nga të cilët 1 punonjës është me kontratë pune me afat dhe 11 punonjës me kontratë pune pa afat.

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë së re Lushnje duhet të jenë 3 punonjës që ushtrojnë *njëkohësisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas përcaktimeve të ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP I konfirmoi edhe nominalisht 3 punonjës në fjalë të cilët vijojnë të jenë në mardhënie pune. (*me ngjyre portokalli*). Në bashkinë Lushnje (qendër) ka edhe një pozicion të përcaktuar shprehimisht për NJMF, me emërtimin “SNL për Mbrojtjen e Femijëve” (markuar me ngjyre jeshile në tabelë).

Bashkia Lushnje								
Nr	Emri Mbiemri	Pozicioni i punes	Sektori	Data e fillimit	Lloji i kontrates se punes	Edukimi/ Kualifikimi	Ekperienca e punes ne njesi	Nr
DREJTORIA E NDIHMES EKONOMIKE								
1		Drejtör	Nd Ekonomike	2000	Nenpunes Civil	Ekonomi Agrari	15 vjet	
2		SNL per Ndhmen Ek	Nd Ekonomike	1994	Nenpunes Civil	Financier I larte	21 vjet	
3		SNL per dhunen ne familje	Nd Ekonomike	2011	Kontrate pa afat	Pune Sociale	4 vjet	
4		SNL per Mbrojtjen e Femijeve	Nd Ekonomike	2014	Kontrate pa afat	Pune Sociale	1 vit	
	Njesia administrative Golem							
5		P/Zyres se Ndhmes Ekonomike	Sherbime Sociale	2011	Kontrate pa afat	Ekonomike	4 vjet e 3 muaj	
	Njesia administrative Dushk							
6		Insp. Nd Ekonomike	Nd Ekonomike	2011	Kontrate	Diplome	4 muaj	

					me afat	Uni.Ekonomik		
	Njesia administrative Ballagat							
7		P.Z Mbr. Shoq Arketar	Nd Ekonomike	2009	Kontrate pa afat	Shkolle e mesme	6 vjet	
	Njesia administrative Krutje							
8		Administrator I Perk.Sociale	Perkrahja Sociale	2014	Kontrate pa afat	Diplome Fak.Ekonomik	1 vit	
	Njesia administrative Allkaj							
9		P.Z.Mbr.Soc.	Mbr. Shoqerore	2011	Kontrate pa afat	Uni. Bujq Zooteknik	18 vjet	
	Njesia administrative Fiershegan							
10		Perk.Sociale	Nd Ekonomike	2012	Kontrate pa afat	DNP Letersi	3 vjet	
	Njesia administrative Bubullimë							
11		Pergj.Zy.Perk.Soc	Nd Ekonomike	2011	Kontrate pa afat	Dipl Kimi e Pergjith.	4 vjet	
	Njesia administrative Kolonjë							
12		Administratore+arketare	Nd Ekonomike	2007	Kontrate pa afat	Dipl.Univ. ne Ekonomik	8 vjet	
	Njesia administrative Hysgjokaj							
13		P/P. Sociale	Nd Ekonomike	2003	Kontrate pa afat	Shkolle e M.Ekonomike	12 vjet	
	Njesia administrative Karbunarë							
14		Administrator	Nd Ekonomike	2000	Kontrate pa afat	Shkolle e Mesme	15 vjet	

Bashkia Lushnje, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrative Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Fier	Qyteti Lushnje	Lushnjë	Qyteti Lushnje, Fshatrat; Karbunarë, Saver	83,659	127,438	372.72
		Allkaj	Fshatrat; Toshkës, Zhelizhan, Delisufaj, Biçakaj i vjetër, Allkaj, Lifaj i ri, Çukas i ri, Mazhaj			
		Bubullimë	Fshatrat; Bubullimë, Eskaj, Gjonas, Halilaj, Pirrë, Kamçishtë, Imsht			
		Hysgjokaj	Fshatrat; Hysgjokaj, Kurtin, Çanakaj, Kupaj, Lekaj			
		Golem	Fshatrat; Golem i Madh, Allprenaj, Shegas, Hajdaraj, Plug, Golemi i vogël			
		Dushk	Fshatrat; Gramsh, Dushk Peqin, Konjat, Zham Fshat, Dushk i Madh, Zham Sektor, Thanasaj			
		Karbunarë	Fshatrat; Karbunarë e Sipërme, Mollas, Kasharaj, Kashtëbardhë, Stankarbunarë, Zgjanë, Balaj, Skilaj, Murizë Peqin , Biçakaj			
		Ballagat	Fshatrat; Ballagat, Gjuzaj, Garunjas, Gjyshaj, Jazexhi, Manasufaj, Xibrakë			
		Fier Shegan	Fshatrat; Jeta e Re, Kosovë e Vogël, Fier Shegan, Koçaj, Barbullinjë, Çinar, Sejmenas, Thanë, Çukas i Vjetër, Murriz Kozare, Qerret i Vjetër, Qerret i ri, Biçakaj i Ri			
		Kolonjë	Fshatrat; Kolonjë, Gorre, Bishqethëm, Lumth, Rrapës Fshat, Shakuj, Ardenicë, Bitaj, Rrapës Sektor			
		Krutje	Fshatrat; Krutje e Sipërme, Krutje e Poshtme, Fier i Ri, Zhym, Rrupaj, Lifaj i Vjetër, Kadiaj, Ngurrës i Madh, Ngurrës i Vogël, Arrës, Gjaz			

Bashkia Malësi e Madhe

Të dhëna të përgjithshme

Zona Gjeografike: Malësia e Madhe kufizohet në veri me Malin e Zi dhe në jug me Bashkinë Shkodër. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Koplikut.

Sipas Censurit të vitit 2011, popullsia e Malësisë së Madhe është 30,823 banorë. Ndërkohë që sipas Regjistrit Civil kjo bashki ka 53,918 banorë. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 951.01 km² me një densitet prej 56.69 banorë/km² sipas Regjistrit Civil dhe 32.41 banorë/km² sipas Censurit 2011.

Kjo bashki ka edhe 5 njësi administrative të tjera, të cilat janë: Gruemira, Kastrati, Kelmendi, Qendra dhe Shkrel. Bashkia e re ka nën administrimin e saj dy qytete (Koplik dhe Bajzë) dhe 56 fshatra. Bashkia është pjesë e Qarkut Shkoder.

Profili i Bashkisë

Malësia e Madhe përmban bukuri të shumta natyrore, siç janë Liqeni i Shkodrës dhe pikat turistike malore të Vermoshit, Razmës dhe Bogës. Turizmi, blegtoaria dhe bujqësia janë burimet kryesore ekonomike për banorët e kësaj zone.

Prej vitesh ka pasur përpjekje për krijimin e një zone industriale përgjatë hekurudhës së vetme ndërkombëtare të Shqipërisë pranë qytetit të Bajzës, por projektet kanë mbetur në letër.

Zhvillimi i turizmit ka hasur në pengesa të shumta për shkak të mungesës së infrastrukturës. Një nga akset më të rëndësishme, ai Hani i Hotit- Tamarë- Vermosh- Plavë Guci, e njohur ndryshe si rruga e Alpeve do të përmirësonte jetesën e banorëve të këtyre zonave dhe do të ndikonte në zhvillimin e turizmit malor.

Bashkia e Malësisë së Madhe zgjerohet me 5 zona rurale, të cilat merren kryesisht me bujqësi, kultivimin e bimëve medicinale dhe blegtori. Një pjesë e vogël e banorëve merren me peshkim. Sigurimi i ujit të pijshëm shtet një problem serioz i cili nuk ka mundur të marrë zgjidhje.



Sfidat e pushtetit vendor pas ndarjes së re

Qyteti i Koplikut ka nivel të lartë papunësie. Pjesa më e madhe e të ardhurave në këtë zonë sigurohen nga emigracioni. Një pjesë e konsiderueshme kanë emigruar ndër vite drejt SHBA dhe Anglisë. Fenomeni ka prekur popullsinë e re në moshë.

Krijimi i një zone industrialo-tregtare në Koplik është një premtim i hershëm, por i parealizuar për Malësinë e Madhe me impakt negative direkt mbi punësimin dhe/ose levisjet migratore.

Skema e subvencionimit të fermerëve dhe krijimi i një qendre të posaçme për grumbullimin dhe shitjen e duhanit dhe bimëve medicinale do të sillte një reduktim të ndjeshëm të nevojave për ndihmë ekonomike të familjeve që merren me bujqësi, dhe që tani me ndarjen e re administrative hyjnë në juridiksionin e bashkisë së Malsisë së Madhe.

Përmirësimi i rrugëve ndërlidhëse me zonat rurale mbetet një detyrë e rëndësishme për administratën e re. Levrimi i ndihmës ekonomike në zonat e thella rurale do të kërkojë koordinim të posaçëm si për identifikimin e nevojave të reja ashtu edhe për lëvrimin e saj efikas në zonat e thella malore, sidomos gjatë dimrit. Problem mbetet gjendja e qendrave shëndetësore dhe arsimore, kryesisht në zonat e thella malore, ku pjesa më e madhe janë të amortizuara apo jo-funksionale.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Në total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Malësi e Madhe për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është “14”, (Shih Listën më poshtë).

Raporti gjinor është 8 femra me 6 meshkuj, një raport mirë me një tendence të lehtë në favor të femrave.

Sa i takon shkollimit, 4 punonjës janë me arsim të lartë (shumica universitar) dhe 10 punonjës janë me arsim të mesëm. 71% e punonjësve në këtë sektor janë pa arsimin përkatës .

Asnjë nga 14 punonjësit në këtë sektor nuk gëzon statusin e nëpunësit civil; 10 punonjës janë me “kontratë” nga të cilët 1

punonjës është me kontratë pune me afat, 7 punonjës me kontrarë pune pa afat, 2 janë me kontrata kolektive. Për 4 punonjës nuk mungon informacioni.

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë së re Malësi e Madhe duhet të jetë 1 punonjës që ushtron *njëkohësisht dhe/ose posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas percaktimeve të ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP nuk e konfirmoi nominalisht këtë punonjës. (me blu). Rekomandohet përcaktimi eksplicit i të paktën një pozicioni për NJMF në strukturën organizative të bashkisë së re Malësi e Madhe (qendrër) për vitin 2016.

Bashkia Malsi e Madhe

Nr	Emri Mbiemri	Pozicioni i punes	Sektori	Data e fillimit	Lloji i kontrates se punes	Edukimi/ Kualifikimi	Ekperienca e punes ne njesi	Nr
1		Pergj e Ndhmes Ekonomike	Ndihma ekonomike	2011	kontrate pa afat	I larte finance kontabilitet		4
2		Inspek Ndigmes Ekonomike	Ndihma ekonomike	2014	kontrate pa afat	Larte Pune Sociale		1
Njesia administrative Kelmend								
3		P/Nd.ekonomike	Drejtoria e nd. Ekonomike	2007	Kontrate pa afat	I mesem	8	
4		Insp.nd.ekonomike	Drejtoria e nd. Ekonomike	2014	Kontrate pa afat	I mesem	1	
5		Sp.z. mardh. Komuniteti	Zyra e ceshtjeve sociale	2011	Kontrate pa afat	I mesem	4	
6		Insp.sherbime sociale	Zyra e ceshtjeve sociale	2011	Kontrate pa afat	I mesem	4	
7		Insp.rini.sporte	Zyra e ceshtjeve sociale	2011	Kontrate pa afat	I mesem	4	

Njesia administrative Shkrel								
8		PEGJ.ND.EKON.	ZYRA ND.EK	01.07.1993	KON.KOLEK	I MESEM	12	-
9		PUN.ND. EKON	ZYRA ND.EK	01.01.1996	KON.KOLEK	I MESEM	9	-
Njesia administrative Kastrat								
10		Pergj Ndhmes Ekonomike	Ndihma ekonomike	1993		I larte	23	
11		Insp Nd Ekonomike	Ndihma ekonomike	1993		I larte	23	
Njesia administrative Qender								
12		zyra e nd.eko	Ndihma ekonomike	2007	kontrate me afat	I mesem I pergjithshem	8	
Njesia administrative Gruemire								
13		Pergj Ndhme ekonomike	Ndihma ekonomike					
14		Spec Ndihma Ekonomike	Ndihma ekonomike					

Bashkia Malsi e Madhe, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrative Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrit Civil	Sipërfaqja KM ²
Shkodër	Qyteti Koplik	Koplik	Qyteti Koplik	30,823	53,918	951.01
		Gruemirë	Fshatrat; Gruemirë, Boriç i vogël, Grudë-Fushë, Grilë, Kurtë, Linaj-egç-lepurosh, Omaraj, Rrash, Vorfë, Demiraj, Ktosh, Gjormë, Mshqerrë, Vajush, Boriç i Madh, Kerraj			
		Kastrat	Qyteti Bajzë, Fshatrat; Ivanaj, Aliaj, Gradec, Hot, Jeran, Pjetroshan, Rapshë, Vukpalaj, Premal, Goraj-Budishtë, Kastrat, Bratosh			
		Kelmend	Fshatrat; Tamarë, Brojë, Kozhnje, Selcë, Vukël, Lëpushë, Vermosh, Nikç			
		Qendër	Fshatrat; Bogiç-Palvar, Dobër, Jubicë, Kamicë-Flakë, Kalldrun, Koplik I sipërm, Stërbeq, Lohe e Poshtme			
		Shkrel	Fshatrat; Dedaj, Bogë, Bzhetë, Bzhetë-Markaj, Lohe e sipërme, Vrith, Vuç-Kurtaj, Zagorë, Qaf-Gradë, Reç, Rrepisht, Kokpapaj			

Bashkia e re Maliq

Të dhëna të përgjithshme

Zona Gjeografike: Maliqi kufizohet në veri me bashkinë Pogradec, në veri-lindje me bashkinë Pustec, në lindje me bashkinë Devoll, në jug me bashkinë Korçë dhe në lindje me bashkitë Skrapar dhe Gramsh. Kryeqendra e bashkisë është qyteti i Maliqit.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia e re numëron 41,757 banorë, ndërsa sipas Regjistrat Civil kjo bashki numëron një popullsi prej 64,664 persona. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 656.34 km². Densiteti i popullsisë sipas censurit është 64 banorë/ km² ndërsa sipas regjistrat civil është 99 banorë/ km².

Bashki e re Maliq ka ne përbërje edhe 6 njësi administrative të tjera: Maliq, Libonik, Gorë, Moglicë, Vreshtas, Pirg dhe Pojan. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e qarkut Korçë. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 80 fshatra.

Profili i bashkisë

Bashkia e Maliqit shtrihet në një nga zonat më pjellore bujqësore të Shqipërisë, më së shumti në një ish-kënetë të tharë me shumë mund dhe sakrifica njerëzore në vitet 1950. Qyteti i Maliqit u krijua si një qendër e rëndësishme e industrisë ushqimore në rang vendi me disa produkte të rëndësishme si sheqeri, melasa apo niseshteja si dhe e industrisë së përpunimit të drurit, por falimentimi i kësaj industrie solli papunësi të lartë në qytet dhe largimin e banorëve. Ndërtimi i rrugës së re kombëtare drejt Korçës anashkaloi qytetin ndërsa dy komuna përbërëse të bashkisë së re rezultojnë se kanë numër më të madh biznesesh për frymë se sa vetë Maliqi. Kjo zonë është vazhdimisht e rrezikuar nga përmytjet. Në zonat malore banorët i kanë dhënë prioritet blegtorisë dhe bletarisë ndërsa problematike mbetet prerja masive e pyjeve. Bashkisë do i duhet të fokusohet në hartimin e politikave orientuese për fermerët, por edhe tek përmirësimi i infrastrukturës për të shmangur përmytjet e tokave

të kultivuara. Rikthimi i kombinatit të sheqerit apo edhe fabrikave të tjera të përpunimit të produkteve bujqësore dhe drusore do i jepnin hov punësimit, çka do të reflektonte edhe me rritjen e nivelit mesatar të të ardhurave dhe jetesës.



Sfidat e përballet pushteti vendor pas ndarjes së re

Niveli ekonomik i familjeve është ulur edhe si pasojë e kthimit të emigrantëve prej krizës greke. Fshatrat e fushës së Korçës kanë pasur zhvendosje të popullsisë, ndërkohë që në zonat malore fenomeni i braktisjes është tejte i përhapur. Të rinjtë zgjedhin të studiojnë në kryeqytet dhe pas përfundimit të studimeve nuk kthehen më, çka ka sjellë për pasojë plakjen e fshatrave. Për pjesën më të madhe të zonës infrastruktura është ndërtuar ndërsa projekti më i rëndësishëm është ai i aksit nacional që lidh Gramshin me Maliqin; punimet ecin me ritme të ngadalta.

Largimi i një pjese të popullsisë në emigrim apo në migrim ka krijuar toka bujqësore të lira të cilat në raste të kufizuara aktualisht janë marrë me qira nga familje fermere për të krijuar biznese bujqësore në ekonomi shkallë.

Sfidat me të cilat do të përballet pushteti vendor pas ndarjes së re vijnë kryesisht për zgjidhjen e problematikës së punësimit dhe sigurimit të tregut për prodhimet bujqësore. Çështja e shkollave të bashkuara, klasave kolektive, ose largësia e tyre nga vendbanimet e shumë nxënësve u identifikua si një tjetër sfidë që kërkon zgjidhje nga pushteti i ri vendor.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Në total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Maliq për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është "9", (Shih Listën më poshtë). Raporti gjinor është 4 femra dhe 5 meshkuj. Sa i takon shkollimit, 5 punonjës janë me arsim të lartë (shumica universitar) dhe 4 punonjës me arsim të mesëm (ose 44% e punonjësve janë pa arsimin përkatës). Janë vetëm 2 nga 9 punonjës në këtë sektor që gëzojnë statusin e nëpunësit civil; pjesa tjetër janë me "kontratë pune" konkretisht 2 punonjës me kontratë pune me afat dhe 5 punonjës me kontratë pune pa afat.

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë së re Maliq duhet të jenë 5 punonjës që ushtrojnë *njëkohësisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas percaktimeve të ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP konfirmoi nominalisht vetëm 2 prej tyre (*me ngyre portokalli*). Nuk konfirmohet emri (jo funksioni) i 3 punonjësi të NJMF në NJA Pojan, Vreshtas dhe Gorë (me blu). Rekomandohet përcaktimi eksplicit i të paktën një pozicioni për NJMF në strukturën organizative të bashkisë së re Maliq për vitin 2016.

Bashkia Maliq

N r	Emri Mbiemri	Pozicioni i punes	Sektori	Data e fillimit	Lloji i kontrates se punes	Edukimi/ Kualifikimi	Ekperienc a e punes ne njesi	Kategori e mrojtur
1		Pergjegjes Zyre	Zyra e Ndhmes Ekonomike	01.05.2009	Nepunes Civil	Diplome Universiteti ne Finance Kontabilitet	6 vjet	
2		Punonjes Soc.i Mesem	Zyra e Ndhmes Ekonomike	19.03.2012	Pa afat	Dipl .Shkolle e Mesme	3 vjet	
Njesia administrative Pojan								
3		Sp admin I ndihmes ekonomike	N/Ekonomike	2002	Nepunes civil	Diplome universiteti ekonomik	12 vjet	
Njesia administrative Libonik								
4		Inspektore e ndihmes ekonomike	N/Ekonomike	1.08.2007	pa afat	Menaxhim .biznes	7vjet 7 muaj	
5		Inspektor I ndihmes ekonomike	N/Ekonomike	13.01.2011	pa afat	Gjuhe-Letersi	4 vjet 3muaj	
Njesia administrative Vreshtas								
6		ADMINISTRATOR I NDIHMES EKONOMIKE	Sektori i finances	02.04.2014	Kontrate me afat	Shkolle e mesme	1 vit	
Njesia administrative Gorë								
7		Administratore e N/Ekonomike	N/Ekonomike	10.12.1999	1 vjecare	Fakulteti C.Ulet UF.NOLI Korce	1 vit	
Njesia administrative Pîrg								
8		Inspektor Ndhmave Ekonomike	N/Ekonomike	2014	Kontrate pa afat	Shkolle e Mesme	1 vjet	
Njesia administrative Moglice								
9		Ins I ndihmes ekonomike	N/Ekonomike	2014	Kontrate pa afat	Shkolle e mesme	6-Muaj	

Bashkia Maliq, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrative Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrativ e përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Korçë	Qyteti Maliq	Maliq	Qyteti Maliq, Fshatrat; Kolanec, Goce, Gjyras, Bickë, Fshat Maliq, Plovisht	41,757	64,664	656.34
		Libonik	Fshatrat; Libonik, Drithas, Vloçisht, Vashtëmi, Pocestë, Symiz, Klocë, Shkozë, Kembëthekër, Beras, Zboq, Memël, Manastirec			
		Gorë	Fshatrat; Zvarisht, Dolan, Lozhan, Lozhan I ri, Senisht, Tresovë, Strelcë, Shalës, Selcë, Velçan, Mesmal, Moçan, Mjaltas, Marjan, Desmirë, Qëncë, Babjen, Dolanec			
		Moglicë	Fshatrat; Moglicë, Gopesh, Dobërçan, Maliq-Opar, Gurkuq, Bardhas, Zerec, Dushar, Torovec, Shpatmal Peshtan, Lumaj, Protopapë, Osojë, Gurshqipe, Kucakë, Nikollarë			
		Vreshtas	Fshatrat; Vreshtas, Sheqeras, Bregas, Podgorie			
		Pirg	Fshatrat; Pirg, Gurishtë, Zvirinë, Leminot, Qershizë, Kakaç, Shqitas, Veliternë, Sovjan, Novoselë, Bubuq			
		Pojan	Fshatrat; Pojan, Zvezdë, Shëngjergj, Kreshpanj, Plasë, Zëmbllak, Burimas, Pendavinj, Terovë, Rov, Orman, Rëmbec			

Bashkia e re Mallakastër

Të dhëna të përgjithshme

Zona Gjeografike: Bashkia e re kufizohet në veri dhe perëndim me bashkinë Fier, në jug me bashkitë Selenicë dhe Memaliaj, në lindje me bashkitë Poliçan dhe Berat, ndërsa në veri me bashkitë Patos dhe Fier. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Ballshit.

Popullsia: Sipas Censusit të vitit 2011, bashkia e re ka një popullsi prej 27.062 banorësh ndërsa në regjistrin civil rezultojnë 43.033 vetë si popullsi. Sipërfaqja e bashkisë së re është 329.19 km². Në bazë të censusit, densiteti i popullsisë është 82.45 banorë për km², ndërsa në bazë të regjistrin civil densiteti është 130.72 banorë për km².

Kjo bashki ka ne perberje edhe 8 njësi administrative, të cilat janë: Qendër Dukas, Greshicë, Aranitas, Hekal, Ngraçan, Kutë, Fratar dhe Selitë. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e qarkut Fier. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 41 fshatra.


Profili i bashkisë

Zona e Mallakastrës është kodrinore me lartësi mbizotëruese 200-300 metra mbi nivelin e detit ndërsa pika më e lartë e krahinës është maja e Shëndëllisë në nivelin 712 metra.

Mallakastra është një zonë e rëndësishme e industrisë nxjerrëse dhe përpunuese të naftës, si dhe një zonë bujqësore e blegtorale me përqendrim të drurët frutorë si ullinj, qershij, dardha e fiq.

Rafineria e Ballshit është aktiviteti kryesor ekonomik i zonës me disa qindra të punësuar ndërsa rafineria dhe fushat naftëmbajtëse janë edhe burimet kryesore të ndotjes për këtë bashki. Pas ndërtimit të superstradës së re Levan – Tepelenë disa vite më parë, Zona e Mallakastrës humbi funksionin e saj si zonë tranzitore në aksin nga Fieri drejt Gjirokastrës. Nevojitet

mirëmbajtja e infrastrukturës vaditëse të krijuar gjatë kohës së komunizmit përmes ndërtimit të disa dhjetërave rezervuarëve të vegjël, të cilat janë shumë të domosdoshme në kushtet kur zona është e varfër në burime ujore.



Sfidat e pushtetit vendor pas ndarjes së re

Bashkia e re e Mallakastrës do të jetë pothuajse tërësisht një zonë rurale pasi qyteti i vetëm, Ballshi, kishte në censusin e vitit 2011 vetëm 7600 banorë ose vetëm 28 për qind të popullsisë të të gjithë bashkisë së re. Për shkak të kushteve të vështira ekonomike gati gjysma e popullsisë së zonës ka migruar Shqipërinë qendrore ose ka ikur në emigrim..

Sfida kryesore e bashkisë së re pritet të jetë ofrimi i shërbimeve publike bazë në kushtet kur ekonomia e zonës është e varfër në burime dhe rrjedhimisht e varfër në të ardhurat fiskale. Investimet e domosdoshme për të ofruar shërbimet bazë janë të larta për shkak të terrenit të thyer kodrinor të zonës dhe largësisë së shumë fshatrave nga kryeqendra e bashkisë. Infrastruktura rrugore në këtë zonë është shumë e amortizuar Zyra e ndihmës ekonomike në Bashki duhet të riformatohet për t'ju përgjigjur sfidave të reja që prodhon zgjerimi juridiksional në zonë të thella rurale. Gjerimi i të ardhurave edhe për vetë bashkinë mbetet gjithashtu një sfidë.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Në total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Mallakastër për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është "11", (Shih Listën më poshtë).

Raporti gjinor është 3 femra dhe 8 meshkuj. Sa i takon shkollimit, 3 punonjës janë me arsim të lartë (shumica universitar), 1 punonjës vazhdon studimet e larta, ndësa 7 punonjës janë me arsim të mesëm (63.6% e punonjësve janë me arsim të mesëm). Në varësi të politikave që do të ndjekë MMSR, sugjerohet që bashkia Kukës të punojë më shumë për ngritjen e nivelit arsimor të stafit të targetuar përmes kualifikimit të posaçëm ose përmes rekrutimit të burimeve njerëzore me arsimin të përshtatshëm duke respektuar edhe çështjet gjinore (raportet gjinore)

Janë vetem 4 nga 11 punonjës në këtë sektor që gëzojnë statusin e nëpunësit civil; pjesa tjetër janë me "kontratë pune" më

konkretisht 1 punonjës me kontratë punë me afat dhe 6 punonjës me kontratë pune pa afat.

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë së re Mallakastër duhet të jenë 6 punonjës që ushtrojnë *njëkohësisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas percaktimeve të ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP konfirmoi nominalisht vetëm 4 prej tyre (*me ngjyre portokalli*). Nuk konfirmohet emri (jo funksioni) i 2 punonjësi të NJMF në NJA Greshicë dhe Fratar (*me blu*). Në bashkinë Mallakastër (qendër) ka edhe një pozicion të përcaktuar shprehimisht për NJMF, me emërtimin "Specialist i të drejtave të Fëmijëve", (markuar me ngjyre jeshile në tabelë).

Bashkia Mallakastër								
Nr	Emri Mbiemri	Pozicioni i punes	Sektori	Data e fillimit	Lloji i kontrates se punes	Edukimi/ Kualifikimi	Ekperienca e punes ne njesi	Nr
Zyra e Sherbimit Sociale								
1		Pergj Zyres se Sherbimit Social	Zyra e Sherbimit Sociale	18/05/1993	punonjes ne sherbimin civil	Diplome Veterinari	22 vjet	
2		inspektor I sherbimit social	Zyra e Sherbimit Sociale	23-08-2008	punonjes ne sherbimin civil	Diplome Filozof-Sociolog	7 vjet	
3		spec te drejtave te femijeve	Zyra e Sherbimit Sociale	19-11/2011	punonjes ne sherbimin civil	Jurist	4 vjet	
Njesia administrative Selitë								
4		Administrator ndihma ekonomike	Sektori i finances	2001	Kontrate pa afat	Arsim imesem	6 vjet	
Njesia administrative Aranitas								
5		Inspektor i Zyres se Ndhimes Ekonomike	Zyra e Ndhimes Ekonomike	2004	Kontrate me afat	Shkolla e Mesme	11 vjet	-

Njesia administrative Greshicë								
6		Pergjegjesi I Finances	Finance	01.05.2007	Kontrat pa afat	Finance ne vazhdim	8	
Njesia administrative Hekal								
7		Pergjegjes Zyre	Zyra e Ndhimes Ekonomike	2001	Kontrate pa afat	Shkolla e Mesme	14 vjet	-
Njesia administrative Kutë								
8		Administrtaor i Perkrahes sociale	Nd Ekonomike	2006	Kontrate pa afat	Shkolla e Mesme	9 vjet	-
Njesia administrative Ngraçan								
9		Administrator	Zyra e perkrahjes sociale	2007	Kontrat pa afat	Shkolle e mesme	7.5 vjet	
Njesia administrative Qender								
10		Pergj Nd Ekonomike	Nd Ekonomike	2010	Kontrat pa afat	Ilarte	5 vjet	
Njesia administrative Fratar								
11		Administrator I perkrahjes Sociale	Perkrahes Sociale	2011	Nenpunes Civil	Shkolle e mesme	4 vjet	

Bashkia Mallakastër, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrative Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Fier	Ballsh	Ballsh	Qyteti Ballsh	27,062	43,033	329.19
		Qëndër Dukas	Fshatrat; Visokë, Belishovë, Belistan, Drenovë, Drenovë Fushë, Kash, Usojë, Ngraçie, Lavdan, Lapulec, Lofkënd, Dukas			
		Greshicë	Fshatrat; Greshicë, Greshicë e Re			
		Aranitas	Fshatrat; Aranitas, Panahor, Kalenjë, Cfir, Metoh, Çyçen			
		Hekal	Fshatrat; Hekal, Klos, Mollaj, Rromës			
		Ngraçan	Fshatrat; Ngraçan, Riban			
		Kutë	Fshatrat; Kutë, Drizar, Anëbreg, Çorrush, Poçëm			
		Fratar	Fshatrat; Behaj, Damës, Gadurovë, Malas, Kremenar, Ninësh			
		Selitë	Fshatrat; Selitë, Gjerbës, Kapaj, Çërrilë			

Bashkia e re Mat

Të dhëna të përgjithshme

Zona Gjeografike: Mati kufizohet në veri me bashkinë e Mirditës, në perëndim me bashkinë e Kurbinit, në jug-perëndim me bashkinë Krujë, në jug me bashkinë Klos dhe në lindje me Bashkinë Dibër. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Burrelit.


Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011 numëron një popullsi prej 27,260 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil kjo bashki numëron 38,615 banorë. Bashkia e re ka në një sipërfaqe prej 493.5 km². Në bazë të të dhënave të censurit densiteti i popullsisë është 55.23 banorë/ km² ndërsa në bazë të të thënave të regjistrimit civil, densiteti është 78.24 banorë/km².

Kjo bashki përbëhet nga 8 njësi administrative, të cilat janë: Burrel, Baz, Derjan, Rukaj, Macukull, Koms, Lis dhe Ulëz. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e qarkut të Dibrës. Bashkia administron tani një qytet dhe 46 fshatra.

Profili i bashkisë

Bashkia e re shtrihet thuajse në të njëjtin territor me krahinën etnografike të Matit dhe ka terren kodrinor dhe malor. Ajo shtrihet në të dyja krahët e lumit Mat dhe pyjet zënë pjesën më të madhe të territorit të bashkisë së re. Shfrytëzimi i pyjeve për industrinë e drurit është aktualisht i kufizuar, paasi pyjet e vjetra janë dëmtuar rëndë nga prerjet pa kriter dhe një pjesë e madhe e sipërfaqes pyjore është aktualisht në fazë rigjenerimi.

Bashkia e re ka pjesë të saj parkun rajonal natyror Ulëz si dhe dy liqenet artificiale, Ulëza dhe Shkopeti, të ndërtuara për prodhimin e energjisë elektrike. Relievi dhe klima mesdhetare mjaft e favorshme, e cila karakterizohet nga vera e nxehtë dhe e thatë me shkëlqim të madh të diellit dhe nga dimri relativisht i butë në luginën e Matit krijon kushte mjaft të favorshme për zhvillimin e bujqësisë, frutikulturës dhe blegtorisë, përcakton si burime kryesore gjeneruese ekonomiko-financiare, bujqësinë dhe blegtorinë.



Sfidat e pushteti vendor pas ndarjes së re

Papunësia dhe/ose punësimi jashtë kushteve të përcaktuara ligjore është problem kryesor. Qyteti i Burrelit u ndërtua i lidhur me industrinë e pasurimit të kromit, e cila është aktualisht në proces për riaktivizim. Gjithsesi kjo industri nuk u verifikuar të kthehet në burim të rëndësishëm punësimi për qytetin, që aktualisht ka rreth 11 mijë banorë.

Bashkia e Matit pritet të ketë një bazë të ulët taksimi; për shkak të numrit të madh të fshatrave, terrenit të thyer malor dhe densitetit të ulët të popullsisë, mirëmbajtja e infrastrukturës pritet të ketë një kosto më të lartë se sa në zonat e ulëta.

Një shqetësim për banorët e zonës përbën fakti që sistemi i transportit publik nga fshatrat për te shkollat apo qendrat shëndetësore është i dobët, gjë që ka sjellë vështirësi në arsimim dhe në kujdesin shëndetësor të banorëve.

Sherbimet sociale dhe kujdesi për femijet (shpeshhere te sidomos ne fshatrat e kesaj bashkie kerkojne vemendje te posaçme). Për banorët e Burrelit ka rëndësi vënia në efikasitet dhe në qendrën rinore me synimin e rigjallërimit dhe aktiviteteve kulturore.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Në total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Mat për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është “12”, (Shih Listen).

Raporti gjinor është 9 ferma dhe 3 meshkuj.

Sa i takon shkollimit, 8 punonjës janë me arsim të lartë (shumica universitar), dhe 4 punonjës me arsim të mesëm. Në varësi të politikave që do të ndjekë MMSR, sugjerohet që bashkia Kukës të punojë më shumë për ngritjen e nivelit arsimor të stafit të targetuar përmes kualifikimit të posaçëm ose përmes rekrutimit të burimeve njerëzore me arsimin të përshtatshëm duke respektuar edhe çështjet gjinore (raportet gjinore)

Janë vetëm 4 nga 12 punonjës në këtë sektor që gëzojnë statusin e nëpunësit civil; pjesa tjetër janë me “kontratë pune” me afat (5 punonjës) dhe pa afat (3 punës).

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë së re Mat duhet të jenë 4 punonjës që ushtrojnë *njëkohësisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas percaktimeve të ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP konfirmoi nominalisht vetëm 2 prej tyre (*me ngyre portokalli*). Nuk konfirmohet emri (jo funksioni) i 2 punonjësi të NJMF në NJA Baz dhe Rukaj (*me blu*). Rekomandohet përcaktimi eksplicit i të paktën një pozicioni për NJMF në strukturën organizative të bashkisë së re Mat për vitin 2016.

Bashkia Burrel								
Nr	Emri Mbiemri	Pozicioni i punes	Sektori	Data e fillimit	Lloji i kontrates se punes	Edukimi/ Kualifikimi	Ekperienca e punes ne njesi	Nr
1		Përgjegjëse Shër. Soc.	Shërbimi Social	8/5/2011	Nëpunës Civil	Diplome Universiteti Punë Sociale	4vjet	
2		Specialiste Shër. Soc.	Shërbimi Social	8/30/2011	Nëpunës Civil	Diplome Universiteti Punë Sociale	4vjet	
3		Specialiste Shër. Soc.	Shërbimi Social	9/1/1993	Nëpunës Civil	Diploma Universiteti Ekonomik	22 vjet	
4		Specialiste Shër. Soc.	Shërbimi Social	8/30/2013	Nëpunës Civil	Diploma Universiteti Ekonomik	2 vjet	
5		Specialiste	Qendra e të Moshuarëve	3/13/2013	Kontratë me afat	Shkollë e mesme	2 vjet	
Njesia administrative Baz								

6		Përgjegjëse Ndihma Ekonomike	Sektori Ndihma Ekonomike	12/1/2003	Kontratë me afat	Shkollë e mesme	12 vjet	
Njesia administrative Derjan								
7		Përgjegjëse Ndihma Ekonomike	Sektori Ndihma Ekonomike	(Janar 2000	Kontratë me afat	Diploma Universitare Histori	15 vjet	
Njesia administrative Komsj								
8		Përgjegjëse Ndihma Ekonomike	Sektori Ndihma Ekonomike	4/1/1994	Kontratë pa afat	Diploma Universitare Ekonomik	21 vjet	
Njesia administrative Lis								
9		Përgjegjës Ndihma Ekonomike	Sektori Ndihma Ekonomike Zhvillim	1/1/2004	Kontratë pa afat	Shkollë e mesme	11 vjet	
Njesia administrative Macukull								
10		Përgjegjëse Ndihma Ekonomike	Sektori Ndihma Ekonomike	1/1/2008	Kontratë pa afat	Diploma Universitare Ekonomik	7 vjet	
Njesia administartive Rukaj								
11		Përgjegjëse Ndihma Ekonomike	Sektori Ndihma Ekonomike	8/1/2011	Kontratë me afat	Shkollë e mesme	4 vjet	
Njesia administrative Ulëz								
12		Përgjegjëse Ndihma Ekonomike	Sektori Ndihma Ekonomike	9/2/2013	Kontratë me afat	Diploma Universitare Juridik	2 vjet	

Bashkia Mat, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrative Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Dibër	Qyteti Burrel	Burrel	Qyteti Burrel	27,600	38,615	493.5
		Baz	Fshatrat; Baz, Fushë-Baz, Rreth Baz, Karicë, Drita			
		Derjan	Fshatrat; Derjan, Urxallë, Barbullej, Dukagjin, Gjoçaj, Lam i Madh, Zall Gjoçaj			
		Rukaj	Fshatrat; Bruç, Prellë, Remull, Rukaj, Laç, Urakë			
		Macukull	Fshatrat; Macukull, Dej Macukull, Shëlli, Vig, Shqefën			
		Komsi	Fshatrat; Komsi, Kodër Qerre, Frankth, Selixë, German, Batër e Vogël, Batër e Madhe, Midhë, Fshati Burrel, Zall-Shoshaj			
		Lis	Fshatrat; Lis, Vinjoll, Gjalish, Burgajet, Zenisht, Shoshaj, Mallunxë			
		Ulëz	Fshatrat; Qyteti Ulëz, Kokërdhok, Stojan, Madhesh, Lundre, Bushkash			

Bashkia e re Memaliaj

Të dhëna të përgjithshme

Zona Gjeografike: Memaliaj kufizohet në veri me bashkinë Mallakstër, në lindje me bashkinë Këlcyrë, në jug me bashkinë Tepelenë dhe në perëndim me bashkinë Himarë dhe Selenicë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Memaliajt.

Popullsia: Sipas Censusit të vitit 2011, bashkia ka një popullsi prej 10.657 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrat Civil, kjo bashki ka 21.476 banorë. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 372.07 km² me një densitet prej 78.90 banorë/km².

Bashkia e re Memaliaj ka edhe 5 njësi administrative ne perberje: Memaliaj Fshat, Luftinjë, Buz, Krahës dhe Qesarat. Të gjitha janë aktualisht pjesë e rrethit Tepelenë dhe e qarkut Gjirokastrë. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 53 fshatra.

Profili social-ekonomik

Qyteza e njohur prej vitesh për minierën e qymyrgurit e ka humbur me kohë këtë profil për shkak të mbylljes së saj. Shumë prej banorëve kanë migruar apo emigruar, ndërsa ata që jetojnë ende në Memaliaj merren me shërbime të vogla apo njësi tregtare lokale. Zona e re që krijohet me njësinë administrative shtrihet kryesisht buzë Lumit Vjosa.

Ajo do të ketë përparësi bujqësinë dhe blegtorinë si dhe zhvillimin e shërbimeve të vogla tregtare për popullsinë urbane. Burimet e tjera të të ardhurave, krahas bujqësisë dhe blegtorisë mund të vijnë dhe nga vreshtaria, mbledhja e bimëve medicinale, turizmi lumor, turizmi historik dhe ai kulturor.

Papunesia është e lartë dhe gjithashtu edhe emigracioni, sidomos në drejtim të greqisë. Edhe lëvizjet e brendshme migratore janë mjaft të aktivizuara.



Sfidat sociale të pushtetit vendor pas ndarjes së re

Sfidat e bashkisë së re do të lidhen me konsolidimin e burimeve njerëzore dhe zgjidhja e problematikave të mbartura prej vitesh. Administrata e mirë-kualifikuar konsiderohet kushti bazë për fillimin e një procesi administrimi për këtë zonë, e cila ka edhe disa fshatra të vegjël malorë që duhen mbështetur me shërbime.

Disa nga këto fshatra bllokohen gjatë dimrit, si pasojë e rrëshqitjes së rrugëve dhe kanë nevojë për investime. Përcaktimi i ndihmës ekonomike dhe skema për familjet e varfra që kanë pak ose aspak burime jetese do të jetë për bashkinë e re një përgjegjësi më e gjerë dhe më e madhe.

Gjendja e shkollave nuk është e mirë dhe shkollimi i fëmijëve, sidomos në dimër paraqet problem. Qendrat shëndetësore janë gjithashtu të amortizuara.

Bashkia duhet të zgjidhë problemin e bazës ekonomike në të cilën do të duhet të mbështete për taksim, pasi popullata është e vogël dhe po ashtu, burimet dhe aktiviteti ekonomik.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Ne total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Memaliaj për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është “6”, (Shih Listën më poshtë).

Raporti gjinor është i balancuar pasi 3 punonjëse janë femra dhe 3 punonjës janë meshkuj.

Sa i takon shkollimit, 3 punonjës janë me arsim të lartë (shumica universitar) ndërsa 3 punonjësit e tjerë janë me arsim të mesëm. Në varësi të politikave që do të ndjekë MMSR, sugjerohet që bashkia të punojë më shumë për ngritjen e nivelit arsimor të stafit të targetuar përmes kualifikimit të posaçëm ose përmes rekrutimit të burimeve njerëzore me arsimin të përshtatshëm

Asnjë nga 6 punonjësit në këtë sektor nuk gëzon statusin e nëpunësit civil; të gjithë punonjësit janë me “kontratë pune” nga të cilët 2 punonjës me kontratë pune me afat, 3 punonjës me kontratë pune pa afat dhe një punonjës është l emëruar.

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë së re Memaliaj nuk ka punonjës që të ushtrojë *njëkohësisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas percaktimeve të ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP konfirmoi të dhënën e mësipërme. Rekomandohet përcaktimi eksplcit i të paktën një pozicioni për NJMF në strukturën organizative të bashkisë së re Memaliaj për vitin 2016 dhe rekrutim stafi me arsim përkatës për të ushtruar funksionin në kuadër të NJDF.

Bashkia Memaliaj

Nr	Emri Mbiemri	Pozicioni i punes	Sektori	Data e fillimit	Lloji i kontrates se punes	Edukimi/ Kualifikimi	Ekperienca e punes ne njesi	Nr
1		sherb.social	nd ekonomike	2012	pa afat	diplom e univ. mesuesi	2 vjet	
Njesia administrative fshat Memaliaj								
2		Ndihma Sociale	Zyra e Ndhmës Soc-Eko	2011	kontrate me afat	Mesme ekonomike	4 Vjet	
Njesia administrative Buz								
3		adm I perkujdesjes shoqerore ekonomike	ndihma ekonomike	2009	pa afat	shkolla e mesme	6 vjet	
Njesia administrative Krahës								
4		ndihm ekonomike	zyra nd ekonomike	2011	me afat	dipl.univ ekonomik	4 vjet	
Njesia administrative Luftinjë								
5		punonjes ndihmave ekonomike	finance	2015	l emruar	shkoll e mesme	1 vit	
Njesia administrative Qesarat								
6		administrator	perkrahje sociale	2013	me afat	dpl univ arsim	3 vjet	

Bashkia Memaliaj, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrative Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Gjirokastrë	Qyteti Memaliaj	Memaliaj	Qyteti Memaliaj	10,657	21,467	272.07
		Memaliaj Fshat	Fshatrat; Memaliaj Fshat, Vasjar, Cerrilë, Mirinë, Damës, Kallëmb, Kashisht, Bylysh			
		Luftinjë	Fshatrat; Izvor, Luftinjë, Luftinjë e Sipërme, Rrapaj, Rabie, Gllavë e Vogël, Maricaj, Arrëz e Madhe, Vagalat, Tosk Martalloz, Dervishaj, Zhapokikë, Zhapokikë e Sipërme, Ballaj, Luadhaj			
		Buz	Fshatrat; Buz, Kalemaj, Badër, Kurtjez, Golemaj, Arrëz e Vogël, Shalës, Xhafaj, Gllavë, Selckë, Selckë e Vogël, Komar, Bardhaj			
		Krahës	Fshatrat; Krahës, Krahës i Sipërm, Zhulaj, Lulëzim, Levan, Allkomemaj, Kalivaç, Përparim, Leshnjë, Xhaxhaj			
		Qesarat	Fshatrat; Qesarat, Iliras, Amanikaj, Toç, Anëvjosë, Koshtan, Kamçisht			

Bashkia e re Mirditë

Të dhëna të përgjithshme

Zona Gjeografike: Mirdita kufizohet në veri me Bashkitë e Fushë Arrësit dhe Pukës, në perëndim me të Lezhës dhe në lindje me Bashkinë e Kukësit. Në jug-lindje me bashkinë Dibër, në jug me Bashkinë Mat ndërsa në jug-perëndim me bashkinë Kurbin. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Rrëshenit.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, Mirdita ka 22,103 banorë. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil kjo bashki numëron 37,384 banorë. Me një sipërfaqe prej 869.71 km², bashkia e re ka një densitet prej 42.98 banorë/km² sipas Regjistrimit Civil dhe 24.64 banorë/km² sipas Censurit 2011.

Bashkia Mirdite ka edhe 6 njësi administrative, të cilat janë: Rubiku, Selitë, Kthellë, Fan, Orosh dhe Kaçinar. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e qarkut të Kukësit. Bashkia e re ka nën administrimin e saj katër qytete (Rrëshen, Rubik, Kurbesh dhe Reps) dhe 81 fshatra (shih tabelën e detajuar)

Profili social-ekonomik

Mirdita mori rëndësi si rrugë kalimi për në Kosovë, pas ndërtimit të autostradës A1. Rruga e Kombit përfundoi së ndërtuari në vitin 2009, megjithatë nuk dha efektet e pritshme për banorët e Mirditës, me një impakt modest për zhvillimin social-ekonomik. Mirdita është një zonë kryesisht bujqësore dhe blegtorale, ndërkohë që vreshtaria paraqetet gjithashtu kompetitive.

Sipërfaqja e pyjeve në bashkinë e Mirditës është 10 herë më e madhe se fondi i tokës bujqësore. Për këtë arsye, problemet ekologjike të zonës, të tilla si përpunimi i drurit, ai i frutave të pyllit, prodhimi i lëngjeve vitaminore dhe zhvillimi i gjuetisë sportive janë të lidhura me pyjet. Një nga fushat më interesante është edhe shfrytëzimi i kapaciteteve hidro – energjetike të lumenjve të Fanit të madh dhe Fanit të vogël, Urakës, Zallit të



Dodajve, dhe përrenjve të tjerë malorë. Pasuritë nëntokësore të Mirditës kanë bërë që në territorin e kësaj krahine të krijohen katër qytete, të cilat janë të lidhura me industrinë minerare. Pjesa më e madhe e kësaj industrie është e mbyllur tashmë. Trajtimi i mbetjeve teknologjike minerare është një problem i mbartur prej kohësh në Mirditë, i kërkon zgjidhje të shpejtë. Ujërat e galerive, “lëngjet e verdha” kancerogjene dhe shirat acide janë kthyer në një problem shqetësues për shëndetin e popullatës.

Sfidat e pushtetit vendor pas ndarjes së re

Krahina e Mirditës shënoi një ndër nivelet më të larta të migrimit të brendshëm përgjatë 25 viteve të fundit. Sfida kryesore për bashkinë e re të Mirditës konsiderohet zbutja e varfërisë ekstreme, duke afuar shërbimet sociale sipas një skeme efikase edhe në fshatin më të largët. Punësimi real do të duhej të zhvendosej nga mbushja e zyrave me militantë partiakë tek krijimi i një mjedisi të favorshëm dhe konkurrues për sipërmarrjet vendase, punishtet e zejtarisë dhe zhvillimit të agroturizmit përmes fermave të vogla. Ndërhyrja e shpejtë në rrugët dytësore që lidhin Selitën me Lurën konsiderohet një projekt i domosdoshëm për zhvillimin social ekonomik të zonës. Me rëndësi mbetet rivitalizimi i rrugëve lidhëse me autostradën për qytetet e Rrëshenit, Rubikut, Repsit.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Në total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Mirditë për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është “13”, (Shih Listën më poshtë).

Raporti gjinor është thujtse I balancuar, 6 femra dhe 7 meshkuj.

Sa i takon shkollimit, 6 punonjës janë me arsim të lartë (shumica universitar) dhe 7 punonjës me arsim të mesëm. Në varësi të politikave që do të ndjekë MMSR, sugjerohet që bashkia Mirdite të punojë më shumë për ngritjen e nivelit arsimor të stafit të targetuar përmes kualifikimit të posaçëm ose përmes rekrutimit të burimeve njerëzore me arsimin të përshtatshëm

Vetëm 1 nga 13 punonjësit në këtë sektor gëzon statusin e nëpunësit civil; 10 punonjës janë me “kontratë pune” me afat (3

punonjës) dhe pa afat (7 punonjës), 2 punonjës janë thjesht të emëruar.

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë së re Mirditë duhet të jenë 4 punonjës që ushtrojnë *njëkohësisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas percaktimeve të ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP konfirmoi nominalisht vetëm 2 prej tyre (*me ngyre portokalli*). Nuk konfirmohet emri (jo funksioni) i 2 punonjësve të NJMF në bashkinë Mirdita dhe NJA Kthellë (me blu). Rekomandohet përcaktimi eksplicit i të paktën një pozicioni për NJMF në strukturën organizative të bashkisë së re Mirditë për vitin 2016.

Bashkia Mirdite

Nr	Emër Mbiemër	Pozicioni i punës	Sektori	Data e fillimit	Lloji i Kontratës së punës	Edukimi/ Kualifikimi	Eksperienca e punës në njësi	Kategori të mbrojtura me ligj
1		Pergjegjese sektori	S/.ndihm.sociale	2001	Nepu.civile III/ 1A	Dipl.univ.buj.dhe pune soc.	14 vite	
2		Administratore Sociale	S/Nd.sociale	2004	Kontrate pa afat	Dipl.univers.bujqesi	11 vite	
3		Administratore Sociale	S/Nd.sociale	2006	Kontrate pa afat	Ars.mes.profesin.	9 vite	
4		Administratore Sociale	S/Nd.sociale	2014	Kontrate pa afat	Arsim i mesem.profes.	1 vite	

Njesia administrative Rubik

5		Përgj. Sektori	Sekt.Nd. Ekonom.	2012	I emëruar	I larte	3 vite	
6		Inspek.Nd. Ekonom.	Sekt.Nd. Ekonom.	1994	E emëruar	I larte	21 vite	

Njesia administrative Fan

7		P.Nd.Ekon.	Nd. Ekonmike	4.4.2007	Pa afat	I mesem prof.	8 vjet	
8		Insp.Nd.Ekon	Nd. Ekonmike	01.05.2008	Pa afat	I mesem ekon.	7 vjet	
9		Insp.Nd.Ekon	Nd. Ekonmike	01.06.2008	pa afat	I mesem	7 vjet	

Nesia adminstrative Kaçinar

10		Pergj nd ekonomike	sektori nd ekono	2011	kontrate me afat	Shkolle e mesme	12 vjet	
----	--	--------------------	------------------	------	---------------------	-----------------	---------	--

Njesia administrative Orosh

11		Pergjegjes I Nd.Ekonomike	Nd.Ekonom.	1997	Kontrate pa afat	Diplome Universiteti ne Arsim	18 vjet	
----	--	------------------------------	------------	------	---------------------	----------------------------------	---------	--

Njesia administrative Selite

12		p.sherb.social	Nd. Ekonmike	1993	kontrate me afat	Shkolla e mesme	22 vjet	
----	--	----------------	--------------	------	---------------------	-----------------	---------	--

Njesia administrative Kthelle

13		Sp/Ndihmes Ekonomike	Ndihme Ek, PAK	2005	Kontrate me afat	Agro-Biznes	10 vjet	
----	--	----------------------	----------------	------	---------------------	-------------	---------	--

Bashkia Mirdite, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrative Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Lezhë	Qyteti Rrëshen	Rrëshen	Qyteti Rrëshen, Fshatrat; Ndërfushas, Ndërfan, Gëziq, Tarazh, Jezull, Kodër Rrëshen, Sheshaj, Fushë-Lumth, Malaj, Malaj Epërm, Tenë, Lurth, Bukmirë, Kulmë	22,103	37,384	870
		Rubik	Qyteti Rubik, Fshatrat; Fierzë, Bulshizë, Fang, Rasfik, Katund i Vjetër, Munaz, Rreja e Zezë, Rreja e Veles, Vau Shkezë, Rrethi i Sipërm, Livadhëz, Bulger			
		Selitë	Qyteti Kurbnesh, Fshatrat; Lufaj, Bardhaj, Lëkundë, Zajs, Kthellë e Sipërme, Kurbnesh-fshat, Mërkurth, Kumbull			
		Kthellë	Fshatrat; Perlat Qendër, Perlat i Sipërm, Shebe, Tharr, Trojë, Prosek, Rrushkull, Ujë, Shtrezë			
		Fan	Fshatrat; Klos, Shtrungaj, Bisakë, Fan, Zall-Xhuxhë, Katundi i Ri, Konaj, Shëngjin, Petoq, Xhuxhë, Dardhëz, Thirrë, Sang, Hebe, Domgjon, Gjakëz, Munellë			
		Orosh	Qyteti Reps, Fshatrat; Kullaxhi, Blinisht, Pshqesh, Mashtëkor, Shëmri, Grykë Orosh, Lgjin, Bulshar, Planet, Ndërshen, Nënshajt, Kodër-Spaç, Gurth-Spaç, Lajthizë			
		Kaçinar	Fshatrat; Kaçinar, Arrëz, Kuzhnen, Simon, Shëngjergj, Shtuf, Shpërdhezë			

Bashkia e re Patos

Të dhëna të përgjithshme

Zona Gjeografike: Bashkia e re e Patosit kufizohet në veri dhe perëndim me bashkinë Fier, në jug me bashkinë Mallakastër dhe në lindje me bashkinë Roskovec. Kryeqendra: qyteti i Patosi.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011 bashkia e re Patos ka një prej 22.959 banorësh ndërsa në regjistrin civil rezultojnë banues 42.738 banorë. Territori i bashkisë së re është vetëm 82.5 km². Në bazë të të dhënave të regjistrin civil densiteti i popullsisë është 518 banorë për km² ndërsa në bazë të censurit densiteti i popullsisë është 278.3 banorë për km².

Bashkia Patos ka edhe dy njësi të tjera administrative: Zharëz dhe Ruzhdie. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e qarkut Fier. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 18 fshatra.

Profili social-ekonomik

Qyteza e Patosit nisi të ndërtohej rreth vitit 1949 për të strehuar punëtorët dhe inxhinierët e naftës. Baseni naftëmbajtës i njohur si "Patos-Marinza" është historikisht zona më e pasur me naftë në Shqipëri dhe sot vijon të prodhojë shumicën dërrmuese të naftës bruto në vendin tonë. Për shumë vite burimi kryesor ekonomik ka qenë sektori naftënxjerrës, por pasi kanë nisur operimin në tregun e naftës kompanitë e huaja niveli i të punësuarve në këtë sektor ka ndryshuar, duke sjellë një përqendrim gjithnjë e më të madh tek sektori i bujqësisë dhe agrikulturë. Sipas të dhënave tashmë, përveç ish komunës Zharëz, zonat e tjera si Patosi dhe Ruzhdia kanë si burim kryesor ekonomik kultivimin e ullirit dhe tregtimin e nënprodukteve të tij, të cilat favorizohen dhe nga vetë relievi kodrinor i kësaj zone. Më tej është sektori privat i shërbimeve ai që siguron të ardhurat për zonën urbane dhe vitet e fundit kanë nisur aktivitetin në këtë njësi vendore edhe bizneset fasone.



Sfidat e pushteti vendor pas ndarjes së re

Vitet e fundit, infrastruktura rrugore e zonës urbane dhe fshatrave përreth është përmirësuar ndjeshëm.

Një ndër sfidat kryesore është shëndeti i popullatës i cili prej vites është i ekspozuar ndaj ndotjes masive të zonave naftënxjerrëse. Probleme serioze të shëndetit janë vetë re tek fëmijët. Media ka raportuar dhjetëra raste të tilla sidomos vitin e fundit. Pastrimi dhe rehabilitimi i shumë nga zonave të braktisura naftënxjerrëse, si dhe marrja e masave për parandalimin e ndotjeve nga pusët ekzistuese perben një sfidë akute.

Një ndër sfidat e tjera të identifikuar nga komuniteti i kësaj zone lidhet me ngritjen dhe përmirësimin e infrastrukturës së godinave arsimore të zonës, kopshte dhe shkolla, të cilat do të ndihmonin në përmirësimin e cilësisë së arsimit në zonë. Një aspekt tjetër që duhet të jetë në vëmendjen e pushtetit të ri lokal është dhe rritja e numrit të familjeve të pastreha gjatë viteve të fundit, në mbështetje të të cilave duhen parashikuar dhe ndërtuar banesa sociale. Gjithashtu, një sfidë tjetër me të cilën do të përballët bashkia e re është lëvrimi nga pushteti qendror dhe mirëadministrimi i rentës minerare të naftës në këtë zonë, nga të cilat bashkia mund të sigurojë të ardhura prej miliona eurosh.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Në total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Patos për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është “5”, (Shih Listën më poshtë). Nuk ka të dhëna për raportin gjinor. Sa i takon shkollimit, të 2 punonjësit e NJA Zharres dhe Ruzhdië janë me arsim të mesëm. S’ kanë të dhëna për 3 punonjësit e tjerë. Të dy punonjësit në fjalë janë në marrëdhënie pune njëri respektivisht me kontratë “pa afat” dhe tjetri me afat (1 vit). Mungojnë të dhënat relevante për 3 punonjësit e tjerë.

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë së re Patos ka një punonjësit që ushtron *njëkohësisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas përcaktimeve të ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP e konfirmoi edhe këtë të dhënë (*me ngjyë portokalli*). Rekomandohet përcaktimi eksplicit i të paktën një pozicioni për NJMF në strukturën organizative të bashkisë së re Patos për vitin 2016.

Bashkia Patos

Nr	Emër Mbiemër	Pozicioni i punës	Spektori	Data e fillimit	Lloji i Kontratës së punës	Edukimi/ Kualifikimi	Eksperienca e punës në njësi	Kategori të mbrojtura me ligj
1		Specialiste për përkrahjen sociale	Spektori Kont/llog/pag e përk Social					
2		Specialiste për përkrahjen sociale	Spektori Kont/llog/pag e përk Social					
3		Specialiste e Shërbimit të barazisë dhe kundër dhunës	Spektori Kont/llog/pag e përk Social					
Njesia administrative Zharres								
4	Gramos Cepele	Administrator i ndihmës ekonomike +Arketar	Nd Ekonomike	1/2/2002	kontrate 1-vjecare	Diplome te shkolles se mesme	13 vjet 2 muaj	
Njesia administrative Ruzhdië								
5		Administrator	Zyra e ndihmës Ekonomike	2012	Kontrat pa afat	Shkolla e Mesme	3-vjet	

Bashkia Patos, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrative Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Fier	Qyteti Patos	Patos	Qyteti Patos, Fshatrat; Kuqar, Dukas, Rërës, Margëlliç, Rusinjë, Griz, Banaj	22,959	42,738	82.55
		Zharëz	Fshatrat; Zharëz, Fshat i Ri, Frashër, Verbas, Sheqishtë, Belinë			
		Ruzhdie	Fshatrat; Ruzhdie, Siqecë, Gjynaqarë, Drenie, Kasnicë			

Bashkia e re Peqin

Të dhëna të përgjithshme

Zona Gjeografike: Peqini kufizohet në veri me bashkinë Tiranë, në lindje me bashkinë Elbasan, në jug-lindje me bashkinë Cërrik, në jug-perëndim me bashkinë Lushnje dhe në jug me bashkinë Belsh. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Peqinit.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, Peqini ka një popullsi prej 26.136 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki numëron 38.900 banorë. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 197.79 km² me një densitet prej 196.67 banorë/km² sipas regjistrimit civil dhe 132 banorë/km² sipas censurit.

Kjo bashki ka edhe 5 njësi administrative: Pajovë, Karinë, Përparim, Gjocaj dhe Shezë. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e qarkut të Elbasanit. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 50 fshatra.

Profili social-ekonomik

Bashkia e re e Peqinit shtrihet përgjatë rrugës së vjetër Egnatia, ndërsa kalaja Klaudiana në qendër të qytetit është dëshmi e lashtësisë së këtij vendbanimi. Qyteti dhe të 50 fshatrat e kësaj bashkie shtrihen në një zonë fushore dhe kodrinore.

Banorët e bashkisë së Peqinit janë të orientuar ndaj bujqësisë dhe vreshtarisë, por edhe mbarështimit të shpendëve. Kultivimi i ullinjve, i perimeve të serave dhe i produkteve të tjera bujqësore janë gjithashtu karakteristike të zonës. Strategjitë mbështetëse për biznesin prodhues, investimet në zonat rurale dhe mbështetja e fermerëve konsiderohen sfidat kryesore për kryebashkiakun e ri të Peqinit. Domosdoshmëri për zhvillimin harmonik të bashkisë mbetet gjithashtu ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve për zonën urbane dhe ai i kanaleve vaditëse për zonën rurale të Peqinit.



Sfidat e pushtetit vendor pas ndarjes së re

Problemi më i madh Bashkine e re Peqin është punësimi. Edhe pse një pjesë e mirë e banorëve merren me bujqësi, mundësitë ekonomike për ta janë të pakta. Sfidat e bashkisë së re janë të harmonizojë zonën urbane me zonën rurale si dhe hapja e bizneseve prodhuese, që mund t'i jepnin hov punësimit.

Perkrahja social ekonomike pritet të jetë nën presin të vazhdueshëm për shkak të situatave të paqarte ende sa l takon zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe situatës në zonat rurale e cila pritet të qartësohet më tej në këtë drejtim. Krijimi i një modeli të qartë ekonomik përmes mbështetjes dhe subvencioneve konsiderohet një sfidë për bashkinë e re. Në këtë drejtim, Peqini ka dhënë tashmë shembuj të mirë në përpunimin e vajit të ullirit apo të mbarështimit të shpendëve, të cilat kërkojnë politika mbështetëse nga ana e administratës së re, por formalizimi dhe futja në skemë taksimi i këtyre aktiviteteve mund të verifikohet i vështirë.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Në total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Peqin për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është “7”, (Shih Listën më poshtë). Raporti gjinor është 2 femra dhe 5 meshkuj. Sa i takon shkollimit, 3 punonjës janë me arsim të lartë (shumica universitar) dhe 4 punonjës janë me arsim të mesëm. Në varësi të politikave që do të ndjekë MMSR, sugjerohet që bashkia Peqin të punojë më shumë për ngritjen e nivelit arsimor të stafit të targetuar përmes kualifikimit të posaçëm ose përmes rekrutimit të burimeve njerëzore me arsimin të përshtatshëm. Vetëm 2 nga 7 punonjësit në këtë sektor gëzojnë statusin e nëpunësit civil; 5 punonjësit e tjerë janë me “kontratë pune” me

afat (3 punonjës) dhe pa afat (2 punonjës).

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë së re Peqin duhet të jenë 6 punonjës që ushtrojnë *njëkohësisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas percaktimeve të ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP konfirmoi nominalisht vetëm 5 prej tyre (*me ngyre portokalli*). Nuk konfirmohet emri (jo funksioni) i 1 punonjësi të NJMF në NJA Gjocaj (me blu). Rekomandohet përcaktimi eksplicit i të paktën një pozicioni për NJMF në strukturën organizative të bashkisë së re Peqin për vitin 2016.

Bashkia Peqin								
Nr	Emër Mbiemër	Pozicioni i punës	Sektori	Data e fillimit	Lloji i Kontratës së punës	Edukimi/ Kualifikimi	Eksperienca e punës në njësi	Kategori e mbrojtur
1		Pergje.sektori Ndhmes ekonomike	Sektori i ndihmes ekonomike	2007	Nenpunes Civil	Diplome Universiteti ne Pune Sociale	8 vjet	
2		Administrator I ndihmes ekonomike	Sektori i ndihmes ekonomike	2014	Nenpunes Civil	Diplome Universiteti ne Ekonomik	1 vit	
Njedsia administrative Perparim								
3		Punonjes Nd Ekonomike	Nd. Ekonomike	2004	Kontrat me afat	Shkolla e Mesme	11 vjet	
Njedsia administrative Shezë								
4		Punonj. Nd.Ekonomike	Nd.Ekonomike	2012	Kontrat pa afat	Diplome Universiteti ne Pune Sociale	3 vjet	
Komuna Karinë								
5		Punonjes I Ndhmes Ekonomike	Nd. Ekonomike	. 1996	Kontrat me afat	Shkolla e Mesme	19 vjet	
Njesia administrative Gjocaj								
6		Admin Nd Ekonomike	Ndihma Ekonomike	2007	Kontrate pa afat	Shkolle e mesme	18 vjet	
Njesia administrative Pajovë								
7		Punonj. Nd. Ekonomike	Nd.Ekonomike	6-Jan-07	Kontrate me afat	Shkolle e mesme	8 vjet	

Bashkia Peqin, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrative Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Elbasan	Qyteti Peqin	Peqin	Qyteti Peqin	26,136	38,900	197.79
		Pajovë	Fshatrat; Pajovë, Gryksh i Madh, Bishqem, Paulesh, Bishqem Fushë, Leqit, Lazarej, Haspiraj, Hasnjok, Çengelaj, Garunjë e Paprit, Cacabej			
		Karinë	Fshatrat; Karinë, Kazije, Rozejë, Progër, Sinametaj, Drangaj, Garunjë e Vogël			
		Përparim	Fshatrat; Përparim, Galush, Lisnajë, Bicaj, Caushaj, Fatish, Garunjë e Madhe, Arven, Gjevur, Kodras, Lolaj, Katesh, Çopana, Uruçaj			
		Gjocaj	Fshatrat; Gjocaj, Bregas, Çelhakaj, Kurtaj, Vashaj, Rumbullak, Hasmashaj, Bardhas, Blinas, Sallbegaj			
		Shezë	Fshatrat; Shezë e Madhe, Karthnekë, Shezë e Vogël, Pekisht, Trash, Algjinaj, Gryksh i Vogël			

Bashkia e re Përmet

Të dhëna të përgjithshme

Zona Gjeografike: Përmeti kufizohet në veri me bashkinë Skrapar, në lindje me bashkinë Kolonjë, në perëndim me bashkinë Libohovë dhe Këlcyrë. Kryeqendra e bashkisë është qyteti i Përmetit.

Popullsia: Sipas Censusit të vitit 2011, bashkia ka një popullsi prej 10.614 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrat Civil, kjo bashki numëron 20.301 banorë. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 601.95 km² me një densitet prej 33.72 banorë/km².

Kjo bashki ka edhe 4 njësi administrative, të cilat janë: Çarçovë, Frashër, Petran dhe Qendër Piskovë. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e qarkut Gjirokastrë. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 49 fshatra.


Profili social-ekonomik

Qyteti i Përmetit mori formë pas rregullimeve urbanistike të kryera në vitin 1964 dhe më pas njohu zhvillim të vogël demografik, kryesisht nga banorët që zbrisnin nga fshatrat përreth. Qyteti ka një arkitekturë tipike të periudhës socialiste, me pak ndërtime të reja. Përmeti është ndoshta qyteti me më shumë sipërfaqe të gjelbëruara e lulishte.

Bashkia e Përmetit rrethohet nga pasuri natyrore e historike. Parku Kombëtar i Hotovës me bredhin e rrallë mesdhetar, banjat kuruese në Bënjë, kanionet e Bënjës dhe të Lengaricës, Shtëpia e vëllezërve Frashëri, Kishat e Leusës, Kosinës, Bualit, Bënjës pasohen nga disa ura tipike me harqe, etj e bëjnë bashkinë e Përmetit një destinacion të lakmueshëm turistik.

Përmetarët merren me aktivitete të vogla tregtare, të cilat janë fragmentare dhe shpesh punësohen vetëm disa nga anëtarët e familjeve. Një nga pasuritë e rralla të zonës, Ujërat Termale të Bënjës, gati 14 km larg qytetit të Përmetit rrezikohen prej ndërtimit të hidrocentraleve të vegjël. Bashkia ka përgjegjësi të

ruajë pasuritë natyrore dhe kulturore, pasi shumë prej tyre rrezikojnë të dëmtohen. Bashkia e re do të duhet gjithashtu të çojë përpara përpjekjet për të frenuar ndërtimin e hidrocentraleve të vegjël në Lengaricë dhe në Vjosë, pasi ato dëmtojnë resurset turistike të zonës.



Sfidat e pushteti vendor pas ndarjes së re

Emigracioni dhe migrimi i brendshëm janë fenomene të hershme në këtë bashki. Papunësia e brendshme mbetet problem madhor për popullatën që nuk është zhvendosur.

Të ardhurat në këtë bashki janë në nivele minimale, pasi aktiviteti ekonomik reduktohet tek Blegtorja, bujqësia dhe agroperpunimi, të cilat janë të vështira për t'u taksuar. Shpesh bashkia nuk arrin të paguajë as shërbimet për furnizim me energji të institucioneve të saj. Bashkia duhet të gjejë mundësi të reja për punësimin e grave, sidomos në biznese të vogla prodhuese dhe me profilin e ri të zhvillojë sektorin e agrobiznesit, të vreshtarisë dhe prodhimit të verës. Disa kantina të verës janë në faliment prej problemeve në këtë treg apo investimeve me kredi. Shërbimet shëndetësore kanë nevojë të përmirësohen. Po kështu, sektori arsimor ka nevojë të ristrukturohet në funksion të mbështetjes së transportit të nxënësve dhe të përmirësimit të mjediseve shkollore. Sistemi i ndihmes ekonomike duhet të përshtatet me kushtet e reja.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Në total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Përmet për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është “7”, (Shih Listën më poshtë).

Raporti gjinor është 3 femra dhe 4 meshkuj. Sa i takon shkollimit, të gjithë janë me arsim të lartë (shkollim universitar).

Janë vetëm 4 nga 10 punonjës në këtë sektor që gëzojnë statusin e nëpunësit civil (një në provë); pjesa tjetër (3 punonjës) janë me kontratë pune “pa afat.

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë së re Përmet asnjë punonjës nuk ushtron *njëkohësisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas percaktimeve të ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP konfirmoi gjithashtu këtë fakt. Rekomandohet përcaktimi eksplicit i të paktën një pozicioni për NJMF në strukturën organizative të bashkisë së re Përmet për vitin 2016 dhe rekrutim stafi për NJMF me arsim të lartë të përshtatshëm për këtë funksion.

Bashkia Permet

Nr	Emër Mbiemër	Pozicioni i punës	Sektori	Data e fillimit	Lloji i Kontratës së punës	Edukimi/ Kualifikimi	Eksperienca e punës në njësi	Kategori të mbrojtura me ligj
1		Specialist i Ndhmes	Nd Ekonomike	06.11.2014	Nepunes civil prove	I Larte Bioteknologji	5 muaj	
2		Specialist per P A K	Nd Ekonomike	01.03.2001	Nepunes civil	I larte Ekon Agrare	14 vjet	
3		Spec per çeshtjet soc dhe dhunen ne familje	Nd Ekonomike	11.08.2011	Nepunes civil	Jurist	4 vjet	

Njesia administrative Frasher

4		Ndihma Sociale	Nd Ekonomike	2013	pa afat	Universitet Ekonomik	2 vjet	
---	--	----------------	--------------	------	---------	----------------------	--------	--

NJesia administrative Çarshovë

5		prgj.finance dhe nd ekon	Finance dhe nd ekon	2001	nen punes civil	dipl.univ. financier	14 vjet	
---	--	--------------------------	---------------------	------	-----------------	----------------------	---------	--

Njesia administrative Petran

6		administrator I ndihmes	nd,ekonomike	2000	pa afat	dip dega plan	14.5	
---	--	-------------------------	--------------	------	---------	---------------	------	--

		ekonomike						
Njesia administrative Qender Piskovë								
7		shf I sektorit te finances dhe nd ekon	Finance dhe nd ekon	2010	pa afat	dipl.univ ne ekonomik	5 vjet	

Bashkia Përmet, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrative Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësiti administrativ e përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census	Popullsia sipas Regjistrimit	Sipërfaqja KM ²
Gjirokastrë	Përmet	Përmet	Qyteti Përmet	10,614	20,301	601.95
		Çarçovë	Fshatrat; Çarçovë, Vllaho – Psilloterë, Biovizhdë, Zhepë, Draçovë, Iliar – Munushtir, Strëmbec, Dëllumbar, Kanikol			
		Frashër	Fshatrat; Frashër, Zavalan, Ogren – kostrec, Gostivisht, Miçan, Vërçisht, Kreshovë, Soropull			
		Petran	Fshatrat; Petran, Leshnicë, Leus, Lipë, Qilarishtë, Badilonjë, Benjë – Novoselë, Delvinë, Kaludh, Lupckë, Gjinakar, Ogdunan, Lipivan-Trabozishtë, Tremisht, Bodar			
		Qendër Piskovë	Fshatrat; Piskovë, Bual, Kosinë, Rapckë, Mokricë-Zleushë, Kutal, Kosovë, Hotovë, Odriçan, Raban, Alipostivan, Borockë, Gosnisht, Pagri, Pacomit, Grabovë, Argovë			

Bashkia e re Pogradec

Të dhëna të përgjithshme

Zona Gjeografike: Pogradeci kufizohet në veri me bashkinë Prrenjas, në perëndim me bashkinë Gramsh, në jug me bashkinë Maliq, në juglindje me bashkinë Pustec, ndërsa në lindje me Republikën e Maqedonisë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Pogradecit.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia e re numëron 61.530 banorë, ndërsa sipas Regjistrat Civil kjo bashki numëron një popullsi prej 90.976 banorë. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 548.77 km².

Bashkia e re Pogradec ka edhe 7 njësi administrative: Udënisht, Buçimas, Çerravë, Dardhas, Trebinjë, Proptisht dhe Velçan. Të gjitha njësitë administrative janë pjesë e rrethit të Pogradecit dhe qarkut të Korçës. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 72 fshatra.

Profili social-ekonomik

Bashkia e Pogradecit do të bashkojë në një të vetme të gjitha njësitë e rrethit të deritanishëm të Pogradecit duke ruajtur të njëjtët kufij territorialë që ka pasur deri tani rrethi. Qytetit të Pogradecit dhe komunave Udënisht e Buçimas që shtrihen përgjatë Liqenit të Ohrit dhe orientohen drejt turizmit, me ndarjen e re territoriale i bashkohen dhe disa zona të thella malore, të cilat përballen me varfërinë dhe mungesën e punësimit. Banorët i janë përshtatur relievit malor dhe mbijetojnë me vështirësi, çka i detyron të gjejnë zgjidhje tek pyjet ose tek minierat e braktisura.

Për shumë familje kryesisht nga fshatrat përreth Pogradecit, vendi fqinj i Maqedonisë është zgjidhja për punësim ditor ose sezonal. Burrat shkojnë për të punuar në vendin fqinj kryesisht në sektorin e ndërtimit dhe punëve të tjera të krahut. Liqeni mbetet një tjetër pikë referimi për një pjesë të mirë të popullsisë ku legalisht dhe ilegalisht peshkatarët hedhin rrjetat e tyre për të kapur peshkun e rrallë të koranit.



Banorët e zonave malore janë zhvendosur drejt fshatrave pranë qytetit dhe një pjesë e tyre edhe brenda tij, ndërsa disa prej tyre kanë zgjedhur emigracionin. Pogradeci dhe fshatrat pranë tij, për shkak se janë kthyer në një destinacion turistik, kanë pasur një hov të sektorit të ndërtimit ku përgjatë dekadës së fundit janë ngritur dhjetra pallate shumëkatësh, duke ngritur shumë pikëpyetje lidhur me planifikimin urbanistik të zonës. Projekt i rëndësishëm i realizuar ka qenë edhe impianti i përpunimit të ujërave të ndotura të cilat për vite të tëra derdheshin në liqen

Sfidat

Me ndarjen e re territoriale, Pogradecit i bashkohen disa zona të thella malore, të cilat përballen me varfërinë dhe mungesën e punësimit. Banorët i janë përshtatur relievit malor dhe mbijetojnë me vështirësi, çka i detyron të gjejnë zgjidhje tek pyjet ose tek minierat e braktisura. Futje në skemën e taksimit të ketyre banorëve është një sfidë.

Pothuaj se gjysma e zonave që tashmë do të kenë si qendër qytetin liqenor, kanë mungesa të theksuara të infrastrukturës ndërlidhëse me Pogradecin dhe jo rrallë izolohehen nga dëbora gjatë muajve të dimrit, çka identifikohet si një sfidë e mundshme lidhur me marrjen dhe aksesin e shërbimeve që do të ofrohen në nivel bashkie.

Strategjitë e deritanishme të punësimit në nivel vendor janë thuajse inekzistente; mungojnë fabrikat e konservimit të peshkut por edhe për prodhimet bujqësore, të cilat do të ofronin të ardhurave banorëve dhe Bashkisë përmes taksave.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Në total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Pogradec për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është “ 29 ”, (Shih Listën më poshtë).

Raporti gjinor është 19 femra dhe 10 meshkuj. Sa i takon shkollimit, 23 gjithë janë me arsim të lartë (shumica universitar) dhe vetem 6 jane me arsim te mesem.

Janë 16 punonjës që kanë statusin e nëpunësit civil, pse thetre jane ne marrdhenie pune kundrejt kontrateve me ose pa afat.

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë së re Pogradec janë 6 punonjës që ushtrojnë *njëkohësisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas percaktimeve të ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP konfirmoi nominalisht vetëm 3 prej tyre (*me ngjyre portokalli*). Nuk konfirmohet emri (jo funksioni) i 3 punonjësi të NJMF në Pogradec, NJA Udenisht, Çerravë dhe Propisht (me blu). Në strukturën e bashkisë (qendër) Pogradec ka një pozicioni për NJMF, me emërtimin “Specialist i nivelit të lartë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”.

Bashkia Pogradec

Nr	Emri Mbiemri	Pozicioni i punes	Sektori	Lloji i kontrates se punes	Edukimi/ Kualifikimi	Ekperienca e punes ne njesi	Kategori te mbrojtura
Drejtoria e Shërbesave ndaj Komunitetit							
1		Drejtor drejtorie	Shërbesat ndaj komunitetit	Nepunës Civil	Diplomë univesitare/ ekonomist për financën	13 vjet	
2		Përgjegjës i sek.te ndihmës dhe kujdesit social	Sektori i ndihmës dhe kujdesit social	Nepunës Civil	Diplomë univesitare/ ekonomist plani i lartë	11 vjet	
3		Specialist i nivelit të lartë për ndihmën dhe kujdesin social	Sektori i ndihmës dhe kujdesit social	Nepunës Civil	Diplomë univesitare / ekonomist plani i lartë	22 vjet	
4		Specialist për ndihmën dhe kujdesin social	Sektori i ndihmës dhe kujdesit social	Me kontratë pa afat	I mesëm	9 vjet	
5		Specialist i nivelit të lartë për verifikim/kontrollin	Sektori i ndihmës dhe kujdesit social	Nepunës Civil	Diplomë univesitare / financier i lartë	7 vjet	

6		Specialist i nivelit të lartë për ndihmën dhe kujdesin social	Sektori i ndihmës dhe kujdesit social	Nenpunës Civil	Diplomë e nivelit të dytë në përkatësi gjinore dhe zhvillim	1 vit	
7		Specialist i nivelit të mesëm për qendrën komunitare	Sektori i ndihmës dhe kujdesit social	Nenpunës Civil	Bachelor si mësues i gjuhës angleze	7 muaj	
8		Specialist i nivelit të mesëm për informimin	Sektori i informimit publik	Nenpunës Civil	Diplomë universitare/ kimist industrial	8 vjet	
9		Specialist i nivelit të lartë për informimin	Sektori i informimit publik	Nenpunës Civil	Diplomë univesitare / inxhinier agro-ushqim	6 vjet	
10		Përgjegjës i sektorit të gjendjes civile	Sektori i gjendjes civile	Nenpunës Civil	Diplomë universitare /ekonomist i lartë	17 vjet	
11		Përgjegjës i sektorit të strehimit	Sektori i strehimit	Nenpunës Civil	Diplomë universitare /ekonomist për industrinë	19 vjet	
12		Specialist i nivelit të lartë për strehimin	Sektori i strehimit	Nenpunës Civil	Diplomë universitare si inxhinier ndërtimi	22 jet	
13		Specialist i nivelit të lartë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve	Sektori i mbrojtjes së nënave dhe fëmijëve	Nenpunës Civil	Diplomë universitare/ ekonomist për industrinë	17 vjet	
14		Specialist i nivelit të lartë për mbrojtjen enënavë të dhunuara	Sektori i mbrojtjes së nënave dhe fëmijëve	Nenpunës Civil	Diplomë universitare/mësues për gjuhë-letërsi	2 vjet	
15		Përgjegjëse e Sektorit të mbrojtjes shoqerore		Kontrate me afat te pa caktuar	Diplome Universitare ne Gjuhe te huaja	2 vjet	

Njesia administrative Buçimas							
17		Pergjegjese e Sektorit te mbrojtjes shoqerore		Kontrate me afat te pa caktuar	Diplome Universitare ne Gjuhe te huaja	2 vjet	
18		Specialiste per mbrojtjen shoqerore		Kontrate me afat te pa caktuar	Shkolle e Mesme	3 vjet	
Njesia administrative Udenisht							
19		shef I ndihmes ekonomike	sektori I ndihmes ekonomike	Nenpunes Civil	Diplome Universiteti ne Ekonomik	7 vjet	
20		INSPEKTORE NEK	sektori I ndihmes ekonomike	Nenpunes Civil	Diplome Universiteti ne Ekonomik	38VJET	
Njesia administrative Dardhas							
21		Administrator shoqeror	Sektori i finances	kontrate pa afat	SHKOLLE E MESME	3vite	
22		Administrator shoqeror	Sektori i finances	kontrate pa afat	SHKOLLE E MESME	2 vite	
Njesia administrative Çerave							
23		Ins.Finan.Nd.Eko	Ndih Ekonom	Pa afat	Agroushqim	3v	
24		Pergj.Nd.Ekonom	Ndih Ekonom	Pa afat	Agro -Biznes	3v.7m	
Njesia administrative Trebinje							
25		NENKRYETAR,P.SHER BIMESH E ND.EKONOMIKE	Ndih Ekonom	Pa afat	I MESEM	13	
Njesia administrative Velçan							
26		Administrator I ndimes ekonomik e	Zyra. Ndih Eko	I emeruar me kontrate 6 mujore deri me 30/6/2015	Arsim I mesem	7 vjet e 10 muaj	
27		Nen administrator I ndimes ekonomike	Zyra. Ndih Eko	I emruar 6 mujore deri ne 30/6/2015	Arsim I mesem	6 muaj	
Njesia administrative Proptisht							
28		Pergjegjes I Zyres se Ndimes ekonomike	Zyra e ndumes ekonomike	Nenpunes Civil	Diplome Universiteti ne agrobiznes	4 vjet	
29		Specialist zyra e ndimes ekonomike	Zyra e ndumes ekonomike	Kontrata pa afat	Arsmi I mesem Ekonomik	12 vjet	

Bashkia Pogradec, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrative Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Korçë	Qyteti Pogradec	Pogradec	Qyteti Pogradec	61,530	90,976	584.77
		Udenisht	Fshatrat; Udenisht, Memlisht, Çervenakë, Piskupat, Lin, Buqez			
		Buçimas	Fshatrat; Buçimas, Tushemisht, Peshkëpi, Gurras, Gështënjas, Remenj, Vërdovë, Bahçallëk			
		Çërrave	Fshatrat; Çërravë, Blacë, Bletas, Alarup, Pretushë, Grabovicë, Nizhavec, Kodras, Leshnicë, Lumas, Qershizë			
		Dardhas	Fshatrat; Dardhas, Stropckë, Grunjas, Prenisht, Derdushë, Osnat, Lekas, Nicë, Stërkanj			
		Trebinjë	Fshatrat; Trebinjë, Çezmë e Madhe, Çezmë e Vogël, Hondisht, Selcë e Sipërme, Llëngë, Plenisht, Hoshtecë, Zemcë, Potgozhan, Malinë, Kalivaç, Pevelan, Dunicë, Guri i Bardhë			
		Proptisht	Fshatrat; Proptisht, Rodokal Sipër, Rodokal Poshtë, Homezh, Slabinjë, Somotinë, Kriçkovë, Selcë e Poshtme, Homçan, Vërri, Golik, Slatinë, Baribardhë, Selishtë, Zalltore			
		Velçan	Fshatrat; Velçan, Buzahishtë, Shpellë, Bishnicë, Jollë, Losnik, Laktesh, Senishtë			

Bashkia e re Poliçan

Të dhëna të përgjithshme

Zona Gjeografike: Poliçani kufizohet në veri dhe në perëndim me bashkinë Berat, në lindje me bashkinë Skrapar, ndërsa në jug dhe jug-lindje me bashkinë Memaliaj. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Poliçanit.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011 numëron 10,953 banorë, ndërsa sipas Regjistrimit Civil ajo numëron një popullsi prej 18,341 banorë. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 272.02 km² me një densitet prej 67.42 banorë/km² sipas regjistrimit civil dhe 40 banorë/km² sipas censurit.

Kjo bashki ka edhe 2 njësi administrative, të cilat janë Tërpan dhe Vërtop. Nga këto, Poliçani është aktualisht pjesë e rrethit Skrapar ndërsa dy njësitë e tjera janë pjesë e rrethit Berat. Të gjitha njësitë janë pjesë e qarkut Berat. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 26 fshatra.

Profili i bashkisë

Bashkia e re e Poliçanit përbëhet nga qyteza ish-industriale e Poliçanit dhe dy ish-komuna të cilat nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me qytezën pasi kanë qenë më parë pjesë e rrethit Berat. Qyteti i Poliçanit ka qenë një qendër e rëndësishme e industrisë ushtarake dhe e industrisë së materialeve të ndërtimit për shkak të burimeve të mëdha të gurit. Poliçani ka qenë më herët një fshat në varësi të Beratit; u shpall qytet në vitin 1967.

Shfrytëzimi i rezervave të gurit vijon sot në mënyrë private. Industria e nxjerrjes së gurit dekorativ është në ditët e sotme një resurs i konsiderueshëm ekonomik për zonën. Qyteti i Poliçanit vuan aktualisht nga furnizimi me ujë për shkak të vjetërsimit të rrjetit të shpërndarjes, pavarësisht se burimet ujore të zonës janë të pafundme. Bazuar në këto resurse, bashkia e re identifikohet se duhet të hartojë politika nxitëse për ngritjen e ndërmarrjeve për shfrytëzimin dhe paketimin e ujit, çka do të mundësonte dhe hapjen e vendeve të reja të punës për banorët e zonës.



Sfidat e pushteti vendor pas ndarjes së re

Të ardhurat në zonat rurale vijnë kryesisht nga kultivimi i ullirit dhe rrushit, por edhe drurëve të tjerë frutorë si gështenjat, arrat dhe fiqtë. Ndihma ekonomike e bashkise është gjithashtu një burim për shtresat me nevojë.

Në zonën e qytetit, industria mekanike ka qenë burim të ardhurash deri pas viteve 1995 duke u kufizuar në disa raste vetëm në procesin e demontimit të municioneve. Ndërpjara e këtij procesi solli papunësi shumë të lartë në qytezë, e cila filloi të depopullohej nga të rinjtë.

Ndërtimi i një administrate në shërbim të të gjithë popullsisë së bashkisë së re, duke marrë parasysh largësinë rrugore me komunën Tërpan, pritet të jetë sfida kryesore, veçanërisht nëse merret parasysh terreni i thyer malor. Një rivlerësim i skemës së ndihmës ekonomike në fshta mund të ishte i domosdoshëm në kushett e reja.

Abjentete shkollimit për fëmijët janë për t'u rivlerësuar dhe për shumicën e shkollave nevojitet plane dhe financime për rikonstruksionin e tyre. Puna e fëmijëve në industrinë e nxjerrjes së gurit është gjithashtu një problem edhe pse është pak i raportuar, për shkak të zonave të thella rurale ku zhvillohet.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Ne total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Poliçan për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është “ 3 ”, (Shih Listën më poshtë).

Raporti gjinor është 3 me 0 ne favor të femrave.

Sa i takon shkollimit, 2 punonjëse janë me arsim të lartë (shumica universitar), ndërsa një punonjëse është me arsim të mesëm.

Dy (2) nga tre (3) punonjës në këtë sektor gëzojnë statusin e nëpunësit civil; 1 punonjëse është me “kontratë pune” pa afat.

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë së re Poliçan duhet të jenë 2 punonjës që ushtrojnë *njëkohësisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas percaktimeve të ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP konfirmoi nominalisht vetëm 1 prej tyre (*me ngyre portokalli*). Nuk konfirmohet emri (jo funksioni) i 1 punonjësi të NJMF në NJA Bashkia Polican (me blu). Rekomandohet përcaktimi eksplicit i të paktën një pozicioni për NJMF në strukturën organizative të bashkisë së re Poliçan për vitin 2016.

Bashkia Poliçan								
N r	Emër Mbiemër	Pozicioni i punës	Sektori	Data e fillimit	Lloji i Kontratës së punës	Edukimi/ Kualifikimi	Eksperienc a e punës në njësi	Kategori të mbrojtura me ligj
1		Spec. Nd Ek dhe Barazise Gjin	Nd Ekonomike		Kontrate pa afat	I mesëm		
Njesia administrative Vertop								
2		Specialiste e ndihmes	Ndihma ekonomike	07.02.2014	Nepunes Civil	Diplome Universiteti ne ekonomik	14.5 vjet	
Njesia administrative Terpan								
3		Specialiste e ndihmes	Ndihma ekonomike	07.02.2014	Nepunes Civil	Diplome Universiteti ne ekonomik	14.5 vjet	

Bashkia Poliçan, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrative Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Berat	Qyteti Poliçan	Poliçan	Qyteti Poliçan	10,953	18,341	272.02
		Tërpan	Fshatrat; Tërpan, Teman, Paraspuar, Tozhar, Vokopolë, Dodovec, Rehovë, Zhapokikë, Çorogjaf, Panarit, Plashnik i Madh, Lugas, Zhitom i Madh, Zhitom i Vogël			
		Vërtop	Fshatrat; Mbrakull, Vërtop, Kapinovë, Zgërbonjë, Vodicë, Fushë Peshtan, Peshtan, Drenovë, Lybeshë, Tomor i madh, Tomor i vogël, Bregas			

Bashkia e re Prrenjas

Të dhëna të përgjithshme

Zona Gjeografike: Përrenjasi kufizohet në veri me bashkinë Librazhd, në lindje me Republikën e Maqedonisë, në jug me Bashkinë Pogradec dhe në perëndim me Bashkinë Elbasan. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Përrenjasit.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, Përrenjasi ka një popullsi prej 24,906 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrat Civil, kjo bashki ka 33,031 banorë. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 322.95 km². Densiteti i popullsisë është 77 banorë/km²; sipas regjistrat civil densiteti është 102.279 banorë/km².

Bashki Prrenjas ka edhe 3 njësi administrative, të cilat janë: Qukës, Rrajcë dhe Stravaj. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Librazhdit dhe qarkut të Elbasanit. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 25 fshatra. Shih me poshte listën e plotë.

Profili i bashkisë

Bashkia e re e Përrenjasit përfshin sipërfaqe të shumta pyjore dhe burime të bollshme hidrike si dhe një fushë pjellore. Nëntoka është e pasur me krom, ndërkohë që ky mineral shfrytëzohet aktualisht në dy prej fshatrave të bashkisë së re. Zonat e Rrajcës, Qukës dhe Stravajt kanë sipërfaqen më të madhe të pyjeve në këtë zonë. Megjithatë, shfrytëzimi pa kriter gjatë dy dekadave të fundit i ka dëmtuar pyjet në një masë të gjerë.

Përgjatë tranzicionit, në këtë zonë kanë munguar strategjitë e zhvillimit. E megjithatë, emigracioni në zonën e Përrenjasit nuk ka qenë i lartë. Kjo pasi shumë banorë të zonës kanë zgjedhur punësimin sezonal në Maqedoninë fqinje, me të ardhurat e të cilëve mbijeton një pjesë e mirë e popullatës.

Në të gjithë bashkinë e re rezultojnë të regjistruara 234 biznese, të cilat e kryejnë aktivitetin e tyre kryesisht në shërbime. Një pjesë e vogël e bizneseve merren me kultivimin e troftës.



Sfidat e pushteti vendor pas ndarjes së re

Papunësia mbetet plaga kryesore për banorët e Përrenjasit dhe një sfidë për administratën e re të zgjedhur më 21 qershor. Një pjesë e mirë e të ardhurave të bashkisë shkojnë për mbështetjen ekonomike për familjet në nevojë. Investimet në fasoneri konsiderohen një mundësi e mirë për punësimin e grave të zonës, ndaj nxitja e bizneseve të kësaj fushe mund të jetë një prioritet për mandatin 4-vjeçar. Pozicioni gjeografik i Përrenjasit megjithatë e favorizon pak këtë mundësi.

Skema e ndihmes ekonomike në bashki është nën presion të vazhdueshëm. Ky presion pritet të shtohet pasi popullsia e zonave rurale jeton në kushte varferie si pasoje e mungesës së tokës bujqesore dhe rusurseve të pakta ekonomike.

Përmirësimi i godinave arsimore si dhe rehabilitimi i infrastrukturës rrugore të fshatrave konsiderohet një tjetër sfidë e rëndësishme për zhvillimin e bashkisë së re. Nga ana tjetër, qyteti vuan nga mungesa e ujit të pijshëm, nga ndriçimi i zonave publike dhe nga shërbimi i pastrimit, çështje që kërkojnë gjithashtu një administrim më të mirë.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Në total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Prrenjas për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është “5”, (Shih Listën më poshtë). Raporti gjinor është 3 me 2 në favor të femrave. Sa i takon shkollimit, 4 punonjës janë me arsim të lartë (shumica universitar), vetëm një punonjës është me arsim të mesëm. Vetëm 2 nga 5 punonjësit në këtë sektor gëzon statusin e nëpunësit civil; 2 janë me kontrata pune; respektivisht 1 “me afat” dhe 1 “pa afat”. Për një punonjës të dhënat janë të paplota.

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë së re Prrenjas duhet të jenë 3 punonjës që ushtrojnë *njëkohësisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas percaktimeve të ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP konfirmoi nominalisht vetëm 2 prej tyre (*me ngjyre portokalli*). Nuk konfirmohet emri (jo funksioni) i 1 punonjësi të NJMF në NJA Qukës (me blu). Rekomandohet përcaktimi eksplicit i të paktën një pozicioni për NJMF në strukturën organizative të bashkisë së re Prrenjas për vitin 2016.

Bashkia Prrenjas								
Nr	Emër Mbiemër	Pozicioni i punës	Sektori	Data e fillimit	Lloji i Kontratës së punës	Edukimi/ Kualifikimi	Eksperienc a e punës në njësi	Kategori të mbrojtura me ligj
<i>Zyra e Ndhmës Ekonomike</i>								
1		P/Zyres Nd/Ekonomike	Zyra e Nd/Ekonomike	09.08.2011	I Plote(PoziPunojes/Admin E Mesme Bujqesore	E Mesme Bujqesore	4 vjet	
2		P/Zyre Emergjencave	Zyra eNd/Ekonomike	16.06.2002	I Plote (Pozicion Sh/Civil)	I Larte Ekonomi Financ	12 vjet - 10muaj	
Njesia administrative Stravaj								
3		Inspektor	Ndhmës Ekonomike	01.01.2003	Kontrate me afat	Diplome Universiteti ne Veterinari	12 vjet	
Njesia administrative Qukës								
4		Pergjegjese Nd.Ekonomike	Zyra e Finance	14.01.2011	Nenpunes Civil	I larte Mesuesi	4 vjet e 3 muaj	
Njesia administrative Rrajcë								
5		Punonjsi nd ekonomike	Zyra e finances	01.06.2007	Kontrate pa afat	Diplome Universiteti ne Ekonomi Agrare	9 vjet e 3 muaj	

Bashkia Përrenjas, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrative Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Elbasan	Qyteti Përrenjas	Prrenjas	Qyteti Prrenjas, Fshatrat; Prrenjas-Fshat, Rrashtan	24,906	33,031	322.95
		Qukës	Fshatrat; Qukës Shkumbin, Qukës Skënderbej, Skroskë, Mënik, Gurrë, Bërzeshtë, Fanjë, Karkavec, Dritaj, Pishkash, Pishkash Veri			
		Rrajcë	Fshatrat; Rrajcë, Sutaj, Skënderbej, Bardhaj, Katjel, Kotodesh, Urakë			
		Stravaj	Fshatrat; Stravaj, Stranik, Farret, Shqiponjë, Sopot			

Bashkia e re Pustec

Të dhëna të përgjithshme

Zona Gjeografike: Pusteci kufizohet në perëndim me bashkitë Pogradec dhe Maliq, ndërsa në veri dhe lindje me Republikën e Maqedonisë. Kryeqendra e bashkisë së re është fshati i Pustecit.

Popullsia: Sipas Censusit të vitit 2011, bashkia e re numëron 3.290 banorë, ndërsa sipas Regjistrat Civil kjo bashki numëron një popullsi prej 5.191 banorë. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 198.68 km².

Kjo bashki nuk ka njësi administrative të tjera në varesi të saj. Ajo në varesi të qarkut të Korçës. Nga viti 1973 deri në vitin 2013, emri zyrtar i kësaj komune ka qenë Liqenas. Bashkia e re ka nën administrimin e saj 9 fshatra. (Shiko listën e plotë me poshte).

Profili i bashkisë

Kjo bashki popullohet nga minoriteti maqedonas, i cili pavarësisht se gëzon unitet të plotë, përballët me vështirësi për shkak të papunësisë dhe nivelit minimal të ardhurave. Minoriteti ruan marrëdhënie të forta me Maqedoninë, kryesisht në aspektin tregtar duke blerë me shumicë përtej kufirit, ndërsa dy prej projekteve më të mëdha janë ajo e Parkut Kombëtar të Prespës dhe projekti për linjën e tragetit mes Shqipërisë, Greqisë dhe Maqedonisë. Këto projekte do të nxisin turizmin si dhe organizimin e guidave të përbashkëta turistike dhe transportin e vizitorëve mes tre shteteve.

Pusteci është një zonë e favorshme për zhvillimin e turizmit veror. Mikroklima e pasur, liqeni i Prespës, pamjet e bukura panoramike me një ndërthurje harmonike të peizazhit, gatimet tradicionale, ndërtesat e vjetra buzë liqenit të Prespës nga shekujt 13 dhe 14, si dhe ishulli i Maligradit janë atraksionet kryesore të kësaj zone aspak të promovuar deri më tani në këtë aspekt. Në ekonominë e Pustecit përfshirja në punët bujqësore është tejet e kufizuar për shkak të rendimentit të ulët nga terreni i thyer dhe mungesa e vaditjes, si dhe mungesës së tregut.



Ndarja e re në këtë bashki nuk krijon probleme për shkak se ruhet e njëjta hapësirë gjeografike por ngre sfida për zgjidhjen e problemeve persistente. Një ndër to është ngritja dhe mirëmbajtja e një rrjeti të furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve, si dhe menaxhimi i mbetjeve urbane në mënyrë që të evitohet ndotja. Gjithashtu, pushteti i ri vendor duhet që të prioritetizojë nevojën e hartimit dhe zbatimit të politikave që mbështesin dhe nxisin turizmin e qendrueshëm lidhur me liqenin dhe parkun kombëtar rreth tij. Për këtë qëllim është e nevojshme jo vetëm zgjidhja sa më e shpejtë e problematikave të mësipërme, por dhe promovimi i zonës dhe orientimi i banorëve drejt krijimit të hapësirave akomoduese të turizmit familjar.

Sfidat e pushtetit vendor pas ndarjes së re

Një sfidë serioze është infrastruktura e keqe ndërlidhëse mes fshatrave të kësaj bashkie dhe qendrës së saj, e cila nën bashkinë e re do të vështirësonte dhe më tej marrjen e shërbimeve nga ana e të gjithë komunitetit. Infrastruktura e keqe rrugore identifikohet dhe si shkak kryesor i nivelit të lartë të braktisjes së shkollës nga fëmijët e këtyre fshatrave, të cilëve nuk u sigurohet transport i përditshëm drejt qendrës së njësive administrative ose mundësi akomodimi (konvikte) në Pustec.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Ky vlerezim inventarizoi vetem nje pozicion ne strukturën e bashkisë së re Pustec, ish komunë me ndarjen e vjetër territoriale (Shih Listën më poshtë). I njëjti punonjës realizon sipas të dhënave edhe funksionin në kuadër të NJMF (sipas përcaktimeve të ligjit Nr.10 347, datë 4.11.2010 **“Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”** (me ngjyrë portokalli). Pozicioni nuk është i përcaktuar

qartësisht në strukturën e bashkisë për vitin 2015. Rekomadohet që ky pozicion të veçohet dhe të përcaktohet qartësisht në strukturën e bashkisë për vitin 2016. Rekomandohet shtimi i personelit në sektorin e ndihmës ekonomike dhe përkrahjes sociale, për t'ju përgjigjur më mirë sfidave të organizimit strukturor në bashkinë e re të sapokrijuar.

Bashkia Pustec

Nr	Emri Mbiemri	Pozicioni i punes	Sektori	Data e fillimit	Lloji i kontrates se punes	Edukimi/ Kualifikimi	Ekperienca e punes ne njesi	Kategori te mbrojtura me ligj
1			Zyra e Ndhmes Ekonomike					

Bashkia Pustec, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrative Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrat Civil	Sipërfaqja KM ²
Korçë	Fshati Pustec	Pustec	Fshatrat; Pustec, Diellas, Lajthizë, Zaroshkë, Cerje, Goricë e vogël, Goricë e madhe, Kallamas, Gollomboc	3,290	5,191	198.68

Bashkia e re Pukë

Të dhëna të përgjithshme

Zona Gjeografike: Puka kufizohet në veri dhe në perëndim me Bashkinë e Vaut të Dejës, në lindje me Bashkinë Fushë Arrëz dhe në jug me Bashkitë Mirditë dhe Lezhë. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Pukës.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, Bashkia e Pukës ka 11,069 banorë. Ndërkohë që sipas Regjistrat Civil kjo bashki numëron 16,836 banorë. Ajo ka një sipërfaqe prej 505.53 km² me një densitet prej 33.30 banorë/km² sipas Regjistrat Civil dhe 21.89 banorë/km² sipas Censurit 2011.

Kjo bashki ka nën varesi 4 njësi administrative, të cilat janë: Gjegjani, Rrapë, Qelëz dhe Qerret. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e qarkut Shkodër. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 41 fshatra.

Profili i Bashkisë

Bashkia e Pukës është një ndër zonat e pasura minerare të vendit, e cila disponon gjithashtu një sipërfaqe të madhe pyjore. Mbyllja e minierave apo dhënia e tyre me koncesion ka shtuar numrin e të papunëve në Pukë. Prerja pa kriter e pyjeve ka shkaktuar jo pak probleme për këtë zonë.

Përpunimi i drurit shihet gjithsesi si një aktivitet me rëndësi për gjallërimin ekonomik të zonës, por ky aktivitet duhet shoqëruar me kriterë të rrepta në shfrytëzimin e fondeve pyjore. Paralelisht me këtë aktivitet, mbështetja e bujqësisë dhe e blegtorisë konsiderohet e domosdoshme për zonën e Pukës.

Prej vitesh në këtë zonë kanë munguar investimet me rëndësi, ndërsa rruga Durrës-Kukës e ka aneksuar dhe izoluar edhe më shumë Bashkinë e Pukës.



Sfidat e pushtetit vendor pas ndarjes së re

Problem për Bashkinë e Pukës vijon të mbetet migrimi në nivele alarmante. Një pjesë e mirë e popullatës ka migruar në drejtim të Shqipërisë së Mesme (Tiranë kryesisht) ose emigruar jashtë Shqipërisë. Të ardhurat nga emigracioni janë një burim i rëndësishëm mbijetese për këtë bashki. Baza e taksueshme është e ulët, dhe kjo kompromenton investimet që duhet të realizohen nga bashkia. Bashkia Puke mbart problemin e mos-shlyerjes së borxheve.

Stina e dimrit, ku bllokimi i rrugëve nga dëbora izolon një pjesë të mirë të zonës dhe vështirëson shumë jetesën e banorëve. Përmirësimi i infrastrukturës rrugore konsiderohet një ndër sfidat kryesore për Bashkinë e re të Pukës. Rrugët dytësore që lidhin fshatrat e Gjegjanit, Qelëz dhe Luf-Qerretit me qytetin e Pukës dhe dërgimi i shërbimit shëndetësor në këto fshatra ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e jetës së banorëve. Ofrimi dhe levrimi i Ndhmës Soc-Eko në fshatrat e thellë është një sfidë serioze,

Mbyllja e minierave apo dhënia e tyre me koncesion ka shtuar numrin e të papunëve në Pukë, duke e kthyer varfërinë në një problem akut për banorët e zonës. Kjo rëndon shumë skemen e ndihmes ekonomike për Bashkinë.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Në total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Pukë për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është “ 5 ”, (Shih Listën më poshtë). Raporti gjinor është 2 me 3, në favor të meshkujve. Sa i takon shkollimit, 3 janë me arsim të lartë (shumica universitar) dhe 2 punonjës janë me arsim të mesëm.

Janë vetëm 2 nga 5 punonjës në këtë sektor që gëzojnë statusin e nëpunësit civil; një punonjës është “kontratë pune” me afat dhe 2 punonjës janë me kontratë pune pa afat

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë së re Pukë duhet të jetë vetëm 1 punonjës që ushtronë *njëkohësisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas përcaktimeve të ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP e konfirmoi nominalisht këtë të dhënë gjithashtu (NJA Qelëz, me blu), edhe pse nominalisht e dhëna nuk përputhet (vetëm funksioni përputhet. Rekomandohet përcaktimi eksplicit i të paktën një pozicioni për NJMF në strukturën organizative të bashkisë së re Pukë për vitin 2016.

Bashkia Puke								
Nr	Emër Mbiemër	Pozicioni i punës	Sektori	Data e fillimit	Lloji i Kontratës së punës	Edukimi/ Kualifikimi	Eksperienca e punës në njësi	Kategori të mbrojtura me ligj
1		spec.ndih.ekon	Ekonomi-financë	01.04.2011	Pa afat	I LARTË(EKONOMIK)	10 VITE	
Njesia administrative Gjegan								
2		Pergj. Ndhimes Ekonomike	Ndihma ekonomike	1993	Nepunes Civil	I Larte Ekonomik	22	
Njesia administrative Qerret								
3		SPEC NDIHMES EKONOMIKE	ZYRA .ND. EKONOMIKE	01.03.2009	Kontrate me afat	I mesem, Ekonomik	6	
Njesia administrative Rrape								
4		P.Sherb.Ndimes Ekonomike	Ndihma ekonomike	1.06.2008	Nenpunes Civil	I larte, Ing Pyjjesh	7	
Njesia administrative Qelëz								
5		Pergj ndihmes ekonom	Ndihma ekonomike	2011	Kontrate pa afat	I Mesem	4	

Bashkia Pukë, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrative Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrativ e përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Shkodër	Qyteti Pukë	Pukë	Qyteti Pukë, Fshatrat; Pukë, Lajthizë	11,069	16,836	505.53
		Gjegjan	Fshatrat; Dom, Gjegjan, Gojan i Vogël, Rras, Kuzhnen, Gojan i Madh, Shkozë, Kimëz, Kalivare, Mesul			
		Rrapë	Fshatrat; Breg, Rrapë, Kabash, Buhot, Bicaj, Blinisht, Lumzi, Meçe			
		Qelëz	Fshatrat; Qelëz, Bushat, Dushnezë, Midhë, Buzhalë, Dedaj, Levrushk, Ukth, Qerret i Vogël			
		Qerret	Fshatrat; Qerret, Luf, Dush, Karmë, Kçirë, Luf-Plan, Korthpulë, Kaftall, Tejkodër, Gomsiqe, Vrith, Plet			

Bashkia e re Roskovec

Të dhëna të përgjithshme:

Zona Gjeografike: Bashkia e re Roskovec kufizohet në veri dhe perëndim me bashkinë Lushnjë, në jug me bashkinë Mallakastër, në lindje me bashkinë Ura Vajgurore, ndërsa në perëndim me bashkinë Patos. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Roskovecit.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia e re Roskovec ka 21.742 banorë ndërsa në Regjistrin Civil popullsia e regjistruar figuron 31.548 banorë. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 118.01 km². Sipas Censurit densiteti i popullsisë së bashkisë së re është 184 banorë për kilometër katror ndërsa në bazë të regjistrit civil densiteti rezulton 263.33 banorë/ km².

Kjo bashki ka edhe 3 njësi administrative, të cilat janë: Kuman, Kurjan dhe Strum. Të gjitha njësitë administrative janë pjesë e qarkut Fier. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 14 fshatra. (shiko me poshte tabelen e detajuar)

Profili i bashkisë

Bashkia e re e Roskovecit shtrihet pjesërisht mbi zonën naftëmbajtëse Patos-Marinzë. Të ardhurat kryesore të banorëve vijnë nga ky sektor, në të cilin janë punësuar shumë prej banorëve të zonës. Gjithashtu, njësitë e tregtimit dhe shërbimeve janë një tjetër sektor ku janë punësuar shumë prej banorëve të qytetit të Roskovecit. Sa i takon zonave rurale, të ardhurat fitohen kryesisht nga prodhimet bujqësore dhe agrumet

Një ndër problematikat kryesore të ngritura nga komuniteti i kësaj zone, është dhe nevoja për krijimin e një tregu për shitblerjen e mallrave bujqësorë dhe blegtorialë të zonës, e cila aktualisht kryhet në këtë zonë çdo të shtunë drejtpërsëdrejti në rrugët e qytetit. Qyteti i Roskovecit ka përfutur disa projekte publike të financuara nga qeveria qendrore gjatë viteve të fundit për zhvillimin e infrastrukturës rrugore brenda qytetit.



Sfidat e pushtetit vendor pas ndarjes së re

Rruga lidhëse Fier – Berat e cila kalon në këtë bashki është ende në proces rikonstruksioni dhe në gjendje shumë të keqe, duke vështirësuar në këtë mënyrë lëvizjen e banorëve drejt këtyre dy qendrave të rëndësishme urbane në afërsi të saj.

Bashkia e re e Roskovecit do të përfshijë një territor të larmishëm me interesa shumë të ndryshme ekonomike. NJA Kuman dhe banorët e saj i kanë interesat kryesore të lidhura me sektorin e naftës ndërkohë që komunat Strum dhe Kurjan janë të përqendruara te bujqësia. Balancimi i nevojave të ndryshme të këtyre banorëve dhe i financimeve që do të parshikohen në buxhetin e bashkisë së re do të përbëjë një nga sfidat kryesore të pushtetit të ri vendor. Për këtë arsye, gjithëpërfshirja e banorëve të zonave të ndryshme në vendimmarrjen e kësaj bashkie, si dhe sigurimi i transparecës përbën një sfidë për kryebashkiakun e ri.

Pavarësisht burimeve ekonomike, përgjatë dekadave të fundit zona ka pasur një fluks të ndjeshëm largimi të popullsisë. Mund të përmendim këtu zonën e fshatit Ngjeqar, në të cilin sot kanë mbetur një numër shumë i vogël banorësh.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Në total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Rroskovec për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është " 5 ", (Shih Listën bashkëlidhur). Raporti gjinor është 3 me 2 në favor të femrave. Sa i takon shkollimit, 3 janë me arsim të lartë (shumica universitar), 1 punonjës është me arsim të mesëm, nuk ka të dhëna për një punonjës. Asnjë punonjës në këtë sektor nuk gëzon statusin e nëpunësit civil, 3 punonjës janë me "kontratë pune" pa afat, një punonjës është me kontratë dhe një punonjës është në periudhë prove.

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë së re Rroskovec duhet të jetë 1 punonjës që ushtronë *njëkohësisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas percaktimeve të ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP e konfirmoi edhe nominalisht këtë të dhënë (*me ngjyre portokalli*). Rekomandohet përcaktimi eksplicit i të paktën një pozicioni për NJMF në strukturën organizative të bashkisë së re Rroskovec për vitin 2016.

Bashkia Rroskovec

N r	Emër Mbiemër	Pozicioni i punës	Sektori	Data e fillimit	Lloji i Kontratës së punës	Edukimi/ Kualifikimi	Eksperienc a e punës në njësi	Kategori të mbrojtur a me ligj
1		Specialist I Ndhmës Ekonomike	Ndihma ekonomike	2013	Periudhe prove	Diplome Filozofi	1 vit/4muaj	
2		Specialist I Ndhmës Ekonomike	Ndihma ekonomike	2015	Kontrate pa afat	Diplome Sociologji	3 muaj	
Njesia administrative Strum								
3		Administrator	Ndihma ekonomike	2007	Kontrat pa afat	Histori Gjeografi	8 vjet	
Njesia administrative Kuman								
4		Admin ndihmes ekonomike	Ndihma ekonomike	01.10.2007	Me Kontrate			
Njesia administrative Kurjan								
5		Administrator	Ndihma ekonomike	2011	Kontrat pa afat	Shkolle e mesme	4 vjet	6 ore ne dite

Bashkia Roskovec, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrative Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrativ e përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrit Civil	Sipërfaqja KM ²
Fier	Qyteti Roskovec	Roskovec	Qyteti Roskovec, Fshatrat; Jagodinë	21,742	31,548	118.01
		Kuman	Fshatrat; Kuman, Marinëz, Vidhishtë, Luar			
		Kurjan	Fshatrat; Kurjan, Mbërs, Ngjeqan, Vlosh			
		Strum	Fshatrat; Strum, Arapaj, Suk 1, Suk 2, Velmish			

Bashkia e re Shkodër

Të dhëna të përgjithshme

Zona Gjeografike: Shkodra kufizohet në veri me Bashkinë e Malësisë së Madhe, në perëndim me Malin e Zi, në lindje me Bashkinë Tropojë, në jug me Bashkinë Vau i Dejës dhe një pjesë e saj me Bashkinë Lezhë. Qendra e bashkise: qyteti Shkodër.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, Bashkia e Shkodrës ka 135,612 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrat Civil, kjo bashki ka 200,889 banorë. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 872.71 km² me një densitet prej 230.18 banorë/km² sipas Regjistrat Civil dhe 155.39 banorë/km² sipas Censurit 2011.

Bashkia e re e Shkodrës kanë përbërjen e saj edhe 10 njësi administrative, të cilat janë: Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi, Postribë, Pult, Rrethinat, Shalë, Shosh dhe Velipojë. Ajo ka nën administrimin e saj një qytet dhe 93 fshatra (shih tabelen)

Profili i Bashkisë

Brenda një hapësire prej 100 km, rajoni paraqet kushte optimale natyrore për turizëm bregdetar dhe liqenor (Velipoja dhe liqeni i Shkodrës); turizëm malor (Thethi); turizëm kulturor (qyteti i Shkodrës dhe kështjella e Rozafës) si dhe agro-turizëm.

Burimet natyrore, afërsia e kësaj zone me Malin e Zi dhe lidhjet tradicionale me bashkësinë matanë kufirit përbëjnë një mjet tjetër të rëndësishëm për zhvillimin social dhe ekonomik të Shkodrës. Bashkia e Shkodrës gjatë viteve të fundit ka pasur një zhvillim të konsiderueshëm në infrastrukturë, por edhe në investime madhore siç janë Ura e Bunës, pika kufitare e Muriqanit, autostrada Shkodër- Hani i Hotit, përfundimi i unazës së qytetit apo ndërtimi i pedonaleve. Megjithatë, mospërfundimi i Bypass- it po e dëmton jo pak liqenin e Shkodrës. Permbytjet janë një problem i vazhdueshëm. Heqja e Shkodrës nga harta e përmytjeve kërkon ndërhyrje të kushtueshme në shtretërit e lumenjve Bunë, Drin dhe Kir. Bashkia e re do të duhet të zgjidhë paralelisht edhe çështjen e depozitimit të mbetjeve urbane.



Sfidat e pushtetit vendor pas ndarjes së re

Shërbimet sociale në bashkinë e re janë të lidhura aktualisht vetëm me shpërndarjen e ndihmës ekonomike për familjet e varfra. Shërbimet e tjera sociale mbeten të mangëta. Në të gjithë bashkinë e re ekziston vetëm një qendër rezidenciale për të moshuarit, ku trajtohen njëkohësisht edhe njerëzit me aftësi të kufizuara. Gjatë viteve të fundit, në qytetin e Shkodrës ka pasur hov biznesi fason, i cili ka ndikuar në zbutjen e papunësisë. Papunësisë megjithatë në Shkodër është e lartë.

Duk u shtrire në një terren shumë të larmishëm, caktimi i bazes ekonomike të teksueshme dhe vjelja e taksave/tarifave është një sfidë. Në qytet, shumica e banorëve nuk paguajnë taksën e pastrim-gjelbërimit. Nderkohe, pritjet për keqesimi i situatës me marrjen nën administrim të shumë fshatrave. Barra e gjetjes se të ardhurave të mjaftueshme për skemen e perkrahjes sociale mund të shkarkohet mbi popullatën urbane dhe kjo mund të shkaktojë pakenaqesi dhe pabarazi në ofrim shërbimesh

Për shkak të bllokimit nga dëbora, zona e thelle e Thethit qëndron i izoluar përgjatë 7-8 muajve të vitit. Infrastruktura nderlidhese dhe ofrimi në kohë i shërbimeve (dhe ato sociale) është një sfidë. Rivitalizimi i shërbimeve sociale mbetet një çështje emergjente. Në vëmendjen e bashkisë së re duhet të jetë gjithashtu krijimi i qendrave për rininë dhe kujdesi social për moshën e tretë.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Në total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Shkodër për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është “28”, (Shih Listën më poshtë). Raporti gjinor është 13 femra dhe 15 meshkuj. Sa i takon shkollimit, 18 punonjës janë me arsim të lartë (shumica universitar) dhe 10 punonjës janë me arsim të mesëm. Në varësi të politikave që do të ndjekë MMSR, sugjerohet që bashkia Shkodër të punojë më shumë për ngritjen e nivelit arsimor të ketyre stafeve përmes kualifikimit të posaçëm ose përmes rekrutimit të burimeve njerëzore me arsimin të përshtatshëm. Vetëm 8 punonjës gëzojnë statusin e nëpunësit

civil; 5 punonjës janë të punësuar me kontratë pune me afat, 12 punonjës janë me kontratë pune “pa afat”, për 3 punonjës nuk ka informacion.

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë së re Shkodër duhet të jenë 3 punonjës që ushtrojnë *njëkohësisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas percaktimeve të ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP konfirmoi nominalisht vetëm 1 prej tyre (*me ngyre portokalli*). Nuk konfirmohet emri (jo funksioni) i 2 punonjësi të NJMF në Bashkinë Shkodër (qendër) dhe NJA Ana e Malit (me blu).

Bashkia Shkodër

Nr	Emri Mbiemri	Pozicioni i punes	Sektori	Data e fillimit	Lloji i kontrates se punes	Arsimi Kualifikimi	Pervoje Pune	Kategori te mbrojtura
1		Drejtor	Ndihma ekonomike		Nepunes civil	I larte ekonomik	25	
2		Pergjegjes	Ndihma ekonomike		Nepunes civil	I larte ekonomik	3	
3		Specialiste	Ndihma ekonomike		Nepunes civil	I larte ekonomik	25	
4		Administrator	Ndihma ekonomike		Kontrate	I mesem		
5		Administrator	Ndihma ekonomike		Kontrate	I mesem		
6		Administrator	Ndihma ekonomike		Nepunes civil	I larte Mesuesi	25	
7		Administrator	Ndihma ekonomike		Nepunes civil	I larte Mesuesi	25	
8		Administrator	Ndihma ekonomike		Nepunes civil	I larte ekonomik	18	
9		Administrator	Ndihma ekonomike		Kontrate	I mesem		
Njesia administrative Ana e Malit								
10		Inspektor perkujdesje sociale	Ndihma ekonomike	01.07.2011	Kontrate pa afat	I larte ekonomi biznes	4	
Njesia administrative Dajç								
11		Pergjegjes ndihmes ekonomike		2009	Kontrate pa afat	I larte, Administrim-Biznesi	6	
12		Pergjegjes qendra komunitare		2011	Kontrate pa afat	I larte, Finance-kontabilitet	3	

Njesia administrative Velipoje

13		Pergjegjese perkr ekonomike	Ndihma ekonomike	2012	Nepunes civil	I larte ekonomik	3	
----	--	-----------------------------	------------------	------	---------------	------------------	---	--

Njesia administrative Postribe

14		Specialiste i larte Pergjegjes	Zyra ndihmes ekonomike	2004	kontrate pa afat	I larte Histori Gjeografi	11	
15		Specialist Ndhme ekonomike	Zyra ndihmes ekonomike	1993	kontrate pa afat	I larte,Finance Kontabilitet	22	

Njesia administrative Shale

16		Pergj I Zyres Ndhmes Ekonomike	Zyra Ndhmes Ekonomike	2011	Kontrate me afat	I mesem I Pergjithshem	2	
17		Administrator I Paaftesise	zyra e ndihmes ekonomike	2011	Kontrate me afat	I mesem I Pergjithshem	4	

Njesia administrative Pult

18		P. Ndhmes Ekonomike	Ndihma ekonomike	2000	Pa afat	I mesem Ekonomik	15	
19		Inspektor nd.ekonomike	Ndihma ekonomike	2008	Pa afat	I mesem Ekonomik	7	

Njesia administrative Shosh

20		Administrators ndihma ekonomike	Ndihma ekonomike			I mesem		
----	--	---------------------------------	------------------	--	--	---------	--	--

Njesia administrative Gur I Zi

21		Pergj Zyres Ndhmes Ekonomike	Zyra e ndihmes ekonomike	2,011	Pa kontrate	I larte Matematike	4	
22		Inspektore	Zyra e ndihmes ekonomike	2,013	Pa kontrate	I larte cikël parashkollor	2	

Njesia administraive Rrethina

23		Pergjegjese	Spektori i Sherbimeve Sociale	14.06.2013	Kontrate pa afat	I larte, Drejtesi dhe Shkenca Sociale	2	
24		Inspektor i NE	Spektori i Sherbimeve Sociale	03.04.2007	Kontrate pa afat	I mesem	8	
25		Inspektor i NE	Spektori i Sherbimeve Sociale	01.08.2011	Kontrate pa afat	I mesem	4	
26		Inspektori i PAK	Spektori i Sherbimeve Sociale	01.10.1992	Kontrate pa afat	I larte, Ekonomik	23	Po
27		Punonjese sociale	Spektori i Sherbimeve Sociale	01.01.2012	Kontrate pa afat	I larte, Psikologji	3	

Njesia administrative Berdice

28		P/Ndhmes ekonomike	ndihma ekonomike	2013	Nenpunes Civil	I larte,ekonomik	5	
----	--	--------------------	------------------	------	----------------	------------------	---	--

Bashkia Shkoder, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrative Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrativ e përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Shkodër	Qyteti Shkodër	Shkodër	Qyteti Shkodër	135,612	200,889	872.71
		Ana e Malit	Fshatrat; Oblikë, Babot, Muriqan, Shtuf, Dramosh, Oblikë e sipërme, Obot, Vallas, Velinaj, Vidhgar			
		Bërdicë	Fshatrat; Bërdice e Madhe, Bërdice e mesme, Bërdice e sipërme, Trush, Beltoje, Mali Hebaj			
		Dajç	Fshatrat; Dajç, Samrisht i Ri, Samrisht i Sipërm, Belaj, Mali i Gjymtit, Pentar, Rrushkull, Mushan, Darragjat, Suka-Dajç, Shirq			
		Guri i Zi	Fshatrat; Guri i Zi, Juban, Ganjollë, Kuç, Rrencë, Vukatanë, Gajtan, Rragam, Sheldi, Mazrek, Shpor			
		Postribë	Fshatrat; Mes, Dragoç, Boks, Kullaj, Myselim, Drisht, Ura e shtrenjtë, Domen, Shakotë, Prekal, Vilëz			
		Pult	Fshatrat; Pog, Kir, Gjuraj, Plan, Xhan, Bruçaj, Mgull			
		Rrethinat	Fshatrat; Dobraç, Grudë e Re, Shtoj i Ri, Guci e Re, Shtoj i vjeter, Zues, Golem, Hot i Ri, Bleran, Bardhaj			
		Shalë	Fshatrat; Breg-Lumi, Abat, Nicaj-Shale, Lekaj, Vuksanaj, Pecaj, Theth, Nderlysaj, Gimaj, Nënnavriq, Lotaj			
		Shosh	Fshatrat; Ndrejaj, Nikaj-Shosh, Palaj, Pepsumaj, Brashtë			
		Velipojë	Fshatrat; Velipojë, Pulaj, Luarzë, Baks-Rrjoll, Gomsiqe, Baks i ri, Pulaj, Reç i Ri, Ças, Mali Kolaj			

Bashkia e re Rrogozhinë

Të dhëna të përgjithshme

Zona Gjeografike: Rrogozhina kufizohet në veri me bashkinë Kavajë, në veri-lindje me bashkinë Tiranë, në jug me bashkinë Lushnje, në lindje me Bashkinë Peqin dhe në perëndim me detin Adriatik. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Rrogozhinës.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia e re numëron 22,148 banorë, ndërsa sipas Regjistrit Civil ajo numëron një popullsi prej 40,684 banorë. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 223.5 km². Sipas regjistrit civil, densiteti i popullsisë është 182 banorë/km², ndërsa sipas censurit, densiteti është 99 banorë/km².

Kjo bashki ka ne perberje edhe 4 njësi administrative, të cilat janë: Kryevidh, Sinaballaj, Lekaj dhe Gosë. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Kavajës dhe qarkut të Tiranës. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 36 fshatra. (listën e plotë me poshte)

Profili i bashkisë

Bashkia e re e Rrogozhinës shtrihet në një terren pjesërisht kodrinor dhe pjesërisht fushor deri në bregun e detit. Bashkia e re do të ketë për qendër qytetin e Rrogozhinës, i cili u krijua në kohën e komunizmit përreth agroindutrisë. Kjo industri tashmë është mbyllur. Njësitë administrative rurale përbërëse të bashkisë së re kanë lidhje të kufizuara me qendrën e saj. Qyteti i Rrogozhinës zë rreth një të tretën e të gjithë popullsisë banuese të bashkisë së re. Dy NJA bregdetare, Gosa dhe Kryevidhi, kanë mundësi të zhvillojnë turizmin por aktualisht infrastruktura e disponueshme rrugore drejt bregdetit është shumë e kufizuar, ndërsa infrastruktura e nevojshme për furnizim me ujë apo kanalizime është inekzistente.

Bashkia e re do të përfshijë edhe zona të rëndësishme bujqësore, të cilat kanë nevojë për mirëmbajtje të infrastrukturës rurale, sidomos lidhur me sistemet vaditëse dhe kanalet kulluese.



Aktualisht bashkia me reformën territoriale përfshin 20 kilometër vijë bregdetare, e cila deri tani ka qenë e pashfrytëzuar. Hartimi i planeve të duhura zhvillimore, të shoqëruara me investimet e përshtatshme për rrugë, kanalizime, ndriçim dhe ujë të pijshëm ofron një mundësi për rritjen e të ardhurave të bashkisë së re, por është edhe një sfidë për shkak se burimet aktuale buxhetore të Rrogozhinës janë shumë të kufizuara.

Sfidat e pushtetit vendor pas ndarjes së re

Kjo bashki është pjesë e qarkut Tiranë por nuk e ka ndihmuar shumë për shkak të largësisë që ka me qendrën e Qarkut. Nuk ka asnjë shkollë profesionale dhe mundësia e vetme është vetëpunësimi ose burgu i Rrogozhinës që duket si i vetmi "aset" për këtë bashki. Ndihma ekonomike është burim i vetëm të ardhurash për shumë familje ne nevojë. Ketu jeton edhe një komunitet rom, ne kushte të vështira jetese.

Levrimi i ndihmes e ekonomike në zonat rurale është një sfidë dhe ekrkon perlogartje të reja, në kushtet e percaktimit të bazës së taksueshme në fshat. Formalizimi i fermereve është gjithashtu një sfidë për mbledhjen e tarifave.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Ne total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Rogozhinë për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është gjashtë “6”, (Shih Listen). Raporti gjinor në njësitë administrative perberese është i barabarte (mungojne te dhenat nominale per admisnitraten e bashkise). Sa i takon shkollimit, nga te dhenat qe disponohen, dy rezultojne me arsim te loarte, e dy me arsim te mesem. Nje (1) gezon statusin e nepunesit civil.

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë së re Rogozhinë duhet të jenë 4 punonjës që ushtrojnë *njëkohësisht*

dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas përcaktimeve të ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP konfirmoi nominalisht vetëm 3 prej tyre (*me ngyre portokalli*). Nuk konfirmohet emri (jo funksioni) i 1 punonjësi të NJMF në Bashkinë Rogozhinë qendër (me blu). Rekomandohet përcaktimi eksplicit i të paktën një pozicioni për NJMF në strukturën organizative të bashkisë së re Rogozhinë për vitin 2016.

Bashkia Rrogozhine								
Nr	Emër Mbiemër	Pozicioni i punës	Sektori	Data e fillimit	Lloji i Kontratës së punës	Edukimi/ Kualifikimi	Eksperienca e punës në njësi	
1		Punonies Ndhme ekonomike						
2		Punonjes I PAK +arke						
Njesia administrative Sinaballaj								
3		Ndihma Ekonomike				I mesem		Rap.mjek p.pun
Njesia administrative Gose								
4		P.Z.B Njerz+Adm Soc	Sek. Burim.Njerzore	01.07.2011	Nenpunes Civil	E larte Ekonomik	4 Vjet	
Njesia administrative Kryevidh								
5		Administrator	Administrator	01.01.2004	Kontrate pa afat	Diplome Universiteti Agronomi	10	
Njesia administrative Lekaj								
6		P/Z Perkrabhjes sociale	Sektori Finances	2011	Kontrate pa afat	Diplome Universiteti ne Ekonomik	4	

Bashkia Rrogozhine, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrative Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrativ e përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Tiranë	Qyteti Rrogozhinë	Rrogozhinë	Qyteti Rrogozhinë, Fshati; Rrogozhinë	22,148	40,684	223.5
		Kryevindh	Fshatrat; Kryevindh, Ballaj, Rreth-Greth, Patkë-Milot, Zhabjak, Spanesh, Spille, Domën, Stërbeg, Shardushk, Kazie			
		Sinaballaj	Fshatrat; Sinaballaj, Methasanaj, Hazdushk, Hamenraj, Koçaj- Sheshaj, Thartor, Rrostej, Fliballije, Demarkaj			
		Lekaj	Fshatrat; Lekaj, Harizaj, German, Zambish, Mushnik, Mlik, Okshtun, Luz i madh, Shkozet , Kryeluzaj			
		Gosë	Fshatrat; Gosë e Madhe, Gosë e Vogel, Kalush, Kërçukaj, Vilë- Ballaj			

Bashkia e re Sarandë

Të dhëna të përgjithshme

Zona Gjeografike: Bashkia e re Sarandë kufizohet në veri me bashkitë Himarë dhe Delvinë, në jug me bashkinë Konispol, në lindje me bashkinë Finiq dhe në perëndim me detin Jon.

Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Sarandës. Bashkia e re Sarandë ka nën varesin njësinë administrative Ksamil.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011 bashkia e re e Sarandës ka një popullsi prej 20,227 banorësh ndërsa në regjistrin civil rezultojnë si popullsi banuese 50,680 banorë. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 58.96 km². Sipas censurit, densiteti i popullsisë në bashkinë e re është 343 banorë/km² ndërsa sipas regjistrit civil, popullsia është 859.56 banorë/km². Bashkia e re është pothuajse tërësisht urbane me përjashtim të fshatrave Shelegar dhe Çukë, ku fshati Çukë është praktikisht zonë e urbanizuar pavarësisht denominimit zyrtar (Shih listën e plotë me poshte)

Profili i bashkisë

Bashkia e re Sarandë përbëhet tërësisht nga vija bregdetare nga Koka e Qefalit në veri deri te Kanali i Vivarit në jug, ku shërbimet e turizmit detar dhe kulturor përbëjnë burimin kryesor të të ardhurave. Fshati i Çukës, i cili u shkëput nga Saranda në vitin 1996 për të kaluar në varësi të ish-komunës Aliko, u rikthye me reformën aktuale në varësi të Sarandës. Asetet kryesore ekonomike të qytetit janë deti, peshkimi, liqeni i Butrintit dhe pasuritë e stërmëdha arkeologjike, parku arkeologjik i Butrintit dhe objekte të tjera të rëndësishme si Manastiri i 40 Shenjtorëve, Kalaja e Lëkurësit, Manastiri i Shën Gjergjit, rrënojat e kalasë së qytetit etj. Në territorin e kësaj bashkie gjenden 118 objekte të regjistruara si monumente kulture të kategorisë së parë.

Saranda dhe Ksamili janë përfshirë nga një bum ndërtimi në shumicën e rasteve pa leje, të cilat kanë shkatërruar një pjesë të madhe të potencialit turistik të qytetit. Furnizimi me ujë është një



problem permanent dhe qyteti ka krijuar një sistem privat dhe të kushtueshëm të furnizimit me autobote. Bashkia e re do të ketë në territor të saj edhe liqenin e Butrintit, i cili është një qendër e rëndësishme e prodhimit të midhjeve dhe për peshkimin në pikën e lidhjes me detin.

Ndërtimet pa leje si dhe infrastruktura bazë, përfshirë ujin e pijshëm, largimin e ujërave të zeza, menaxhimi i plazheve publike dhe plazheve që aktualisht shfrytëzohen privatisht, rrugët lidhëse me plazhet si dhe menaxhimi i mbetjeve duan zgjidhe urgjente.

Sfidat e pushtetit vendor pas ndarjes së re

Bashkia e re Sarandë aktualisht është e avantazhuar nga zhvillimi i turizmit dhe industrisë së ndërtimeve. Problem i varfërisë ekziston por jo aq i mprehtë sa në bashki të tjera. Ndiha ekonomike e bashkisë është një burim të ardhurash për një pjesë të familjeve (kryesisht të moshuar). Qyteti ka një jetimore, nga e cila shpesh janë raportuar problem lidhur me trajtimin e fëmijëve si dhe me garantimin e të drejtave të tyre. Emigracioni drejt Greqisë është shumë i shprehur, ndërkohë që edhe migrimi drejt Tiranës është një fenomen konstant. Popullsia ka pësuar ndryshime substanciale në terma demografikë dhe paraqitet më homogjene.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Ne total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Sarandë për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është “ 4”, (Shih Listen). Raporti gjinor është 3 me 1. në favor të femrave . Te gjithë jane me arsim te larte, një tregues ky që e pozicionon mire personelin bashkise se re Sarande . Tre (3) nga 4 punonjes ne kete sektor kanë statusin e nepunesit civil;.

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë e re Sarandë duhet të jenë 3 punonjës që ushtrojnë *njëkohësisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas percaktimeve te ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP konfirmoi nominalisht të tre punonjësit (*me portokalli*). Ka madje edhe përcaktim eksplicit të një pozicioni për NJMF në strukturën e bashkisë Sarandë për 2015-ën, (ngjyrë jeshile në tabelë).

Bashkia Sarande								
Nr	Emër Mbiemër	Pozicioni i punës	Sektori	Data e fillimit	Lloji i Kontratës së punës	Edukimi/ Kualifikimi	Eksperienca e punës në njësi	Kategori të mbrojtura me ligj
1		Specialiste per ndihmen ekonomike	Nd. Ekonom.	31,03,2009	Nepunes Civil	I larte, Ekonomik	6 vjet(2009-2015)	
2		Specialiste per ndihmen ekonomike	Nd. Ekonom.	27,07,2007	Nepunes Civil	I larte,Ekonomik	8 vjet(2007-2015)	
3		Specialist per mbrojtjen e te drejtave te grave dhe femijeve	Nd. Ekonom.	03,09,2007	Kod. Pune	I larte,	8 vjet(2007-2015)	
Njesia administrative Ksamil								
4		administrator I ndihmes eko	Nd. Ekonom	01.01.1997	Nëpunës civil	instituti I larte bujqesor ekonomist	16vjet(1997-2015)	

Bashkia Sarandë, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrativo-Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative e përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Vlorë	Qyteti Sarandë	Sarandë	Qyteti Sarandë, Fshatrat; Gjashtë, Metoq, Çukë, Shelegar	20,227	50680	58.96
		Ksamil	Fshatrat; Ksamil			

Bashkia e re Selenicë

Të dhëna të përgjithshme

Zona Gjeografike: Bashkia e Selenicës kufizohet në veri me bashkinë Fier, në lindje me bashkinë Mallakastër, Tepelenë dhe Memaliaj, në jug me bashkinë Himarë dhe perëndim me bashkinë Vlorë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Selenicës.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, zona e bashkisë së re Selenicë ka një popullsi prej 18.476 banorësh ndërsa në Regjistrin Civil rezulton me 35.793 banorë. Dallimi i madh mes shifrave të regjistrit civil dhe të censurit flet për një shkallë të lartë emigrimi. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 561.24 km². Sipas të dhënave të censurit, bashkia e re ka një densitet prej 32.9 banorësh për kilometër katror ndërsa sipas regjistrit civil, densiteti është 63.77 banorë/km².

Kjo bashki ka edhe 5 njësi administrative: Armen, Vllahinë, Kotë, Sevastër dhe Brataj. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e qarkut të Vlorës. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 47 fshatra (shih tabelen)

Profili i bashkisë

Bashkia e re e Selenicës shtrihet në një zonë kodrinore në bregun e majtë të lumit Vjosa si dhe përgjatë lumit Shushicë, i cili është tributar i Vjosës. Bashkia e re ka në territorin e saj minierën historike të bitumit në Selenicë, ku punësohen edhe banorët e fshatrave përreth, si dhe zonën naftëmbajtëse të Vllahinës ku nafta është drejt shterimit duke lënë pas një zonë të ndotur.

Bashkia e re përbëhet nga disa ish-komuna të cilat nuk kanë lidhje organike me qytetin e Selenicës, si dhe nuk kanë lidhje të drejtpërdrejta rrugore me këtë qytet, duke vështirësuar në këtë mënyrë komunikimin mes tyre.

Bujqësia dhe blegtoria është aktiviteti kryesor ekonomik i bashkisë së re. Remitancat nga emigracioni ajne gjithashtu burim paresor.



Rehabilitimi i territorit të ndotur nga nafta dhe nga gazi është një proces i kushtueshëm që sugjerohet se duhet të kryhet nga pronari i këtyre puseve, kompania shtetërore e naftës Albpetrol.

Si zonë kodrinore me klimë të butë, Selenica dhe komunat përbërëse janë zonë e përshtatshme për zhvillimin e drurëve frutorë, ndërsa Lumi Vjosë mund të përdoret për turizmin e aventurës.

Sfidat e pushtetit vendor pas ndarjes së re

Ndihma ekonomike është e rëndësishme për një numër të madh familjesh. Zhvillimi i infrastrukturës ndërlidhëse të NJA përbërëse me qytetin e Selenicës, është një prioritet. Zhvillimi i bujqësisë dhe blegtorisë identifikohen si sfidat kryesore të bashkisë së re për të përmirësuar nivelin ekonomik të banorëve dhe për të gjeneruar të ardhura.

Ndotja mjedisore në zonën e Vllahinës e shkaktuar nga industria e naftës, kërkon gjithashtu ndërhyrje, pasi ka ndikuar negativisht në shëndetin e popullatës dhe në uljen e cilësisë së prodhimeve bujqësore dhe blegtorale.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Ne total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Selenice për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është “ 7 ”, (Shih Listen). Raporti gjinor është 4 me 3 ne favor te meshkujve. Sa i takon shkollimit, 4 nga 7 jane me arsim te larte (shumica universitar). Vetem 1 nga 7 punonjes ne kete sektor ka statusin e nepunesit civil; pjesa tjetër janë me “kontratë pune”.

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë së re Selenice duhet të jenë 7 punonjës që ushtrojnë *njëkohësisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas percaktimeve te ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP konfirmoi nominalisht vetëm 5 prej tyre (*me ngyre portokalli*). Nuk konfirmohet emri (jo funksioni) i 2 punonjësi të NJMF në NJA Armen dhe Vllahine (me blu).

Bashkia Selenice								
Nr	Emër Mbiemër	Pozicioni i punës	Sektori	Data e fillimit	Lloji i Kontratës së punës	Edukimi/ Kualifikimi	Eksperienca e punës në njësi	Kategori të mbrojtura me ligj
1		insp.ndihmes dhe barazise gjinore	Financa	01.05.2007	statusi NC	diplome universiteti per menaxhim biznes	8 vjet (2007-2015)	
Njesia administrative Brataj								
2		Inspektor NdiH.Ekonomike	Financa	2007	Kod. Pune	Shkollë e mesme për Ekonomik	8 vjet (2007-2015)	
Njesia administrative Kotë								
3		Adm. Shoqërore/ Nj.M.B.Njerëzore	Zyra e Sh.Social	01.08.2007	Kod. Pune	Diplomë Universiteti në Agronomi	8 vjet (2007-2015)	Invalid pune
Njesia administrative Sevaster								
4		Specialiat NdiH. Ekonomike	Financa	01.08.2013	Kod. Pune	Shkollë e mesme Bujqësore	2 vjet (2013-2015)	
Njesia administrative Armen								
5		Inspektor	Zyra e Sh.Social	16.03.2006	Kod. Pune	Diplomë Universiteti në Ing.Topograf	9 vjet (2006-2015)	
6		Administrator I Nd.sociale	Shërbime Mbështetëse	03.12.2003	Kod. Pune	shkollë e mesme e përgjithshme	12 vjet (2003-2015)	
Njesia administrative Vllahine								
7		Administrator Shoqëror		10.07.1998	Kod. Pune	Diplomë Universiteti në Ekonomik/Plan	17 vjet (1998-2015)	

Bashkia Selenicë, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrativo-Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Vlorë	Qyteti Selenicë	Selenicë	Qyteti Selenicë	18,476	35,793	561.24
		Armen	Fshatrat; Armen, Karbunarë, Rromës, Treblovë, Lubonjë, Picar, Mesarak			
		Vllahinë	Fshatrat; Vllahinë, Kocul, Mërtiraj, Rexhepaj, Hadëraj, Mallkeq, Gërnec, Petë, Kropisht, Vezhdanisht, Peshkëpi, Penkovë			
		Kotë	Fshatrat; Kotë, Gumenicë, Hysoverdhë, Lapardha, Mavrovë, Mazhar, Vajzë, Vodicë, Shkallë Mavrovë, Drashovicë			
		Sevaster	Fshatrat; Sevaster, Golimbash, Dushkarak, Shkozë, Mazhar, Ploçë, Lezhan, Amonicë			
		Brataj	Fshatrat; Brataj, Lepenicë, Gjorm, Velçë, Ramicë, Mesaplik, Matogjin, Bashaj, Vërmik, Malas			

Bashkia e re Shijak

Të dhëna të përgjithshme

Zona Gjeografike: Shijaku kufizohet në veri, perëndim dhe jug nga bashkia Durrës dhe në lindje nga bashkitë Vorë dhe Tiranë. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Shijakut.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011 numëron një popullsi prej 27,861 banorësh, ndërkohë që sipas Regjistrat Civil kjo bashki numëron 44,103 banorë. Me sipërfaqe prej 92.19 km², ajo ka densitet prej 302 banorë/km² sipas censurit dhe 478 banorë/km² sipas regjistrat civil.

Bashkia e re Shijak ka edhe tre njësi administrative në perberje, të cilat janë Maminasi, Xhafzotaj dhe Gjepalaj. Të gjitha janë pjesë e Qarkut Durrës. Bashkia e re ka një qytet dhe 25 fshatra.

Profili Bashkisë

Bashkia e re Shijak shtrihet në një zonë fushore dhe kodrinore përgjatë lumit Erzen. Shijaku është një qytet i pasur me burime ujore, Ekonomia në vend është e orientuar kryesisht te tregtia, industria fashone dhe ajo përpunuese e prodhuese. Firmat private numërohen 263 subjekte nga të cilat 17 klasifikohen si biznes i madh dhe 246 si biznes i vogël. Këto biznese operojnë kryesisht në fushën e shërbimeve, prodhimit dhe ndërtimit.

Bujqësia është orientuar drejt kultivimit të perimeve, foragjereve, dhe pemëtarisë. Por një pjesë e tokës bujqësore ka mbetur e papunuar ndërsa shumë toka janë të rrezikuara nga lumi Erzen

Furnizimi me ujë të pijshëm i komunitetit mbetet problem. Furnizimin me ujë të pijshëm në disa fshatra bëhet me burime natyrore (puse). Po kështu dhe kanalizimi i ujërave të zeza dhe të bardha është një tjetër problem i mbartur prej vitesh.

Mënyra më e përhapur për sistemimin e ujërave të zeza në fshatra është ajo me gropa septike individuale, mosfunksionimi i të cilave shpesh sjell rrjedhjen e tyre duke shkaktuar probleme me mjedisin. Po kështu, drejtuesit e rijë duhet të mendojnë për

hartimin e projekteve për vaditjen e tokave bujqësore të fshatrave të zonës, ku thatësira shkatërron pjesën më të madhe të prodhimit të banorëve. Përpunimi i mbeturinave është një tjetër shqetësim që përballen banorët e zonës.



Sfidat e pushtetit vendor pas ndarjes së re

Infrastruktura rrugore që lidh fshatrat me qytetin është pothuajse e stabilizuar. Kjo ndihmon ndërvëprimin e bashkisë me njësitë administrative dhe fshatrat nën juridiksionin e tyre.

Shijaku është një zonë që ka patur rritje të popullsisë gjatë dekadave të fundit si pasojë e migrimit nga zonat veri-lindore të Shqipërisë. Duke parë ndryshimin e madh midis popullsisë rezidente dhe asaj prezente në regjistrat civilë vihet re se, zona është e prekur ndjeshëm nga emigracioni. Remitancat e emigrantëve kanë luajtur një rol të madh në zhvillimin e zonës, kryesisht në Shijak dhe Xhafzotaj.

Hartimi i një plani të detajuar të taksimit në qytet dhe në fshat dhe përdorim i mirë i të ardhurave mund të lehtësojë përdorimin e mekanizmit të ndihmës ekonomike në nivel vendor.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Ne total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është Shijak është “7”, (Shih Listen). Raporti gjinor është 7 me 0, në favor të femrave. Sa i takon shkollimit, te gjitha jane me arsim te larte (shumica universitar). Te dy keta tregues e pozicionojne mire bashkine e re Shijak. Jane vetem 3 nga 7 punonjes gezojne statusin e nepunesit civil; Dy punonjës janë me kontrate pune me afat; për dy punonjës të tjerë nuk ka informacion.

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë së re Shijak duhet të jenë 5 punonjës që ushtrojnë *njëkohësisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas percaktimeve te ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP i konfirmoi nominalisht te 5 punonjësit e sipërcituar (*me ngyre portokalli*). Rekomandohet përcaktimi eksplicit i të paktën një pozicioni për NJMF në strukturën organizative të bashkisë së re Shijak për vitin 2016.

Bashkia Shijak								
Nr	Emër Mbiemër	Pozicioni i punës	Sektori	Data e fillimit	Lloji i Kontratës së punës	Edukimi/ Kualifikimi	Eksperienc a e punës në njësi	Kategori të mbrojtura me ligj
1		Administratore	Ndihma Ekonomike	03.04.2013	Nepunes Civil	Mesuesi	2 vjet e 1 muaj	
2		Inspektore	Ndihma Ekonomike	18.06.2014	Kontrate me afat	Mesuesi	10 muaj	
Njesia administrative Maminas								
3		Administratore ndihmes ekonomike		01.01.2008	Kontrate me afat	Agronomi e pergjithshme	7 vjet	
Njesia administrative Gjepalaj								
4		Specialist i Ndhmes Ekonomike	Sektori ndihmes ekonomike	2008	Nepunes Civil	Diplome Universitare ne Shkenca Sociale	7 vjet	
Njesia administrative Xhafzotaj								
5		P/sektori	Ndih.ekonomike	01.10.1992	nenpunes civil	Ekonomik Plan	23	
6		Inspketore	" "	25.04.2013	" "	Administrim Biznes	2	
7		In.Barazi/gjinore	" "	01.07.2013	" "	Cikli I Ulet	1	

Bashkia Shijak, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrativo-Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësiti administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Durrës	Qyteti Shijak	Shijak	Qyteti Shijak	34,513	44,103	92.19
		Maminas	Fshatrat; Maminas, Karreç, Vlashaj, Karpen, Bodinak, Metallë, Bilalas, Rubjek			
		Xhafzotaj	Fshatrat; Xhafzotaj, Pjezë, Rreth, Sallmone, Koxhas, Borake, Guzaj, Vllazërimi			
		Gjepalaj	Fshatrat; Gjepalaj, Hardhishtë, Çizmeli, Eminas i Vogël, Likesh, Kënetë, Shtrazë, Shahinaj, Shetël			

Bashkia e re Skrapar

Të dhëna të përgjithshme

Zona Gjeografike: Skrapari kufizohet në veri me bashkinë Gramsh, në perëndim me bashkitë Berat dhe Poliçan, në jug-perëndim me bashkinë Këlcyrë, në jug me bashkinë Përmet dhe në lindje me bashkitë Maliq e Korçë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Çorovodës.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, kjo bashki numëron 12,403 banorë, ndërsa sipas Regjistrit Civil ajo numëron një popullsi prej 19,072 banorë. Bashkia e re ka një sipërfaqe të konsiderueshme prej 831.44 km². Sipas censurit, densiteti i popullsisë është 15 banorë/km² ndërsa sipas regjistrit civil densiteti është 22.93 banorë/km².

Kjo bashki përbëhet nga 8 njësi administrative, të cilat janë: Çorovodë, Qendër Skrapar, Bogovë, Vëndreshë, Çepan, Potom, Leshnje, Gjerbës dhe Zhepë. Të gjitha njësitë administrative janë pjesë e qarkut Berat. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 106 fshatra (me poshte shih listën e plotë)

Profili i bashkisë

Bashkia e re e Skraparit ka një reliev të thyer malor, territor shumë të gjerë dhe popullsi të ulët. Popullsia e zonës është pakësuar ndjeshëm gjatë dekadës së fundit nga largimet e banorëve drejt qyteteve të mëdha dhe/ose emigrim. Vetë qyteti i Çorovodës humbi mbi 40 për qind të popullsisë mes viteve 2001 dhe 2011, ndërsa shumë nga komunat përbërëse kanë humbur mbi gjysmën e popullsisë.

Mungesa e perspektivës, kryesisht ajo e vendeve të punës, ka bërë që banorët e qytetit të vendosen për një të ardhme më të mirë për fëmijët e tyre drejt qyteteve të mëdha, ndërsa banorët e zonave të thella janë larguar drejt qytetit të Çorovodës, si rezultat i mungesës së rrugëve dhe mjekëve në fshatrat e tyre.



Skrapari si burim kryesor ka të ardhurat që vijnë nga blegtoria dhe bujqësia, Vitet e fundit Skraparit i është shtuar shpresa për zhvillimin nëpërmjet turizmit. (Kanionet e Skraparit). Parku Kombëtar i Tomorit, është një tjetër resurs mjaft i rëndësishëm i kësaj zone, ende i pa vënë në shërbim të turizmit malor,

Sfidat e pushtetit vendor pas ndarjes së re

Administrimi i qytetit të Çorovodës me problematikat e veta sociale dhe administrimi i shtatë ish-komunave me një numër të konsiderueshëm fshatrash të shpërndarë në një territor të gjerë me pak toke bujqesore në përdorim do të jetë sfida e parë e kësaj bashkie. Ndihamë ekonomike është burimi i vetëm i të ardhurave për një numër shumë të madh familjesh, të cilat tani pritet të shtohen edhe me shume.

Infrastruktura ndërlidhëse me 7 NJA është mjaft problematike dhe mund të vështirësojë marrjen e shërbimeve nga banorët e zonave të thella, sidomos gjatë periudhës së dimrit kur disa fshatra izoloohen nga bora. Sfidë e bashkisë do të jetë dhe mirëmbajtja e institucioneve shëndetësore dhe arsimore në zonat më të thella të kësaj bashkie. Rikthimi i institucioneve të gjykatës dhe prokurorisë në shërbim të qytetarëve tashmë më të shumta në numër dhe të shpërndarë në zonat më të thella, do të jetë tjetër sfida. Ndihamë ekonomike duhet lehtësuar përmes nxitjes së metejshme të punësimit. De-pupullimi vijon me ritme të larta edhe sot.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Ne total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Skrapar për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është “ 10 ”, (Shih Listen). Raporti gjinor është 6 me 4 në favor të femrave. Sa i takon shkollimit, vetem 3 nga 10 jane me arsim të lartë, ndërsa 7 punonjës të tjerë janë me arsim të mesëm. Asnjë nga punonjësit nuk e gëzon statusin e nëpunësit civil. Janë 9 punonjes (nga 10 gjithsej) që janë me kontratë pune me afat; një punonjës është me kontratë pune “pa afat”.

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë së re Skrapar duhet të jenë 4 punonjës që ushtrojnë *njëkohësisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas percaktimeve të ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP konfirmoi nominalisht vetëm 3 prej tyre (*me ngyre portokalli*). Nuk konfirmohet emri (jo funksioni) i 1 punonjësi në NJA Qendër (me blu). Rekomandohet përcaktimi eksplicit i të paktën një pozicioni për NJMF në strukturën organizative të bashkisë së re Skrapar për vitin 2016.

Bashkia Skrapar								
Nr	Emër Mbiemër	Pozicioni i punës	Sektori	Data e fillimit	Lloji i Kontratës	Edukimi/ Kualifikimi	Eksperienc e pune	Kategori të mbrojtura
ZYRA E NDIHMES EKONOMIKE								
1		Spec. Nd. Ekonomike	Nd ekonomike	08.11.2010	Kontratë pa afat	Mësues Gjeografi	05 vjet	
2		Insp. Nd. Ekonomike	Nd ekonomike	05.06.2014	Kont me afat	I mesëm	10 muaj	
Njesia administrative Qender								
3		Insp.ndi ekonomike	Nd ekonomike	2013	Kontrat me afat	Diplome Universitar ne Agro-Mjedis	2 vjet	
Njesia administrative Bogove								
4		Insp nd ekonomike dhe I tatimeve	Nd ekonomike	2011	Kontrat pa afat	Shkolle e mesme	4 vjet	
Njesia administrative Leshnje								
5		Spec I nd ekonomike	Nd Ekonomike	27.03.2007	Kontrate me afat	Shkolle e mesme	8 vjet	
Njesia administrative Potom								
6		Insp. I nd ekonomike	Nd ekonomike	2002	Kontrate me afat	DiplomeUniversiteti ne Zooteknike	13 vjet	
Njesia administrative Çepan								
7		Insp I nd ekonomike	Nd ekonomike	01.05.2007	Kontrate pa afat	Shkolle e mesme	8 vjet	
Njesia administrative Gjerbes								
8		adm. I ndekonomike	Nd. Ekonomike	2011	Kontrat me afat	Shkolla e mesme	4 vjet	
Njesia administrative Vendreshe								
9		Punonjes I nd ekonomike	Nd ekonomike		Kontrate pa afat	Shkolla e mesme		
Njesia administrative Zhepe								
10		Inspektore. Nd ekonomike	Nd ekonomike	2011	Kontrate me afat	Shkolla e mesme	4 vjet	

Bashkia Skrapar, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrativo-Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative e përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Berat	Qyteti Çorovodë	Çorovodë	Qyteti Çorovodë	12,403	19,072	831.44
		Qëndër Skrapar	Fshatrat; Zogas, Kalanjas, Dhores, Vesesh të, Polenë, Osojë, Grepckë, Liqeth, Rehovicë, Orizaj, Cerovë, Veleshnjë, Nishicë, Sharovë, Çerenisht, Buzuq, Munushtir, Radësh, Koritë, Mollas, Gradec, Vërzhezhë, Slatinjë, Storrë			
		Bogovë	Fshatrat; Bogovë, Kakrukë, Dobrushë, Përparim, Bargullas, Novaj, Nishovë, Jaupas, Selan			
		Vëndreshë	Fshatrat; Lavdar, Spatharë, Therepel, Valë, Vëndreshë e Madhe 1, Vëndreshë e Vogël 2, Vëndreshë e Malit 3, Ibro			
		Çepan	Fshatrat; Çepan, Muzhakë, Rog, Zabërzan i Ri, Zabërzan, Blezëncë, Malind, Muzhëncë, Sevan i madh, Sevan i Vogël, Qeshibes, Strënc, Kakos, Prishtë			
		Potom	Fshatrat; Potom, Gjergjovë, Koprëncë, Gërmenj, Visockë, Qafë, Helmës, Backë, Melskë, Nikollarë, Dyrkish, Staraveckë			
		Leshnje	Fshatrat; Turbohovë, Kapinovë, Krastë, Krushovë, Fagëkuq, Gostëncë, Leshnje, Vlushë, Bërsakë			

Bashkia e re Tepelenë

Të dhëna të përgjithshme

Zona Gjeografike: Tepelena kufizohet në veri me bashkinë Memaliaj, në lindje me bashkinë Këlcyrë, në jug me bashkinë Gjirokastrë dhe në perëndim me bashkinë Himarë dhe Selenicë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Tepelenës.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia ka një popullsi prej 8.949 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrat Civil, kjo bashki numëron 16.371 banorë. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 431.24 km² me një densitet prej 37.96 banorë/km².


Bashkia e re ka edhe 3 njësi administrative nën varesi të saj: Qendër Tepelenë, Lopës dhe Kurvelesh. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit Tepelenë dhe e qarkut Gjirokastrë. Bashkia e re ka nën administrim një qytet dhe 24 fshatra (shih listën e plotë)

Profili i bashkisë

Bashkia e Tepelenës zgjerohet me disa zona rurale, të cilat merren kryesisht me blegtori. Qyteti ka një varfëri të skajshme dhe vuan nga niveli i lartë i papunësisë. Shërbimet e vogla tregtare dhe mbledhja e bimëve medicinale sigurojnë pak të ardhura për familjet në qytet, ndërsa të ardhurat nga emigracioni kanë pësuar një ulje të ndjeshme gjatë viteve të fundit.

Një nga projektet më të rëndësishme është ai i qendrës së qytetit të Tepelenës, ku synohet edhe rivitalizimi i kalasë së Ali Pashës në funksion të nxitjes së turizmit. Një projekt tjetër është ai i përmirësimit të rrugëve të brendshme në qytet. Në Tepelenë pritet të nisë edhe projekti për bajpasin e qytetit, që lidh autostradën Levan – Gjirokastrë.

Në zonat rurale, nxitja e agrobiznesit dhe e baxhove të përpunimit të qumështit, e prodhimit të verës apo e produkteve tradicionale shihen si mundësia e vetme e të ardhurave të qendrueshme.



Sfidat e pushtetit vendor pas ndarjes së re

Shumë zona malore të Tepelenës janë zbratur për shkak të lëvizjes së popullsisë kryesisht drejt zonës bregdetare (Ksamil, Sarandë). Niveli i emigrimit në disa prej këtyre fshatrave është gjithashtu i lartë. Kjo ka sjellë zvogëlim të numrit të nxënësve në disa shkolla dhe braktisje të fshatrave nga të rinjtë.

Sfida e parë e bashkisë së re do të jetë harmonizimi i shpërndarjes së fondeve mes qytetit dhe zonave rurale që i bashkohen Tepelenës me ndarjen e re.

Bashkia e re do të duhet të gjejë rrugë të reja si mundësi për punësimin e banorëve të vet si hapja e njësisë të fasonëve apo njësisë të vogla të prodhimeve artizanale.

Njësia e re vendore ka nevojë të avancojë projekte pilot në përmirësimin e mjediseve të shkollave që janë amortizuar, të rregullimit të sistemit të transportit të nxënësve, të trajtimit të atyre shkollave që kanë pak nxënës nga lëvizjet demografike të popullsisë.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Ne total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Tepelenë për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është “5”, (Shih Listen). Raporti gjinor është 4 me 1 në favor të femrave. Sa i takon shkollimit, 3 nga 5 janë me arsim të lartë (shumica universitar). Ndërsa dy punonjës janë me arsim të mesëm. Janë vetëm 2 nga 5 punonjës në këtë sektor që gëzojnë statusin e nepunës civil; pjesa tjetër janë me “kontratë pune” me afat dhe/ose pa afat.

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë së re Tepelenë asnjë punonjës nuk ushtron *njëkohësisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas përcaktimeve të ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP e konfirmoi këtë fakt gjithashtu. Rekomandohet përcaktimi eksplicit i të paktën një pozicioni për NJMF në strukturën organizative të bashkisë së re Tepelenë për vitin 2016 dhe rekrutim stafi me arsim të lartë të përshtatshëm.

Bashkia Tepelene

N r	Emër Mbiemër	Pozicioni i punës	Sektori	Data e fillimit	Lloji i Kontratës së punës	Edukimi/ Kualifikimi	Eksperienc a e punës në njësi	Kategori të mbrojtur a me ligj
1		Shëf sektori	Sektori i Ndhmës Ekonomike	03.10.2011	Statusi i N.C	Punonjës social	4 vjet	
2		Specialist	Sektori i Ndhmës Ekonomike dhe Invaliditetit	20.12.1995	Statusi i N.C	Ekonomist,	20 vjet	
Njesia administrative Kurvelesh								
3		ins.ekon.	Nd.Ekonomike	2011	pa afat	dipl.univ ekonomik	4 vjet	
Njesia administrative Lopen								
4		specialiste	Nd.Ekonomike	2001	Kontrate me afat	Arsim I Mesem	21 vjet	
Njesia administrative Qendër								
5		administrim ndihma sociale	Nd.Ekonomike	2012	pa afat	e mesme ekonomik	3 vjet	

Bashkia Tepelenë, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrativo-Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Gjirokastrë	Qyteti Tepelenë	Tepelenë	Qyteti Tepelenë	8,949	16,371	431.24
		Qendër Tepelenë	Fshatrat; Dukaj, Salari, Turan, Mamaj, Veliqot, Bënçë, Dragot, Beçisht, Mezhgoran, Peshtan, Hormovë, Lekël, Kodër, Luzat			
		Lopës	Fshatrat; Sinanaj, Matohasanaj, Dorëz, Dhëmban, Lab Martall			
		Kurvelesh	Fshatrat; Progonat, Lekdush, Gusmar, Nivicë, Rexhin			

Bashkia e re Tiranë

Të dhëna të përgjithshme

Zona Gjeografike: Bashkia e re e Tiranës kufizohet në veri me bashkitë Vorë, Kamëz dhe Krujë, në verilindje me bashkinë Klos, në lindje me bashkitë Bulqizë dhe Librazhd, në jug me bashkitë Elbasan dhe Peqin dhe në perëndim me bashkitë Rrogozhinë, Kavajë, Durrës dhe Shijak.

Popullsia: Sipas censurit të vitit 2011, në territorin e bashkisë së re Tiranë banojnë 557,422 banorë, ndërsa sipas Regjistrimit Civil banojnë 757,361 banorë. Me një sipërfaqe prej 1,110.03 kilometrash katrorë, densiteti i popullsisë sipas të dhënave të Censurit është 502 banorë/ km² ndërsa sipas Regjistrimit Civil, densiteti është 682 banorë km².

Bashkia Tirane ka edhe 24 njësi administrative të tjera në përbërje: 11 brenda në qytetin e Tiranës dhe 13 NJA në zonën rurale: Petrela, Farka, Dajti, Zall-Bastari, Bërzhita, Krraba, Baldushku, Shëngjergji, Vaqarri, Kashari, Peza, Ndroqi dhe Zall Herri. Të gjitha njësitë e bashkisë së re Tiranë janë pjesë e rrethit Tiranë dhe qarkut Tiranë, me përjashtim të qytetit të Tiranës, i cili historikisht ka qenë rreth më vete. Në territorin e kësaj bashkie ka dy qytete dhe 135 fshatra.

Profili i Bashkisë

Tirana do të jetë bashkia më e madhe në vend si për nga popullsia, ashtu edhe nga territori. Ajo shtrihet në tri zona gjeografike të veçanta; zona bujqësore në veri, perëndim dhe jug, zona urbane e Tiranës dhe e katër komunave rrethuese, pjesërisht të urbanizuara si dhe zona e thyer malore në lindje.

Tirana është një zonë e pasur me burime ujore, pasi përshkohet nga lumenjtë Erzen, Lumi i Tiranës dhe Lumi Tërkuzë. Në territorin e saj ndodhen edhe një numër i konsiderueshëm liqenesh artificiale, të ndërtuara si në zonat malore, ashtu edhe në ultësi. Në territorin e bashkisë së re gjendet edhe Parku Kombëtar i Dajtit.



Qyteti i Tiranës është zemra ekonomike e Shqipërisë, me përqendrimin e numrit më të madh të bizneseve në shkallë vendi si dhe me zhvillimin e industrisë së lehtë. Fuqia ekonomike e Tiranës dallohet te sasia shumë më e lartë e kursimeve dhe e kreditit në rang kombëtar, te të ardhurat tatimore, të cilat në masë dërmuese realizohen në Tiranë si dhe te zhvillimi i sektorit të ndërtimit.

Komuna e Kasharit, e cila përfshihet në territorin e bashkisë së re konsiderohet zona më e industrializuar e vendit, si pasojë e përqendrimit të bizneseve dhe industrisë përgjatë autostradës Tiranë-Durrës.

Tirana rezulton bashkia me normën më të lartë të urbanizimit për kilometër katror, pas bashkisë së Durrësit.

Zonat bujqësore të Tiranës janë përqendruar në shkallë të gjerë te blegtoria dhe prodhimet e qumështit, por edhe tek agroturizmi. Zonat kodrinore rreth Tiranës kanë gjithashtu traditë ullirin dhe drurët frutorë.

Të territorin e Tiranës gjenden disa vendburime qymyrguri të pashfrytëzuara, ndërsa aktiviteti më i përhapur sa i përket shfrytëzimit të burimeve natyrore është përpunimi i gurit për ndërtim dhe atij dekorativ.

Sfidat e pushtetit vendor pas ndarjes së re

Bashkia e re e Tiranës konsiderohet më kompleksja për t'u administruar, pasi kryebashkiakut të ri do t'i duhet të adresojë shqetësimet e bashkësive shumë të ndryshme, të cilat jetojnë në mbi 135 vendbanime të njohura ligjërisht. Ai do të duhet të emërojë nën përgjegjësinë e vet politike 25 administratorë.

Komunat që rrethojnë Tiranën; Dajti, Farka, Vaqarri apo Kashari kanë dalë përtej klasifikimit “qendër e banuar rurale” për shkak të ndërtimeve të shumta. Urbanizimi i këtyre zonave dhe integrimi me planet rregulluese të Tiranës përbëjnë një sfidë të rëndësishme për kryebashkiakun e ri dhe të ardhmen e kryeqytetit.

Plotësimi i nevojave të zonave të reja urbane me infrastrukture kërkon investime të konsiderueshme dhe një strategji të qartë.

Një pjesë e fshatrave përreth Tiranës janë lidhur me infrastrukture rrugore me qytetin, ndërkohë që disa zona të thella kodrinore apo malore janë të distancuara për shkak të rrugëve të këqija. Ndërtimi i rrugëve drejt fshatrave të thellë si dhe mirëmbajtja e rrjetit rrugor ekzistues është një domosdoshmëri për zhvillimin e qëndrueshëm.

Sistemi i taksimit për bashkinë e re të Tiranës duhet të marrë parasysh disnivelel ekonomike mes qytetit dhe zonave rurale, ndërkohë që shërbimi i pastrimit duhet të shtrihet në të gjithë territorin.

Si një zonë thellësisht urbane, por me detyrimin për të ofruar shërbime në sasinë dhe cilësinë e duhur për të 135 fshatrat përbërëse të bashkisë së re, Tirana rrezikon që investimet t'i shpërndajë në përputhje me interesin politik. Kjo gjë rrezikon marginalizimin e mëtejshëm të zonave me densitet më të ulët të popullsisë.

Me zgjerimin e territorit dhe zhvendosjet e shumta nga qyteti në fshat dhe anasjelltas, përballë bashkisë së re të Tiranës shtrohet nevoja e gjetjes së zgjidhjeve të reja për transportin publik. Zhvillimi i një sistemi efikas për transportin publik që lidh Tiranën

me fshatrat do t'u shërbente si banorëve ruralë që vijnë në kryeqytet për të punuar, ashtu edhe atyre urbanë, të cilët kanë shfaqur prej vitesh tendencën e jetesës në periferi.

Avarësisht se Tirana është qendra më e amdhe ekonomike e vendit, ajo numëron një numër të lartë të papunësh. Programet e punësimit të promovuara deri më tani kanë ende për të provuar efikasitetin e tyre.

Krimi I rrugës, sidomos ai i moshave të reja (juvenile crime) është i përhapur dhe sa vjen e në rritje.

Kohezini social është i dobët. Dallgët e lëvizjeve migratore janë përlasuar vazhdimisht në Tiranë qysh pas viteve 90 dhe vijojnë akoma të jenë aktive

Dhuna në familje është një fenomen në rritje, për shkak të vështirësive social ekonomike që vijnë duke u bërë gjithmonë e më komplekse.

Sistemi akomodues për edikumin e fëmijeve është në presion të vazhdueshëm. Garantimi i të drejtave të tyre ka njohur progress, por akoma mbetet shumë për të bërë në kushtet e një ndrysimi dinamik të vazhdueshmë shoqëror.

Shmangia e krijimit të lagjeve ku dominon varfëria dhe segregimi është një sfidë që kërkon para së gjithash trajtimin e duhur të problemeve që kanë grupet vulnerabël të shoqërisë.

Komuniteti Rom dhe sfida e strehimit të përshtatshëm për të është njëproblem akut për bashkinë e re të Tiranës. Programet e shumta për promovimin e të drejtave të tyre duket se nuk kanë gjetur terrenin e duhur për të dhënë rezultate konkrete.

Zhvillimi i politikave të duhura dhe transparente të strehimit social në shërbim të familjeve në nevojë është e domosdoshme, pavarësisht menaxhimit efikas të stokut të banesave sociale të bashkisë së Tiranës, që vetëm së fundmi u aktivizua duku iu shpërndarë banorëve që ishin klasifikuar që më parë si të pastrehë.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Ne total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Tiranë për personelin e ndihmës ekonomike, kujdesit social dhe mbrojtjes së fëmijëve është “67”, (Shih Listen). Bashkia Tiranë rezulton të ketë numrin më të madh të pozicioneve në strukture që targetohen nga ky inventarizim krahasuar me çdo bashki tjetër. Në 11 ish-minibashkitë e kryeqytetit (pas ndarjes së re edhe ato quhen Njësi Administrative) rezultojnë **11** pozicione për administratorë socialë të cilët ushtrojnë funksione të dedikuara në kuadër të NJMF. Në total janë **18** administratorë të NJMF të cilët janë të integruar në strukturën e Bashkisë së madhe Tiranë, të cilët figurojnë edhe në listat integrale (kombëtare) që disponohen nga ASHMDF.

Sa i takon arsimimit të stafit, tabela më poshtë, nuk ka reflektuar të dhëna të detajuara. Arsyeja e mos-përfshirjes së të dhënave për bashkinë Tiranë (qendër + 11 ish-minibashkitë) lidhet me dinamikën e shpejta që u aktivizuan menjëherë pas përfundimit të zgjedhjeve të 21 Qershorit 2015, që përfshinë edhe sistemin e stafëve teksa ky inventarizim ishte në proces të sipër. Ky vlerësim limitohet vetëm në stafin e njësive administrative ish-komuna. Konkretisht, në 12 NJA rurale (ish-komunat) rezulton se, prej një totali prej 15 punonjësish të ndihmës ekonomike dhe përkrahjes sociale, 5 kanë statusin e nëpunësit civil, 5 janë në kontratë punë pa afat, 4 me afat, (për një nuk ka të dhëna). Rekomandohet rifreskimi i të dhënave për bashkinë e madhe Tiranë menjëherë pas përfundimit të procesit të miratimit të strukturës së detajuar për vitin ushtrimor 2016.

Bashkia Tirane								
Nr	Emri Mbiemri	Pozicioni i punes	Sektori	Data e fillimit	Lloji i kontrates se punes	Edukimi/ Kualifikimi	Ekperienca e punes ne njesi	Kategori te mbrojtura me ligj
Zyra për barazinë gjinore								
1		Përgjegjës zyre				III-b		
Zyra e mbrojtjes nga diskriminimi								
2		Përgjegjës zyre				III-b		
Drejtoria e kujdesit social								
3		Drejtor				II-b		
Sektori I standarteve arsimore dhe shëndetësore								
4		Përgjegjës sektori				III-a		
5		Specialist				III-b		
6		Specialist				IV-a		
Sektori I programeve sociale								
7		Përgjegjës sektori				III-a		
8		Specialist				III-b		
9		Specialist				IV-a		

10		Specialist				III-b		
11		Specialist				IV-a		
Drejtoria e Menaxhimit të Strehimit dhe Shërbimit Social								
12		Drejtori				II-b		
Sektori I Menaxhimit të Strehimit								
13		Përgjegjës sektori				III-a		
14		Specialist				III-b		
15		Specialist				IV-a		
Sektori I Shërbimit Social								
16		Përgjegjës sektori				III-a		
17		Specialist				III-b		
18		Specialist				IV-a		
njesia administrative 1, qender urbane (ish-minibashkite)								
Zyra e Ndhimes Ekonomike								
19		administrator Social						
20		administrator Social						
21		specialist I NJMF						
njesia administrative 2, qender urbane (ish-minibashkite)								
Zyra e Ndhimes Ekonomike								
22		administrator Social						
23		administrator Social						
24		specialist I NJMF						
njesia administrative 3, qender urbane (ish-minibashkite)								
Zyra e Ndhimes Ekonomike								
25		administrator Social						
26		administrator Social						
27		specialist I NJMF						
njesia administrative 4, qender urbane (ish-minibashkite)								
Zyra e Ndhimes Ekonomike								
28		administrator Social						
29		administrator Social						
30		specialist I NJMF						
njesia administrative 5, qender urbane (ish-minibashkite)								
Zyra e Ndhimes Ekonomike								
31		administrator Social						
32		administrator Social						
33		specialist I NJMF						

njesia administrative 6, qender urbane (ish-minibashkite)

Zyra e Ndhmes Ekonomike

34		administrator Social						
35		administrator Social						
36		specialist I NJMF						

njesia administrative 7, qender urbane (ish-minibashkite)

Zyra e Ndhmes Ekonomike

37		administrator Social						
38		administrator Social						
39		specialist I NJMF						

njesia administrative 8, qender urbane (ish-minibashkite)

Zyra e Ndhmes Ekonomike

40		administrator Social						
41		administrator Social						
42		specialist I NJMF						

njesia administrative 9, qender urbane (ish-minibashkite)

Zyra e Ndhmes Ekonomike

43		administrator Social						
44		administrator Social						
45		specialist I NJMF						

njesia administrative 10, qender urbane (ish-minibashkite)

Zyra e Ndhmes Ekonomike

46		administrator Social						
47		administrator Social						
48		specialist I NJMF						

njesia administrative 11, qender urbane (ish-minibashkite)

Zyra e Ndhmes Ekonomike

49		administrator Social						
50		administrator Social						
51		specialist I NJMF						

Njesia administrative Dajt

52		Spec. ndihmes dhe perkujd shoq		1993	nepunes civil	Diplo. Univer. Ekonomik	12 Vjet	
----	--	--------------------------------	--	------	---------------	-------------------------	---------	--

Njesia administrative Kashar

53		P/Z/Nd/Ekonomike		2008	Nenpunes Civil	Diplome Universiteti ne Drejtesi	7	
54		Specialist		2008	Nenpunes	Diplome Universiteti ne	7	

					Civil	Ekonomik		
55		Specialist		2015	Nenpunes Civil	Diplome Universiteti ne Drejtesi		
Njesia administrative Ndroq								
56		Administratore e Ndhimes Ekonomike	Ndihmë ekonomike	01.03.2012	Kontrate me afat	Diplomë Universiteti në Ekonomi, Marketing	5 vite e 6 muaj	
57		Specialiste e Nd.Ekonomike dhe Magaziniere	Ndihmë ekonomike	06.08.2014	Kontrate me afat	Diplomë Universiteti në Agronomi	5 vite e 2 muaj	
Njesia administrative Berzhite								
58		Inspektor Ndhimes ekonomike		09.01.2012	Kontrate me afat	Fakulteti I Bujqesis	3 vjet	
Njesia administrative Baldushk								
59		Adm/ND.Ekonomike	FINANCA	2004	kontrate	mesem teknike	12	
Njesia administrative Krrabe								
60		Administrator I sherbimit social		2011	Ska te dhena	Shkolle e mesme	4	
Njesia administrative Zall-Herr								
61		Specialiste e zyres se Ndhimes Ekonomike	Zyra e Ndhimes Ekonomike	2012	Kontrate Pune	Diplome Universitare ne Ekonomi	3 Vjet	
Njesia administrative Shengjergj								
62		Administrator nd. Ekonomike	Mbrojtje sociale	01.01.2011	Kontrate pa afat	Shkolla e mesme Bujqesore	4	
Njesia administrative Farke								
63		Administrator Shoqeror	Sektori ndihme Ekonomike	2002	Punonjes	Diplome Universiteti ne Ekonomik	13 vite	
Njesia administrative Vaqarr								
64		Specialiste zyre	sek.social	2005	Kontrate me afat	Diplome Universit.Buqësor Ekonomik	14 vjet	
Njesia administrative Peze								
65		Specialist	Sektori i Ndhimes Ekonomike	2006	Nepune Civil	Diplomë Universiteti në Inxhinieri Minerare	9 vjet	
Njesia administrative Zall-Bastar								
66		Shef Ndhim. Ekonomike	Sektori i finances	2011	Kontrtae pa afat	Diplome Universiteti ne Ekonomi Agrare	22 vjet	ska
67		Administrator Ndhim. Ekonomike	Sektori i finances	2011	Kontrate pa afat	Diplome Universiteti ne Histori-Gjeografi	8 vjet	ska

Bashkia Tiranë, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrativo-Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Tiranë	Qyteti Tiranë	Tiranë	Njësia bashkiake nr.1, Njësia bashkiake nr.2, Njësia bashkiake nr.3, Njësia bashkiake nr.4, Njësia bashkiake nr.5, Njësia bashkiake nr.6, Njësia bashkiake nr.7, Njësia bashkiake nr.8, Njësia bashkiake nr.9, Njësia bashkiake nr.10, Njësia bashkiake nr.11	557,422	757,361	1110.03
		Petrelë	Fshatrat; Petrelë, Mullet, Stërmas, Picall, Shënkoll, Gurrë e Madhe, Gurrë e Vogel, Daias, Barbas, Fikas, Mangull, Qeha, Shytaj, Hekal, Kryezi, Percëllesh, Durishtë			
		Farkë	Fshatrat; Farkë e Madhe, Farkë e Vogel, Lundër, Mjull Bathore, Sauk, Selitë			
		Dajt	Fshatrat; Linzë, Shishtufinë, Tujan, Brrar, Ferraj, Priskë e Madhe, Surrel, Lanabreges, Shkallë, Qafmollë, Darshen, Selbë, Murth			
		Zall-Bastar	Fshatrat; Zall-Bastar, Bastar i Mesem, Bastar – Murriz, Vilëz, Zall-Mner, Mner i Sipërm, Bulçesh, Zall Dajt, Besh, Dajt, Shëngjin i vogel, Selitë Mali			
		Bërzhitë	Fshatrat; Ibë, Bërzhitë, Dobresh, Ibë e Poshtme, Pëllumbas, Mihajas-Cirmë, Kus, Fravesh, Klllojkë, Pashkashesh, Lugë- Shalqizë, Rozaverë			
		Krrabë	Qyteti Krrabë, Fshatrat; Mushqeta, Skuterë			

		Baldushk	Fshatrat; Baldushk, Mumajes, Fushas, Balshaban, Shpatë, Isufmuçaj, Mustafakoçaj, Koçaj, Kakunj, Vesqi, Parret, Shënkoll, Vrap, Shpat i sipërm			
		Shëngjergj	Fshatrat; Shëngjergj, Verri, Urë, Burimas, Shëngjin, Façesh, Bizë, Fage, Parpujë, Vakumone, Domje, Derje			
		Vaqarr	Fshatrat; Vaqarr, Allgjatë, Arbanë, Bulticë, Damjan-Fortuzaj, Gropaj, Lalm, Prush, Vishaj, Sharrë			
		Kashar	Fshatrat; Kashar, Yzberish, Mëzez, Yrshek, Katundi i Ri, Kus, Mazrek			
		Pezë	Fshatrat; Pezë e Madhe, Pezë Helmës, Pezë e Vogel, Varosh, Maknor, Dorëz, Gror, Grecë, Pajanë, Gjysylkanë			
		Ndroq	Fshatrat; Ndroq, Zbarqe, Kërçukje, Zhurje, Lagje e re, Pinet, Sauqet, Çalabërzezë, Shesh, Grebllesh, Mënik			
		Zall-Herr	Fshatrat; Zall - Herr, Dritas, Çerkezë-Morinë, Qinam, Kallmet, Herraj, Pinar, Priskë e Vogël, Radhesh			

Bashkia e re Tropojë

Të dhëna të përgjithshme

Zona Gjeografike: Tropoja kufizohet në veri me Republikën e Kosovës dhe të Malit të Zi, në perëndim me Bashkinë Shkodër, në jug me bashkitë Vau i Dejës dhe Fushë-Arrëz dhe në jug-lindje me Bashkinë Has. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Bajram Currit.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia e re ka një popullsi prej 20,517 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki ka 28,216 banorë. Ajo shtrihet në një sipërfaqe prej 1057.3 km² me një densitet prej 26.68 banorë/km² sipas të dhënave të Regjistrimit Civil dhe 19.40 banorë/km² sipas Censurit.

Kjo bashki përbëhet nga 8 njësi administrative, të cilat janë: Bajram Curri, Fierza, Lekbibaj, Margegaj, Llugaj, Bujan, Bytyç dhe Tropojë. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Tropojës dhe qarkut të Kukësit. Bashkia e re ka nën administrimin e saj dy qytete (Bajram Curri dhe Fierza) dhe 68 fshatra (listën e plotë me poshte).

Profili i Bashkisë

Tropoja zotëron pasuri të shumta natyrore, por Tropoja është një zonë kryesisht bujqësore dhe blegtorale. Sektorët prioritarë me bazë zhvillimi për të ardhmen konsiderohen turizmi rural dhe malor. Ndër sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë konsiderohet industria nxjerrëse e minierave. Një rol të rëndësishëm luan sektori i blegtorisë, pasi zona ka shumëllojshmëri të kullotave natyrore. Hapësira e gjerë e kullotave alpine ofron një kapacitet të mjaftueshëm për zhvillimin bletarisë. Industria minerare është përqendruar në një numër të vogël kompanish, në krahasim me potencialin e madh mineral të Tropojës. Minerat kryesore që ndeshen në rrethin e Tropojës janë kromi (3 milion ton të pa shfrytëzuara), kuarci (300 mijë tonë të pa shfrytëzuar), boksitet (3 milion ton të pa shfrytëzuar), olivinitet (50 milion ton të pa shfrytëzuar).



Sfidat e pushteti vendor pas ndarjes së re

Mungesa e investimeve dhe e perspektivës së zhvillimit ka detyruar një pjesë të konsiderueshme të banorëve të kryejnë migrim të brendshëm dhe të jashtëm. Mesatarja e rënies së popullsisë në shkallë rrethi është 26.60 %.

Përmirësimi i infrastrukturës rrugore dhe nderlidhese me NJA është një sfidë për të levruar në kohë dhe me efikasitet shërbimet e bashkisë së re, ku përfshihet edhe ndihma ekonomike.

Periudha e dimrit izon një pjesë të fshatrave. Shkollimi i fëmijëve në keto kushte është një sfidë. Ndërkohë, zonave të thella malore u duhet ofruar shërbimi shëndetësor, pasi ato nuk mund të presin vetëm çfarë ofron spitali i qytetit apo ai i Gjakovës.

Migrimi i brendshëm në drejtim të Tiranës dhe Durrësit, vijon ende, por me ritme më të ulëta. Zona vuan de-popullimin dhe rigjenerimi i bazës së taksueshme për këto bashki mbetet një problem i rëndësishëm për gjenrimin e të ardhurave.

Lugina e Valbones ka marrë zhvillim vitet e fundit për shkak të infrastrukturës së përmirësuar, por ende informaliteti është shumë i lartë dhe të ardhurat nga taksimi janë pothuajse zero.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Ne total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Tropojë për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është “ 12 ”, (Shih Listën më poshtë). Raporti gjinor është 5 me 8 në favor të meshkujve. Sa i takon shkollimit, 9 punonjës janë me arsim të lartë (shumica universitar), 3 punonjës janë me arsim të mesëm.

Në varësi të politikave që do të ndjekë MMSR, sugjerohet që bashkia Tropoje të punojë më shumë për ngritjen e nivelit arsimor të stafit të targetuar përmes kualifikimit të posaçëm ose përmes rekrutimit të burimeve njerëzore me arsimin të përshtatshëm.

Janë vetëm 4 nga 12 punonjës në këtë sektor që gëzojnë statusin e nëpunësit civil; pjesa tjetër (8 punonjës) janë me “kontratë” .

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë së re Tropojë duhet të jenë 6 punonjës që ushtrojnë *njëkohësisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas percaktimeve të ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP konfirmoi nominalisht vetëm 4 prej tyre (*me ngyre portokalli*). Nuk konfirmohet emri (jo funksioni) i 2 punonjësi në NJA Margegaj dhe Bujan (me blu). Rekomandohet përcaktimi eksplicit i të paktën një pozicioni për NJMF në strukturën organizative të bashkisë së re Tropojë për vitin 2016.

Bashkia Tropoje								
Nr	Emër Mbiemër	Pozicioni i punës	Sektori	Data e fillimit	Lloji i Kontratës së punës	Edukimi/ Kualifikimi	Eksperienc a e punës në njësi	Kategori të mbrojtura me ligj
1		Ins baraz gjinore e dhunes ne familje	Nd. Ekonomike	02.05.2014	Nepunes Civil	Barcelor I drejtesise	11 muaj	
2		Pergjegjes Sektori	Nd. Ekonomike	10.04.2007	Nepunes Civil	Ekonomist I larte	9 vjet	
3		Administrator	Nd. Ekonomike	15.05.1998	Nepunes Civil	Ekonomist per Finance	23 vjet	Invalid Grupi .IV
4		Administrator	Nd. Ekonomike	18.03.2011	Nepunes Civil	Ekonomist I mesem	23 vjet	
Njesia administrative Lekbibaj								
5		P/Admin dhe nd ekon	Administrata	2011	Kontrate	E mesme	4 vjet	
Njesia administrative Margegaj								

6		Pergj.nd.ek	Nd. Ekonomike	2011	Kontrate	Diplome universitare Inxh.Pyjore	4 vjet	
Njesia administrative Tropoje								
7		Insp/Nd.Ekon	Nd. Ekonomike	1-Nov-03	Kontrate	I larte Drejtesi	12 vjet	
8		Prgj/Mbrojtjes Shoqerore	Nd. Ekonomike	7-Jan-95	Kontrate	I larte Sociologji	19 vite	
Njesia administrative Llugaj								
9		Ekonomiste Nd.Ekonomike	Nd. Ekonomike	01.01.2012	Kontrate	Agrobiznes	4 vjet.	
Njesia administrative Fierze								
10		Pergj.zyres Nd.Ekonomike	Nd. Ekonomike	2006	Kontrate	Arsim I Mesem	9 vjet	
Njesia administrative Bujan								
11		P.nd ekonomike	Nd. Ekonomike	06.12.2013	Kontrate	Ekonomik	1.5	
Njesia administrative Bytyç								
12		Ins.Nd.Ekonomike	Nd. Ekonomike	01.09.2012	Kontrate	I Mesem	20	

Bashkia Tropoje, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrativo-Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Kukës	Qyteti Tropoje	Bajram Curri	Qyteti Bajram Curri	20,517	28,216	1057.3
		Fierzë	Qyteti Fierzë, Fshatrat; Tpla, Dushaj i Poshtëm, Degë, Breg-Lum			
		Lekbibaj	Fshatrat; Brisë, Salce, Palç, Peraj, Gjonpepaj, Lekbibaj, Tetaj, Shëngjergj, Curraj i Poshtëm, Betoshe, Qerreç Mulaj, Curraj i Sipërm			
		Margegaj	Fshatrat; Margegaj, Fushë Lumi, Koçanaj, Shoshan, Lagja Paqës, Bradoshnicë, Dragobi, Çerem, Valbonë, Rragam			
		Llugaj	Fshatrat; Bukovë, Jaho Salihi, Llugaj, Luzhë, Rrez-Mali, Rragam			
		Bujan	Fshatrat; Bujan, Rosujë, Dojan, Markaj, Gri, Lekurtaj, Selimaj, Bllatë, Gri e Re			
		Bytyç	Fshatrat; Pac, Zherkë, Vlad, Çorraj-Veliç, Berishë, Visoçë, Mash, Zogaj, Prush, Kepenek, Kam, Leniq,			
		Tropojë	Fshatrat; Astë, Kojel, Viçidol, Kasaj, Gegaj, Buçaj, Papaj, Sopot, Babinë, Begaj, Shumice-Ahmetaj, Myhejan, Kovaç, Kërrnajë, Shkëlzen			

Bashkia Ura-Vajgurore

Të dhëna të përgjithshme

Zona Gjeografike: Ura Vajgurore kufizohet në veri- perëndim me bashkinë Lushnjë, në veri-lindje me bashkinë Kuçovë, në jug-lindje me bashkinë Berat dhe në jug-perëndim me bashkinë e Roskovecit. Kryeqendra e bashkisë është qyteti i Urës Vajgurore.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, kjo bashki numëron 27,295 banorë, ndërsa sipas Regjistrat Civil ajo numëron një popullsi prej 39,551 banorë. Me një sipërfaqe prej 156.56 km², ajo ka densitet prej 174 banorë/km² sipas censurit dhe densitet prej 226 banorë/km² sipas regjistrat civil.

Kjo bashki përbëhet nga 4 njësi administrative, të cilat janë: Ura-Vajgurore (qendra e Bashkisë) , Poshnje, Kutalli dhe Cukalat. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit Berat dhe pjesë e po këtij qarku. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 34 fshatra (listën e plotë me poshte).

Profili i bashkisë

Burimet kryesore të të ardhurave për banorët e kësaj zone bazohen te shfrytëzimi i resurseve natyrore, sidomos atyre të përpunimit të inerteve të gurit dhe të lumenjve, i fermave private, përpunimit agro-industrial, plantacioneve me ullinj, dru frutorë dhe vreshta, perimeve, blegtorisë, si dhe përpunimit të produkteve të qumështit dhe mishit.

Me ndarjen e re administrative kjo njësi vendore do të marrë një profil të rëndësishëm bujqësor, të orientuar sidomos në frutikulturë me prodhimin e ullirit, por nuk mbetet pas dhe blegtorisë, drithërat dhe perimet, si dhe shumë foragjere. Veçanërisht ish-komuna Kutalli është e njohur në rang kombëtar për kultivimin dhe hershmërinë e perimeve në serat pa ngrohje.. Janë ndërtuar shume sera dhe çdo vit prodhohen mbi 25 mijë ton perime, ku 80 për qind e tyre eksportohen.



Sfidat e pushteti vendor pas ndarjes së re

Qyteza e Ures Vajgurore ka nje numer te vogel banoresh komunitet te vogel rom. Pozicioni transitdrejt Berati dhe Kucoves nuk duket si ndihmon ne ekonomine e Bashkise. Në qytetin e Urës Vajgurore ndihme ekonomike eshte burimi I vetem I te ardhurave per nje pjese te familjeve. Ne territory e bashkise jeton edhe nje komunitet rom i cili jeton me pune artizanale.

Ndërkohë, rezervat shumë të mëdha të gurit të cilat shfrytëzohen nga qindra familje, një pjesë e të cilave janë jashtë sistemit ligjor ka krijuar shqetësime të mëdha për ndotjen si dhe për dëmtimin e pyjeve që gjenden mbi gurore. Shumë banorë ankohen për sëmundje në rrugët e frymëmarrjes, të cilat mund të përkeqësohen nga niveli i lartë i pluhurit nga shfrytëzimi i gurit.

Gjithashtu, bashkisë së re do i duhet të përballë me problemet e përmbytjeve duke qenë se edhe këtë dimër në zonën e Urës Vajgurore situata ka qenë shumë problematike dhe janë përmbytur rreth 100 familje, çka ka kërkuar ndërhyrjen e forcave të ushtrisë. Në zonat rurale ka nevojë për përmirësimin e godinave të shërbimit shëndetësor dhe arsimor, rrjetit të furnizimit me ujë të pijshëm, por dhe rritjen e transparencës në lidhje me qeverisjen në kuadër të përmirësimit të shërbimeve që i ofrohen qytetarëve.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Ne total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Ura Vajgurore për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është “4 ”, (Shih Listën më poshtë).Raporti gjinor është respektuar (2 nga punjëset janë femra dhe 2 punonjësit e tjere janë meshkuj.) Sa i takon shkollimit, të gjithë janë me arsim të lartë (shumica universitar). Të dy këta tregues e pozicionojmë mjaft mirë personelin bashkise së re Ura Vajgurore. 2 nga 4 punonjës në këtë sektor gëzojnë statusin e nëpunësit civil ndërsa 2 punonjësit e tjerë janë me “kontratë pune” me afat

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë së re Ura Vajgurore duhet të jenë 3 punonjës që ushtrojnë *njëkohësisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas percaktimeve të ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP konfirmoi nominalisht vetëm 1 prej tyre (*me ngyre portokalli*). Nuk konfirmohet emri (jo funksioni) i 2 punonjës të NJMF në Ura Vajgurore dhe Cukalat (me blu). Rekomandohet përcaktimi eksplicit i të paktën një pozicioni për NJMF në strukturën organizative të bashkisë së re Ura Vajgurore për vitin 2016.

Bashkia Ura Vajgurore								
N r	Emër Mbiemër	Pozicioni i punës	Sektori	Data e fillimit	Lloji i Kontratës së punës	Edukimi/ Kualifikimi	Eksperienc a e punës në njësi	Kategori të mbrojtura me ligj
1		Spec. Nd Ekon dhe Paaftesise	Nd Ekonomike	16.07.2002	Nëpunës Civil	Matematikë	13 vjet	
Njesia administrative Kutalli								
2		Pergjegjes Zyre	Nd. ekonomike	2014	Kontrat me afat	Diplome Univeristeti	1 vit	
Njesia administrative Cukalat								
3		Insp. Nd. Ekonomike	Nd. Ekonomike	16.11.2000	Kontrat me afat	Diplome Univeristeti ne Ekonomi	14 vjet	
Njesia administrative Poshnje								
4		Pergj zyres nd ekonomike	Nd ekonomike	2004	Nenpunes Civil	Diplome Universiteti ne Ekonomi	11 vjet	

Bashkia Ura Vajguore, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrativo-Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Berat	Qyteti Ura - Vajguore	Ura- Vajguore	Qyteti Ura Vajguore, Fshatrat; Bistrovicë, Konisbaltë, Pashalli, Vokopolë, Skrevan	27,295	39,551	156.56
		Poshnje	Fshatrat; Poshnje, Polizhan, Çiflik, Arrëz, Agim, Banaj, Gajdë, Malas Gropë, Syzez, Sheq Gajdë, Hingë, Kuç			
		Kutalli	Fshatrat; Kutalli, Sqepur, Drenovicë, Samaticë, Pobrat, Rërëz, Protoduar, Goriçan Qendër, Goriçan Çlirim, Malas Breg			
		Cukalat	Fshatrat; Donofrosë, Slanicë, Cukalat, Allambres, Krotinë, Çetë			

Bashkia e re Vau i Dejës

Të dhëna të përgjithshme

Zona Gjeografike: Bashkia Vau i Dejës kufizohet në veri dhe në perëndim me bashkinë e Shkodrës, në lindje me bashkinë Fushë Arrëz ndërsa në jug me bashkitë Pukë dhe Lezhë. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Vaut të Dejës.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011 ka një popullsi prej 30,438 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki numëron 48,966 banorë. Bashkia e re ka në një sipërfaqe prej 499.09 km² me një densitet prej 98.11 banorë/km².

Kjo bashki ka në perberje edhe 5 njësi administrative, Bushat, Vig-Mnele, Hajmel, Temal, Shllak. Të gjitha njësitë administrative janë pjesë e qarkut Shkodër. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 47 fshatra (listën e plotë me poshtë).

Profili i Bashkisë

Bashkia e Vaut të Dejës zgjerohet me 5 ish-komuna, të cilat merren kryesisht me bujqësi, ndërsa zona ka resurse të konsiderueshme ujore. Në të ndodhet hidrocentrali i Vaut të Dejës si dhe HEC-et Ashta 1 dhe Ashta 2, të ndërtuara me koncesion privat gjatë viteve të fundit.

Para viteve 90, shumica e banorëve në Vaun e Dejës punonin në hidrocentral, në fabrikën e bakrit si dhe në kooperativa bujqësore. Ndërkohë që zhvillimi ekonomik aktual mbështetet kryesisht në bizneset e vogla të shërbimit.

E veçantë për këtë bashki është ekzistenca e sipërfaqeve të konsiderueshme ujore, ku dominon liqeni i Hidrocentralit të Vaut të Dejës, lumi Drin që vazhdon në shtratin e tij të vjetër që nga pengesa e digës së Hidrocentralit si dhe lumi Gjadër që shkëputet nga lumi i parë, rreth 1 km në juglindje të qytetit të Vaut të Dejës. Pasuria e madhe ujore e bën gjithashtu zonën të prekur

nga përmbytjet. Evitimi i përmbytjeve mbetet një nga sfidat kryesore të kësaj bashkie, nëpërmjet investimeve në kanalet kulluese dhe vaditëse, por edhe ndërtimin e argjinaturave përgjatë brigjeve të lumenjve.



Sfidat e pushtetit vendor pas ndarjes së re

Niveli i papunësisë është i lartë, ndaj edhe një pjesë e madhe e popullsisë gjendet në emigrim, kryesisht në shtetet e Italisë dhe Greqisë. Ndiham ekonomike e bashkise eshte burim te ardhurash per nje pjese te familjeve.Integrimi, dhe ne disa rast pastrami I saj tashme edhe me nevojat ne pjesen e ish-komunave mbetet nje sfide.

Ofrimi i shërbimeve publike për dy komunat matanë liqenit të Vaut të Dejës konsiderohet gjithashtu sfidë për bashkisë së re, e cila duhet të sigurojë më së pari infrastrukturën rrugore për lidhjen e këtyre Njesive admisnitrative me qytetin.

Një tjetër problem i trashëguar që kërkon zgjidhje është edhe strehimi i dhjetëra familjeve në ish-kapanonet e degraduara të hidrocentralit të Vaut të Dejës.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Në total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Vau i Dejës.për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është “ 12”, (Shih Listën më poshtë).

Raporti gjinor është 5 ferma me 7 meshkuj. Sa i takon shkollimit, vetëm 3 punonjës janë me arsim të lartë (shumica universitar), 6 punonjës janë me asim të mesëm, për tre punonjës mungojnë të dhënat.

Janë vetëm 2 nga 12 punonjës në këtë sektor që gëzojnë statusin e nëpunësit civil; 1 punonjës janë me “kontratë pune” me afat , 3

punonjës janë me “kontratë pune” pa afat . Për 6 punonjës mungojnë të dhënat.

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë e re Vau i Dejës asnjë punonjës nuk ushtron *njëkohësisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas percaktimeve të ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP konfirmoi këtë të dhënë gjithashtu. Rekomandohet përcaktimi eksplicit i të paktën një pozicioni për NJMF në strukturën organizative të bashkisë së re Vau i Dejës për vitin 2016 dhe rekrutim stafi për këtë funksion.

Bashkia Vau i Dejës								
Nr	Emër Mbiemër	Pozicioni i punës	Sektori	Data e fillimit	Lloji i Kontratës së punës	Edukimi/ Kualifikimi	Eksperienca e punës në njësi	Kategori të mbrojtura me ligj
1		Pergjegjese Sektori	Sek. Ndhimes Ekonomike	01.04.2004	Nepunes civil	I Larte,Menaxhim Biznes	11	
2		Inspektor & Llogaritar	Sek. Ndhimes Ekonomike	02.12.1993	Nepunes civil	I Larte,Ekonomist agrar	21	
3		Inspektor Nivelit te Mesem	Sek. Ndhimes Ekonomike	16.03.2005	Kontrate pa afat	E mesme	10	
Njesia administrative Vig Mnele								
4		Pergjegj i nd ekonomike etj	Zyra e nd Ekonom	1998	Kontrate pa afat	I mesem gjeolog	17	
5		Inspektor I nd ekonomike etj	Zyra e nd Ekonom	2014	Kontrate pa afat	I mesem Petag gjuhe e huaj	2	
Njesia administrative Shllak								
6		Adm. Nd. Ekonomike	Zyra Nd. Ekonomike	1996	Kontrate me afat	Mesem Bujqesor	20	
Njesia administrative Temal								

7		Pergjegjes.Nd,Eko-Per-Sociale	Ndihma ekonomike	1/4/2014		Mesem	1	
8		Inspektor.Nd,Eko-Per-Sociale	Ndihma ekonomike	1/6/2007		Mesem	7	
Njesia administrative Hajmel								
9		Inspektor ndihma ekonomike	Ndihma ekonomike			I larte		
Njesia administrative Bushat								
10		Pergjegjese e Ndihmes Ekonomike	Ndihma ekonomike					
11		Inspektor I perkrahjes sociale	Ndihma ekonomike					
12		Punonjes Social ne Arsim						

Bashkia Vau-Dejës, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrativo-Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Shkodër	Qyteti Vau-Dejës	Vau-Dejës	Qytetet Vau Dejes, Fshatrat; Mjede, Spathare, Shelqet, Kaç, Naraç, Dush, Karmë, Gomsiqe	30,438	48,966	499.09
		Bushat	Fshatrat; Bushat, Shkjezë, Plezhë, Kosmaç, Stajkë, Ashtë, Rranxa, Fshat i Ri, Mali i Jushit, Plepan-Konaj, Melgush, Barbullush, Kukël, Hoten			
		Vig-Mnele	Fshatrat; Mnelë e Madhe, Mnelë e Vogël, Vig			
		Hajmel	Fshatrat; Hajmel, Dheu i Lehtë, Pistull, Paçram, Nënshatë			
		Temal	Fshatrat; Koman, Qerret, Arrë, Vilë, Telum, Kllogjen, Malagji-Kajvall, Toplanë, Sermë, Gushtë			
		Shllak	Fshatrat; Vukjakaj-Gegaj, Palaj-Gushaj, Benë, Kroni i Madh, Barcollë, Vukaj, Uk-Bibaj			

Bashkia e re Vlorë

Të dhëna të përgjithshme:

Zona Gjeografike: Bashkia e re e Vlorës kufizohet në veri me bashkinë Fier, në lindje me bashkinë Selenicë dhe në jug me bashkinë Himarë. Kryeqendra e bashkisë është qyteti i Vlorës.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011 bashkia e re ka 104.827 banorë. Gjithsesi, në regjistrin civil në këtë bashki rezultojnë si popullsi banuese 194.147 njerëz. Bashkia e re e Vlorës ka një sipërfaqe prej 616.85 km². Nëse merren parasysh të dhënat e censurit, densiteti i popullsisë në këtë bashki është 169.9 banorë për km² ndërsa sipas të dhënave të regjistrit civil, densiteti është 314.73 banorë për km².

Bashkia e re Vlore ka edhe 4 njësi administrative të tjera në perberje të saj: Orikum, Qendër Vlorë, Novoselë dhe Shushicë. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Vlorës dhe qarkut të Vlorës. Bashkia e re ka nën administrimin e saj dy qytete (Vlorë dhe Orikum) dhe 37 fshatra. Në listën e fshatrave përfshihet edhe Sazani.

Profili i bashkisë

Bashkia e re e Vlorës do të përfshijë të gjithë zonën bregdetare nga Lumi i Vjosës në veri deri në Qafën e Llogarasë në jug, duke përfshirë nominalisht gadishullin e Karaburinit dhe Ishullin e Sazanit.

Qyteti ka nevojë për një plan urbanistik gjithëpërfshirës për të gjithë vijën bregdetare në mënyrë që të shmangë ndërtimet pa plan, të cilat e bëjnë shtrirjen e shërbimeve më të vështirë.

Furnizimi me ujë dhe ndërtimet e shumta me gropa septike, sidomos përrreth ujësjellësit në Ujin e Ftohtë, janë problematike për zonën.

Qyteti i Vlorës ka një aktivitet të vogël tregtar përmes Portit të Vlorës, i cili përpunoi 64 mijë tonë mallra gjatë vitit 2013, rreth 1.6 për qind të volumit të mallrave të përpunuara nëpër portet

shqiptare. Vlora ka si burim kryesor ekonomik, ndërtimin, turizmin dhe bujqësinë e përqendruar te blegtoria dhe ullinjë. Vlora është edhe një qendër e rëndësishme e peshkimit.



Sfidat e pushtetit vendor pas ndarjes së re

Zona ka praninë e minorancave etnike, përkatësisht minorancës Greke në zonën e Nartës dhe asaj rome në Novoselë.

Tendencat demografike kanë qenë ato të një qyteti që ka pësuar si emigrimin edhe migrimin nga zonat rurale në atë urbane. Fshatrat e thella kanë lëvizur drejt Vlorës. Emigrimi i popullsisë dallohet edhe nga diferenca e theksuar mes numrit të popullsisë të regjistruar në gjendjen civile dhe numrit të nxjerrë nga Censuri 2011.

Ndihma ekonomike është edhe këtu një burim i ardhurash për familjet në nevojë. Bashkia dhe ish komunat kanë mundur të gjenojnë të ardhura të konsiderueshme përmes industrisë së ndërtimit, e cila dy vitet e fundit ka stopuar thuajse tërësisht. Zonat rurale të komunave Qendër, Novoselë dhe Shushicë, si dhe zonat rurale që deri tani kanë qenë pjesë e Bashkisë Orikum kanë nevojë për të zhvilluar potencialin e tyre të lartë bujqësor e blegtoral, si dhe mirëmenaxhimin e infrastrukturës bujqësore.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Ne total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Vlorë për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është “16”, (Shih Listën më poshtë). Raporti gjinor është 11 femra me 5 meshkuj, Sa i takon shkollimit, 13 punonjës (81% e punonjësve) janë me arsim të lartë (shumica universitar) ndërsa 3 punonjës janë me arsim të mesëm. Te dy keta tregues e pozicionojme mire personelin bashkise se re Vlorë. Janë vetëm 3 nga 16 punonjës në këtë sektor gëzon statusin e nëpunësit civil; 3 punonjës janë me “kontratë pune” për punonjësit e mbetur të dhënat janë për konsolidim.

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë së re Vlorë duhet të jenë 5 punonjës që ushtrojnë *njëkohësisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas percaktimeve të ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP konfirmoi nominalisht vetëm 4 prej tyre (*me ngyre portokalli*). Nuk konfirmohet emri (jo funksioni) i 1 punonjësi të NJMF në NJA Shushicë (me blu). Ka edhe përcaktim eksplicit i të paktën një pozicioni për NJMF në strukturën organizative të bashkisë Vlorë (qendër) dhe NJA Novoselë dhe Qendrër për vitin 2015 (me jeshile në tabelë).

Bashkia Vlore								
Nr	Emër Mbiemër	Pozicioni i punës	Sektori	Data e fillimit	Lloji i Kontratës së punës	Edukimi/ Kualifikimi	Eksperienca e punës në njësi	Kategori të mbrojtura me ligj
<i>Drejtoria e Ndhmës dhe Shërbimit Social</i>								
1		Drejt. E Nd. Dhe sherb soc	Drejt. E Nd. Dhe sherb soc	07.09.1999		Diplomë Universiteti për Merceologji	16 vjet (1999-2015)	
2		Insp. i Nd. Social (financë/statistikës)	Drejt. E Nd. Dhe sherb soc	01.06.1993	Po (1999)	Diplomë Universiteti për Ekonomik	22 vjet (1993-2015)	
3		Sp. i niv. të lartë (për dhunën në familje)	Drejt. E Nd. Dhe sherb soc	02.11.2009	Po nr.51 02.11.99	Diplomë Universiteti për Gjuhë të Huaj	6 vjet (2009-2015)	
4		Sp. i nivelit të lartë (për Mb. e fëmijëve)	Drejt. E Nd. Dhe sherb soc	25.01.2010	Po nr.07 25.01.10	Diplomë Universiteti për Psikologji	5 vjet (2010-2015)	
5		Specialist i nivelit të mesëm (A.shoqëror)	Drejt. E Nd. Dhe sherb soc	28.02.2007		Diplomë Universiteti për Cikël të Ulët	8 vjet (2007-2015)	
6		Specialist i nivelit të mesëm (A.shoqëror)	Drejt. E Nd. Dhe sherb soc	01.05.1998	Po 1999	Diplomë Universiteti për Merceologji	17 vjet (1998-2015)	

7		Specialist i nivelit të mesëm (A.shoqëror)	Drejt. E Nd. Dhe sherb soc	14.07.1997	Po 1999	Diplomë Universiteti për Ekonomik	18 vjet (1997-2015)	
8		Specialist i nivelit të mesëm (A.shoqëror)	Drejt. E Nd. Dhe sherb soc	18.05.2009	po nr24 dt18.05.09	Diplomë Universiteti për Parashkollor		
9		Specialist i nivelit të mesëm (A.shoqëror)	Drejt. E Nd. Dhe sherb soc	02.04.2008		Diplomë Universiteti për Manaxhim Biznesi	7 vjet (2008-2015)	
10		Specialist i nivelit të mesëm (A.shoqëror)	Drejt. E Nd. Dhe sherb soc	1998		Shkollë e Mesme e Përgjithshme	17 vjet (1998-2015)	
Njesia administrative Orikum								
11		insp.soc.dhe statist	Financa dhe nd ekon	01.02.2011	kod pune	administrim biznes	4 vjet (2011-2015)	
Njesia administrative Shushice								
12		Administrator i Nd.Ekonomike	Financa	18.07.2011	Kod. Pune	Shkollë e mesme për Mekanik	4 vjet (2011-2015)	Komuniteti Egjyptian
Njesia administrative Qender								
13		P.Sociale/ magaziniere	Financa	01.05.2008	Kod. Pune	Shkollë e mesme për Ekonomik	7 vjet (2008-2015)	
14		Nj.Mb.Femijëve /Përgj.Arsimi	Nd. Ekonomike	01.08.2008	Nëpunës civil	Diplomë Universiteti në Mësuesi	7 vjet (2008-2015)	
Njesia administrative Novosele								
15		Përgjegjës i Zyrës	Nd. Ekonomike	05.08.1993	Nëpunës civil	Diplomë Universiteti në ekonomi kontabel	11 vjet (1993-2007) (2011-2015)	
16		Specialist i Mb.Fëmijëve	Nd. Ekonomike	09.03.2011	Nëpunës civil	Diplomë Universiteti në Cikli i Ulët	4 vjet (2011-2015)	

Bashkia Vlorë, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrativo-Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Vlorë	Qyteti Vlorë	Vlorë	Qyteti Vlorë	104,827	194,147	616.85
		Orikum	Qyteti Orikum, Fshatrat; Dukat, Dukat Fshat, Tragjas, Radhimë			
		Qendër Vlorë	Fshatrat; Bestrovë, Babicë e Madhe, Babicë e Vogël, Hoshtimë, Kaninë, Kërkovë, Nartë, Sherishtë, Panaja, Xhyherinë, Zvërnec, Sazan			
		Novoselë	Fshatrat; Novoselë, Aliban, Bishan, Mifol, Poro, Dëllenjë, Delisuf, Trevllazër, Cerkovinë, Skrofotinë, Fitore, Akërn			
		Shushicë	Fshatrat; Shushicë, Bunavi, Beshisht, Grabian, Drithas, Mekat, Llakatund, Çeprat, Risili			

Bashkia e re Vorë

Të dhëna të përgjithshme

Zona Gjeografike: Bashkia e re e Vorës shtrihet në Shqipërinë qendrore dhe kufizohet në veri me bashkinë Krujë, në lindje me bashkinë Kamëz, në jug me bashkinë Tiranë, në jug-perëndim me bashkinë Shijak dhe në lindje me bashkinë Durrës.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, në territorin e bashkisë së re Vorë ka 25,511 banorë ndërsa sipas Regjistrit Civil ka 36,230 banorë. Me një sipërfaqe prej 82.72 kilometrash katrore, densiteti i popullsisë sipas të dhënave të censurit është 308 banorë km² ndërsa sipas Regjistrit Civil, densiteti është 438 banorë km².

Bashkia e re Vorë ka ne përbërjen e saj edhe njësitë administrative Prezë dhe Bërxullë. Në këtë bashki ka një qytet 18 fshatra. Të gjitha janë njësi përbërëse të rrethit Tiranë, qarku Tiranë.

Profili i Bashkisë

Bashkia e re e Vorës shtrihet në kryqëzimin kryesor rrugor të Shqipërisë ku lidhet Tirana me Durrësin dhe veriu me jugun e vendit. Për rrjedhojë, në territorin e kësaj bashkie janë vendosur një pjesë e rëndësishme e industrisë së lehtë dhe të ndërtimit ndërsa bujqësia është përqendruar në disa produkte me vlerë të lartë të shtuar si lulet. Në Bashkinë e Vorës janë të regjistruara mbi 800 biznese të mëdha.

Në ish-komunën Prezë gjendet një kala mesjetare e cila përbën në resurs të vogël turistik.

Vora dhe 2 njësitë e tjera përbërëse kanë parë rritje të shpejtë të popullsisë përgjatë 25 viteve të fundit, gjë që ka sjellë edhe një numër të konsiderueshëm ndërtimesh jashtë planeve urbanistike dhe pa infrastrukturë.



Sfidat e pushtetit vendor pas ndarjes së re

Vora është një bashki e cila mund të gjenerojë të ardhura të mira nga bizneset e shumta që janë zhvilluar në territorin e saj, duke i dhënë një mbështetje të plotë skemës së ndihmës ekonomike për familjet në nevojë. Punësimi mbetet një problem gjithsesi, sidomos për popullatën në zonat me periferike. Puna tek fëmijët mbetet një problem, edhe pse latent (tragjedia në Gërdec në vitin 2008 e ekspozoi për herë të parë këtë problem në Vorë).

Rritja e konsiderueshme e popullsisë së zonës gjatë 25 viteve të fundit nuk është shoqëruar me investimet e nevojshme në infrastrukturë për t'i shërbyer popullsisë ndërkohë që ndërtimet e shumta pa kriter e kanë vështirësuar më tej ndërtimin e infrastrukturës.

Për rrjedhojë, mirëmenaxhimi i burimeve ekonomike aktuale dhe ndërtimi i infrastrukturës, përfshirë furnizimin me ujë dhe kanalizime janë sfidat kryesore.

Inventarizimi i personelit te Ndhmës Soc-Eko dhe NJMF

Ne total, numri i pozicioneve në strukturën e bashkisë së re Vorë.për personelin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesit social është “3”, (Shih Listën më poshtë).

Raporti gjinor është 3 me 0 në favor të femrave.

Sa i takon shkollimit, të dyja janë me arsim të lartë (shumica universitar). Të dy këta tregues e pozicionojnë mjaft mirë personelin e bashkisë së re Vorë.

Asnjë nga punonjëset në këtë sektor nuk gëzojnë statusin e nëpunësit civil; njëra është me “kontratë pune” pa afat ndërsa për punonjësen tjetër mungojnë të dhënat.

Të dhënat e ASHMDF sugjerojnë se në strukturën e bashkisë së re Vorë duhet të jetë 1 punonjës që ushtronë *njëkohësisht* dhe/ose *posaçërisht* funksione në kuadër të NJMF (sipas percaktimeve të ligjit 10347/2010). Vlerësimi i INFOÇIP e konfirmoi edhe nominalisht këtë punonjës që ushtron *njëkohësisht* funksione në kuadër të NJMF (*me ngyre portokalli*). Rekomandohet përcaktimi eksplicit i të paktën një pozicioni për NJMF në strukturën organizative të bashkisë së re Vorë për vitin 2016.

Bashkia Vore								
Nr	Emër Mbiemër	Pozicioni i punës	Sektori	Data e fillimit	Lloji i Kontratës së punës	Edukimi/ Kualifikimi	Eksperienca e punës në njësi	Kategori e mbrojtur
1								
Njesia administrative Berxulle								
2			Ndihmes Ekonomike	15.03.2008	kontrate pa afat	Kimi industriale	7 vjet	jo
Njesia administrative Breze								
3		Pergj.zyre	social	2012		Diplome Universiteti Bujqesor	3	

Bashkia Vorë, qytetet dhe fshatrat sipas ndarjes së re Administrativo-Territoriale

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrativ e përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Tiranë	Qyteti Vorë	Vorë	Qyteti Vorë, Fshatrat; Vorë, Marqinet, Shargë, Gerdec, Gjokaj, Kuc, Marikaj, Picar	25,511	36,230	82.72
		Prezë	Fshatrat; Prezë, Ahmetaq, Palaq, Fushë Prezë, Gjeç-Kodër, Ndërmjetës, Breg - Shkozë			
		Bërxullë	Fshatrat; Bërxullë, Mukaj, Domje			